



TAKVIM
1440 - 1441
KALENDAR
2019

50

Prishtinë

TAKVIM
1440-1441

KALENDAR
2019

Boton:

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" (Ish-Vellusha) nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-001

www.bislame.net

e-mail: takvimi@hotmail.com

Për botuesin:

Myftiu, Naim ef. Tërnavë

Kryeredaktor:

Resul Rexhepi -

email: resulr@hotmail.com

Hajrullah Hoxha - *sekretar i redaksisë*

Redaktor teknik &

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

"Iliri" - Prishtinë

© Copyright:

Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.

Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

**TAKVIM
1440-1441
KALENDAR
2019**

Prishtinë



Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

NË VEND TË PARATHËNIES

"Takvimi" - tribunë e vërtetë e përhapjes së mësimave islame në gjuhën shqipe

Falënderimi dhe lavdërimi I takon vetëm Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm nga Ai ndihmë dhe mbrojtje kërkojmë.

Përshëndetjet dhe salavatet ia dërgojmë më të zgjedhurit të Allahut-Muhamed–Mustafasë, vulës së pejgamberisë, familjes së tij të ndershme, shokëve të tij besnikë dhe gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit!

Lexues të nderuar!

Sikurse e keni vërejtur, me të marrë në dorë këtë botim të ri të *"Takvim"*-it, ky është numër jubilar i tij; është numri pesëdhjetë i *"Takvim"*-it, me të cilin po mbyllet gjysmë shekulli i daljes së tij dhe po hyhet në dekadën e gjashtë me synimin, me Emër të Zotit, për të përmbyllur një shekull, dhe jo vetëm kaq.

Është thënë edhe në një jubile tjetër të *"Takvim"*-it, dhe ne e konstatojmë përsëri se nga revistat islame në gjuhën shqipe, që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen dhe

vetëdijesimin e besimtarëve islamë në Kosovë, që ka rëndësi në dhe simbolikën e vet, është, pa dyshim revista, "*Takvim*"-it, numri i parë i së cilës qe botuar më 1970, në fillim me qëllim për të llogaritur kohët e namazit dhe festat fetare, e më vonë i pasuruar edhe me shkrime e vështirime të ndryshme nga fushat e islamologjisë dhe të tjera, dhe me qëllim që besimtarët islamë të kishin një revistë islame në gjuhën shqipe.

Është e madhe, prandaj, rëndësia kulturore-arsimore, dhe sidomos ajo fetare, e kësaj reviste, natyrisht në qoftë se ajo vështrohet në kontekst të rrethanave të kohës, kur, krahas mbarëvajtjes së institucioneve të tjera islame, qe marrë vendimi për botimin e kësaj reviste, e cila asokohe kishte mbushur sa do pak një boshllëk të shkrimeve në gjuhën shqipe.

Revista "*Takvim*"-i, që nga ajo kohë e deri më sot, jo vetëm që ishte një kronikë e vërtetë e ngritjes së nivelit kulturor-arsimor të besimtarëve, por ishte edhe një tribunë e vërtetë e përhapjes së mësimave islame në përgjithësi.

Nuk është tepër të konstatojmë se revista "*Takvim*"-i paraqet një histori të gjallë të islamologjisë në këtë gjysmëshekulli. Asnjë studiues që merret sidomos me fushat e islamologjisë, nuk mund të shpresojë se do të mund të shkruaj për islamologjinë dhe trashëgiminë tonë islame pa shfletuar me kujdes shkencor faqet e të gjithë numrave të "*Takvim*"-it.

Gjatë gjithë kësaj kohe, - që nga numri i parë e deri në numrin e pesëdhjetë, "*Takvim*"-i shërbeu si nxitëse e frymëzuese dhe tribunë e fjalës me peshë në këtë fushë. Në faqet e saj vend meritore kanë zënë dhe në to janë trajtuar aktualitetet fetare, për të cilat populli kishte nevojë për t'i drejtudhëzuar, sikundër edhe tema të ndryshme në fushën e tefsirit, fikhut,

hadithit, akaidit, etikës, trashëgimisë, historisë islame e shumë të tjera.

Në faqet e "*Takvim*"-it kanë gjetur vend dhe hapësirë shumë autorë që nga ata të brezit më të vjetër e deri tek ata më të rinjtë, dhe kjo tregon se ai ka qenë i hapur për të gjithë ata që kanë dëshiruar të japin kontributet e tyre dhe të pasuronin dijen në këto fusha. Në këtë drejtim, "*Takvim*"-i ka luajtur edhe një rol tjetër; ai ka shërbyer si urëlidhëse midisi brezash të autorëve, të nxënësve me mësuesit e tyre. Dhe jo vetëm kaq, por në çdo numër të "*Takvim*"-it, sidomos vitet e fundit, botohen shkrime në fushë të kulturës dhe trashëgimisë sonë islame. Në mënyrë sistematike në revistë janë botuar edhe shkrime të autorëve të shquar nga Bota Islame, qofshin arabë, turq, boshnjakë ose të tjerë.

Edhe në këtë numër jubilar të "*Takvim*"-it, është respektuar kjo traditë dhe në faqet e tij kanë zënë vend shkrime nga tefsiri, nga jurisprudenca islame, nga akaidi, nga hadithi, nga etika islame, nga trashëgimia jonë e pasur, nga historia e arsimit, shkrime përkujtimore të personaliteteve etj.

Sido që të jetë, pesëdhjetë numra të "*Takvim*"-it, themi, janë të mjaftueshëm për të bërë një rekapitullim të gjithë asaj që është shkruar e botuar aty, gjithnjë duke pasur parasysh faktin se me "*Takvim*"-in vihen themelet e periodikut dhe publicistikës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, e cila do të zhvillohet, do të rritet e kultivohet në vitet në vazhdim.

Duke shënuar këtë jubile të "*Takvim*"-it, ne shënojmë përvjetorin e një reviste tradicionale, e cila tashmë ka depërtuar dhe gjendet në shumë familje shqiptare, jo vetëm në Kosovë, po edhe jashtë saj dhe në Diasporë.

Prandaj, duke pasur parasysh këto, mendojmë dhe na mbanë shpresa se, botuesi - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, do ta vlerësoj si të nevojshme të organizoj një tryezë a konferencë shkencore të veçantë me temë bosht fillet, zhvillimin, sukseset dhe perspektivën e "*Takvim*"-it dhe në të cilën nga studiues kompetentë, do të vihet në dukje roli dhe rëndësia e "*Takvim*"-it përgjatë këtyre pesë dekadave.

Sigurisht dhe pa asnjë dyshim, dalja dhe botimi i "*Takvim*"-it ndër këto vite është meritë e botuesit, e themeluesve, e drejtuesve dhe sidomos e bashkëpunëtorëve dhe e lexuesve besnikë të tij. Pa kontributet e tyre, "*Takvim*"-i nuk do ishte ky që është dhe, mbase, nuk do kishte përmbajtjen që e shquan një pasuri dhe laryshi temash. Prandaj, që të gjithë këta, pa përjashtim, meritojnë një mirënjohje shumë të veçantë nga ne dhe pikërisht këta janë garancia më e fortë se "*Takvim*"-i do të vazhdoj rrugëtimin dhe sukseset e tij edhe për shumë vjet e dekada.

Një falënderim të veçantë e ndjejë për të gjithë bashkëpunëtorët dhe për të gjithë ata që na ndihmuan me kontributet dhe punën e tyre nga viti 2002 e deri në këtë numër (2019), nga kur e morëm dhe e drejtuam "*Takvim*"-it.

Ndërsa po bëheshin përgatitjet e fundit për këtë numër jubilar të "*Takvim*"-it, po bëheshin edhe përgatitjet që, në kuadër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, të mbaheshin edhe zgjedhjet për titullarët më të lartë të Bashkësisë Islame të Kosovës. Falë ndihmës së Allahut të Gjithëpu-

shtetshëm, zgjedhjet u zhvilluan dhe u përmbyllën në mënyrën më të mirë të mundshme, duke i respektuar Kushtetutën e BI-së dhe aktet tjera normative. Dhe kështu, nga ky proces zgjedhor, dolën forumet dhe udhëheqësit e Bashkësisë Islame të Kosovës për periudhën 2018-2023, me një fjalë u zgjodhën Myftiu, anëtarët e Kryesisë, kryetari dhe nënkryetari i Kuvendit dhe komisionet e tij. Ndërkaq, neve nuk na mbetet tjetër, përveç se t'ju urojmë suksese në punën e tyre të mëtejme, suksese në atë që kënaqët Krijuesi, i dërguari i Tij dhe besimtarët.

Edhe në numrat e mëparshëm e kemi thënë se “*Takvim*”- i përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., në origjinal dhe të përkthyer, prandaj luten lexuesit e nderuar të jenë të kujdesshëm gjatë përdorimit të tij.

Dhe në fund fare, pa harruar asnjëherë, lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm të na ndihmojë që amanetin ta kryejmë me përgjegjësi, të na i falë gabimet dhe të na ketë nën mbrojtjen e Tij të vazhdueshme.

والحمد لله الذي بنعمته تتم الصالحات

Vel hamdulil-lahi l-ledhi bini'metih tetimus-salihat!

Resul Rexhepi

Sabri BAJGORA

KOMENTIMI I KAPTINËS “EL-KARIATU”

الْقَارِعَةُ ﴿١﴾ مَا الْقَارِعَةُ ﴿٢﴾ وَمَا أَذْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ ﴿٣﴾
يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ ﴿٤﴾ وَتَكُونُ الْجِبَالُ
كَالْعِهْنِ الْمَنْفُوشِ ﴿٥﴾ فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ ﴿٦﴾ فَهُوَ فِي
عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ ﴿٧﴾ وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ﴿٨﴾ فَأُمُّهُ
هَاطِيَةٌ ﴿٩﴾ وَمَا أَذْرَاكَ مَا هِيَّةٌ ﴿١٠﴾ نَارٌ حَامِيَةٌ ﴿١١﴾

“Krisma (e Kiametit). Ç’është Krisma? E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Krisma?

Atë ditë kur njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara, dhe kodrat të bëhen si leshi i shprishur. E sa i përket atij që i rëndohet peshoja (e veprave të tij), ai është në një jetë të kënaqshme. Ndërsa, ai që ka peshojën e lehtë (të veprave të tij), vendi i tij do të jetë në ‘Havije’. E ç’është ajo që të njoftoi se ç’është ai (Havije)? Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë.” - (El-Kariatu, 1-11)

Kaptina “El-Kariatu” është kaptinë mekase. Transmeton Ibn Merduvije nga Ibn Abasi se kjo kaptinë (El-Kariatu) ka zbritur në Mekë.¹ Ka gjithsej 11 ajete, 36 fjalë e 150 shkronja.² Ka zbritur pas sures “Kur-rejsh” dhe para sures “El-Kijame”. Në radhitjen e Mus’hafit mban numrin 101, kurse në radhitjen e zbritjes është e 30-ta.³

Emërtimi i kësaj kaptine

Emërtimi i vetëm i kësaj kaptine, me të cilin është radhitur nëpër Mus’hafa dhe nëpër librat e Tefsirit, është **“El-Kariatu”**. Arsyeja e këtij emërtimi është fakti se kjo fjali është përmendur tri herë radhazi në fillim të kësaj sureje, në ajetet (1-3): **“Krisma, Ç’është Krisma? E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Krisma?”**

Fjala *“El-Kariatu”* është një prej emërtimeve të Ditës së Kiametit, dhe nënkupton pëlcitjen dhe tronditjen e zemrave⁴.

Vlera e kësaj kaptine

- Surja *“El-Kariatu”* bën pjesë në grupin e sureve *“El-Mufassal”*, me të cilat Resulullahu s.a.v.s. është nderuar ndaj të dërguarve të tjerë. Në lidhje me këtë është transmetuar nga

¹ Imam Shevkaniu, *Fet’hul Kadiir*, vëll.V, f. 488.

² Fejruzabadi, *Besairu dhevi-t-temjiz*, vëll. I, f. 539.

³ Ibn Ashur, *Et-Tahriru ve-t-Tenviru*, vëll XXX f. 509

⁴ Dr. Munire ed-Devserij, *Esmau suveri-l Kurani-l Kerim*, f. 227.

Vathilete ibnul Eska'ë el-Lejthi të ketë thënë” Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: *“Më është dhënë në vend të Tev-ratit, shtatëshja, (suret prej El-Bekare deri te ato El-Enfal ose Et-Tevbe), më janë dhënë në vend të Zeburit, “El-Meine”-njëqindëshet (suret që kanë mbi 100 ajete), më është dhënë në vend të Inxhilit “El-Methani”, ndërsa jam nderuar (ndaj të dërguarve të tjerë) me suret “El-Mufassal” (prej sures Kaf, e është thënë prej asaj El-Huxhurat, e deri te En-Nas).⁵*

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake “El-Adijat”

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake “El-Adijat”, është mjaft indikative, sepse në ajetet e fundit të saj (9-11): ***“A nuk e di ai se kur të nxirret çka është në varreza? Dhe të tubohet (të dalë në shesh) ajo që ishte në gjokse. E atë ditë, pa dyshim Zoti i tyre është i njohur për punën e tyre.”***, përshkruhen momentet e fillimit të ringjalljes dhe daljes para Allahut të Madhërishëm, ndërkohë që tash në këtë sure “El-Kariatu” vazhdohet me përshkrimin e mëtutjeshëm të kësaj dite, duke folur për mundimet dhe tmerrin e saj, ditën kur njerëzit do të jenë të shkapërderdhur si flutura, kur kodrat do të lëvizin fluturojnë sa andej e sa këndeje dhe kur në ankth pritet llogaria dhe marrja e librave etj.

⁵ Transmeton Imam Ahmedi (4/107); Bejhekiu në *Shuabi-l Iman* (2/465).

Koment

﴿١﴾ مَا الْقَارِعَةُ ﴿٢﴾ وَمَا أَذْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ ﴿٣﴾

1. **Krisma** (e Kiametit).

2. **Ç'është Krisma?**

3. **E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Krisma?**

Fjala “*El-Kariatu*” ashtu siç theksuam më parë, sipas mendimit unanimit të dijetarëve, është një emërtim i Ditës së Kiametit dhe nënkupton një krismë të tmerrshme nga e cila çahen e copëtohen zemrat e njerëzve si pasojë e trishtimit dhe frikës që do ta përjetojnë. Ka edhe prej të tillëve që anojnë nga mendimi se fjala ‘*El-Kariatu*’ nënkupton fryrjen e parë në Sur, kur do të vdesin të gjitha krijesat, megjithatë, mendimi i parë është më i pranueshmi dhe më i sakti.

Ndërsa kjo fjalë në aspektin gjuhësor nënkupton krismën, trokitjen apo goditjen e fortë, sepse kjo krismë i shurdhon veshët, i çan zemrat dhe e dërmon trupin nga tmerri.⁶

Se ky moment është i lemerishëm flasin edhe shumë ajete kuranore su f.v.:

“O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe! Ditën, që do të shihni (përjetoni) atë, çdo grua me fëmijë në gji, do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë (para kohe) barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.” - (El-Haxh, 1-2)

⁶ *Ishrakat kuranije*, vëll. II, f. 208.

Fjala “*El-Kariatu*” është përmendur edhe në dy sure të tjera në Kuran: në *Er-Rra’d*, 31: “**Kurse, jobesimtarët (e Mekës), për atë që kanë bërë, vazhdon t’i godasë shkatërrimi...**” dhe në *El-Hakah*, 4: “**Themudi dhe Adi përgënjeshtroan Krismen e tmerrshme (Kiametin)**”. Ajeti në suren ‘*Er-Rra’d*’ nënkupton fatkeqësinë, kurse i sures ‘*El-Haka*’, nënkupton Krismen lemeritëse të Kiametit.

Përsëritja e këtij emërtimi tri herë radhazi në këtë sure, duke filluar së pari me “**Krisma (e Kiametit)**” dëfton për madhësitë e këtij momenti tmerrues, për të cilin jobesimtarët nuk çajnë fare kokën. Allahu sikur ka dashur t’ua tërheq vërejtjen atyre që të mos jetojnë të shkujdesur nga ky çast, i cili vjen në befasi, sepse ardhja e të Dërguarit të fundit Muhamedit a.s., në një mënyrë, është shenja më e madhe se jetës së kësaj bote, po i vjen fundi.

Edhe në suren “*El-Hakkah*” në ajetet 1-3, vjen i njëjti paralajmërim dhe në të njëjtën formë si në këtë sure, ku Allahu xh.sh. thotë: “**E Vërteta e pashmangshme! Ç’është e Vërteta e pashmangshme? E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është e Vërteta e pashmangshme?**”

Ky moment i Kiametit, apo kjo Ditë e llahtarshme, në Kuran ka ardhur me shumë emra të tjerë, dhe secili prej tyre nënkupton trishtim, tmerr e llahtari të atyre çasteve. Ja disa prej këtyre emërtimeve të kësaj Dite: “*El-Hakkatu*”⁷, “*Et-*

⁷ El-Hakka, 1-3.

Tammetu”⁸ *Es-Sahha*”⁹, “*Et-Tegabun*”¹⁰, “*Jevmu-d-Din*”¹¹, “*El-Gashije*”¹², “*Es-Sa’atu*”¹³, “*Jevmu-t-Tenad*”¹⁴, “*El-Xhathije*”¹⁵, “*El-Vakia*”¹⁶, “*Ez-Zelzeletu*”¹⁷, etj.

Është përmendur disa herë konstatimi, se, sa herë që në Kuran, ka ardhur shprehja “*Ve ma edrake*”, kjo nënkupton, që njeriu me të menduarit e tij të kufizuar, nuk është në gjendje të kuptojë urretësinë dhe fshehtësinë e asaj për të cilën flet i Madhërishtmi, përveçse me hamendësim. Prandaj, çdo ajet që ka ardhur në këtë formë të shprehurit, ajeti pasues, rëndom vjen si sqarim i kuptimit paraprak, më saktësisht i asaj çfarë është synuar në të vërtetë. Dhe përgjigjja e këtyre pyetjeve, vjen në ajetet vijuese të sures me përshkrimin e kësaj Dite:

يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ ﴿٤﴾

4. Atë ditë kur njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara

Ky ajet sqaron momentet e daljes së njerëzve nga varret tyre, duke u nisur në një drejtim të panjohur për ta. Grumbujt

⁸ En-Naziat, 34.

⁹ Abese, 33.

¹⁰ Et-Tegabun, 9.

¹¹ El-Fatiha, 4.

¹² El-Gashije, 1.

¹³ Muhamed, 18.

¹⁴ Gafir, 32.

¹⁵ El-Xhathije, 28.

¹⁶ El-Vakiatu, 1.

¹⁷ Ez-Zelzeletu, 1.

dhe turmat e shkapërderdhura të tyre u ngjasojnë fluturave, të cilat enden nëpër ajër, duke mos pasur ndonjë cak, por shkojnë duke lëvizur ngado që u sheh syri, sa andej e sa këndeji.

Një shembull të ngjashëm me këtë përshkrim, kemi edhe në ajetin e 7, të kaptinës “*Ek-Kamer*”: **“Dalin prej varreve, si karkaleca të shpërndarë”**, ku përshkruhen lëvizjet e njerëzve pasi të kenë dalë prej varrezave, sikur të ishin turma të mëdha të karkalecave.

Megjithatë, këtu shtrohet pyetja, përse Allahu xh.sh. i ka bërë këto dy përshkrime, për momentin kur njerëzit ringjallen dhe dalin nga varrezat, njëherë si flutura, e tjetrën si karkaleca. Ajeti ku njerëzit shëmbëllesh me fluturat: **“Atë ditë kur njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara”**, nënkupton se njerëzit do të shpërndahen e do të ikin prej njëri-tjetrit, duke ditur se i kanë hak njëri-tjetrit, sidomos të afërmve, ashtu siç na e përshkruan edhe Kurani fisnik: **“Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve të vet”** - (*Abese*, 34-36).

Ndërsa përshkrimi i dytë: **“Dalin prej varreve, si karkaleca të shpërndarë”**, nënkupton shqetësimin dhe tronditjen e thellë që do ta pësojnë njerëzit, kur të vetëdijesohen se tashmë, që të gjithë, prej të parit e deri te i mbrami, po nisen drejt Tubimit të Madh, të shpërndarë e të hutuar, për të dalë para madhërisë së Allahut, që të japin Llogarinë e tyre.

Dijetari i mirënjohur Zemahsheri teksa flet lidhur me këtë ajet, për momentin e ringjalljes, kur njerëzit pasi të kenë dalë nga varret, u ngjasojnë fluturave që fluturojnë të shpërqendruara, thotë: “Ky shëmbëllim tregon se sa të dobët e të

pafuqishëm janë njerëzit në këtë ditë të vështirë, pikërisht siç janë të dobëta edhe fluturat me krahët e tyre të brishtë.”¹⁸

Vërtetë momentet e fundit të kësaj bote vejnë në pah dobësinë e krijesës njerëzore që të ndryshojë diçka nga rrjedha dhe përcaktimi i Krijuesit. Ata njerëz të cilët deri në këtë ditë kishin pasuri, fuqi, sundim dhe bënin çfarëdo që donin, tash mbesin të shtangur e të pafuqishëm, sepse më nuk kanë asgjë në dorë. Ata tash do t’u nënshtrohen rregullave dhe ligjeve të reja të cilat nuk mund t’i ndryshojnë. Përkundrazi ata do të qëndrojnë me kokë të ulur poshtë, duke u tërhequr zvarrë, të turpëruar nga veprat e tyre të shëmtuara. Ata në heshtje do të presin verdiktin e fundit i cili për destinim ka zjarrin - skëterrën, në të cilin do të shijojnë ndëshkim pas ndëshkimi.

وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنْفُوشِ ﴿٥﴾

5. dhe kodrat të bëhen si leshi i shprishur.

Në ditën e Kiametit, me lejen e Allahut, do të çrregullohen ligjet ekzistuese të gjithësisë. Çdo gjë do të kthehet mbra-pshhtë. Çdo trup qiellor do të humb baraspeshën. Kodrat do të lëvizin në hapësirë sa andej sa këndeje, pa kurrfarë kontrolli, sikur të ishin shtëllunga leshi të shprishur.¹⁹ Këto kodra të cilat njerëit i shihnin deri dje stabile e të palëvizshme, sot do t’i shohin teksa fluturojnë në ajër, sikur të ishin pendla. Madje në shumë ajete kuranore shpjegohet gjendja e kodrave në këtë ditë të vështirë si f.v. në suren “*El-Muzzemmil*”, ajeti

¹⁸ Zemahsheri, *El-Kesh-shaf*, Rijad, 1998, vëll. VI, f. 421.

¹⁹ Dr. Vehbe ez-Zuhajli, *Et-Tefsiru-l Munir*, Damask, 2003, vëll.XXX, f. 772.

14: **“Atë ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse.”** etj.

Arsyeja e shëmbëllimit të kodrave me leshin e shprishur, është pikërisht koloriti i kodrave, me ngjyra të ndryshme, përse flet edhe ky ajet kuranor: **“Nëpër male (kodra) gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza.”** - (Fatir, 27). Po kështu, me këtë përshkrim ka ardhur edhe ajeti i sipërtheksuar i sures *El-Kariatu*: **dhe kodrat të bëhen si leshi i shprishur**”, d.t.th. që kodrat do të jenë aq të lehta saqë do të enden në hapësirë si të ishin shtëllunga leshi me ngjyra, duke u thërrmuar e bërë copa-copa.²⁰

Përmendja e këtyre dy ajeteve kuranore shërben që një-rëzve t’ua tërheq vërejtjen për momentet trishtuese e të llah-tarshme të ditës së Kiametit të cilët do të ndodhin në gjithësi. Në të njëjtën kohë, ky shembull është tërheqje e vërejtjes për njerëzit që të logjikojnë, që, nëse kodrat, me tërë madhësinë dhe fortësinë e tyre, në Ditën e Kiametit do të bëhen si shtëllunga leshi, atëherë, a thua si do të jetë gjendja e njeriut, si krijesë e brishtë, e dobët dhe e pafuqishme, në raport me kodrat dhe malet e mëdha?! Ai që ka pak mend dhe logjikon, nuk bën t’i injorojë këto shenja, por duhet të pendohet te Allahu para se t’i mbyllet libri i shënimeve të tij, përndryshe për çdo gjë do të jetë vonë. Pas vdekjes më nuk ka rast për përmirësim a pendim, sepse tash secili njeri do t’i shoh gjurmët e veprave të tij, të cilat do të dëshmojnë pro ose kundër tij.

²⁰ Muhamedinil Emin el Arumijj, *Hadaiku-r-rrevhi ve-r-rrejhan*, Bejrut, 2001, vëll. XXXII, f. 270.

Ajetet në vazhdim sqarojnë për shpërblimin ose ndëshkimin e njerëzve gjatë marrjes në Llogari...

﴿فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ﴾ ﴿٦﴾ ﴿فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ﴾ ﴿٧﴾

6. E sa i përket atij që i rëndohet peshoja (e veprave të tij),

7. ai është në një jetë të kënaqshme.

Momenti i marrjes në llogari është momenti më i vështirë i Ditës së Gjykimit. Askush nuk është i sigurt në këtë ditë përveç të Dërguarve dhe të dashurve të Allahut, të cilët nuk do t'i kaplojë frika e kësaj dite, siç ka premtuar Allahu xh.sh.:

“Ata nuk do t'i shqetësojë ajo frika e madhe (e fryrjes së surit), **dhe do t'i presin engjëjt** (duke i uruar): **“Kjo është dita juaj që ju premtohej”**. - (El-Enbija'ë, 103)

Ankthi dhe pasiguria do t'i mbërthejë njerëzit dhe exhibet. Secili pret rezultatin e llogarisë së vet, secili shpreson në mëshirën e Allahut të gjithëmëshirshëm, por kjo mëshirë do t'i arrijë vetëm vepërmirët.

Ne edhe gjatë jetës në këtë botë, përjetojmë ankthe dhe strese të ndryshme, si p.sh. kur presim rezultatin e ndonjë provimi, ose rezultatin e ndonjë ekzamimini mjekësor për ndonjë sëmundje të pashërueshme etj, por megjithatë, ky moment është i pakrahasueshëm.

Nga hadithet e Pejgamberit a.s. kemi mësuar se vepra e parë që do të llogaritet është namazi. Nëse namazi që e kemi falur në këtë botë, rëndon në peshoren e saktë të Krijuesit, atëherë shpresa për shpëtim është e madhe, e nëse është e ku-

ndërta, atëherë, atëherë mjerimi dhe dëshpërimi do t'i pllakosë fytyrat e njerëzve. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *“Gjëja e parë për të cilën do të japë llogari rob i Ditën e Ringjalljes është namazi. Nëse i ka kryer namazet sipas rregullave, atëherë do të jetë i shpëtuar dhe ka korrur sukses. Nëse namazet do të jenë të paplota, do të përjashtohet nga mirësia dhe do të jetë i humbur. Nëse do të ketë diçka të paplotësuar nga farzet (obligimet e domosdoshme), Allahu i Lartmadhëruar do t'u thotë (melekëve): -Shihni se a ka kryer rob i ndonjë namaz vullnetar, me të cilin do t'ia plotësoj farzin? Pastaj edhe veprat tjera do të gjykohen në të njëjtën mënyrë.”*²¹

Në këtë Ditë, askujt nuk i bëhet e padrejtë as sa grimca. Të lumët ata, veprat e mira të të cilëve do të rëndojnë në peshoren hyjnore, sepse të tillët do të jenë të lumtur e të gëzuar dhe do të shijojnë begatitë e Xhenetit.

Sa i përket Mizanit (peshores) në Ditën e Gjykimit, në të cilët do të peshohen të gjitha veprat e njerëzve, në “peshoren” që nuk krahasohet me peshojat e kësaj bote,²² ne besojmë në të pa kurrfarë dyshimi, ashtu siç është përmendur në Kuran, ndonëse nuk e dimë mënyrën e peshimit e as dukjen (formën) e saj. Zaten, kjo as nuk bën të na preokupojë sepse dija e Allahut është e pakufishme dhe ne nuk mund ta kuptojmë këtë dije, sepse jemi të kufizuar në të kuptuarit e gjërave abstrakte.

²¹ Transmetojnë Tirmidhiu (413), Ebu Davudi (864) dhe Nesaiu (465). Hadithi është i kategorisë “sahih-i vërtetë”.

²² Kasim Gërguri, *Akaidi sipas Imam Maturidiut*, Prishtinë, 2015, f. 268.

وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ﴿٨﴾ فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ ﴿٩﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا
هِيَ ﴿١٠﴾ نَارٌ حَامِيَةٌ ﴿١١﴾

8. Ndërsa, ai që ka peshojën e lehtë (të veprave të tij),

9. Vendi i tij do të jetë në Havije.

10. E ç'është ajo që të njoftoi se ç'është ai (Havije)?

11. Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë.

Ata njerëz, të cilëve në peshojë, veprat e këqija do t'u rëndojnë më tepër sesa ato të mirat, janë njerë të pavlerë,²³ dhe të tillët do të përballen me drejtësinë hyjnore dhe ndëshkimin e dhimbshëm në zjarrin e Xhehenemit. Ata do të përfshihen nga flakët e tij, të cilat do t'i djegin dhe përcëllojnë.

Peshorja do t'u vijë e lehtë, sepse ata nuk kanë asnjë vepër të mirë me vete. Nuk kishin qenë prej falësve të namazit e as kryes të ibadeteve të tjera. Ishin tallur me dispozitat e Allahut, duke fyer e nënçmuar besimtarët, duke i quajtur naivë e të prapambetur. Pikërisht, në këtë moment, do të vjen në shprehje drejtësia e Allahut, i Cili nuk i bën të padrejtë askujt. Në Mizan-Peshore, secili njeri është peng i veprave të tij në këtë botë.

Duhet sqaruar se kjo peshore ka kuptim dhe domethënie vetëm për besimtarët, si për të mirët ashtu edhe për të shkujdesurit ndaj detyrimeve fetare, sepse për femohuesit dhe idhujtarët, në fakt, llogaria do të jetë shumë e shpejtë, meqë libri i veprave të tyre është i mbyllur dhe i vulosur me vulën e kufrit dhe mbase nuk ka nevojë të peshohet fare, përveçse simboli-

²³ Muhamed Abduhu, *Tefsir xhu'u Amme*, Kajro, 1341 h., f. 146.

kisht. Atyre vetëm do t'u komunikohet verdikti i fundit gjykues e më pastaj do të tërhiqen zvarrë nga engjëjt e Xhehenemit për t'i futur në greminat flakëruese e përcëlluese të tij. Vendi i tyre do të jetë në 'Havije' që nënkupton një prej greminave më të thella e më të thepisura të Xhehenemit, në të cilën do të ndëshkohen përjetësisht. Shtrohet pyetja: Përse Allahu në ajetin e 9-të, të kësaj kaptine: **“Vendi i tij do të jetë në Havije”**, e ka përdorur fjalën “Umm-Nënë”? Përgjigja është se këtu, Allahu xh.sh., në mënyrë alegorike e përshkruan se, ashtu siç nëna e përqafton fëmijën e saj, po ashtu edhe zjarri i Xhehenemit do t'i “përqafojë” jobesimtarët dhe idhujtarët, me përqaftimin e tij përcëllues, përjetësisht.²⁴

Se çfarë cilësish ka ky zjarr, këtë e ka përshkruar më së miri i Dërguari i Allahut në një hadith, i cili transmetohet nga Ebu Hurejra, kur thotë: *“Zjarri të cilin e ndez njeriu, është një pjesë prej shtatëdhjetë pjesëve të zjarrit dhe nxehtësisë së Xhehenemit”*²⁵

Ky zjarr i quajtur *“narun hamije”*, nënkupton një zjarr me nxehtësi të lartë që përcëllon, djeg e shkrumbon çdo gjë para vetes.

²⁴ Dr.Musaid et-Tajjar, Tefsir khuz'u Amme, Demmam, 1430 h., f. 216.

²⁵ Muslimi, (5077), Shih: *Et-Tefsiru-l mevdu li suveri-l Kuran*, vëll. VII, f.312.

Porosia e kësaj sureje:

- *Nga kjo sure madhështore mund të konkludojmë se Kiameti nënkupton momente të tmerrshme, të llah-tarshme e lemerishme, momente që dridhin e frikësojnë zemrat e njerëzve, momente që të kallin datën nga ashpërsia e ndëshkimit. Këto momente vështirë se mund të imagjinojnë as të përshkruhen me fjalë, sepse tejkalojnë çdo përmasë të të përfytyruarit tonë. Nëse e bëjmë vetëm një krahasim të vogël në mes të zjarrit të kësaj bote dhe atij të Xhehenemit, atëherë, do të shohim se krahasimet këtu humbin vlerën dhe arsyen, sepse zjarri i Xhehenemit është diçka krejtësisht tjetër nga zjarri i kësaj bote.*
- *Në këtë ditë, njerëzit do të jenë të ndarë në dy grupe: atyre që do t'u rëndohet mizani (peshorja) i veprave të mira, do të jenë të shpëtuarit, kurse atyre që mizani do t'u mbetet i lehtë, ata do të jenë të humburit dhe fatkeqët, të cilët do të përjetojnë nënçmimet, poshtërimet dhe dënime më të rrepta nga ana e Allahut fuqiplotë.*
- *Në peshoren e Ditës së Gjykimit do të peshohen veprat e mira dhe të këqija. Natyrisht, veprat e mira rëndojnë në këtë peshojë hyjnore sepse janë vlera të pakontestueshme kurse veprat e këqija, në esencë janë të pavlera dhe nuk kanë kurrfarë peshe në këtë ditë.*

Azmir JUSUFI

MAHMUD SHELTUTI DHE KOMENTIMI I TIJ I KURANIT

Hyrje

Në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe gjysmën e parë të shekullit XX në skenë shfaqen mendimtarët myslimanë, të cilët përpiqen për të afirmuar dhe aktualizuar parime islame në rrethana të reja politike, ekonomike, ushtarake, kulturore dhe sociale. Dy fenomene të mëdha në tefsirin modern janë interpretimi tematik i Kuranit dhe interpretimi i Kuranit si një tërësi organike “përbrenda”. Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të kësaj mënyre të interpretimit të Kuranit është pa mëdyshje Mahmud Sheltuti, reformator, reorganizator, jurist islam dhe ekzegjetë. Në këtë punim do të bëhet fjalë rreth qasjes së Sheltutit në interpretimin e Kuranit përmes tefsirit të tij të titulluar “*Komentimi i Kuran el-Kerimit - dhjetë xhu-*

zeve të para (*Tefsirul-Kur'an el-Kerim: el-exhza'ul-'ashere-tul-ula*).”

Gjatë përpunimit të tekstit, është konsultuar literatura në gjuhët arabe, angleze dhe boshnjake. Për këtë temë më gjerësisht ka shkruar autori Kate Zebiri, i cili rreth Sheltutit ka shkruar në më se njëqind e shtatëdhjetë faqe. Ky tekst është përkthyer, ndër të tjerash, edhe në gjuhën boshnjake, botuar në librin *Kur'an u savremenom dobu*, të përgatitur nga prof. dr. Enes Karić. Po ashtu, edhe vetë tefsiri i Mahmud Sheltutit është përkthyer nga prof. dr. Omer Nakičević, të cilin përkthim e kam si referencën kryesore gjatë përpunimit të kësaj teme.

Mahmud Sheltuti - biografia (1893-1963)

Mahmud Sheltuti lindi më 26 prill 1893 në një fshat në Egjiptin e Ulët, i quajtur Minjat Beni Mensur, në provincën Buḥajrah¹. Kur ishte si fëmijë e mësoi Kuranin përmendsh. Shkollimin fillor dhe të mesme e përfundoi në vendlindje, në Aleksandri, kurse, diplomoi në El-Ezher në vitin 1918.²

Mahmud Sheltuti i takon plejadës së ulemasë që vepronte në të ashtuquajturën epokë moderne, e cila dëshironte dhe përpiquej për ruajtjen e dinjitetit të ulemasë, kur këtij rrethi të njerëzve, kujdestarëve mijëvjeçarë të traditës islame, u është marrë ose atakuar çdo gjë nga programet tradicionale në me-

¹ Kate Zebiri, *Encyclopaedia of islam* (IX dio), Brill, Leiden, 1997, f. 260

² Jusuf Ramić, *Bošnjaci na El-Ezheru*, Rijaseti i Bashkësisë Islame në Bosnje e Hercegovinë, Sarajevë, 1997, f. 23.

dresetë e vendit e deri te sistemi vakfnor, nga pozita dinjitoze në minberin e xhamisë e deri te trajtimi dinjitoz mediatik.

Mahmud Sheltuti me angazhimin e tij të shkruar dhe atë praktik, dhe sidomos me karrierën e tij respektabile të rektorit të Universitetit “El-Az'har”, bëri përpjekje për të rivendosur dinjitetin e shtresës së ulemasë dhe traditës, u përpoq që traditën islame e të mësuarit, njohurive dhe *ilmit*, si dhe vetë tradicionalizmin e Islamit, t'i shprehë në gjuhën moderne arabe dhe se këtë trashëgimi të lavdishme ta shprehë nëpërmjet idiomës moderne apo të modernizuar të arabishtes si medium më efikas të Islamit.³

Pikërisht në vitin 1919, u emërua si profesor në shkollën e mesme të “El-Ezherit” në Aleksandri, ku që në fillim zhvilloi një aktivitet të madh shkencor në shkollë dhe institucione të tjera shkencore. Që atëherë e mbron idenë e riorganizimit të “El-Ezherit” dhe autonominë e tij. Në vitin 1927 ai u transferua nga Aleksandria në Kajro, në departamentin për studime të larta. Një vit më vonë, përkatësisht në vitin 1928, Shejh Mustafa el-Meragi u emërua rektor i “El-Ezherit”. Sheltuti e përshëndeti me entuziazëm ardhjen e El-Meragit si rektor në një seri artikujsh të botuar në gazetën *Politika*, duke avokuar dhe mbrojtur reformat e “El-Ezherit”. El-Meragi, duke vlerësuar diturinë e Sheltutit, sidomos vizionin e tij të shëndoshë, e emëroi profesor të legjislacionit islam në shkollën e specializimit-*Tehassus*. Megjithatë, kur El-Meragi, u ndesh në vështirësi dhe keqkuptime në përpjekjet rreth ri-

³ Enes Karić, *Predgovor prijvodu Komentara Kur'ana, deset džuzova, Mahmuda Šeltuta (1893-1963)*, El-Kalem: FIN, Sarajevë, 2007.

organizimit të “El-Ezherit”, dha dorëheqje dhe administrimi i “El-Ezherit” bie në duart e elementëve konservatorë, Sheltut për shkak të ideve të tij përparimtare, po ashtu u bë i padëshirueshëm, dhe si i tillë më 17 shtator 1931, u përjashtua nga “El-Ezheri” dhe iu ndalua angazhimi i tij në këtë vatër diturie.⁴

Gjatë kësaj periudhe, Sheltuti punoi si avokat në gjykatat e Sheriatit dhe ishte aktiv në gazetari, duke vazhduar kështu publikimin e pikëpamjeve të tij reformiste. Ajo që është interesante, është se ai ka punuar si partner me Ali Abdurrazikun, të cilin “El-Ezher” e denoncoi dhe ia mori titullin e alimit në vitin 1926, për shkak të mohimit të tij se Islami domosdoshmërisht nënkupton edhe qeverisjen islamike. Megjithatë, në vitin 1935, kur El-Meragi e filloi mandatin e tij të dytë si Shejh-ul-El-Ezher, Sheltuti rikthehet përsëri duke u emëruar *vekil*, d.m.th. prodekan i Fakultetit të Sheriatit, kurse në vitin 1939 emërohet inspektor i institucioneve fetare. Që atëherë karriera e tij në El-Ezher lëvizi vetëm lart e më lart.⁵

Në vitin 1937 e përfaqëson Egjiptin dhe “El-Ezherin” në Kongresin Ndërkombëtar të së Drejtës Krahassimtare në Hagë, dhe me këtë rast paraqiti punën e tij shkencore rreth ligjit islam. Si rezultat i ekspozimit të tij, konkluzioni i Kongresit ishte se Sheriati paraqet legjislacionin e pavarur të plotë dhe që mund të konsiderohet si një burim i legjislacionit kudo

⁴ Husein Đozo, *Novi rektor El-Ezhera - šejh Mahmud Šeltut*, **Glasnik** VIS-a në SFRJ, Sarajevë, 1959, f. 6-7.

⁵ Kate Zebiri, “Mahmud Šeltut i islamski modernizam”, në: *Kur'an u savremenom dobu*, përgatiti: Enes Karić, El-Kalem, Sarajevë, 2000, Pjesa e parë, f. 346-347.

dhe për të gjitha kohërat. Në vitin 1941 në bazë të punës shkencore *“Përgjegjësia civile dhe ajo penale në legjislacionin e sheriatit”*, u zgjodh unanimisht në Kolegjin e Lartë të Ulemasë e që qe edhe anëtar i më i ri i këtij kolegji. Për anëtar të Akademisë së Shkencave është zgjedhur në vitin 1946. Në vitin 1950 u emërua për udhëheqës i institucionit për kërkime shkencore në fushën e kulturës dhe qytetërimit islam. Puna e tij në këtë fushë ka qenë shumë e rëndësishme. Ai e zgjeroi punën e këtij institucioni, vuri themelet për lidhje më të forta kulturore të Egjiptit me vende të tjera arabe dhe islame.⁶

Në vitin 1957 Sheltuti u emërua si këshilltar i Konferencës Islamike, kurse me 9 nëntor të po të njëjtit vit presidenti i Egjiptit lëshoi një dekret me të cilin e emëron atë për pozitën e prorektorit të Universitetit të “El-Ezherit”. Me 21 tetor 1958, pas dorëheqjes së Shejh Abdurrahman Taxhit, u shpall promovimi i Sheltutit në Shejh El-Ezher. Ai atëherë ishte në moshën 65-vjeçare.⁷

Ai, përveç funksioneve të përmendura më sipër, kryente edhe funksione të tjera: ishte anëtar i Këshillit të Lartë për Marrëdhënie Kulturore në Ministrinë e Arsimit, anëtar i Këshillit për shërbimin e Radio-Kajros, kryetar i Këshillit për zakone dhe tradita në Ministrinë e Çështjeve Sociale, anëtar i Komitetit të Lartë për ndihma dimërore etj.⁸

⁶ H. Dozo, *Novi rektor El-Ezhera - šejh Mahmud Šeltut*, op. cit., f. 7.

⁷ K. Zebiri, op. cit., f. 347.

⁸ Husein Dozo, “Merhum šejh Mahmut Šeltut”, **Glasnik** VIS-a, Këshilli i Lartë Islam në SFRJ, Sarajevë, 1964, f. 20.

Sheltuti ishte dijetar i shkollës juridike (medhhebit) shafi'i. Pavarësisht rezistencës që i ishte bërë atij, mundin e tij shumëvjeçar e kurorëzoi me sukses - e realizoi riorganizimin e Universitetit të El-Ezherit dhe themelimin e Akademisë së Studimeve Islame në Kajro.⁹ Në pozitën e rektorit ka mbetur deri në vdekjen e tij. Ai vdiq në Kajro në vitin 1963.

Husein Đozo vdekjen e tij e shoqëroi me fjalët vijuese: “Në horizontin e ringjalljes islame u shua edhe një tjetër yll i ndritshëm. U ndal që të rrezatojë mendjen, i cili tregonte për humbje dhe rrugë të shtrembëruara të së kaluarës dhe ndriçoi rrugët për një të ardhme më të mirë dhe më të lumtur. U humb njeriu i cili për një gjysmë shekulli luftoi aktivisht kundër të kuptuarit monstruoz dhe të prapambetur të mësimi islam, dhe për një mendim të shëndoshë progresiv islam. Vdiq Shejh Sheltuti. Me 12 dhjetor 1963 ndaloi së rrahuri zemra e atij që ishte mbushur me zell të madh dhe me dashurinë më të fuqishme për Islamin, zemra e të cilit as dhimbjet nuk mund ta pengonin në misionin e tij të madh. Ato mundën ta e ndalnin atë, në fakt edhe e ndalën, por, përderisa rrihte, rrihte vetëm në emër të Zotit dhe për të mirën e Islamit, dhe pastaj edhe për të mirën e njerëzve.”¹⁰

⁹ Fikret Karčić, *Historija šerijatskog prava*, FIN, Sarajevë, 2005, f. 198.

¹⁰ H. Đozo “Merhum šejh Mahmut Šeltut”, *op. cit.*, f. 17.

Opusi letrar i Mahmud Sheltutit

Mahmud Sheltuti shkroi vepra të shumta. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: *Fetva, Islami - të mësuarit dhe sheriatit* dhe *Komenti i Kuranit (dhjetë xhuzet e parë)*.

Fetva është libër në të cilin ai dha zgjidhje sheriatike-ligjore në shumë çështje dhe probleme me të cilat përballlet njeriu modern. Libri ka 450 faqe. Në parathënie, Mahmud Sheltuti ndër të tjera, ka thënë se gjatë këtyre zgjidhjeve sheriatoligjore nuk i është përmbajtur asnjë shkolle sheriatike-ligjore e as mendimit të një juristi islam. Përgjigjet për pyetjet i dha duke pasur parasysh Kuranin, Hadithin dhe parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet Islami. Këto zgjidhje sheriatoligjore fillimisht qenë thënë në radio e më pas edhe qenë botuar në shtyp. Më pas, ato u mbledhën në një vend dhe u përgatitën si libër i veçantë, botuar nga *Darul-kelami* në Kajro.¹¹

Libri tjetër i Sheltutit, i botuar nga kjo shtëpia e famshme botuese në Kajro është *Islami - të mësuarit dhe sheriatit*, përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë flet rreth mësimëve islame, e dyta rreth sheriatit, kurse e treta rreth burimeve të Sheriatit.¹²

Tefsiri i Sheltutit përmban 650 faqe, në të cilat ai komentoi 9 suret e para. Nga veprat tjera, në literaturë dallohen:

¹¹ Jusuf Ramić, "Racionalna tumačenja Kur'ana", në: *Metodologija tefsira*, përgatiti: Džemaludin Latić, FIN, Sarajevë, 2005, f. 458.

¹² Ibid., f. 458 - 459.

- *El-Kuranu vel-Kitalu* (Kurani dhe lufta),
- *El-Kuranu vel-mer'etu* (Kurani dhe gruaja),
- *Tenzimul-alakatid-devlijjeti fil-islam* (Rregullimi i marrëdhënieve ndërkombëtare në Islam)¹³
- *Mukarenetul-medhahib* (Studim krahasimtar i shkollave juridike),
- *Përgjegjësia civile sipas ligjit dhe sipas Sheriatit*, etj.¹⁴

Mahmud Sheltuti dhe kërkimi për dinjitetin e ulemasë në shek. XX

Mahmud Sheltuti i takon plejadës së *ulemasë* të Egjiptit të cilët kanë vepruar në të ashtuquajturën epokë moderne të botës arabe-islame, dhe e cila synonte për të ruajtur dinjitetin e *ulemasë*, në një kohë kur këtij rrethi të njerëzve, ruajtësve mijëvjeçarë të traditës islame, u ishte marrë apo atakuar e tëra nga programet tradicionale në medrese e deri në vakëfe, nga pozicione dinjitoze në minbere të xhamive e deri te trajtimi dinjitoz social.

Shejh Mahmud Sheltuti me punën e tij të shkruar dhe atë praktike, sidomos me karrierën respektabile si rektor i Universitetit “El-Ez'har”, u përpoq për të rivendosur dinjitetin e shtresës së ulemasë dhe traditës, synoi që traditën islame e të mësuarit, njohurive dhe *ilmit*, si dhe vetë tradicionalizmin islam, ta shprehë në gjuhën moderne arabe, apo bashkëkohore, dhe se këtë trashëgimi madhështore tërësisht ta shprehë për-

¹³ Ibid., f. 458.

¹⁴ Fikret Karčić, *op. cit.*, f. 198.

mes idiomës bashkëkohore dhe të modernizuar të arabishtes si një medie më efikase islame.

Në shumë nga librat e tij, në diskutime të gjera, ku trajton udhëzime islame, ose në të cilat ekspozon besimin islam dhe ligjin islam, Mahmud Sheltuti është i freskët, konciz, erudit, i ditur. Fjala e tij është fjalë *ulemaje*, e butë dhe përmbajtësore. Mendimi i tij nuk shkakton acarime dhe goditje, përkundrazi, ai synonte që në zemrën e lexuesit të mbillte gëzim dhe ndjenjë kënaqësie për Zotin dhe për besimin në Zot. Pikërisht nga fakti se një libri të rëndësishëm i kishte dhënë titullin i cili menjëherë *definon* dhe *sugjeron* (“Islami është besimi dhe ligji islam”), shohim qartë se Mahmud Sheltuti ngadalë u distancua nga platformat, të cilat Islamin e kishin shpallur “ideologjinë shtetërore”.

Praktikisht, të gjitha veprat e tij pasqyrojnë përpjekjet e tij në të cilat ai flet për vizionin islam të karakterizuar nga *samaha* ose “toleranca”, *jusri* ose “lehtësia”, *tasamuh* ose “butësia/toleranca”, dhe, më në fund, *tawassuti* ose “moderimi/përmbajtja”.¹⁵

¹⁵ Enes Karić, “Mahmud Šeltut (1893-1963) i njegov projekt pomirenja među mezhebima”, **Bilten** - 154, Bashkësia Islame në Kroaci, korrik 2014, Zagreb, f. 35.

Sheltuti dhe "Tefsiri tematik"

Dy fenomenet kryesore në epokën moderne janë shfaqja e tefsirit tematik dhe theksimi në tërësinë organike të Kuranit. Të dy fenomenet janë të pranishme në tefsirin e Sheltutit ("Tefsir el-Kuran el-Karim"). Tefsiri i Sheltutit merret me pjesën e parë të së tretës së Kuranit, dhe për herë të parë filloi botimin në vitin 1949, dhe në vitin 1959 u botua për herë të parë në formë të librit. Sheltuti dallon dy gjëra nga të cilat duhet shmangur gjatë komentimit të Kuranit: sektarizmi në tefsir dhe tafsiri `ilmi (interpretimi shkencor). Në rastin e parë, mufesiri e vartëson Kuranin me bindjet e tij personale, në vend se të jetë e kundërta, dhe anon kah materialet të pasigurta (israilijate, hadithet e dobëta apo të fabrikuara etj.). Në rastin e dytë, me sarkazëm vuri në dukje se "në qoftë se arrijnë (komentatorët) në fjalinë ku përmendet shiu, ose përshkruhen retë, apo flitet në lidhje me bubullimën ose rrufenë, ata gëzojnë dhe thonë: "Shikoni! Kurani iu drejtohet shkencëtarëve!" Ata kështu mund edhe të bëjnë dëm meqë Kuranin e ndërli-dhin me teoritë specifike, dhe kur këto teori të hidhen poshtë nga drita e zbulimeve të mëvonshme, atëherë Kurani bëhet i hapur ndaj akuzave se ai përmban gabime eventuale.

Tefsiri i Kuranit (dhjetë xhuzat e parë)

Një nga prirjet kryesore në interpretimin e Kuranit në kohën moderne është tefsiri tematik (*et-tefsirul-mevdu'ijju*). Arsyet kryesore për praninë e tij dhe popullaritetin në tefsire moderne mund të gjenden në orientimin dhe thelbin e këtyre tefsire. Ato janë më afër frymës së njeriut modern, i cili është

i penguar në shumë aspekte, sidomos në kohën e lirë, dhe nuk mund të lexojë tefsire tradicionale të shkruara në disa vëllime, të cilat janë, përveç kësaj, të ngarkuara me analiza gramatikore, me përmendjen e qëndrimeve të shumta e kontraktore dhe argumentimet e tyre, dhe me të thëna për kuptimin e të cilave është e nevojshme ekspertiza dhe paranjohuri e madhe. Shumë reformatorë dhe komentatorë kanë theksuar se qëllimi i Kuranit është *udhëzimi*, e jo analiza gramatikore ose elaborimi teorik. Prandaj, ata kanë shkruar tefsire tematike ku ata i përmendën të gjitha ajetet që flasin për një temë në mënyrë të qartë dhe koncize, dhe kryesisht i interpretonin nga pikëpamja e implikimeve të tyre praktike për *udhëzim* që ato i ofrojnë njeriut. Gjithashtu, në tefsirin tematik, mufesiri ka një rol më aktiv në interpretimin e Kuranit, përfshin pyetje dhe probleme të shoqërisë bashkëkohore myslimane dhe përpiket të ofrojë zgjidhje më të mirë duke interpretuar të gjitha ajetet që në mënyrë direkte apo indirekte merren me çështje të veçanta. Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të këtij trendi në tefsir është edhe Mahmud Sheltuti.

Tefsiri i Sheltutit përmban 650 faqe, në të cilat ai i komentoit nëntë suret e para. Pas pjesës hyrëse, fillon me suren El-Fatiha, dhe përfundon me Et-Teube. Në fillim të çdo sureje, përveç El-Fatijasë, Sheltuti përmend temat që do të trajtohen në vazhdimin e tekstit. Suret i komenton sipas renditjes së temave, dhe jo sipas renditjes së sureve. Që në fillim shpalos se pse sureja e caktuar e mori emërtimin që ka. Edhe pse ai komentoit vetëm 1/3 e Kuranit, ai i përfshiu të gjitha temat e rëndësishme. Kur Sheltuti flet për një temë të caktuar, ai i

përmend të gjitha ajetet që kanë të bëjnë me këtë temë, duke e analizuar në detaje.¹⁶

Në hyrje të Tefsirit të tij, Sheltuti thekson se nuk ka asnjë libër që të ishte më i studiuar, më i lexuar dhe me ndikim më të madh se ç'ishte rasti me Kuranin. Në fakt, duke studiuar çdo disiplinë shkencore, myslimanët i bënë shërbim Kuranit dhe e pasuruan komentimin e tij multidisiplinar. Studimi i gramatikës është në shërbim të shqiptimit korrekt të Kuranit. Studimi i retorikës dhe leksikut luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fjalëve të Kuranit dhe kuptimet e tyre për të shmangur ndryshimin në kuptim dhe paqartësi. Marrja me legjislacionin islam lehtëson të kuptuarit e rregullave ligjore nga Kurani, sikur që marrja me metodologjinë e legjislacionit islam shpjegon parimet e ligjit islam. Poezia, për ata që specializohen në të, u ndihmon për të kuptuar mbinatyrshmërinë dhe bukurinë kuranore etj.

Në hyrjen e tij, Sheltuti përmend dy fusha të cilat duhet të hiqen në interpretimin e Kuranit. Fusha e parë është interpretimi tendencioz i Kuranit, në të cilin kanë ndërhyrë fraksione të ndryshme dhe sekte me dëshirë për të vërtetuar saktësinë e bindjeve dhe qëndrimeve të tyre. Ata, në interpretimin e Kuranit, kanë përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, duke përfshirë hadithe apokrife dhe israilijate, në mënyrë për të interpretuar Kuranin në përputhje me mësimet e medhhebit (drejtimit) të tyre. Interpretimet e tilla kanë mbuluar dritën e udhëzimit të përmbajtur në Kuran. Fusha e dytë e tillë sipas

¹⁶ Mahmud Sheltut, *Tefsirul-Kur'anil-kerim: el-exhza'ul-asheretul-ula*, Darul-kelam, Kajro, 1966, f. 40 - 41, 90 - 91, 162.

Sheltutit, është interpretimi shkencor i Kuranit (*tefsirun 'ilmijj*). Ai e dënon fuqishëm këtë qasje, sepse Kurani nuk është libër që i shpalos teoritë shkencore, detajet e artit dhe llojet e njohjes. Nga ana tjetër, shkenca nuk është finalja e natyrshme, definitive, fjala e fundit. Nëse ajetet kuranore do t'i kufizonim në çështjet shkencore jo të përhershme dhe të ndryshueshme, edhe Kuranin ashtu do ta vinin në dukje ndryshimi dhe keqkuptimi, dhe kështu ne vetë do ta çonim në një pozitë serioze në mbrojtje të Kuranit. Kurani flet për misteret e krijimit dhe fenomenet natyrore, në mënyrë që njerëzit të stimulohen në të menduarit dhe për t'i ndihmuar ata të rrisin besimin e tyre.¹⁷

Karakteristikat kryesore të tefsirit të Sheltutit

Nga karakteristikat më të rëndësishme të tefsirit të Sheltutit janë:

a. Komentimi i Kuranit dhe i sureve si “njësi organike” - I tërë Kurani, sikur edhe secila sure më vete, paraqet një tërësi të baraspeshuar. Para së gjithash, ai i shpalos karakteristikat e përgjithshme të sures, pastaj kalon në paraqitjen dhe komentimin e temave kryesore të sures. P.sh. në suren “El-Bekare” ai identifikon dy pjesët të saj kryesore, në përputhje me objektivat apo çështjet që i trajton. Pjesa e parë përfaqëson ajete nga 40 deri 177, dhe u drejtohet hebrenjve,

¹⁷ Mahmud Šeltut, *Komentar Kuran-i kerima (prvih deset džuzova)*, El-Kalem: FIN, Sarajevë, 2007, f. 11 - 19.

duke i përkujtuar ata për veprat e këqija që i kanë bërë në të kaluarën, dhe duke i hedhur poshtë gënjeshttrat dhe dyshimet e tyre në lidhje me misionin e Muhamedit a.s. Pjesa e dytë, ndërkaq, përbëhet nga ajetet prej 177 e deri në fund, të cilat rregullojnë legjislacionin e komunitetit të ri medinas.

Brenda një interpretimi të një sureje, ai shpesh i krahason suret dhe përmbajtjet e tyre, duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet. P.sh. gjatë komentimit të sures “*El-En'am*”, ai thekson se i paraprijnë katër suret medinase, të cilat, edhe pse ato ndryshojnë në detaje, kanë për qëllim të rregullojnë çështjet ligjore të komunitetit mysliman medinas. Pastaj, flet për dallimet në mes të sures “*El-En'am*” dhe suret që i paraprijnë asaj. Një nga dallimet që ai përmend është se surja “*El-En'am*” është mekase, dhe për këtë arsye nuk përmban materiale legjislative, rregullat që lidhen me luftën dhe *ehlul-kitabët- ithtarët e librit*, e as që ka *nida'ate* (ajete që fillojnë me *ejjuha*), sepse Zoti në suret mekase nuk u drejtohet besimtarëve si një grup i caktuar. Suren *El-En'am* e krahason edhe me katër sure të tjera të cilat fillojnë me *hamdin* (falënderim ndaj Allahut): *El-Fatiha*, *El-Kehf*, *Sebe'* dhe *Fatir*, duke treguar se të gjitha këto fokusohen mbi aspektet e *rububijetit të Zotit*. Fillimi i sures nuk është vetëm një frazë e izoluar, por ndikon në natyrën e saj dhe tematikën rreth së cilës flet. Pesë suret që fillojnë në këtë mënyrë kanë disa karakteristika të tyre të përbashkëta pikërisht për shkak të një fillimi të këtillë. Pastaj, suren *El-En'am* e krahason me atë të radhës, po ashtu mekase “*El-E'raf*”, dhe përmend nëntë pika në të cilat këto dy sure dallojnë ndërmjet vete.

Kur Sheltuti merret me një temë të veçantë të sures së caktuar, ai u referohet pjesëve të tjera të Kuranit, gjë që është në përputhje me kërkesat e tefsirit tematik. Kurani është buri-mi i parë i tefsirit dhe në komentim ka përparësi mbi burime të tjera. Kur i komenton ajetet e trashëgimisë në suren En-Nisa', i përmend ajetet nga suret tjera që flasin në temën e pasurisë-trashëgimisë. Prandaj, ai një kapitull e emërtoi me titull: Pyetja e pasurisë në këtë dhe në suret tjera. Shumë shpesh Sheltuti përdor ajete dhe pjesë të tjera të sureve të tjera në mënyrë që të shpjegojë kuptimin e saktë të një fjale apo për të shprehur karakteristikat specifike të stilit kuranor. Duke marrë shembuj nga i gjithë Kurani, ai shpjegon se *jes-teftuneke*, ndryshe nga *jes'eluneke*, përdoret për pyetjet e komplikuar dhe jo të qarta.¹⁸

Në suren “Ali Imran” Sheltuti identifikon dy lloje të thirrjeve me të cilat Kurani u drejtohet krijesave:

1. Thirrje të arsyeshmeve - thirrja e obligueshmërisë e cila përmban një urdhër i cili duhet zbatuar ose një tjetër urdhër për t'u ndaluar nga diçka.
2. Thirrja për të paarsyeshmit - duke formuar thirrjen, me të cilën paraqet përkushtimin e asaj që ekziston për krijimin dhe bindjen ndaj ligjeve të Allahut.

Thirrjet e llojit të parë i ndan në gjashtë kategori: 1. Thirrjet personave të përmendur me emër, 2. Thirrja me përshkrim që përcakton një mision, referencë që ky mision të

¹⁸ Kate Zebiri, *op. cit.*, f. 479 - 483.

kryhet dhe mosrënia nën ndikimin e çdo gjëje në rrugën e kryerjes së këtij misioni, 3. Thirrja e drejtuar të gjithë njerëzve me një përshkrim të përgjithshëm të njerëzve (O njerëz) ose me një përshkrim të bijve (O bijtë e Ademit) e që është e lidhur me prindin e parë, 4. Thirrja grupeve dhe të gjithë popujve, 5. Thirrja e drejtuar ehl-i kitabeve (pasuesit e Librit) dhe 6. Thirrje e drejtuar besimtarëve dhe besimtareve.

Për secilën nga këto kategori, Sheltuti përmend një numër të ajeteve nga suret e ndryshme dhe jep një shpjegim të shkurtër të qëllimit të thirrjes. Si një shembull përfaqësues, ne do të përmendim kapitullin që flet për thirrjen drejtuar besimtarëve dhe besimtareve. Sheltuti shumë shndritshëm vëren se të gjitha ajetet në të cilat Allahu u drejtohet besimtarëve si një grup të shpallur në Medinë, pasi që myslimanët formuan xhematin-kongregacionin e tyre si organizatë të vet, një forcë të veçantë dhe rrugë, pas emigrimit nga Meka. Numri i thirrjeve të besimtarëve është 89. Do të përmendim disa ajete që Sheltuti përmend në tefsirin e tij dhe për të shfaqur interpretimin e tij të integruar të Kuranit. ***O ju që besuat, ju është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje (El-Bekare, 178); O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që i keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre (Et-Tevbe, 123); O ju që besuat, mos e tradhtoni All-llahun dhe të Dërguarin, e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo (El-Enfal, 27); O ju që besuat, kur t'ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, zgjerohuni, se Allahu bën zgjerim për ju, e kur t'ju thuhet: ngrihuni! Atëherë ju ngrihuni (El-Muxhadele, 11); O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vep-***

*ra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar (El-Maide, 90), etj.*¹⁹

b. Fokusimi në çështjet praktike - si shumë komentatorë dhe reformatorë të tjerë, Sheltuti në komentimet e tij jep përgjigje për çështjet sociale dhe ligjore si dhe për problemet me të cilat u ballafaquan myslimanët në kohën e tij. Aplikimet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të krijuara nën ndikimin e kolonializmit, kanë vënë para komentatorëve çështjen e kontekstualizimit të mesazheve të Kuranit. Reagimet dhe përgjigjet e dijetarëve myslimanë mbi gjendjen aktuale të komuniteteve myslimane zënë një pjesë të madhe të tefsirit të shkruar në shekullin e 20-të. Në këtë kuptim, Mahmud Sheltuti nuk bënte përjashtim. Ai beson se tefsiri tematik është metoda më e mirë e interpretimit të Kuranit për shkak të praktikimit të saj e që objektivi kryesor i Kuranit është që njerëzit t'i shpjerë në Udhëzimin të përmbajtur në Kuran. P.sh. çështja e unitetit mysliman është me interes të tij më të madh. Në një vend në tefsirin e tij thotë: “O myslimanë, se sa është e rëndësishme për ne, sidomos sot, në një kohë kur lidhjet e unitetit islam u dobësuan, kurse myslimanët janë të minuar dhe përbrenda të grupuar, por edhe në marrëdhëniet e tyre të jashtme - sa e rëndësishme është për të dëgjuar këto thirrje Hyjnore (thirrje për unitet), të mendojmë rreth tyre dhe t'i kuptojmë korrektësisht, t'i bëjmë ato si udhëzues në jetë, kështu që përsëri të bëhemi një komunitet i

¹⁹ Mahmud Šeltut, *Komentar Kuran-i kerima (prvih deset džuzova)*, op. cit., f. 131-139.

fortë, me moral të fortë dhe të zëmë vendin që Zoti e synoi për ne”.

c. Interpretimi stilistik i Kuranit (belaga) - Sheltuti me kujdes dhe në mënyrë të sofistikuar i analizon fjalët e Kuranit dhe tregon për harmoninë dhe renditjen e tyre të përsosur. Ai në këtë, ndryshe nga komentuesit klasikë, ndryshon në dy aspekte: 1. Nuk analizon me fjalë dhe parafjalë, veç aplikon një perspektivë më të gjerë, duke diskutuar rreth karakteristیکave të përgjithshme të stilit kuranor, 2. Thekson ndikimin psikologjik të formave të caktuara të shprehjes (fillimin e sureve me shkronjat el-mukatta'at, efekti i fillimit të sureve me përmendjen e gjërave të mira, etj.). Në tefsirin e tij ka shumë shembuj të analizës stilistike të fjalëve, parafjalëve dhe aje-teve, siç është e qartë nga titujt, të tilla si “Stilet e Kuranit në adhurimin e përcaktuar”, “Stilet e Kuranit në thirrjen e njerëzve për të menduarit e dobishëm”, etj.²⁰

Përfundim

Mahmud Sheltuti i takon plejadës së ylemave që vepronte në të ashtuquajturën kohën moderne dhe e cila donte të ruante dinjitetin e ylemave kur këtij rrethi të njerëzve, kujdestarëve mijëvjeçare të traditës islame, i qe marrë ose sulmuar çdo gjë nga programet tradicionale në medrese deri te vakëfet, nga pozicioni dinjitoz në minberet e xhamisë deri te trajtimi dinjitoz te mediat.

²⁰ Mahmud Šeltut, *Komentar Kuran-i kerima (prvih deset džuzova)*, op. cit., f.140.

Mahmud Sheltuti, komentator i Kuranit, egjiptas dhe ez'herist, kishte në mendje rritjen dhe shfaqjen e lexuesve të ri nga radhët e myslimanëve, paraqitjen në skenë të brezave e njerëzve të cilët ishin të privuar nga komunikimi i duhur me komentimet tradicionale të Kuranit. Tani këtij lexuesi të ri (i cili zakonisht është punëtor industrial dhe i cili është i privuar nga shumëçka, e sidomos nga koha e lirë, ose i cili është i punësuar në administratë, e cila është zhytur në politikë si një jetë e lirë dhe e kotë e përditshme, apo i cili është anëtar i klasës tregtare e cila nxiton për fitim), kështu që tani këtij lexuesi të ri duhet t'i ofrohet një komentim konciz me qëllim që mesazhet nga faqet kuranore të kuptohen sa më qartë, në mënyrë koncize dhe me përgjegjësi.

Shejh Mahmud Sheltuti me punën e tij të shkruar dhe praktike, dhe sidomos me karrierën e tij të respektuar si rektor i Universitetit El-Ezher, u përpoq që të rikthej dinjitetin e shtresës së ylemasë dhe ta rikthej traditën e lavdishme, u mundua që traditën islame të të mësuarit, njohurive dhe *ilmit*, si dhe tradicionalizmin islam, të vesh në gjuhën moderne arabe dhe këtë trashëgimi madhështore ta shpreh tërësisht nëpërmjet idiomit bashkëkohor apo modern të arabishtes si medium më efikas të Islamit.

Musa VILA

SHPJEGIM I NJË HADITHI TË PEJGAMBERIT A.S.

عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي بَكْرَةَ عَنْ أَبِيهِ ذَكَرَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ
وَسَلَّمَ قَعَدَ عَلَى بَعِيرِهِ وَأَمْسَكَ إِنْسَانٌ بِخِطَامِهِ أَوْ بِرِمَامِهِ قَالَ أَيُّ يَوْمٍ
هَذَا فَسَكَتْنَا حَتَّى ظَنَنَّا أَنَّهُ سَيُسَمِّيهِ سِوَى اسْمِهِ قَالَ أَلَيْسَ يَوْمَ النَّحْرِ
قُلْنَا بَلَى قَالَ فَأَيُّ شَهْرٍ هَذَا فَسَكَتْنَا حَتَّى ظَنَنَّا أَنَّهُ سَيُسَمِّيهِ بِغَيْرِ
اسْمِهِ فَقَالَ أَلَيْسَ بِذِي الْحِجَّةِ
قُلْنَا بَلَى قَالَ فَإِنَّ دِمَاءَكُمْ وَأَمْوَالَكُمْ وَأَعْرَاضَكُمْ بَيْنَكُمْ حَرَامٌ كَحُرْمَةِ
يَوْمِكُمْ هَذَا فِي شَهْرِكُمْ هَذَا
فِي بَلَدِكُمْ هَذَا لِيَسْلُغَ الشَّاهِدُ الْغَائِبَ فَإِنَّ الشَّاهِدَ عَسَى أَنْ يُبْلَغَ مَنْ
هُوَ أَوْعَى لَهُ مِنْهُ.

Ebu Bekrete r.a. tregon se Pejgamberi s.a.v.s. njëherë
ishte hipur në devenë e tij, të cilën një person e mbante
kapur me litar e pastaj tha:

“Cila ditë është kjo?” Atëherë ne heshtëm dhe menduam se do ta emërtojmë me një emër tjetër. Ai vet tha: “A nuk është dita e therjes (së kurbaneve)?” Ne thamë: “Gjithsesi!” Ai tha: “E cili muaj është ky?” Ne përsëri heshtëm dhe menduam se do ta emërojmë me një emër tjetër. Ai prap tha: “A nuk është muaji Dhulhixhe?” Ne thamë: “Po, gjithsesi!” Ai tha: “Vërtet gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të ndaluar mes jush ashtu siç është i ndaluar në këtë ditë, në këtë muaj dhe në këtë vendin tuaj. Atëherë, ai që është prezent le t’ia komunikojë (këto fjalë) atij që nuk është prezent, se ndoshta ai që është prezent ia komunikon atij që është më i kuptueshëm se ai.”¹

Shpjegimi i hadithit

Këtë hadith Resulullahu s.a.v.s. e kishte thënë duke qenë hipur në devenë e tij, në Haxhin Lamtumirës, në ditën e Kurban Bajramit, në vendin Mina, në prani të mijëra sahabë.

Sa i përket uljes së Pejgamberit s.a.v.s. mbi deve kemi dy mendime:

- a) Lejohet ulja mbi kafshë kur ajo është ndalur vetëm për ndonjë nevojë të patjetërsueshme, ngase kemi edhe hadithe të tjera që ndalojnë qëndrimin ulur mbi kafshë pa nevojë. Kështu që nuk lejohet të qëndrohet ulur mbi kafshë kur ajo është në një vend, ngase kështu i bëhet dëm kafshës pa ndonjë arsye.

¹ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq. 158, nr. 67.

- b) Është e pëlqyeshme (mustehab) që hytbeja të bëhet nga një vend më i lartë për arsye se dëgjuesit e kanë më të lehtë t'i dëgjojnë dhe kuptojnë fjalët, këshillat, urdhrat dhe mesazhet e hatibit, i cili përveçse shprehet me fjalë, ndiqet edhe përmes lëvizjes së duarve dhe kokës.

Resulullahu s.a.v.s. u parapriu njerëzve me pyetje, madje kjo konsiderohet prej metodave të tij për të tërhequr vëmendjen se kemi të bëjmë me një çështje madhore, ku interesimi duhet të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm. Kjo e bën dëgjuesin më të përqendruar për pritjen e fjalëve dhe këshillave, se çka do të pasojë më tutje, çfarë përgjigjeje të japë etj.

Fjala e sahabëve në hadith سَكُنَّا - *kemi heshtur*, tregon më së miri për edukatën e tyre karshi të Dërguarit s.a.v.s.. Ata ishin të qetë, të dëgjueshëm dhe ndiqnin çdo shkronjë dhe fjalë që dilte nga të folurit e Resulullahut s.a.v.s.. Po ashtu ata pritnin se Resulullahu do të emëronte ditën dhe muajin me ndonjë emër tjetër, që nuk e kishin dëgjuar deri atëherë. Në një version tjetër është përmend shprehja: اللَّهُ وَ رَسُولُهُ أَعْلَمُ - *"Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri."*²

Këtu tregohet edukata dhe respekti i sahabëve, ngase ata e dinin fort mirë se ishte dita e therjes së kurbaneve dhe muaji i Dhu-l-hixhes. Pastaj, Resulullahu s.a.v.s. heshti derisa ata menduan se do t'i emëronte me tjetër emër. Heshtja e tij tregon për një pushim të shkurtër apo ndërprerje të fjalive,

² "Sahihul Buhari", vëll. III, fq. 573, nr. 1741.

gjë që e rrit intensitetin e përqendrimit. Heshtja është po ashtu metodë që luan rol të rëndësishëm në tërheqjen e vëmendjes së dëgjuesit.

Lexuesi mund të pyesë: Përse ka transmetime të ndryshme përderisa ngjarja është një?

Përgjigjja: Është gjë e natyrshme që në këto raste të kemi përgjigje të shumta për arsye se audienca ishte e madhe, ishin të pranishëm me dhjetëra mijëra sahabë. Dihet se në Haxhin Lamtumirës ishin njëqind e katërmbëdhjetë mijë sahabë. Kështu disa kur e dëgjuan pyetjen heshtën, e disa të tjerë thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri”, e disa të tjerë thanë se është *dita e ndaluar (dita e shenjtë)* - *يَوْمٌ حَرَامٌ*, siç ceket në versionin e tretë³. Disa transmetues dëgjuan përgjigjen e parë, disa dëgjuan përgjigjen e dytë, e disa të tjerë e dëgjuan përgjigjen e tretë, secili transmetues ka përcjellë atë që ka dëgjuar dhe vërtet kështu ndodhi që ngjarja të jetë e njëjtë, por përgjigjet të jenë të ndryshme dhe të shumta.

³ Po aty, nr. 1739.

Shenjtëria e gjakut, pasurisë dhe nderit

Sahabët nuk e pyetnin të Dërguarin s.a.v.s. për një arsye shtesë, se ishin të vetëdijshëm për pasojat e përgjigjeve, pasi mund të kishte shpallje nga Allahu xh.sh.. Në këtë kontekst kemi hadithin:

إِنَّ أَعْظَمَ الْمُسْلِمِينَ جُرْمًا مَنْ سَأَلَ عَنْ شَيْءٍ لَمْ يُحَرِّمْ فَحَرَّمَ مِنْ أَجْلِ مَسْأَلَتِهِ

“Krimin më të madh të muslimanëve e bën ai që pyet për një gjë që nuk është e ndaluar e për shkak të pyetjes së tij ajo ndalohej.”⁴

Në hadithin bazë kemi një konfirmim shtesë për shenjtërinë e gjakut, se nuk lejohet të derdhet gjak në mes besimtarëve. Po ashtu edhe pasuria e çdo besimtari është e shenjtë, ajo nuk guxon të vidhet, as të plaçkitet e as të përfitohet me mashtrime. Krahas gjakut dhe pasurisë është i shenjtë edhe nderi, autoriteti dhe dinjiteti i besimtarit. Nuk lejohet të bëjmë shpifje, përgojime dhe fjalë të ulëta në adresë të besimtarit. Këtu në hadith kemi një krahasim për nga shenjtëria në mes kohës, vendit dhe gjakut, pasurisë dhe nderit, edhe pse gjaku, pasuria dhe nderi janë më të shenjta se shenjtëria e kohës dhe vendit. Në realitet trajta krahasuese duhet të realizohet te krahasuesi në shkallë më të lartë se i krahasuari. Shkak për këtë është se shenjtëria e ditës, muajit dhe vendit të Mekës ka qenë e vërtetuar dhe e njohur te ata qysh prej kohës së injorancës, ata nuk dyshonin në shenjtërinë e tyre,

⁴ “Sahihul Buhari”, vëll. 22, fq. 257, nr. 6745.

kurse derdhjen e gjakut, vjedhjen e pasurisë, shkeljen e nderit vazhdonin t'i trajtonin si të lehta dhe jo të shenjta.

Pasi Resulullahu i pyeti sahabët, ua sqaroi dhe urdhëroi se është e detyrueshme që t'i përkushtohemi shenjtërisë së gjakut, pasurisë dhe nderit ashtu siç i përkushtohemi dhe kujdesemi për shenjtërinë e ditës së therjes së kurbanit, muajit Dhulhixhe dhe qytetit të Mekës. Nuk duhet bërë dallim në mes tyre, përkundrazi shenjtëria e gjakut, pasurisë dhe nderit të muslimanëve të mbetet në pedestalin më të lartë se koha dhe vendi. Në këtë drejtim Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

لَزَوَالِ الدُّنْيَا أَهْوَنُ عَلَى اللَّهِ مِنْ قَتْلِ رَجُلٍ مُسْلِمٍ

“Zhdukja e kësaj bote është më e lehtë për Allahun sesa mbytja (derdhja e gjakut) e muslimanit.”⁵

E gjithë bota dhe çfarë ka në të nuk e ka vlerën e gjakut të muslimanit, kuptohet nëse gjaku i tij derdhet në pafajësi dhe pa të drejtë. Këtë e hasim te pjesa e hadithit:

لِيُبَلِّغَ الشَّاهِدُ الْعَائِبَ – “... ai që është prezent le t’ia komunikojë (këto fjalë) atij që nuk është prezent...”.

Për shenjtërinë e gjakut dhe ndalesën e derdhjes së tij na e tërheq vërejtjen edhe i Dërguari s.a.v.s. përmes këtij hadithi në Haxhin Lamtumirës:

لَا تَرَجِعُوا بَعْدِي كُفَّارًا يَضْرِبُ بَعْضُكُمْ رِقَابَ بَعْضٍ

“Dhe kurrsesi mos u ktheni pas meje në jobesimtarë duke e vrarë njëri-tjetrin.”⁶

⁵ “Sunen Et-Tirmidhi”, vëll. V, fq. 275, nr. 1315.

⁶ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq. 205, nr. 118.

Si rregull është se: “Kur muslimanët fillojnë ta luftojnë njëri-tjetrin, atëherë kalojnë në jobesimtarë sepse nuk e lejon derdhjen e gjakut të muslimanit vetëm se jobesimtari. Myslimani nuk është e mundur të ngrejë armë kundër vëllait të vet, askush nuk ngre armë kundër myslimanit, vetëm jobesimtari, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. i konsideroi myslimanët që bëjnë luftë kundër njëri-tjetrit si jobesimtarë. Kjo çështje, në bazë të argumenteve relevante, ka sqarim. Kush e vret një mysliman duke pasur bindje se gjaku i tij është i lejuar, pa ndonjë arsyetim nga sheriat, atëherë ky është jobesimtar, i dalë nga feja islame. Por, nëse e vret me ndonjë interpretim të gabuar ose për qëllime pozite, pushteti ose sundimi, atëherë ka bërë kufër (mosbesim) që nuk e nxjerr jashtë fesë islame.”⁷

Në lidhje me këtë kemi edhe shumë ngjarje të pakuptimta që sot po zhvillohen në botën islame, në veçanti në Irak dhe Siri, ku jo rrallëherë po vriten në mënyrë masive me qindra myslimanë. Sunitët po ballafaqohen me shiinjte në njërën anë dhe me forcat tjera ushtarake prezente. Pejgamberi a.s. ka thënë:

سَبَابُ الْمُسْلِمِ فُسُوقٌ وَقِتَالُهُ كُفْرٌ

“Sharja e muslimanit konsiderohet mëkat i madh (shthurje), ndërsa luftimi i tij është mosbesim (kufër).”⁸

⁷ Shejh Muhamed Uthejmin, “Sherh Rijadu s-salihin”, vëll. II, fq. 499.

⁸ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq. 84, nr. 46.

Komunikimi i dijes mbetet obligativ

Hadithi bazë urdhëron për përhapjen dhe komunikimin e dijes, e në veçanti të dispozitave dhe principeve të fesë. Meqenëse hadithi ndërlidhet me shtyllën e pestë të Islamit, haxhin, atëherë kjo shtyllë duhet të merret dhe kryhet vetëm sipas veprimeve dhe porosive të Resulullahut s.a.v.s., i cili tha:

خُذُوا عَنِّي مَنَاسِكَكُمْ

*“Merrni nga unë rregullat e haxhit tuaj.”*⁹

Dijetarët thanë se këto fjalë janë të përgjithshme, disa prej veprimeve janë obligative, disa janë sunete, e disa të pëlqyeshme. Kjo thënie e tij është në nivel të njëjtë me thënien e tij në kryerjen e namazit:

صَلُّوا كَمَا رَأَيْتُمُونِي أُصَلِّي

*“Faleni namazin ashtu siç më shihni mua duke u falur.”*¹⁰

Sikurse ky hadith që i dedikohet namazit, hadithi para tij bënë fjalë për rregullat e haxhit (farzet, vaxhibet, sunetet, të pëlqyerat, të ndaluarat etj.).

Secili besimtar për aq sa ka dije duhet edhe ta komunikojë atë, gjithnjë duke respektuar nivelin dhe përgjegjësinë që mban. Hadithi tregon se disa dijetarë janë më kompetentë dhe më të shkathët në kuptimin e hadithit, dispozitave dhe fesë se disa të tjerë, të cilët e dëgjojnë dhe marrin drejtpërsë-

⁹ “Es-sunenu-l-kubra lil Bejhekiy”, vëll. V, fq. 125.

¹⁰ “Sahihu-l-Buhari”, vëll. III, fq. 7, nr. 595.

drejti. Edhe sahabët nuk janë të gjithë në shkallë të njëjtë të dijes, disa janë të shkallës së parë për nga kuptimi dhe meditim i haditheve, e disa të tjerë janë më të ulët. Po ashtu, disa dijetarë të vonshëm janë më të kuptueshëm dhe më me merita në hadith se disa që ndoshta e kanë marrë hadithin më herët drejtpërdrejt, edhe pse të tillët janë të rrallë, por që një gjë e tillë është e pamohueshme dhe e mundshme. Për këtë arsye nuk duhet të ndalemi në të kuptuarit e teksteve, por duhet bërë përpjekje dhe angazhim që secili prej nesh në bazë të mundësive t'i kuptojë ato, por gjithnjë në suaza të rregullave dhe normave të njohura të legjislacionit - shariatit islam. Çdo shmangie nga rregullat dhe normat e vërteta në të kuptuarit e teksteve konsiderohet devijim e jo kuptim i tyre.

JURISPRUDENCË ISLAME

Resul REXHEPI

RREGULLAT E FIKHUT PËRKITAZI ME IMAMIN, NAMAZIN ME XHEMAT DHE EZANIN*

Hyrje

Feja islame i ka kushtuar rëndësi të madhe faljes së namazit me xhemat. Kështu, duke e nxitur faljen e namazit me xhemat, Pejgamberi a.s. ka bërë të ditur se një veprim i tillë është njëzeteshtatë herë më i vlefshëm se sa namazi i falur individualisht. I Dërguari i Allahut, me një rast, siç transmeton Abdullah ibni Ymeri, kishte deklaruar:

* Ky punim është bazuar kryesisht në shkrimin e botuar në “*Takvim*”-in për 2009, të botuar nga Rijaseti i BI të BeH, Sarajevë, 2008 dhe mbi bazën e literaturës tjetër që është dhënë në referenca.

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ قَالَ: صَلَاةُ الْجَمَاعَةِ تَفْضُلُ
 صَلَاةَ الْفَذِّ بِسَبْعٍ وَ عِشْرَيْنَ دَرَجَةً

“Namazi i falur me xhemat është njëzet e shtatë herë më me vlerë se namazi i falur individualisht”¹.

Vetë Pejgamberi a.s. edhe para hixhretit sa ishte akoma në Mekë, ndonëse nuk kishte një vendfalje (mesxhid), i ka prirë xhematit në namaz, natyrisht fshehtas në shtëpinë e Erkamit, e mirënjohur në historinë islame si “Daru ‘l-Erkam”. Më vonë, me pranimin e Islamit nga ana e hazreti Ymerit, ashabët për herë të parë filluan të faleshin në Qabe me xhemat publikisht. Ndërkaq, pas hixhretit, në Medinë, namazi falej me xhemat pa ndonjë vështirësi. E si mos të falej namazi me xhemat, kur vet Pejgamberi a.s. kishte thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنْ النَّبِيِّ قَالَ: حِينَ يَخْرُجُ الرَّجُلُ مِنْ بَيْتِهِ إِلَى
 مَسْجِدِهِ، فَرَجُلٌ تُكْتَبُ حَسَنَةٌ وَ رَجُلٌ تَمْحُو سَيِّئَةٌ.

“Një person i cili del nga shtëpia me qëllimin për të shkuar në xhami, me njërin hap që hedh i shkruhet një sevap, kurse me tjetrin i shlyhet një mëkat”².

Kështu ka ndodhur me Pejgamberin a.s. sa ishte në gje-ndje të shëndosh, e kur qe sëmurë, përsëri pati marrë pjesë në xhemat, por jo si imam dhe qe falur pas Ebu Bekrit, deri në një të enjte të fundit, ndërsa qe thirrur ezani i namazit të jacisë dhe xhemati qenë tubuar, i Dërguari nuk kishte mundur

¹ Transmeton: Buhariu dhe Muslimi.

² Transmeton: Nesaiu dhe Ibn Hanbeli.

për t'ju bashkuar. Dhe, ndërsa të gjithë e prisnin, ai edhe në atë gjendje që ishte pyeste: “*A e fali xhemati namazin?*”, sepse ai më se miri e dinte rëndësinë e faljes së namazit me xhemat. Në pamundësi që të shkonte në xhami, sepse gjendja dukshëm i qe rënduar, aq sa kishte humbur edhe ndjenjat, e kishte lajmëruar Ebu Bekrin që t'i printe xhematit në namaz.³

Dhe jo vetëm kaq, por dispozitat islame shkojnë aq larg sa që përcaktojnë edhe mënyrën e faljes me xhemat edhe në çaste të rrezikshme lufte. Në Kuran, Allahu xh.sh. ka urdhëruar:

وَإِذَا كُنْتَ فِيهِمْ فَأَقَمْتَ لَهُمُ الصَّلَاةَ فَلْتُمْ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ مَعَكَ
وَلْيَأْخُذُوا أَسْلِحَتَهُمْ

“Dhe kur ti të jesh mes tyre e të drejtosh namazin për ta, me ty të qëndrojnë në namaz një pjesë e tyre duke marrë edhe armët pranë”.⁴

E pra, në qoftë se është vlerësuar kaq shumë falja e namazit me xhemat edhe në kushte lufte, kjo të jep të kuptosh se sa e virtytshme dhe e shpërblyer është kjo në jetën e rëndomtë. Prandaj, për këtë arsye, falja me xhemat është shndërruar në një shenjë dalluese dhe në simbol të Islamit dhe ka vazhduar kështu si një praktikë e pamënjanueshme qysh nga “epoka e lumtur” (*asru s-seadeh*) e deri në ditët tona dhe do të vazhdojë e duhet të vazhdojë kështu deri në Kiamet.

³ Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, vëllimi II, bot. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, 2017, f. 203.

⁴ Kuran, Nisa: 102.

I Dërguari i Allahut ka njoftuar se me sa më shumë xhemat të falët namazi aq më i dashur dhe i pranueshëm do të jetë për Allahun e Lartëmadhërishëm dhe aq më shumë sevape do të sjellë.

Shkenca juridike islame (fikh), duke u bazuar në Kuranin famëlartë, në hadithet e Pejgamberit a.s. dhe në praktikën e sahabëve, në hollësi i ka përpunuar rregullat të cilat kanë të bëjnë me faljen e namazit me xhemat. Këto rregulla, kryesisht kanë të bëjnë me personin i cili i prinë xhematit gjatë faljes dhe me ata që falen pas tij, pra me *imamin* dhe me *xhematlinjtë* (*muktedinjtë*).⁵

I. RREGULLAT E IMAMIT

عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ: لِيُؤَدَّنَ لَكُمْ خِيَارُكُمْ وَلِيُؤْمَكُم
قُرَّؤُكُمْ.

Transmeton Ibn Abasi se i Dërguari i Allahut ka thënë:
“Më të mirët mes jush le t’ju bëhen myezinë, kurse
ata që e njohin më mirë Kuranin le t’ju prijnë në namaz!”⁶

Termi *imam* ka disa kuptime, si: udhëheqës, prijës, shembull, yrnek, person që i prinë xhematit në namaz, i parë etj. Ndërkaq, *imameh* nënkupton detyrën e imamit, udhëheqjen dhe të udhëhequrit. Në literaturën e shkencës juridike islame

⁵ Teufik Muftić, *Arapsko-srpskohrvatski rječnik*, izdavač: Izvršni odbor Udruženja ilmiye u SR BiH, vëll. I, Sarajevë, 1973, f. 103-104.

⁶ Ebu Davud, *Salat*, 60.

flitet për dy lloje të udhëheqjes: udhëheqje e madhe dhe udhëheqje e vogël. Udhëheqje e madhe (*imameh kubra*) nënkupton funksionin e udhëheqësit fetar dhe politik të myslimanëve. Udhëheqje e vogël (*imameh sugra*), ndërkah, nënkupton udhëheqje në namaz, gjegjësisht lidhjen e namazit të *muktediut* me namazin e *imamit*⁷.

Personi i cili udhëheq xhematlinjtë në namaz, duhet t'i plotësojë kushtet e poshtëshënuara:

- *Të jetë mysliman (islami)*, sepse jomyslimani nuk mund të jetë imam, e gjithashtu nuk vlen për imam edhe ai që konsiderohet mysliman, por ka simptoma të kufrit, siç është f.v. mohimi i ringjalljes Ditën e Kiametit, mohimi i shefaatit, fyerja e Ebu Bekrit dhe e Ymerit r.a., etj.
- *Të jetë i mençur (el-aklu)*, sepse në mungesë të aftësisë mendore, namazi nuk është i vlefshëm, për këtë arsye edhe namazi i të dehurit nuk është i vlefshëm.
- *Të jetë i moshës madhore (bulug)*, pra të jetë në moshën e pjekurisë gjinore.⁸

⁷ *Muktedi (ar.)* - është personi i cili e falë namazin me xhemat i lidhur pas imamit. Në literaturën e fikhut përmendet edhe me termet *mu'temm* dhe *me'mum*. Më gjerësisht, shih: Vehbe Ez-Zuhejli, *El-fikhul islamijju ve edil-le-tuh*, pj. II, Daru 'l-fikr, Damask, 1996, f. 173.

⁸ Sipas shkollës juridike hanefite nuk lejohet që personi i moshës madhore të falë namaz pas personit të mitur (papjekuri gjinore), sepse personi i moshës madhore faljen e namazit e ka obligim për dallim nga i mituri i cili nuk e ka. Këtë fakt ata e argumentojnë me transmetimin e Abdullah ibn Mesudit dhe ibni Abasit: "*Fëmija (i mituri) nuk mund të bëhet imam deri sa të arrij moshën e pjekurisë gjinore*".

- *Të jetë mashkull* (dhukureh). Nuk bënë të falët mashkulli pas femrës, qoftë ai namaz farz ose edhe nafile. Mirëpo, në qoftë se xhematin e përbëjnë vetëm femrat, namazit mund t'i prijë njëra prej tyre, por veprimi i tillë është i papëlqyeshëm (mekruh).
- *Personi i cili arrin në namaz me vonesë (mesbuk) nuk mund t'i bëhet imam tjetrit⁹*. Ja një rast që mund të ndodh: Në qoftë se personi A arrin në xhemat me vonesë, kështu që pasi që imami të jep selam, ngritët për t'i falur rekatet e paarritura, në rast të tillë, nuk bënë që personi B, d.m.th. personi tjetër i cili nuk e ka arritur xhematin të falët pas personit A si imam. Pra, personi A nuk mund të jetë imam i personit B.
- Nuk mund të udhëheq namazin, gjithashtu, personi i cili e ka falur atë namaz në cilësi të imamit. Ky rregull vlen për namazet farz.
- *Të dijë të lexojë drejtë Kuranin*. Imami duhet t'i dijë rregullat e drejtëleximit të Kuranit dhe që i shqipton tingujt me saktësi, dhe, të mos jetë *sahibi yzër* (sahibi yzër është personi që ka ndonjë arsye fiziologjike).

⁹ *Mesbuk* - është personi i cili nuk e ka arritur një ose ma shumë rekate të namazit me xhemat. E, pra, ky person nuk mund të bëhet imam i të tjerëve për namazin që është duke e falur.

Lidhshmëria e namazit të imanit dhe muktedinjëve

Të falurit e namazit me xhemat, siç u tha më sipër, ka rëndësi të madhe. Për këtë flasin shumë hadithe të Pejgamberit a.s., dhe në veçanti hadithi tashmë i përmendur, i cili thotë se kryerja e namazit me xhemat është më i vlefshëm se ai individual për njëzeteshtatë herë. Të falurit e namazit me xhemat është pjesë përbërëse e Udhëzimit me të cilin ka ardhur Pejgamberi a.s..

Prezantimi i *muktediut* në xhemat nënkupton se ai namazin e tij e lidh me namazin e imanit. Pra, lidhshmëria e namazit të imanit me atë të muktedinjëve është karakteristikë e rëndësishme e namazit që falët me xhemat. Pejgamberi a.s., sipas transmetimit të Ebu Hurejres, ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ: الْإِمَامُ ضَامِنٌ وَ الْمُؤَدِّئُ مُؤْتَمَنٌ،
اللَّهُمَّ ارْشِدِ الْأَئِمَّةَ وَ اغْفِرْ لِلْمُؤَدِّينَ.

*“Imami është garantues (damin) për namazin e atyre që u prinë, kurse myezini është ai të cilit njerëzit i besojnë (mu’temen) në lidhje me kohët e namazit. O Zoti im! Jepu sukses imamëve (në atë që garantojnë) dhe fali myezinët (për gabimet e mundshme)”!*¹⁰

Kështu pra, imami është ai i cili kujdeset për namazin e tij dhe të xhematit që ai namaz të jetë në rregull. Për këtë arsye, nëse imanit i paraqitet ndonjë rrethanë sa që ai e prish

¹⁰ Transmetojnë: Shafiu, Ahmedi, Ebu Davudi, Termidhiu, Nesaiu, Ibn Hab-bani dhe Ibn Huzejme. Marrë nga Vehbe Zuhejli, vep. e cit., pj. I, f. 535. Më gjerësisht për këtë, shih edhe: Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, vëll. II, vep.cit., f. 215.

namazin (p.sh. e prish abdesin) para se ta merr tekbirin fillestar ose në momentin kur muktedinjtë e marrin atë tekbir, namazi do të konsiderohet i pavlefshëm, si për imamin ashtu edhe për xhematin. Në qoftë se *muktediu* është falur pas imamit, e pastaj, me të përfunduar namazi, e marrin vesh se imami është falur pa abdes ose në gjendje të papastër (xhunub), namazin duhet përsëritur.¹¹

Mirëpo, në qoftë se gjatë namazit imamit i paraqitet një rrethanë e caktuar e cila ia prish namazin, gjegjësisht në qoftë se imami nuk i plotëson të gjitha kushtet e namazit (shurutus-salah) dhe ato përbërëse (erkanus-salah), namazi i imamit do jetë i prishur, por jo edhe i muktedinjëve (xhematlinjëve). Ky rregull mbase vlen vetëm nëse muktedinjtë nuk e dinë për rrethanën e cila e prish namazin, gjegjësisht mungesën e ndonjërit prej kushteve ose pjesëve përbërëse të namazit. E, në qoftë se imami i ka njoftuar muktedinjtë për rrethanën që e prish namazin, - e cila i ka ndodhur imamit gjatë namazit, - ata janë të obliguar ta përsërisin namazin.

Leximi i Kuranit nga imami në namaz

Juristët hanefit rekomandojnë që imami duhet të merr tekbir pasi që myezini të thotë “*kad kameti-s-salatu*” (*namazi filloi!*), gjegjësisht ai duhet të merr tekbir sapo myezini ta përfundoj ikametin. Deri te një përfundim i tillë ata kanë ardhur duke u bazuar në komentimin e asaj që ka treguar Bilalli r.a. kur thotë se i kishte bërë ikamet Pejgamberit a.s. dhe

¹¹ Vehbe Zuhejli, vep. e cit., II, f. 197.

më pas i kishte thënë: “*Ja Resula-llah, mos më tejkalohet me amin!*” Nga kjo vetëkuptohet se Pejgamberi a.s. ka marrë tekbinin fillestar para se Bilalli të ketë mbaruar ikametin.¹²

Një prej karakteristikave të faljes së namazit me xhemat është edhe fakti se imami në raport me xhematin e merr përsipër leximin e Kuranit gjatë qëndrimit në këmbë. Xhabir bin Abdullahu r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

من كان له امام فقراءته (فقراءة الامام) له قرائه

“*Leximi i imanit është lexim edhe i personit i cili është lidhur pas imanit*”.

Pra, imami lexon pjesë nga Kurani, kurse xhemati e dëgjon atë në heshtje. Sipas Ebu Hanifes dhe Ebi Jusufit, këndimi nga xhemati në namazet ku imami këndon me zë është *mekruh tahrimen*, kurse në namazet ku këndon pa zë, është *mekruh*.

Pjesët tjera përbërëse të namazit, si: tekbi fillestar (*tek-biru 'l-iftitah*), qëndrimi në këmbë (*kijam*), përkulja (*ruku*), shkuarja në sexhde (*sexhde*), qëndrimi ulur (*teshehud*), - janë të obliguar t'i bëjnë edhe imami edhe *muktediu* (xhematliu). Imami e lexon me zë Fatihanë dhe një sure ose pjesë të një sure në namazin e xhumasë, në namazet e Bajrameve, në atë të sabahut dhe në dy rekatet e para të namazit të akshamit dhe të jaciesë. Në namazin e drekës, të ikindisë dhe të xhenazes, imami lexon në vete. Leximi në vete ose pa zë, lexohet në atë mënyrë aq sa nuk e dëgjojnë të tjerët.

¹² Ibid, f. 204-205.

Juristët islam kanë shqyrtuar edhe çështjen nëse imami duhet të thotë “Amin” pas përfundimit të Fatihasë, apo këtë e thonë vetëm muktedijntë? *Muktedi*, u mor vesh, është personi që falet pas imamit. Shumica dërmuese e juristëve janë të mendimit se imami duhet të thotë “Amin” pa zë. Të njëjtën e veprojnë edhe muktedijntë, pra e thonë “Amin”-in pa zë.

Në rast se imami gjatë leximit të pjesëve të Kuranit harron ndonjë ajet ose pjesë të ajetit, i lejohet muktediut që t’ia rikujtoj. Pas të rikujtuarit, imami e lexon pjesën e harruar. Në qoftë se imami ndërkaq, bënë ndonjë gabim tjetër, p.sh. ngri-tët me vonesë në rekatin e katërt, muktediu ia rikujton atij duke i thënë: “*Subhanall-llah*”, sepse me këtë imami e kup-ton se ka gabuar dhe mund ta përmirësoje me sehvi-sexhde.

Në namazet me xhemat, imami duhet të lexoj jo edhe aq gjatë, sepse në mesin e xhematlinjëve mund të ketë të tillë që nuk mund ta përballojnë. Këtë më së miri e ka përshkruar i Dërguari i Allahut, kur ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ قَالَ: إِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ بِالنَّاسِ فَلْيُخَفِّفْ،
فَإِنَّ فِيهِمُ السَّقِيمَ وَالضَّعِيفَ وَالْكَبِيرَ، فَإِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ لِنَفْسِهِ
فَلْيُطَوِّلْ مَا شَاءَ.

“Kur ndonjëri prej jush t’i prijë xhematit në namaz, le ta falë shkurt namazin, sepse në mesin e xhematit mund të ketë të sëmurë, të dobët dhe të moshuar. Ndërsa kur të falët vetëm, le ta zgjasë namazin aq sa të dojë!”

Zëvendësimi i imamit gjatë namazit

Është mirë, madje e rekomanduar, që mundësisht në safin e parë pas imamit, të falët dikush që është në gjendje për ta zëvendësuar imamin në rast nevojë.

Mund të ndodh që imami të mbetet pa abdes ose të mos mund ta vazhdoj leximin gjatë namazit. Në të tilla raste, lejohej zëvendësimi i imamit gjatë atij namazi. Imami duhet të tërhiqet nga mihrabi dhe do t'i jep shenj (isharet) dikujt tjetër që të del në vend të tij. Madje, edhe në rast se imami nuk i jep shenj ndokujt për zëvendësim, në qoftë se ai nuk është në gjendje të udhëheq xhematin, njëri nga të pranishmit (nga muktedijntë) mund të dalë para xhematit dhe të vazhdoj t'ju prijë në namaz.

Në rast se imami nuk është në gjendje për shkak të sëmundjes të vazhdoj të falët në këmbë, ai mund të ulët dhe ashtu të vazhdoj namazin deri në fund. Nëse mund ta bëjë këtë, atëherë nuk ka nevojë për zëvendësim (istihlaf). Lejimin e zëvendësimit të imamit gjatë namazit, juristët e kanë bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Sehl ibn Sead: “Pejgamberi a.s. me një rast kishte vajtur te Benu Amr b. Aufët që t'i pajtonte. Kur kishte hyrë koha e namazit, myezini i qe afruar Ebu Bekrit dhe e kishte pyetur: “A po ju prinë njerëzve në namaz që të bëjë ikamet? “Po!” - i kishte thënë Ebu Bekri dhe kishte filluar t'ju printe. Dhe gjerë sa ishin duke u falur, kishte mbërritur Pejgamberi a.s., ishte afruar dhe kishte qëndruar në saf, sa kohë që të pranishmit kishin filluar të bënin shenjë me duar. Ebu Bekri nuk kishte kthye kokën, por kur njerëzit kishin vazhduar akoma më shumë të bënin me duar, ai ishte kthyer dhe kishte vërejtur se

kishte hyrë Pejgamberi a.s.. Pejgamberi me një shenjë dore i kishte sinjalizuar që të vazhdonte më tej. Në atë moment, Ebu Bekri i ngriti duart e tij duke e falënderuar Allahun xh.sh. që Pejgamberi e kishte urdhëruar ashtu. Më pas, Ebu Bekri ishte tërhequr sa ishte drejtuar me tjerët në saf, ndërsa Pejgamberi a.s. kishte lëvizur më përpara për t'i udhëhequr në namaz. E, kur e kishte përfunduar namazin, qe kthyer kah Ebu Bekri dhe e kishte pyetur: *"O Ebu Bekr, kur të bëra me shenjë që ta vazhdoje namazin, pse nuk qëndrove në vend?"* Përgjigja e Ebu Bekrit qe e tillë që theksonte edhe respektin e tij ndaj Pejgamberit a.s. edhe rëndësinë e meritës dhe të kompetencës në pozitën e imamllekut: *"Sepse nuk ishte me vend që i biri i Ebu Kuhafes (d.m.th. ai vetë) t'ju prijë, sa kohë që Pejgamberi a.s. ishte aty i pranishëm!"*

E, pra, i tillë është imamlleku, në namaz para xhematit, ndërsa jashtë lider i shoqërisë, të interesohesh në vazhdimësi për hallet e brengat e xhematit dhe ta ndash gëzimin me ta.

Le ta themi edhe një herë se imami i parë në Islam ka qenë Muhamedi a.s. Këtë detyrë ai e ka mësuar nga meleku Xhibrili a.s.. Gjatë Mi'raxhit, Muhamedi a.s. u është bërë imam të gjithë pejgamberëve a.s.

II. Rregullat e pasimit të imamit në namaz (kudveh)

Llojet e muktedinjëve

Tri janë kategoritë e personave të cilët e falin namazin pas imamit: *mudrik*, *lahik* dhe *mesbuk*.

- **Mudrik** - është personi i cili e falë tërë namazin pas imamit.
- **Lahik** - është personi i cili hyn në namaz kur hyn edhe imami, mirëpo, për shkak të rrethanave të caktuara (p.sh. prishja e abdesit), ky person i lë një ose më shumë rekate. Kjo lënie e kësaj pjese të namazit, qoftë edhe nëse ky person është larguar për pak nga xhemati (p.sh. sa për ta ndërruar abdesin), nuk ndikon në të mos qenët muktedi-xhematli. Ndërkohë, *lahiku* pas rikthimit në namaz, do vazhdoj të falë nga aty ku ka dalë nga namazi, duke qëndruar në këmbë (kijam) aq kohë sa mund të lexohen tre ajete kuranore. Pra, ai nuk do të lexoj atë që lexon imami në kijam. Në qoftë se *lahiku* e arrin imamin, do të vazhdoj ta pasojë atë; në të kundërtën, vet do ta plotësoj namazin. Duke iu kushtuar kujdes këtyre rregullave, *lahiku* e gëzon vlerën e faljes së namazit me xhemat.
- **Mesbuk** - është personi i cili futet në namaz me xhemat me vonesë të një ose më shumë rekateve. Hyrja e tij në namaz dhe veprimet tjera të tij janë të kushtëzuara me llojin e namazit dhe me pjesën e namazit në të ci-

lën gjendet imami¹³. *Mesbuku* pjesën e lënë të namazit do ta kompensoj pasi që imami të ketë dhënë selam. Përndryshe, për dallim nga lahiku, *mesbuki* do të lexoj pjesë nga Kurani gjatë qëndrimit në këmbë (në kijam).

Është shumë e shëmtuar (*mekruh tahrimen*) që *mesbuki* të ngritet në këmbë për t'i plotësuar rekatet e lëshuara para se imami të jep selam, me përjashtim në raste të caktuara, si p.sh. kur koha e namazit është duke kaluar, ose kur bëhet fjalë për personin që është *sahibi yzër*. Në qoftë se ndodh që imami, pasi që të ketë dhënë selam, bënë sehvi-sexhde¹⁴ për shkak të ndonjë lëshimi gjatë namazit, ndërkaq personi që është vonuar në namaz (*mesbuki*) është ngritur për t'i falur rekatet e paarritura, duhet ta pasojë imamin dhe me të të bëjë sehvi-sexhde.

Kushtet e pasimit të imamit (kudveh) në namaz

Për të qenë pasimi i imamit në namaz i vlefshëm duhet plotësuar kushtet vijuese:

1. *Qëllimi (nijeti) që të pasohet imami gjatë namazit*. Muktediu duhet ta bëjë nijetin para se ta merr tekbinin fillestar duke thënë më vete se namazin do ta falë me imamin e caktuar. Nijetin e namazit e bënë në vete pa zë, dhe kjo

¹³ Nedim Begović, *Šerijatski propisi o džamijama*, "Takvim", 2007, Rijaseti i BI të BeH, Sarajevë, 2006.

¹⁴ Më gjerësisht, shih veprën e famshme të fikut hanefij: "*Multeka 'l-ebhur*" të autorit Ibrahim el-Halebi.

është më e lavdëruar, madje mundet që nijetin ta ketë vetëm në mendje. Nëse nijeti mungon, namazi i muktediut do të prishet, pavarësisht se e pason imamin në namaz. Të qenët e xhematit në rregull, sipas shumicës së juristëve, nuk është e kushtëzuar me atë që imami ta bëjë nijetin për udhëheqje të xhematit në namaz, sakaq, po, është kusht në mënyrë që vet imami ta arrijë vlerën e namazit me xhemat, sepse rregulli i fikhut është se veprat çmohen sipas qëllimit.¹⁵ Mirëpo, juristët hanefit konsiderojnë se nijeti i imamit për të udhëhequr xhematin në namaz është kusht për të qenë në rregull pasimi i imamit nga ana e femrave. Prandaj, rregulli i fikhut është se vlefshmëria e namazit të femrave pas imamit, varet nga nijeti i imamit që të njoftohet si imam edhe për femra, me përjashtim të namazit të xhumasë.

2. *Imami dhe muktediu ta falin të njëjtin namaz.* Rregulli është se muktediu i bashkohet xhematit me nijet që ta falë atë namaz të cilin e falë imami. Kështu, personi që dëshiron të falë namaz të detyruar (farz) nuk mund të falët pas imamit i cili falë namaz vullnetar (nafile). Gjithashtu, personi i cili falë një namaz farz, nuk mund të falët pas imamit i cili falë tjetër namaz farz (p.sh. nuk mundet të falët namazi i pafalur i drekës me xhemat pas imamit që po e falë namazin e ikindisë).

¹⁵ Rregulli është: “El-umûru bi mekâsidihâ”- “Çështjet vlerësohen sipas qëllimeve të tyre, dhe atë duke u bazuar në hadithin e mirënjohur të Pejgamberit a.s.: “Innemel-e’amalû bin-nijât ve innema likul-limriin ma neva...”. Më gjerësisht për këtë, shih: Ali Ahmed En-Nedevi, *El-Kavaidu ‘l-fikhijje*, Daru ‘l-kalem, Damask, 2000.

3. *Imami të qëndroj para muktediut.* Shumica e juristëve konsiderojnë se shputa e muktediut nuk guxon të qëndroj paralel ose edhe para shputës së imamit, në të kundërtën, namazi i muktediut nuk do të jetë në rregull. Ky qëndrim bazohet në hadithin e Pejgamberit a.s.: “*Imami është vendosur për ta pasuar/ndjekur atë*”. Në rast se muktediu qëndron para imamit, atëherë detyrohet që të tërhiqet mbrapa në mënyrë që ta pasoj imamin. Në qoftë se muktediu falet pranë (paralel) me imamin, ky veprim është mekruh.
4. *Imami dhe muktediu të falën në të njëjtin vend.* Pasimi i imamit nuk do të jetë i vlefshëm në qoftë se në mes të imamit dhe muktedinjëve ka rrugë nëpër të cilën mbase mund të kalojë ndonjë makinë, ose lumi, ose rreshti (safi) i femrave, të paktën, nuk është i ndarë nga ai i meshkujve me ndonjë perde. Këtu bënë përjashtim falja e namazit në Dy Haremet (Mekë dhe Medinë) ku mund të ndodh që dy grupet e atyre që janë duke u falur i lidh xhemati që janë duke u falur në rrugë.
5. *Muktediu ta përcjell imamin.* Argument për këtë kusht është transmetimi në të cilin Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Imami prinë në namaz dhe atë duhet përcjellur. Kur imami ta thotë tekbirin, thojeni edhe ju, kur imami të bie në shexhde, bini edhe ju; kur imami të ngritët, ngrihuni edhe ju, e kur imami të shqipton: SemiAllahu li men hamideh, ju thoni: Rabbena ve leke ‘l-hamdu. Nëse imami falët ulur, ashtu faluni edhe ju!*”¹⁶. Prandaj, muktediu

¹⁶ Transmeton: Muslimi. Shih edhe: “*Takvim*” për 2009, të botuar nga Rijaseti i BI të BeH, Sarajevë, 2008.

është i obliguar ta përcjellë imamin në namazet farz dhe vaxhib. E pra, në qoftë se muktediu, bie fjala, shkon vet në ruku pa e pasuar imamin, detyrohet që atë rekat ta plotësoj pasi imami të jep selam. Nëse muktediu këtë nuk e bënë, namazi i tij është prishur. Në qoftë se muktediu ngritët nga sexhdeja para imamit, ose shkon në ruku para imamit, është i detyruar të kthehet në pozitën e mëparshme duke vazhduar ta pasojë imamin. Nëse nuk vepron në këtë mënyrë, namazi i tij nuk është në rregull. Pejgamberi a.s. posaçërisht iu ka tërhequr vërejtjen ashabëve të tij që të mos bëjnë veprime të namazit para tij, me këto fjalë: *“Njerëz, unë jam imami juaj e mos më tejkaloni në ruku ose sexhde, as mos më tejkaloni në qëndrimin në këmbë dhe as në përfundim të namazit, sepse unë shoh para meje, si dhe pas meje”*.

Nëse në momentin e pasimit të imamit muktediu e bënë ndonjë vaxhib të namazit, do ta mbaron atë, e pastaj do të vazhdoj ta pasojë imamin. Me këtë rast, muktediu nuk e braktis pasimin e imamit, por vetëm e prolongon-e shtynë atë. Le ta ilustrojmë me një shembull që mund të ndodhë gjatë namazit: Imami ngritët në rekatën e tretë, para se muktediu të ketë mbaruar *teshehudin* në ndejën e parë, i cili është vaxhib, ose siç ndodh shpesh herë, muktediu mund të gjendet në situatën kur imami jep selam para se muktediu të ketë mbaruar leximin në uljen (tehijjatin) e fundit. Me këtë rast, muktediu do ta mbaron leximin e teshehudit (jo edhe leximin e salavateve dhe të duasë, sepse ato janë synet), e më pastaj do të jep selam.

Muktediu në disa raste nuk është i obliguar ta pasojë imamin:

- a) Kur imami merr tekbire ma shumë se ç'duhet në namaz të Bajramit ose të xhenazes.
 - b) Kur imami, nga harresa, ngritët në këmbë (në kijam) pas uljes së fundit në namazet farz. Me atë rast, muktediu i sugjeron imamit se ka gabuar. Nëse imami ulët në tehiyyat, duhet të bëjë sehvi-sexhde dhe ta përfundoj namazin. Në qoftë se ndodh që edhe imami edhe muktediu ngritën në rekatin shtesë (të pestin) pa ndënjur pas rekatit të katërt në ulje të fundit, më pas e bëjnë edhe sexhdën e atij rekati, namazi i tyre konsiderohet i prishur, prandaj atë namaz duhet ta rifalin.
6. Juristët hanefit kanë vëndosur edhe një kusht shtesë e që është kujdesi në radhitjen e safave-radhëve (tertibu s-sufuf) në xhemat. Në të vërtetë, synet i Pejgamberit ka qenë që safat në xhemat të ndjekin këtë renditje: meshkujt, pastaj fëmijët meshkuj, e më pastaj femrat. Hanefijtë konsiderojnë se radhitja e safave në këtë mënyrë është farz¹⁷. Pasojë e këtij qëndrimi është rregulli i hanefitëve se femra e cila qëndron në namaz pranë mashkullit ose para tij, ia prish namazin atij mashkulli. Në qoftë se një femër gjendet në saf me meshkujt, ia prish namazin një mashkulli në të djathtë, njërit në të majtë, dhe njërit pas saj. Nëse janë dy femra në të njëjtin saf me meshkuj, namazin ia prishin një personi në të djathtë, një në të majtë,

¹⁷ Hanefitët mbështetën në transmetimin e Ibni Mesudit r.a. në të cilin ai për femrat thotë: “Vendosni ato prapa, sepse Allahu ashtu ka urdhëruar, d.m.th. ashtu ka urdhëruar të veprohet për në namaz”.

dhe dy personave prapa tyre, dhe kështu me radhë. Megjithatë, edhe ky rregull është i kushtëzuar me sa vijon: a) që të bëhet fjalë për femër që i ka shtatë e më shumë vjet (mumejjize), b) të jetë e aftë mendërisht dhe e cila namazin e ka obligim, c) të bëhet fjalë për namazin me të gjitha pjesët përbërëse të tij, përfshirë edhe rukunë dhe sexhdet (që nuk është rast te namazi i xhenazes).

Pozita (qëndrimi) i imamit dhe i xhematit (muktedinjëve)

Pozita e imamit dhe e xhematit në namaz dallon sipas situatave vijuese:

1. Nëse imami e falë namazin me një person (muktedij), do ta vendos atë në krahun e tij të djathtë,
2. Nëse xhematin e përbëjnë, përveç imamit, një mashkull dhe një grua, mashkulli do të qëndrojë pranë imamit pak mbra-pa e jo paralelisht me të, kurse gruaja plotësisht pas tyre.
3. Në qoftë se xhematin e përbëjnë, përveç imamit, dy e më shumë meshkuj, ata pozicionohen pas imamit në saf-rresht të veçantë e jo paralelisht me imamin. Në rast se vendfalja është e vogël, imami mund të qëndrojë në mes të dy xhematlinjëve duke u vendosur para dy xhematlinjëve aq sa e lejon vendi.
4. Në qoftë se xhematin e përbëjnë vetëm femrat, gruaja që do t'iu prijë në namaz do të pozicionohet në mes të safit të parë, pa qëndruar para safit.¹⁸

¹⁸ Ma gjerësisht, Vehbe Zuhejli, vepra e cit.

Shtrohet pyetja: A është në rregull namazi i personit i cili falët në xhami, pas safave të formuar? Shumica e juristëve konsiderojnë se namazi i personit të tillë është në rregull, por, megjithatë është mekruh. Në të vërtetë, nga Enes bin Maliku transmetohet të ketë thënë: *“Pejgamberi a.s. mua dhe një të varfëri na ka vendosur që të faleshim pas tij, kurse nënën time, Umme Seleme, e ka vendosur që të falej pas nesh”*. Hadithi tregon se Umme Seleme që falur e vetme në saf pas dy vetave që janë falur para saj.

Ndërkaq, hadithin - kur Pejgamberi a.s. kishte vërejtur se si një njeri po falej i vetëm pas safave, ndaj dhe e kishte urdhëruar që ta përsëriste namazin, sepse *“la salate limunferidin halfe s-saffi”* - *“nuk ka namaz ai që falët i vetmuar pas safit”*, - juristët hanefit e interpretojnë në atë mënyrë që personi i tillë nuk e arrin sevapin e plotë të namazit me xhemat.

Justifikimet për mosfaljen e namazit me xhemat

Sipas hanefijve dhe malikijve, falja me xhemat e namazeve farz, me përjashtim të namazit të xhumasë, është synet i fortë (*synneti muekkede*) me fuqinë e vaxhibit për meshkujt që kanë mundësi fizike.¹⁹ Prandaj, falja e namazeve me xhemat duhet ndjekur rregullisht, nëse nuk ekziston ndonjë pengesë e justifikueshme për këtë. Justifikimet që do ta bënin *mubah* mosndjekjen e xhematit janë:

¹⁹ Ali Zaimi-Resul Rexhepi-Jusuf Zimeri, *Ilmihali i zgjeruar*, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2018, fq. 241.

1. Sëmundjet që e bëjnë mubah tejemumin, si f.v. paraliza.
Në rast se personi ka pësuar paralizë të gjymtyrëve dhe nuk ka mundësi të ecë, atëherë nuk është i obliguar të marrë pjesë në faljet kolektive.
2. Pleqëria e thellë aq sa personi nuk mund të ec.
3. Frika nga ndonjë sulm i padrejtë (i papritur),
4. Shiu i rrëmbyeshëm, përmbytja, kur është në përmasa të tilla sa që paraqet rrezik, të ftohtit dhe errësira ose nxeh-tësia (temperatura) shumë e lartë.
5. Bora e madhe, sa që ecja paraqet rrezik për jetën.
6. Marrja me përgatitjen e xhenazes,
7. Kërkimi i të humburit-ve,
8. Kujdesi për një të sëmurë i cili nuk mund të lihet vetëm.
Nëse është kujdetar i një të sëmuri dhe me largimin e tij sëmundja mund t'i rëndohet, ose kur i sëmuri ka nevojë për kujdesje të vazhdueshme.
9. I privuari nga liria (i burgosuri).
10. Verbëria, në rast se nuk ka asnjë person që mund ta shoqëroj deri në vendin e faljes, atëherë detyrimi i faljes kolektive bie. E, nëse gjendet dikush që ta ndihmojë, atëherë sipas dy imamëve, është i detyruar t'i bashkohet xhematit.
11. Edhe personi i cili, megjithëse dëshiron të marrë pjesë rregullisht në xhemat, pengohet si rrjedhojë e një pengese të justifikueshme, e fiton të mirën përkatëse sipas njetit që ka²⁰.

²⁰ Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, vëll. II, vep.cit.; Ali Zaimi-Resul Rexhepi-Jusuf Zimeri, *Ilmihali i zgjeruar*, vep.cit., f. 241-242.

III. Rregullat e ezanit

Nocioni, baza juridike dhe rëndësia e ezanit

Ezani ka një rëndësi të veçantë si në jetën adhurimore të myslimanëve ashtu edhe në kulturën dhe qytetërimin islam.

Ezan do të thotë “njoftim, lajmërim, thirrje” kurse në kuptimin terminologjik e ka këtë kuptim: “thirrje (informim) i veçantë i myslimanëve për faljen e namazeve farze dhe njoftim për hyrjen e kohës së namazit”. Ezani, siç dihet, nuk thirret për namazin e xhenazes, namazin e Bajrameve, namazin e vitrit dhe namazet nafle.

Në fillimet e para të Islamit, ezani nuk thirrej siç e thërrasim ne sot. Gjatë kohës sa Pejgamberi a.s. ishte në Mekë falej namazi farz, e edhe kur shkoi në Medinë jo se u mendua për ndonjë mënyrë të veçantë për të njoftuar për kohët e namazit. Kjo ndoshta edhe për faktin se falja nuk bëhej me xhemat. E pasi që Pejgamberi a.s. u vendos në Medinë, për një farë kohe u përdorë mënyra e lajmërimit nëpër rrugë me fjalët “*salah, salah*” (*namazi, namazi*) ose “*es-salatu xhamia*” (*tubohuni për në namaz*), por, me kalimin e kohës, u pa se kjo ishte e pamjaftueshme. Në vitin e parë të hixhretit, në Medinë, kur përfundoi ndërtimi i Xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe kur myslimanët filluan të grumbulloheshin rregullisht dhe të falnin namazin me xhemat, Pejgamberi a.s. filloi të diskutonte me shokët se ç’duhej bërë për të lajmëruar se kishte hyrë koha e një namazi dhe koha për faljen e tij me xhemat. Më në fund, duke u mbështetur në të njëjtën ëndërr të parë në të njëjtën natë nga disa ashabë, teksti i pranuar për ezan u thirr për herë të parë për të lajmëruar namazin e sa-

bahut nga Bilalli, i cili hipi në çatinë e një shtëpie më të lartë, duke u bërë ezani, kështu, shenjë e fesë islame.²¹

Përndryshe, ezani ka mbështetje në Kuran dhe në synetin e Pejgamberit a.s.. Allahu i Gjithëmëshirshëm ka urdhëruar duke thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O besimtarë! Kur të thirret për namaz ditën e xhuma, lëreni shitblerjen dhe nxitoni në kryerjen e namazit, kjo, - në qoftë se e dini, - është më e mirë për ju”.²²

Nga ana tjetër, ka një numër të konsiderueshëm të haditheve që flasin lidhur me ezanin. Me një rast, Pejgamberi a.s., kishte thënë:

*“Kur të vjen koha e namazit, le ta thirr ndokush ezanin, kurse në namaz le t’ju prijë më i vjetri prej jush”.*²³

Ezani ka vlerë të madhe, kurse myezinit i dhuron shpërblim të madh. Ezani është njëri prej syneteve të forta (synneti muekkede), por arrin deri në gradën e vaxhibit, nëse në një zonë nuk thirret ezani fare dhe atë për pesë kohët e namazit dhe për namazin e xhumasë për meshkuj, e jo edhe për femra sepse është mekruh.

²¹ Grup autorësh, *Udhërrëfyese i një myslimani-adhurimet*, Shtëpia botuese “Prizmi”, Tiranë, 2010.

²² Kuran, Xhum’ah: 9.

²³ Transmeton: Buhariu në “Xhami’u s-sahihu ‘l-muhtesar”.

Kushtet e ezanit

Kushtet për thirrjen e ezanit janë si vijon:

- Hyrja e kohës së namazit. Duke qenë se ezani është lajmërim për hyrjen e kohës së namazit, nuk është në rregull që myezini ta thirr para hyrjes së kohës. Në qoftë se këtë gabimisht e ka bërë, ezanin duhet përsëritur.
- Thirrja e ezanit bëhet ekskluzivisht në gjuhën arabe.
- Që ezanin ta dëgjojë një pjesë e xhematit, nuk duhet ta dëgjoj ndokush kur atë e thirr një person që do vet me e falë atë kohë të namazit (munferid).
- Të respektuarit e renditjes së fjalëve gjatë thirrjes së ezanit, duke e ndjekur Synetin e Pejgamberit a.s.²⁴
- Që ezanin ta thirr një person; nuk është në rregull në qoftë se një myezin e thirr një pjesë të ezanit e tjetri pjesën tjetër.
- Juristët hanefit konsiderojnë se është *mekruh tahrimen* që ezanin ta thirr personi i cili nuk i plotëson këto kushte: të jetë i aftë psiqikisht, të jetë mashkull, të ketë më shumë se shtatë vjet, ndonëse juristët malikij, shafij dhe hanbelij konsiderojnë se këto kushte kanë të bëjnë me vlefshmërinë e ezanit²⁵.

²⁴ Në qoftë se eventualisht nuk është respektuar renditja e fjalëve, ezani është i vlefshëm sipas juristëve hanefit dhe malikij, por konsiderojnë se është shumë e pahijshme (mekruh), prandaj në të tilla raste ezani është e dëshirueshme që të përsëritet. Shih: Ali Ahmed En-Nedevi, *El-Kavaidu 'l-fikhijje*, vepr. e cit.

²⁵ Më gjerësisht, shih: Vehbe Zuhejli, vep. e cit., f. 539-542.

Synetet e ezanit

Synetet që kanë të bëjnë me thirrjen e ezanit janë si më poshtë:

- Që myezini ezanin ta thirr me zë më të lartë dhe melodik, sepse qëllimi i ezanit është që njerëzit t'i lajmëroj për arritjen e kohës së namazit dhe t'i përfitojë zemrat e tyre për të vajtur në xhemat.
- Që myezini ezanin ta thirr ngadalshëm, me pauza ndërmjet fjalive, për dallim nga ikameti të cilin është synet më e thënë më shpejtë.
- Që me rastin e thirrjes së ezanit myezini të kthehet në drejtim të Kibles, sepse ashtu kanë vepruar edhe myezinët e Pejgamberir a.s. Kur myezini të thotë “hajjale-s-salah”, kokën e kthen pak djathtas, kurse kur të thotë “Hajjale-l-felah”, kokën do ta kthej pak majtas.
- Që ezanin ta thirr në minare ose në një vend paksa më të ngritur.
- Që ezanin ta thirr në fillim të hyrjes së kohës së namazit, në mënyrë që njerëzit të përgatitën për falje të namazit.

Ka edhe synete të tjera, por këto janë më kryesoret.

Myezini-sipas Syneetit të Pejgamberit a.s., duhet t'i posedojë këto cilësi:

- Të jetë i aftë psiqikisht, i moshës madhore dhe mashkull;
- Të jetë i ndershëm dhe i devotshëm;
- T'i dinë rregullat (synetet) e ezanit;
- Ta thirr me abdes ezanin;
- Të ketë zë të mirë;

- Ta thirr ezanin vetëm në një xhami për një kohë të namazit.
- Lënia e syneteve të përmendura është e shëmtuar-mekruh. Përveç kësaj, juristët hanefit e llogarisin të shëmtuar (mekruh) edhe bërjen këtyre veprimeve gjatë thirrjes së ezanit ose krahas thirrjes së tij:
- Në qoftë se gjatë thirrjes së ezanit e zgjatë ma shumë se sa duhet ose për shkak të melodisë ia ndryshon edhe fjalët e ezanit ose kuptimin e tyre.
- Lëvizja-ecja dhe biseda gjatë thirrjes së ezanit.

Duke qenë se qëllimi i ezanit është lajmërimi i hyrjes së kohës së namazit, kjo mund të bëhet edhe me thirrjen e ezanit përmes altoparlantit. Mirëpo, meqë ezani e ka edhe dimensionin e ibadetit për faktin se është i lidhur me namazin, s'do mend se më mirë është që sa më shumë të respektohen synetet e tij.

Si duhet vepruar gjatë thirrjes së ezanit dhe pas përfundimit të tij

Gjatë thirrjes së ezanit duhet ndërprerë çdo aktivitet, bisedën, madje nuk lejohet edhe me i dhënë selam ndokujt. Ezanin duhet dëgjuar me vëmendje e fjalët e tij duhet përsëritur, pra duhet ndjekur myezinin dhe në heshtje duhet përsëritur fjalët e ezanit pas myezinit. Ebu Seid El-Hudari transmeton thënien e Pejgamberit a.s.: *“Kur ta dëgjoni thirrjen (për namaz), thoni ashtu siç thotë myezini”*. E pra, dëgjuesi duhet t'i përsëris fjalët e ezanit pas myezinit, e kur myezini të thotë “hajjales-salah”, ai thotë: *“la haule ve la kuvvete il-la bil-*

lahi ‘l-alijji ‘l-adhim”. Kur ta dëgjion fjalën “hajjale ‘l felah”, thotë: “Ma shaAllahu kane ve ma lem jeshe’ lem jekun”. E kur të thotë: “Es-salatu hajrun minen-neumi”, duhet thënë: “sadakte ve bererte ve bi ‘l-hakki natakte”. Pas përfundimit të ezanit, mirë është të lexohen në vete salavate mbi Pejgamberin a.s. si dhe duaaja, të cilën e transmeton Xhabir bin Abdullahu:

بسم الله الرحمن الرحيم

اللَّهُمَّ رَبَّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ

وَالْفُضِيلَةَ وَالدرَجَةَ الرَّفِيعَةَ وَأَبْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتُهُ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Zoti ynë, Zoti i kësaj thirrje të plotë dhe namazit që do të falët, dhuroja Muhamedit vendin merititor dhe gradë të lartë. Dërgoje atë në pozitë falënderuese të cilën Ia ke premtuar!”

Pas kësaj, mirë është me iu drejtua Allahut me lutje për falje në këtë dhe në botën tjetër. Nuk duhet harruar se Pejgamberi a.s. në një hadith të tij ka thënë: “*Lutja në mes të ezanit dhe ikametit nuk kthehet*”. Ashabët kishin pyetur: Çka do të lutemi, o i dashuri Allahut? Ai ishte përgjigjur: “*Kërkoni nga Allahu falje e shëndet në këtë dhe në botën tjetër*”.²⁶

E, pra, me anë të ezanit i njoftohet popullit se ka hyrë koha e namazit i cili do të falët me xhemat, shpallet madhështia e Allahut, njoftohet se Pejgamberi a.s. është i dërguar

²⁶ Marë nga: “Subulus-selam”.

Allahut dhe se namazi është porta e rrugës së shpëtimit. Meqenëse kohët e namazit janë të rregulluara sipas rrotullimit të tokës rreth boshtit të saj, gjatë 24-orëve nuk ka asnjë moment e të mos të thirret ezan diku në botë.

Pejgamberi a.s. lidhur me ezanin me një rast ka thënë: *“Kur fillon thirrja e ezanit për namaz, shejtani kthen shpinën dhe ikën”*.²⁷ Natyrisht, ezani i krijon shqetësim djallit dhe shpirtrave djallëzor, kurse e qetëson besimtarin që e përcjell me vëmendje. Jo rastësisht, Pejgamberi a.s. nuk i ka thënë hazreti Bilallit ta zëmë “thirre ezanin”, por i ka thënë: *“Eri-hna ja Bilal”* (*“Na qetëso, o Bilal!”*)

Kur jemi këtu, duhet pasur kujdes edhe në sa vijon:

Namazi duhet të falët me të hyrë koha e tij, dhe kjo është më e mira, e te namazi i akshamit pauza në mes të ezanit dhe ikametit më së shumti mund të jetë aq sa mund të lexohen tre ajete të shkurta, d.m.th. një pauzë fare e shkurtër.

Njohja e rregullave të mësipërme, na lejojnë të nxjerrim përfundimet se ato në fakt janë në funksion të:

- Që namazi me xhemat të bëhet në mënyrën sa më të rregullt dhe më të kompletuar;
- Pasimi i praktikës së Pejgamberit a.s. dhe ashabëve të tij në shumë detaje dhe finesa të ezanit, ikametit, namazit etj.;
- Arritja e vlefshmërisë - sevapit të xhematit, madje edhe në ato situata kur muktediu nuk e falë tërë namazin me imam;

²⁷ Transmeton: Muslimi, kapitulli *“Salat”*, 15.

- Lehtësimi besimtarëve;
- Forcimi i bashkimit të besimtarëve;
- Të merituarit e faljes së mëkateve dhe shpërblimeve të Allahut xh.sh..

Në vend të përmbylljes

Sado që vlera e xhematit mund të realizohet edhe me një njeri dhe që namaz me xhemat mund të falët edhe me njerëzit e shtëpisë, kjo nuk është e njëvlershme me shkuarjen në xhami dhe me pjesëmarrjen në një xhemat më të madh. Shumë hadithe tregojnë për rëndësinë e madhe që ka xhemati. Me një rast, Pejgamberi a.s. është shprehur: *“Po që se tre vetë ndodhën bashkë në një fshatë ose në një fushë dhe nuk falin namazin me xhemat, shejtani bëhet zotërues mbi ta. Prandaj, mos u ndaj prej xhematit, sepse delen që ndahet nga tufa e hanë ujku!”*²⁸ Kurse në një hadith tjetër, lidhur me braktisjen kolektive të namazit, - e që është një veprim i gabuar dhe me pasoja të rënda, - Pejgamberi a.s., pohon: *“Betohem në Allahun i Cili e ka në dorë frymën time se kam menduar që të urdhëroj të mblidhen dru për të ndezur zjarr, pastaj, pasi të urdhëroj të thirret ezan për namaz dhe të caktoj dikë për imam, të shkoj t’ua djeg shtëpitë atyre që s’vijnë për në namazin me xhemat!”*²⁹

Namazi me xhemat është strehim në mëshirën e Allahut xh.sh. Shpërblimin për këtë Pejgamberi a.s. e shpreh:

²⁸ Transmeton: Ebu Davud, “*Salat*”, 47.

²⁹ Transmeton: Buhariu, “*Edhan*”, 29, 34; Muslimi, “*Mesaxhid*”, 251-254

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ قَالَ: مَنْ عَدَا إِلَى الْمَسْجِدِ وَ رَاحَ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُ
نُزُلَهُ مِنَ الْجَنَّةِ كُلَّمَا عَدَا أَوْ رَاحَ

*“Kush shkon në xhami në mëngjes dhe mbrëmje, çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje Allahu i përgatit një vend në Xhenet!”*³⁰

Nuk ka dyshim se shpërblimi më i madh i faljes së namazit me xhemat është për personin i cili e ka arritur imamin bashkërisht me xhematin, pra prej tekbitit fillestar. Kjo vërtohet me hadithin e transmetuar nga Enesi se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kush e falë namazin në xhemat me imam, duke e zënë tekbitin fillestar, atij i shkruhen dy shpëtime, shpëtimi nga zjarri i Xhehenemit dhe shpëtimi nga hipokrizia.”*³¹

³⁰ Më gjerësisht, shih: Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, vëll II, vep. cit., f. 203 .

³¹ Hadithin e transmeton: Termidhiu. Shih: Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve, vëll. II*, vep.cit., si dhe Ali Zaimi-Resul Rexhepi-Jusuf Zimeri, *Ilmihali i zgjeruar*, vep.cit., f. 241-242.

JURISPRUDENCË ISLAME

Jusuf ZIMERI

MALLI- KAPITALI PËR TË CILIN JEPET ZEKAT

Hyrje

Zekati në kuptimin linguistik nënkupton: *pastrim, rritje, shtim të pasurisë*, kurse në aspektin terminologjik të sheriatit islam: ***“Shpronësimin për hir të Allahut të një pjese të caktuar të pasurisë, nga pasuria e veçantë, për llogari të personit (institucionit) të veçantë që e ka përcaktuar Ligjvënësi (Allahu xh.sh.).”*** Nga kuptimi i nocionit “ar. Zekat” vërejmë se ekziston harmonizimi dhe lidhshmëria e plotë mes kuptimit linguistik të “Zekatit” dhe atij terminologjik, sepse përmes shpronësimit të një pjese të caktuar të pasurisë në llogari të atyre kategorive që Ligjvënësi e ka lejuar t'u jepet, bëhet jo vetëm pastrimi i pasurisë, por edhe pastrimi shpirtëror dhe zemëror i besimtarit islam, sepse pasuria e dhënë për hir të Allahut xh.sh. shton vlerën dhe bereqetin e pasurisë së ngelur.

Nëse institucionin e zekatit e kundrojmë nga aspekti i metodologjisë se si përshkruhet në argumentet autentike islame, me lehtësi nënkuptojmë se zekati para së gjithash është adhurim (ibadet) i ligjësuar nga Krijuesi Absolut, që vetvetiu nënkupton edhe rregullimin dhe sistemimin e dimensionit praktik duke përcaktuar mënyrën pragmatike të kryerjes së këtij ibadeti. Allahu i Plotfuqishëm thotë: ***“Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’ua shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon e sheh.”*** (El Bekare: 103)

Zekati jo rastësisht vlerësohet shtylla esenciale e Islamit për të cilën Pejgamberi a.s. në hadithin e regjistruar në sahihun e Imam Buhariut me transmetim nga Abdullah ibn Omeri thotë: *“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi a.s. është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e Haxhit për ata që kanë mundësi”*. Nga ky hadith autentik nënkuptojmë se shtylla e parë që është shehadeti (dëshmia) është parametri pa të cilin nuk mund të bëhet vlerësimi i asnjë veprimi për qenien njeri. Kurse sa u përket katër shtyllave tjera që i përmend hadithi, vërejmë se dy prej tyre ndërlidhen drejtpërdrejt me qenien e njeriut, janë adhurime trupore-fizike siç janë, namazi dhe agjërimi, e kjo nënkupton se askush nuk mund që këto dy ibadete (adhurime) t’i kryejë për tjetrin, kurse dy shtyllat e tjera janë adhurime (ibadete) që ndërlidhen edhe me qenien fizike e shpirtërore të njeriut, por lidhen edhe me pasurinë e tij siç janë zekati dhe haxhi. Pra, namazi dhe agjërimi janë detyrim (farz) si për të pasurin ashtu edhe për të varfrin, kur-

se zekati dhe haxhi janë vetëm për të pasurit e jo edhe për të varfrit.

Nga kjo që thamë, gjithsesi vërehet se në parim çështja e zekatit është adhurim dhe detyrim (farz) dhe pikërisht për këtë arsye nijeti për dhënien e zekatit është kusht i vlefshmërisë së zekatit. Intenca e Zekatit nuk është humanizmi apo lëmosha siç po tentohet të përshkruhet, edhe humanizmi dhe lëmosha janë pjesë të zekatit. Gjykojmë kështu ngase lëmosha e rëndomtë dhe humanizmi mund dhe duhet të implemntohet nga të gjitha kategoritë e njerëzve në shoqëri. Edhe i varfri mund të japë lëmoshë dhe të ndihmojë tjetrin, por ai nuk ka për detyrim të japë zekatin, sepse zekati është detyrim vetëm për të pasurit. Besimtari islam duhet ta ketë parasysh një fakt të rëndësishëm se çdo veprim me të cilin nuk synohet kënaqësia e Allahut, ai nuk arrin qëllimin dhe si i tillë as shpërblimin. Besimtari islam e ka shumë të qartë se kënaqësia e Allahut xh.sh. arrihet përmes asaj që ai u jep të tjerëve dhe i lumturon ata, e jo përmes asaj që u merr të tjerëve dhe e lumturon veten e tij.

Pasuria për të cilën jepet zekati

Që në fillim duhet të theksojmë se juristët islam kanë dhënë përkufizime të shumta se çka quhet **“pasuri”**, mirëpo ne do të theksojmë vetëm përkufizimin e juristëve nga medhebi hanefij që me nocionin **pasuri** nënkuptojnë të gjitha llojet e pasurisë që ligjërisht janë të lejuara dhe që kanë vlerë për myslimanët.

Sipas shariatit islam, nuk jepet zekat për të gjitha llojet e pasurisë, prandaj në vazhdim do të përmendim ato lloje të pasurisë për të cilat jepet zekati, që juristët islamë i kanë përfshirë në pesë lloje e që janë:

1. Zekati në ar (flori) dhe argjend;
2. Zekati në kafshë;
3. Zekati në bereqete tokësore;
4. Zekati në mallra tregtie;
5. Zekati në xehe dhe pasuri të fshehura në tokë.

1. Zekati në ar (flori) dhe argjend.

Floriri dhe argjendi konsiderohen jo vetëm si pasuri buri-more dhe konstante, por edhe si parametër ekonomik në shoqërinë islame dhe njerëzore në përgjithësi. Prandaj, sipas shariatit dhënia e zekatit në flori dhe argjend është obligim i përfutur nga argumentet autentike islame. Megjithatë, jo çdokush që posedon diç nga floriri dhe argjendi detyrohet me dhënie të zekatit, sepse për t'u obliguar dhënia e zekatit në flori dhe argjend detyrimisht duhet të plotësohet sasia e përcaktuar e floririt dhe argjendit që në terminologjinë islame njihet me nocionin *Nisab*.

E, pra, *nisabi* në flori është njëzet (20) mithkalë¹ që sipas juristëve të shkollës juridike hanefite² është i barabartë me 91.6 gram ari³.

¹ Mithkali është dinar nga ari, me të cilën është përcaktuar Nisabi.

² Sipas dijetarëve të medhhebit malikij, hanbelij dhe shafii një mithkal është i barabartë me 3.60 gram ari.

³ Këto njëzet mithkal janë të barabartë për afërsisht me vlerën e 14 lirave osmane.

Nga kjo nënkuptohet se personi i cili posedon në pronësinë e tij 91.6 gram flori për një vit të plotë, ai obligohet me dhënien e zekatit 2.5%. nga ajo pasuri, që nënkupton se mosplotësimi i kësaj sasive nuk obligohet me dhënien e zekatit.

Edhe për dhënien e zekatit në argjend duhet të plotësohet sasia e përcaktuar (Nisabi) i cili është 200 dërhëm që sipas dijetarëve të medhhebit hanefij⁴ është i barabartë përafërsisht me 700 gr. argjend. Kur plotësohet ky nisab dhe i ka kaluar një vit i plot, atëherë jepet zekat 2.5%.

Meqë përdorimi i bankënotave është relativisht i kohës së re, juristët islamë bënë hulumtime të thukhtë dhe në fund njëzëri përfunduan për obligueshmërinë e dhënies së zekatit edhe në bankënota. Nisabi i bankënotave llogaritet në flori dhe argjend që janë bazë për llogaritjen e nisabit të zekatit në monedha të hekurta, të letrës, apo letrave me vlerë, do të thotë se nëse posedon aq para sa kushton çmimi i nisabit të arit apo argjendit, atëherë duhet të jepet zekat. Edhe pse nisabi në flori dhe argjend në kohën e ligjësimit të tyre ishte përafërsisht i barabartë në vlerë, marrë parasysh faktin se këta dy artikuj janë variabël nga koha në kohë, pra në rastet kur ekzistojnë diferencime mes arit dhe argjendit, për nisabin e monedhave merret për bazë çmimi më i ulët, ngase sipas rregullit të Sheriatit islam kur flitet për interesin e të varfrit dhe të pasurit, i jepet përparësi interesit të të varfrit.

Sa i përket pasurisë që e posedon besimtari islam nga floriri, argjendi, monedha apo letra me vlerë, nëse njëra nga

⁴ Një dërhëm sipas dijetarëve të medhhebit shafij, malikij dhe hanbelij është i barabartë me 3.208 gr. $200 \times 3.208 = 641.6$ gram.

këto në vete nuk e përmbush nisabin, por që të gjitha nga pak e përmbushin nisabin, atëherë obligohet me zekat.

Zekati në stolitë e femrës

Juristët islamë janë unikë në mendimet e tyre se stolitë e femrës që nuk janë nga floriri dhe argjendi, siç janë inxhitë dhe stolitë e tjera që nxirren nga deti, për to nuk është obligim dhënia e zekatit.

Sa i përket stolive të femrave që janë nga ari dhe argjendi, dijetarët e medhhebit hanefij janë të mendimit se për to duhet dhënë zekat nëse plotësohet nisabi i tyre. Ky mendim mbështetet në gjithpërfshieshmërinë e shumë haditheve që flasin për obligueshmërinë e zekatit.

Në një hadith tjetër të regjistruar te Ebu Davudi, transmetohet se kishte ardhur një grua te Pejgamberi s.a.v.s dhe me vete kishte edhe vajzën e saj. Vajza në dorë kishte dy zinxhirë të trashë dhe të shtrenjtë nga ari, e Pejgamberi [s.a.v.s] e pyeti: *“A e jep zekatin e kësaj?”* ajo tha: jo. Pejgamberi [s.a.v.s] tha: *Të qoftë lehtë, sepse All-llahu këto dy do t'i shndërrojë në zinxhir prej zjarrit të Xhehenemit Ditën e Kiametit.* Vajza i hoqi nga dora dhe i lëshoi para Pejgamberit s.a.v.s dhe tha: Këta dy zinxhirë le të jenë për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.

Nga këto hadithe nënkuptohet se femrat që kanë flori apo argjend për stoli, obligohen të japin zekatin nëse e plotësojnë nisabin.

Dijetari bashkëkohor dr. Ibrahim Salkini, në veprën e tij “Fikhul islamij”, sjell edhe mendimet e disa dijetarëve të tje-

rë të cilët thonë se nëse femra ka stoli nga ari dhe argjendi, deri në një masë të rëndomtë, pa e tepruar sasinë, atëherë nuk obligohet me dhënien e zekatit. Këtu na paraqitet edhe fetvaja e shejh Muhamed Sheltutit, i cili ka thënë: nëse me zbulim apo stoli është për qëllim nevoja normale e stolisë së femrës, atëherë nuk obligohet me zekat, mirëpo nëse ajo ka stolisur trupin e saj me stoli tej mase atëherë duhet të japë zekat. Si duket, tërë kjo që dijetarët islamë bashkëkohorë ten-tojnë të gjejnë zgjedhje, sërish nuk mund të dalin nga korniza e vlerësimit që e kishte bërë Imam Ebu Hanifja, sepse nëse femra ka stoli nga ari dhe argjendi më shumë se nisabi që është 91.6 gram, atëherë obligohet me zekat, e nëse ka më pak, nuk obligohet me zekat, sepse nuk e ka plotësuar nisabin, andaj mendoj se sa për stoli të femrës 91.6 gr. ari janë të mjaftueshme. Gjithashtu, nuk duhet harruar se zekat jepet edhe në enët shtëpiake nga ari, edhe pse përdorimi i tyre është i ndaluar sipas së drejtës islame.

2. Zekati në kafshë

Meqë kafshët konsiderohen pasuri, atëherë s'ka dilemë se edhe për to jepet zekat. Për dhënien e zekatit të kafshëve ekzistojnë shumë hadithe, por më të njohura janë: hadithi i Ebu Bekrit i regjistruar në sahihun e imam Buhariut, që përshkruan sasinë e dhënies së zekatit të deveve, dhe hadithi i Muadhit, i cili përshkruan nisabin e zekatit të lopëve. Juristët islamë, për dhënin e zekatit të kafshëve paraqitën këto kushte: Kushtet që duhet të plotësojnë kafshët për dhënien e zekatit janë: të jenë kafshë shtëpiake, - të jenë **saimë** kafshë e cila

kalon në kullota shumicën e vitit, apo më shumë se gjashtë muaj - - Të plotësohet nisabi i kafshëve, i cili është i ndryshëm varësisht nga lloji i kafshëve -plotësimi i vitit, dhe kafshët të cilat ruhen për ta shtuar llojin e tyre.

Llojet e kafshëve për të cilat jepet zekat janë, devetë, lopët, përfshirë edhe buallicat, dhentë dhe dhitë, andaj në vazhdim do flasim për secilën në veçanti.

Nisabi për lopët

Nisabi është kusht i obligueshmërisë së zekatit. Argumenti për obligueshmërinë e dhënies së zekatit të lopëve është hadithi i Pejgamberit [s.a.v.s] kur e dërgoi Muadhin në Jemen dhe e urdhëroi që për çdo 30 lopë të marrë zekat nga një shtjerrë që ka mbushur një vit, kurse për çdo 40 lopë të merr zekat nga një viç (ose shtjerrë) që ka mbushur 2 vjet.

Nisabi i lopëve është si vijon:

- Prej **30** deri **39** lopë apo buallica, jepet zekat një shtjerrë (viç) që ka mbushur një vit;
- Prej **40** deri **59** lopë apo buallica jepet zekat një shtjerrë (viç) që ka mbushur dy vjet;
- Prej **60** deri **79** lopë apo buallica, jepet zekat një shtjerrë (viç) që ka mbushur një vit, dhe një që ka mbushur 2 vjet;
- Prej **80** deri **89** lopë apo buallica jepen zekat dy shtjerra që kanë mbushur nga dy vjet;
- Prej **90** deri **99** jepen zekat tri shtjerra që kanë mbushur nga një vit;
- **100** Dy shtjerra që kanë mbushur nga një vit dhe një që ka mbushur 2 vjet.

Nisabi i zekatit për kafshët e imta

Zekati në kafshë të imta përfshihet në dhen dhe dhi. Nisabi prej ku fillon obligueshmëria e zekatit në kafshë të imta është si vijon:

Prej 40-120 - një dele;

Prej 121-200 - dy dele;

Prej 201-399 - tri dele;

Prej 400-499 - katër dele;

Pastaj në çdo 100 dele jepet një dele.

Në këtë kategori të zekatit njejtë llogaritet edhe dhitë. Nëse bagëtia është e përzier në dhen dhe dhi, atëherë zekati jepet prej atij lloji që janë më shumë, e nëse janë të barabartë në numër, atëherë zekati jepet sipas dëshirës.

Pagimi i zekatit në kundërvlerë

Juristët e shkollës juridike hanefite, e kanë parim të tyre që obligim nga zekati është dhënia e një pjese të pasurisë nga nisabi, pavarësisht nëse kjo bëhet në aspektin formal apo kuptimor. Nga kjo nënkuptohet se pronari i mallit ka të drejtë të japë zekatin duke e nxjerrë një pjesë nga esenca e mallit, por ka të drejtë të japë zekatin edhe në kundërvlerën e saj.

Kur flitet për zekatin e kafshëve, dijetarët e medhhebit hanefij theksojnë se vlera e zekatit llogaritet në ditën e dhënies së zekatit e jo në ditën e obligueshmërisë, kurse vlerësimi bëhet sipas vendit ku gjendet pasuria. Pra, sipas juristëve të medhhebit hanefij, dhënia e vlerës për zekat është ngjashëm sikur dhënia e një pjese të nisabit, sepse edhe nisabi konsiderohet pasuri, pastaj këtu qëndron edhe përparësia se është

më lehtë për personin që jep zekat, e ndoshta edhe më efektive për të varfrin, sepse ai këtë pasuri të marrë si zekat mund ta shfrytëzojë për nevojat më prioritare të tij.

3. Zekati në mallra tregtie

Mall tregtar konsiderohet ajo pasuri e cila është përgatitur për tregti. Në mallrat tregtarë, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, nuk bëjnë pjesë ari, argjendi dhe monedhat, por bëjnë pjesë të gjitha pasuritë e tjera. Dhënia e zekatit në mallra tregtarë sipas mendimit të dijetarëve të medhhebit Haneefij duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Që vlera e pasurisë për tregti të arrijë nisabin e arit apo argjendit. Nëse nuk e arrin nisabin e njërit atëherë llogaritet me nisabin e tjetrit. Vlera e tyre llogaritet me çmimin e nisabit të arit dhe argjendit në vendin që gjendet pasuria.
2. Të kalojë një vit (çmimi i saj), prej ditës në të cilën është bërë pronë e pronarit me qëllim tregtie.
3. Në momentin kur pronari e blen atë pasuri kushtëzohet që pronari atë ta blejë me nijet tregtie. Në rastet kur personi ka blerë një mall por jo me nijet tregtie, e më pas e vendos që ajo pasuri të jetë pasuri tregtie, rrjedhja e vitit llogaritet nga dita kur ka vendosur që ajo pasuri të jetë pasuri tregtie.

Tregtari për dhënien e zekatit duhet të llogarisë kapitalin, fitimin, rezervat e pastaj të hollat në përgjithësi dhe për të gjitha këto jep 2.5% në emër të zekatit. Çmimi i llogaritjes

për dhënien e zekatit llogaritet në momentin e obligueshmërisë së dhënies së zekatit e jo në momentin e blerjes së asaj pasurie.

4. Zekati në bereqetet e tokës

Të gjithë dijetarët islam, duke u mbështetur në argumentet fundamentale të Sheriatit islam, janë unikë në mendimet e tyre për obligueshmërinë e dhënies së zekatit për bereqetet tokësore që dalin nga ajo. Këtë e vërteton ajeti kuranor: ***“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që fituat dhe nga ajo që nxorëm për ju prej tokës”***⁵ Pastaj, ajeti tjetër kuranor, ku All-llahu xh.sh. thotë: ***“..dhe ditën e korrjes (vjeljes) së fryteve jepni atë pjesë që është obligim.”***⁶

Argument nga sunneti i Pejgamberit s.a.v.s për obligueshmërinë e zekatit në bereqetet e tokës kemi hadithin: *“Për atë që ujitet nga qielli apo burimi ose është afër ujit jepet 10%, kurse në ato që ujiten me mjete të ujitjes 5% (gjysmë ushri).”*⁷

Nga ky hadith i Pejgamberit s.a.v.s. nënkuptohet se obligueshmëria e zekatit në bereqetet që dalin nga toka e që ujiten vetvetiu ose nga qielli pa përdorimin e fuqisë dhe shpenzimeve, jepet 10 %, kurse nëse për to përdoren shpenzime siç është sistemi i ujitjes, motorë të ndryshëm, atëherë jepet 5 %.

⁵ El Bekare: 267.

⁶ El En’am: 141.

⁷ Buhariu.

Kushtet e dhënies së zekatit për bereqetet tokësore

Krahas kushteve të përgjithshme për obligueshmërinë e zekatit në bereqetet tokësore, duhen plotësuar edhe këto tri kushte që janë:

1. Që toka nga e cila përfitohet bereqeti, të jetë tokë ushrije,⁸ e të mos jetë tokë haraxhije⁹, sepse sipas dijetarëve të medhhebit hanefij nuk mund të bashkohen ushri dhe haraxhi, kurse sipas medhhebeve të tjera mund të bashkohet ushri me haraxhin. Argumenti ku këta dijetarë e mbështesin mendimin e tyre është hadithi i transmetuar nga Ibni Mes'udi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s se ka thënë: *“Nuk bashkohen ushri dhe haraxhi në tokën e myslimanit”*.
2. Që bereqeti të jetë i dalë nga toka, do të thotë të ekzistojë bereqeti, sepse nuk mund të ketë zekat në bereqetin i cili nuk ekziston.
3. Që me atë që del nga toka, të jetë për qëllim shfrytëzimi, kultivimi dhe përpunimi i tokës dhe fryteve të saj, që nënkupton se për bimët e dala vetvetiu nuk jepet zekat siç është bari, drunjtë etj.

⁸ Tokë ushrije, konsiderohet çdo tokë banorët e së cilës e kanë pranuar Islamin dhe kanë ngelur pronarë të saj, ose çdo tokë që është çliruar me luftë e më pas toka e njëjtë u është ndarë myslimanëve. Quhet tokë *Ushrije* sepse prej bereqeteve të saj jepet zekat 10%.

⁹ Tokë haraxhije konsiderohet çdo tokë e cila është çliruar me luftë, por toka i është lënë në pronësi pronarëve të tyre, duke i obliguar të paguajnë haraxhin (tatimin).

Nisabi në bereqetet tokësore

Dijetarët islamë kur biseduan për nisabin dhe për cilat rendimente duhet të jepet zekat, i ndanë mendimet e tyre.

Sipas mendimit të Ebu Hanifes nisabi nuk është kusht për dhënien e zekatit nga bereqetet tokësore, andaj jepet zekat si për shumicën ashtu edhe për pakicën e saj. Ky mendim mbështetet në gjithpërfshieshmërinë e argumenteve që obligojnë dhënien e zekatit në bereqetet tokësore, që nënkupton se në ato argumente nuk përcaktohet nisabi për dhënien e zekatit, e kjo vërteton se zekati në bereqetet tokësore jepet si për shumicën ashtu edhe për pakicën.

Sipas mendimit të Imam Ebu Jusufit dhe Muhammedit dhe shumicës tjetër të fukahave islamë, nisabi është kusht për dhënien e zekatit në prodhime bujqësore që kanë farë dhe fryt, të cilat qëndrojnë një vit pa u prishur madje pa kurrfarë intervenimi për ruajtjen e tyre. Në këtë bëjnë pjesë gruri, orizi, misri etj. Sipas tyre nuk është obligim të jepet zekat nëse nuk plotësohet nisabi. Ky mendim mbështetet në hadithin e Pejgamberit s.a.v.s: *“Nuk ka zekat në më pak se pesë evsuk-ke”*. Sa i përket nisabit të bimëve dhe fryteve në kohën e sotme, në bazë të elaborimeve që bënë Vehbi Sulejman Gavoçi, ai është 1092 kg.¹⁰

¹⁰ Kurse sipas mendimit të malikijve dhe shafijve nisabi është kusht për obligueshmërinë e zekatit nga bereqetet tokësore që është 5 evsuk (563 kg.)

5. Zekati në xehe dhe në pasurinë e fshehur në tokë

Me shprehjen “zekati në xehe dhe në pasurinë nëntokësor” nënkuptojmë pasurinë e cila gjendet në tokë dhe nuk e dimë pronarin e saj. Në këtë përfshihet çdo pasuri nëntokësore si p.sh., hekuri, bakri, nafta etj. Këtu kemi të bëjmë me pasurinë të cilën e ka krijuar All-llahu xh.sh. në tokë me krijimin e saj.

Nga llojet e pasurisë së fshehur në tokë kemi edhe një lloj pasurie e cila është e fshehur nga njerëzit e cila quhet *rekaz*. Pasuri *rekaz* quhet ajo pasuri e gjetur në tokë e cila përmban simptome joislame pavarësisht se bëhet fjalë për flori apo argjend.

Sipas fukahave islamë, personi i cili e gjen pasurinë “**Rekkaz**” në tokën e cila nuk është pronë e askujt, obligohet të japë zekatë 20 % do të thotë $1/5$ e saj, pavarësisht se plotësohet apo nuk plotësohet nisabi i zekatit, kurse pasuria tjetër i ngel atij. Ky zekat i jepet arkës shtetërore të myslimanëve (Bejtu-l-mal). Nëse pasuria e gjetur në tokë ka shenja të Islamit, sikur të ketë ndonjë emër të ndonjë udhëheqësi islam, apo në te ka dëshminë, atëherë ajo pasuri paraqitet dhe duhet të ruhet një vit, e pastaj mundet që atë pasuri ta ndajë lëmoshë, ose ta shfrytëzojë për interesat e veta, mirëpo, pasi ta ketë shfrytëzuar për interesat e veta, nëse paraqitet pronari i saj, atëherë duhet kompensuar ai. Argumenti i cili flet për dhënien e zekatit të pasurisë së gjetur nëntokësore është hadithi i Pejgamberit s.a.v.s: “*Në pasurinë e gjetur në brendësi të tokës jepet zekat 1/5.*”¹¹ Po ashtu edhe hadithi, sipas të cilit

¹¹ Buhariu.

Pejgamberi s.a.v.s kur është pyetur për pasurinë e gjetur, ka thënë: *“Pasuria e cila është gjetur në rrugë kalimtare ose në ndonjë vendbanim, një vit duhet ta reklamojë dhe paraqes, nëse paraqitet pronari i kthehet e nëse jo, atëherë është jotja. Nëse ajo pasuri është gjetur në rrugë jokalimtare ose jashtë vendbanimit për atë pasuri jepet zekat 1/5”*¹²

Zekati në xehe

Xehet nëntokësore ndahen në tri lloje:

1. Xehet që janë të ngurta, përpunohen, shkrihen dhe përsëri ngurren siç është ari, argjendi, bakri, plumbi etj. Në këtë lloj xehesh zekat jepet 20% ose 1/5 e saj, pa marrë parasysh sa është sasia e saj, plotësohet apo nuk plotësohet nisabi dhe nuk kushtëzohet të kalojë viti. Për këtë argumenton ajeti kuranor: ***“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej toke”***¹³
2. Pasuri e ngurtë që nuk shkrihet siç është gipsi, zinku, qymyri, gëlqerja etj. Për këtë lloj pasuri nëse nuk është nxjerrë për tregti nuk jepet fare zekat, e nëse është nxjerrë për tregti atëherë zekati i saj është 2.5%.
3. Pasuria e cila është në gjendje të lëngët e që nuk pran-on ngurtësi si p.sh. nafta, gazi, etj. Edhe në këtë pasuri nuk jepet zekat nëse nuk përdoret për tregti e nëse përdoret për tregti, atëherë zekati i saj është 2.5%.

¹² Nesaiu.

¹³ El Bekare: 267.

Hajrullah HOXHA

TË GJITHË PEJGAMBERËT I THIRRËN NJERËZIT PËR BESIM NË NJË ZOT

Zoti i Madhërishëm në Kur'anin famëlartë ka thënë:

***“Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka Zot tjetër përveç
Allahut, krijues i çdo gjëje, andaj adhuronie vetëm
Atë”. (El-En'ame, 102).***

Njeriu si një qenie e vetëdijshme dhe intelektuale, nga vetë natyra e tij është i prirë për ta njohur dhe besuar Zotin e Madhërishëm. Ideja e të besuarit për ekzistimin e Zotit, ndonëse në forma të ndryshme, gjatë tërë historisë, u manifestua tek të gjithë popujt e botës. Si vizatimet dhe figurat e zbuluara në shpellat e varrezat e popujve parahistorik, ashtu shkriimet dhe përmendoret e popujve pas historik, dëshmojnë se jeta e tyre individuale dhe kolektive ka qenë e përshkruar nga besimi në Zotin dhe nga ritet fetare. Vetëm emri “Zot”, i cili gjendet në të gjitha gjuhët e popujve të botës dhe figuron në fjalorët e tyre, më së miri këtë e konfirmon. Në histori mund

të hasim në raste të rralla kur mohohet tërësisht ekzistimi i Zotit, ngase njerëzit zakonisht Atij i shpifnin dhe i shoqëronin hyjni të tjera në besim dhe adhurim. Por, edhe pse nga injoranca e primitivizmi, ata besonin në shumë zota, ideja e besimit në Zotin si Krijues suprem, gjithmonë ka qenë e prapishme tek ta.

Me qëllim që t'i udhëzoj njerëzimin në pikëpamje të besimit të vërtetë dhe t'i bashkojë mendimet e ndara të tyre rreth Tij, Allahu xh.sh. u dërgoi atyre shpalljet e Tij me anë të peygamberëve, duke filluar nga njeriu i parë, Ademi a.s. e deri te Muhamedi a.s. Detyra dhe qëllimi kryesor i të gjithë peygamberëve ka qenë thirrja e njerëzve në Tevhid – përkatësisht në fjalën “la ilahe il-lAllah” që do të thotë: “Nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet¹ përveç Allahut”. Në lidhje me këtë Allahu xh.sh. në Kur'an ka thënë:

“Padyshim Ne, në çdo popull kemi dërguar peygamber (për t'i thënë) adhurone (vetëm) Allahun dhe largohuni nga idhujt”. (En-Nahl, 36).

“Ne nuk kemi dërguar asnjë peygamber e të mos i kemi shpallur se: Nuk ka Zot tjetër përveç Meje, andaj vetëm Mua t'Më adhuroni”. (El-Enbija, 25).

Nga përmbajtja e këtyre ajeteve kuptohet qartë se Allahu xh.sh. secilit popull i ka dërguar peygamber për t'i thirr që të besojnë dhe adhurojnë vetëm Një Zot, si dhe të largohen nga adhurimi i çfarëdo idhulli në vend të Tij. Pas Ademit a.s. njerëzit në besimit të tillë ju përmbajtën një kohë të gjatë,

¹ Fjala ibadet – adhurim do të thotë: skllavëri, lutje, falje me përulje, respekt dhe nënshtrim ashtu siç vepron skllavi ndaj zotërisë së tij.

mirëpo më vonë filluan të përçahen dhe përveç Allahut nisën të adhurojnë idhuj. Kjo nënkuptohet nga fjala e Allahut xh.sh. në Kuran:

“Njerëzit kanë qenë në një fe dhe (kur u përçanë) Allahu u dërgoi peygamber përgëzues e qortues dhe me ta zbriti librin më të vërtetën për të gjykuar mes njerëzve për atë që kishin rënë në kundërshtim”. (El-Bekare, 213).

Në lidhje me përmbajtjen e këtij ajeti Ibn Abasi r.a. tregon se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Ndërmjet Nuhit dhe Ademit a.s. kanë qenë dhjetë gjenerata dhe gjatë gjithë atyre gjeneratave është gjykuar me sheriat - ligj të Allahut, Pastaj njerëzit u kundërshtuan mes veti, andaj Allahu dërgoi peygamber përgëzues dhe qortues”*.²

Pas vdekjes së Idrisit a.s. disa pasues nuk u larguan nga rruga e tij. Ata vazhduan ta udhëheqin popullin në rrugë të drejtë. Këta dijetarë me fjalë të ëmbla dhe me sjellje e shembëlltyrë përfituan zemrat e popullit. Mirëpo, sikur edhe çdo qenie e gjallë, edhe ata i plotësuan ditët e tyre të përcaktuara të kësaj jete dhe u ndanë nga kjo botë. Vdekja e secilit prej tyre, linte nga një varrë në zemrat e popullit. Kjo botë është vendi i sprovimit, prandaj ka njerëz të mirë dhe të këqij. Ata njerëz që u bënë miq të djallit, respektin e popullit ndaj atyre dijetarëve që kishin kaluar, filluan ta shpërdorin për t'i larguar nga rruga e drejtë. Këta njerëz djallëzor u thoshin besimtarëve: Këta dijetarë tanë të njohur pas një kohe të shkurtër do

² Hakim Tefsir Ibn Kethir.

të harrohen dhe fjalëve e këshillave të tyre do t'u humb vlera në mesin e popullit. Mirëpo, nëse nëpër ato vende ku kanë jetuar, ngremë nga një statujë-përmendore, apo të bëjmë statuja të vogla që t'i mbajmë nëpër shtëpi, do të përjetësonte kujtimin për ta dhe nuk do të harroheshin nga njerëzit, të cilët përherë do t'i kujtonin fjalët e tyre, dhe nuk do të largoheshin prej rrugës së drejtë. Ky mendim u pëlqye në popull, dhe ndërtuan përmendoret e dijetarëve më të njohur siç ishin: Vedda, Suva, Jeguth, Jeuke dhe Nesra. Pas lutjeve të obliguara që i bënin populli, njerëzit dalëngadalë filluan të tuboheshin edhe rreth përmendoreve, duke i përkujtuar fjalët e atyre dijetarëve. Me kalimin e kohës, mendimet e këtyre të këqijve filluan të ndikonin në zemrat e njerëzve, pos disa ndryshime, që i ndërftën në besimin dhe në lutjet e popullit. Kështu, gjeneratat e reja harruan besimin e drejtë e të pastër, sepse i gjetën këto përmendore të ngritura, të cilat u luteshin dhe i kishin bërë si zota të tyre. Këta ishin njerëzit e parë që u besuan statujave të gdhendura në vend të Zotit të vërtetë.³

Thirrja e Nuhut a.s. për besim në Një Zot

Allahu xh.sh. popullit të lartpërmendur ia dërgoi për pejgamber Nuhun a.s. me qëllim që t'i udhëzoj në rrugë të drejtë dhe t'i këshilloj, që ta adhurojnë vetëm Allahun, e nëse refuzojnë, do t'i godet nga Allahu xhsh. ndonjë dënim i rëndë.

Nuhu a.s. e thirri dhe e këshilloji popullin e tij me fjalë të urta dhe argumente të qarta që të heqin dorë nga adhurimi i

³ Dhulkarnejn Vardari, *Historia e profetëve*, 2015, fq. 63.

idhujve dhe të adhurojnë vetëm Allahun për Zot sepse nuk kanë Zot tjetër pos Tij. Mirëpo paria e popullit të tij jo vetëm që nuk i besuan por e kundërshtuan ashpër, kurse popullit i thanë që kurrresi të mos heqin dorë nga adhurimi i zotave të tyre dhe statujave të njerëzve të mirë të lartpërmendur. Më në fund ata kërkuan nga Nuhu që të heqë dorë nga polemikat me ta dhe tua sjellë dënimin e premtuar nëse është duke folur të vërtetën.

Nga sjelljet dhe veprimet e popullit të tij, Nuhu u dëshpërua dhe përfundimisht e humbi shpresën prej tyre, andaj ju drejtua Allahut me lutje për t'i shkatërruar ata. Me këtë rast Allahu xh.sh. e ngushëlloi atë që të mos brengoset për veprimet e tyre sepse ata do të jenë të dënuar me përmbytje. Ndërkaj Nuhun a.s. e porositi të ndërtoj një anije dhe me rastin e tufanit të hyp në të me familjen dhe besimtarët e tij.

Raportet e Nuhut a.s. me popullin e tij, Allahu xh.sh. e ka potencuar në shumë ajete kuranore, ndërsa kaptina 71 e mbanë emrin e tij. Lidhur me këtë po i theksojmë vetëm disa prej tyre në të cilat Allahu xh.sh. thotë:

“Ne dërguam Nuhun te populli i tij e tha: O populli im adhuroni (vetëm) Allahun, ju nuk keni Zot tjetër pos Tij. Unë frikohem për ju për dënimin në një ditë të madhe”. Paria nga populli i tij tha: “Ne po të shohim se ti je në humbje të qartë”. Ai tha: O populli im, unë nuk jam në kurrfarë humbje, por jam i dërguar nga Zoti i botëve (gjithësisë). Unë ju komunikoj juve shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Allahu atë që ju nuk dini!” (A’rafë, 59-62).

“Ne e dërguam Nuhun te populli i tij (e i thamë): “Tërhiqja vërejtjen popullit tënd para se t’u vijë atyre dënim i pikëllues” Ai tha: “O populli im, unë për ju jam këshillues i qartë”. Andaj, adhurojeni All-llahun e frikësohuni Atij dhe më dëgjoni mua”. (Nuh, 1-3).

“Dhe u thanë: Mos i braktisni kurrsesi zotat tuaj, e mos e braktisni Veda-në as Suva-në, e as Jeguth-in, as Jeuk-ën e as Nesra-në”. (Nuh, 23).

Për shkak të mos dëgjimit për të heq dorë nga adhurimi i idhujve në vend të Zotit, zullumet dhe punët e këqija të atyre, Allahu xh.sh. ata i dënoi me përmbytje. Ndërkaq, Nuhu a.s. e të gjithë besimtarët e tij hipën në anije të cilën e kishte ndër-tuar më parë, me porosi të Allahut xh.sh. dhe shpëtuan. Me këtë rast u përmbytën edhe dy anëtarë të familjes së Nuhut a.s. një grua e tij, për shkak se nuk i besoj dhe një djalë i tij, për shkak se kur e thirri babai i tij për të hipur në anije, refuzoi duke u arsyetuar se do të hip në maje të bjeshkës dhe do të shpëton. Andaj, ajo edhe pse e pat burrin pejgamber të Zotit, ndërsa ai babanë, nuk u bëri dobi për të shpëtuar, sepse nuk i ishin përgjigjur thirrjes së tij për të besuar.

Thirrja e Hudit a.s. për besim në Një Zot

Adi populli i Hudit a.s. ka jetuar në Ahkaf, vend në mes Hixhazit, Jemenit dhe Jemanës. Vendet ku jetonte fisi Ad ishin vende me shumë bereqet. Ishin të rrethuara me kopshte, me vreshta dhe me fusha të gjelbra. Allahu xh.sh. u kishte dhuruar shumë të mira atyre. I kishte pasuruar me fëmijë e me pasuri. Ishin shtatgjatë dhe të fuqishëm. Ky popull kishte

ngritur një qytet shumë të bukur me emrin Irem, i cili përme-ndet në Kuran. Mirëpo, në vend se ta falënderonin Allahun xh.sh. për të mirat që ua kishte dhuruar, ata mbaheshin me mendjelartësi. Lavdëroheshin me të mirat e Allahut xh.sh. Arritën ne atë shkallë sa që harruan më të madhin! Atë, Fuqplotin.⁴

Populli i Adit kishte devijuar nga rruga e besimit të drejtë, dhe në vend të Allahut, adhuronte idhuj, sikur populli i Nuhut më parë. Tregohet se ata i adhuronin tre idhuj kryesor që i kishin emërtuar me këta emra: Suda, Semuda dhe El-Heba. Ky ishte populli i parë, pas Tufanit të Nuhut a.s. i cili e ringjalli traditën e idhujtarisë.

Allahu i madhërishëm këtij popullit ia dërgoi Hudin për pejgamber për t'i udhëzuar në besim të drejtë. Nuhu as.s. kërkoi prej tyre që t'i frikësoheshin Allahut xh.sh. e të largohen nga adhurimi i idhujve, ngase ata nuk kanë Zot tjetër pos Tij. Ai u mundua për t'i bindur me fjalë të urta duke iu përkujtuar të mirat e llojllojshme që ua kishte dhuruar Allahu xh.sh. për të cilat Atë duhet falënderuar dhe kërkuar falje prej Tij.

Për raportet e Hudit a.s. me popullin e tij, flitet në disa ajete kur'anore, e sidomos në kaptinën Hud, që mbanë emrin e tij dhe në kaptinën Ahkaf, që mbanë emrin e vendbanimit të tyre. Ne lidhje me këtë Allahu xh.sh. ka thënë:

“Dhe popullit Ad (ia dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai u tha: "O populli im, adhurojeni All-llahun, ju nuk

⁴ Dhulkarnejn Vardari, Historia e profetëve, 2015, fq. 102.

keni Zot tjetër përveç Tij, a nuk po frikësoheni”. Paria e popullit të tij që nuk besonte tha: Ne të shohim se je mendjelehtë dhe mendojmë se ti je gënjeshtar. Ai tha: O populli im, unë nuk jam mendjelehtë, por jam i dërguar nga Zoti i botëve. Unë ju komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe për ju, jam këshillues besnik”. (A'raf, 65-68).

Nga përmbajtja e ajeteve të lartpërmendur kuptohet qartë se elita e popullit Ad, shkaku i pasurisë ishin njerëz mendjemëdhenj, kokëfortë dhe arrogant. Andaj, jo vetëm që nuk e përfillën thirrjen e Hudit a.s. por me të polemizuan në mënyrë të vrazhdë. Për shkak të sjelljeve kundërshtuese dhe veprave të këqija të tyre, Allahu xh.sh. i dënoi me një katastrofë të tillë, ndërsa Hudin e porositi që të largohet me të gjithë besimtarët e tij nga ai vend para se të ndodhë shkatërrimi i tij.

Thirrja e Ibrahimit a.s. për besim në Një Zot

Ibrahimi a.s. i takonte popullit Kaldej që jetonte në Mesopotami, përkatësisht në Irakun e sotshëm. Edhe ky popull sikur ai i Adit, qe larguar nga besimi i drejtë në Një Zot, dhe ishte dhënë pas besimit në trupat qiellor dhe adhurimin e tyre për zot. Për këtë qëllim, ata gdhendnin statuja ne forma të ndryshme nga gurët dhe drunjtë, të cilat i adhuronin duke iu lutur me përlësi për plotësimin e dëshirave të tyre dhe për mbrojtjen nga fatkeqësitë e ndryshme jetësore. Allahu i madhërishëm këtij populli ia dërgoi për pejgamber Ibrahimin a.s. me qëllim për t'i thirr që të heqin dorë nga adhurimi i kot i idhujve dhe ta adhurojnë vetëm Allahun për Zot. Për një de-

tyrë të tillë fisnike dhe të rëndë. Allahu xh.sh. Ibrahimin a.s. e kishte përgatit qysh herët, duke i dhuruar zgjuarsin të dalluar, sinjeritet dhe oratori, të cilat do t'i shërbenin si dëshmi se ishte pejgamber i vërtetë. Duke u përpjekur për të bindur popullin e tij se janë në rrugë të gabuar, bëri dialog dhe polemizoi vazhdimisht me ta duke i këshilluar dhe qortuar me argumente dhe shembuj konkret duke ju thënë: Përse i adhuroni këta idhuj për Zot, pasi që ata as nuk flasin, as nuk shohin, as nuk dëgjojnë dhe si të tillë nuk mund tu sjellin kurrfarë dobie as dëmi. Edhe pse këto fakte ata nuk mund t'i demantonin, për shkak të fanatizmit dhe injorancës, nuk i besuan. Si dialogjet dhe polemikat që i zhvilloi Ibrahim a.s. me popullin e tij duke u përpjekur për t'i udhëzuar në besim të drejtë, ashtu edhe vështirësitë dhe mundimet që i përjetoi nga kundërshtarët e tij, janë të përshkruara si në kaptinën që quhet me emrin e tij "Ibrahim", ashtu edhe në një varg ajetesh kur'anore. Allahu xh.sh. ka thënë:

"Dhe kur e mbuloi nata, ai (Ibrahimi) e pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" E kur ai perëndoi, tha: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë". Kur e pa hënën të posalindur tha: "Ky është Zoti im!" e kur perëndoi ajo, tha: "Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugë të drejtë, me siguri unë do të jem një nga njerëzit e humbur!" Kur e pa diellin të lindur, tha: "Ky është Zoti im, ky është më i madhi!" por pasi që dielli perëndoi, tha: "O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni (Allahut)!" Unë fytyrën time (vetën) e kthej kah Ai që i ka krijuar qiejt dhe tokën duke qenë besimtar i drejtë dhe unë nuk jam nga idhujtarët". (El En-am, 76-79).

Disa komentues të Kur'anit thonë se Ibrahim i.a.s. këto fjalë i ka thënë para se t'i vinte shpallja, sepse vet fjala e tij nëse nuk më udhëzon Zoti im, do të thotë se ende nuk ishte i udhëzuar me anë të shpalljes, andaj edhe e udhëzoi duke thënë që për Zot i beson Atij që e ka krijuar qiellin dhe tokën. Mirëpo, disa të tjerë janë të mendimit se kjo ka ndodhur në fillim të shpalljes dhe se Ibrahim i.a.s. fjalët: ky është Zoti im për yllin, hënën dhe diellin i ka thënë vetëm formalisht me gjuhë sa për sy e faqe, me qëllim për t'ua demantuar popullit të tij besimet e kota të tyre në trupat qiellor praktikisht duke deklaruar se ai nuk ju beson atyre por drejtohet dhe i beson për Zot vetëm Atij që e ka krijuar gjithësinë.⁵

Nga përmbajtja e këtyre ajeteve kuptohet gjykimi i drejtë i Ibrahimit i.a.s. i bazuar në shembuj konkret se vetëm Ai që e ka krijuar gjithësinë është Zoti, edhe se vetëm Ai meriton dhe duhet të adhurohet, e jo krijesat e tij siç janë yjet, hëna dielli, etj. Andaj, me këtë Ibrahim i.a.s. ka dashtë t'i thotë popullit se ju jeni në rrugë të gabuar, andaj duhet të heqin dorë nga besimi dhe adhurimi i tyre dhe të besoni si unë në Krijuesin e tyre.

Pas marrjes së shpalljes nga Allahu xh.sh. Ibrahim i.a.s. filloi për t'i thirr njerëzit në besim të vërtetë në Një Zot, duke u nisur nga babi i tij. Dialogu apo polemika e tij me të dhe popullin e tij janë përshkruar në Kuran si në vijim:

“Kur i tha (Ibrahimi) babait të vet: O babai im, përse e adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që

⁵ Abdul Vehhab En-Nexhxhar, Kasasul-Enbija, Bejrut, pa vit botimi.

mund të sjellë farë dobie? O babai im, mua më ka ardhur nga dituria ajo që nuk të ka ardhur ty, andaj më paso mua e unë do të të udhëzoj ty në rrugën e drejtë. O babai im, mos e adhuro (mos e dëgjo) djallin se padyshim djalli është kundërshtar i Mëshiruesit (Zotit). O babai im, unë kam frikë se do të godasë dënimi nga Mëshiruesi (Allahu) dhe të bëhesh shok i djallit. Ai tha: A ti po distancohesh nga zotat e mi, o Ibrahim? Nëse nuk heq dorë (nga nënçmimi i tyre) unë do të gjuaj me gurë, andaj largohu nga unë për kohë të gjatë. Ai (Ibrahimi) tha: Paqja qoftë mbi ty, unë do të kërkojë falje për ty te Zoti im, vërtetë Ai ndaj meje është i kujdesshëm”. (Merjem, 42-47).

Nga përmbajtja e ajeteve kuptohet se Ibrahimi a.s. përveç se me fjalë u tregoi atyre edhe praktikisht me vepër se statujat të cilat i adhuronin nuk janë në gjendje për ta mbrojtur vetvetën e lerë më adhuresit e tyre dhe se nuk janë në gjendje t'i sillnin askujt dëm madje as atij që i theu dhe i bëri copa.

Ibrahimi a.s. jo vetëm me popullin e tij, por edhe me mbretin Nemrud kishte zhvilluar polemika rreth besimit në Zot. Nemrudi ka qenë një zullumqar i madh dhe njeri arrogant, i cili mburrej pse i kishte dhënë Zoti pushtet dhe mendonte se është Zoti vet, andaj në mënyrë nënçmuese e pyet Ibrahimin a.s. se kush është Zoti i yti:

“Ibrahimi i thotë: Zoti im është Ai që jep jetë dhe jep vdekje. Ai thotë: Edhe unë jap jetë dhe jap vdekje. Ibrahimi i thotë: Zoti im sjellë diellin nga lindja, sillë pra ti nga perëndimi. Atëherë mbeti i habitur ai që nuk

besonte (Nemrudi). Allahu nuk e drejton (në rrugë të drejtë) popullin mizorë". (El-Bekare, 258).

Tregohet se kur ka thënë Nemrudi se edhe unë jap jetë dhe vdekje, Ibrahim i a.s. e ka pyetur, si jep t'i jetë dhe vdekje? Nemrudi i ka thënë: Dy njerëz i kam dënuar me vdekje njërin e ekzekutoj, i jap vdekje, ndërsa e fali tjetrin dhe i jap jetë.

Pas të gjitha këtyre sfidave dhe sprovave të cilat i përballoi me ndihmën e Allahut xh.sh. me dinjitet dhe vendosshmëri, Ibrahim i a.s. vendosi të largohet nga populli dhe vendi i tij. Ai shkoi dhe u vendos në Palestinë dhe në moshë të shtyre Allahu xh.sh. ia fali Ismailin, e më vonë edhe Ishakun. Ismailin me nënën e tij Haxheren e vendosi në Mekë, dhe më vonë bashkë me të, Ibrahim i a.s. e ndërtoi Qabenë e madhërishme.

Për shkak të devotshmërisë, vendosshmërisë dhe përkushtimit në besim të drejtë, Allahu xh.sh. Ibrahimin e mori për dost – mik të ngushtë dhe e bëri model dhe shembull orientues për të gjithë peygamberët e mëvonshëm e sidomos për Muhmedin a.s.

Thirrja e Musait për besim në Një Zot

Musa a.s. i takonte popullit Beni Israil të cilët jetonin në Egjipt që nga koha e Jusufit a.s. Ai qysh herët për shkaqe objektive e kishte lënë Egjiptin dhe kishte shkuar në Medjen ku ishte martuar me vajzën e Shuajbit a.s. Pas qëndrimit të tij dhjetë vjeçar ku kishte shërbyer si bari dhënësh kishte vendosur që të kthehet në Egjipt. Duke udhëtuar me familje në një natë të ftoftë e humb rrugën. Mirëpo, papritmas e sheh një dritë zjarri në kodrën e Turi-Sinait, andaj i thotë familjes që të qëndrojnë në vend, ndërsa ai do të shkoj për të pyetur për rrugën ose për të marrë ndonjë unë për të ndezur zjarrin. Mirëpo, kur afrohet te zjarri Allahu i madhërishëm ju lajmërua me këto fjalë:

“O Musa, me të vërtetë unë jam Zoti yt, zbathi të mbathurat se ti je në luginën e shenjtë Tuva. Unë të kam zgjedhur ty, andaj dëgjo çka po të shpallet. Pa dyshim unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Meje, andaj (vetëm) Mua më adhuro dhe fale namazin për të më kujtuar Mua”. (Ta-Ha, 11-14).

Nga përmbajtja e këtyre ajeteve kuptohet se Allahu xh.sh. me fjalët e para që ia shpalli Musait a.s. e njoftoi se Ai është Zoti i tij, i Cili e ka zgjedhur për peygamber dhe se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, andaj vetëm Atë duhet adhuruar dhe kujtuar gjatë faljes së namazit. Një mesazh i tillë duhet të jetë program kryesor i thirrjes së tij drejtuar popullit të Egjiptit.

Allahu xh.sh. e porositi Musain që të shkon dhe ta fton Faraonin (Perandorin e Egjiptit) në besim në një Zot, mirëpo, ai ju lut Zotit që t’ia jap vëllanë e tij Harunin për ndihmës

ngase është më orator. Allahu xh.sh. ia pranoi këtë kërkesë dhe i tha: ***“Shkoni ti dhe vëllai i yt me argumentet (mrekullitë) e Mia mos reshteni se përmenduri Mua. Shkoni që të dy te Faraoni, se më të vërtetë ai i ka tejkaluar kufijtë, dhe folni atij fjalë të buta, ndoshta ai mendohet ose frikësohet”.*** (Ta-Ha, 42-44).

Allahu xh.sh. Musain a.s. e përforcoi me dy mrekulli të cilat do t'i shërbejnë si argument për ta vërtetuar se është i dërguar i Zotit. Ato mrekulli kanë qenë: shkopi me të cilin ka ruajtur delet, i cili me urdhër të Zotit shndërrohej në gjarpër dhe dora e djathtë të cilën kur e fuste nën sqetulla dhe e nxjerrke, me urdhër të Zotit, ndriçonte. Kur dolën para Faraonit, Musai me Harunin i thanë se janë të dërguar të Zotit, ai i pyeti: ***“E kush është Zoti juaj o Musa? Ai tha: Zoti i ynë është Ai që çdo gjëje ia ka dhënë trajtën e saj e pastaj e ka udhëzuar”.*** (Ta-Ha, 49-50).

Me një rast tjetër Musai a.s. zhvilloi një dialog të gjatë me Faraonin rreth besimit në Zot si në vijim:

Faraoni i tha: ***“Ç’është Zoti i botëve”?***

Musai: ***“Zoti i qiejve, i tokës dhe gjithë ç’ka ndërmjet tyre nëse jeni të bindur”.***

Faraoni: ***“U tha atyre që i kishte për rreth, a nuk po e dëgjoni”?***

Musai: ***“Zoti juaj dhe Zoti i baballarëve tuaj të parë”.***

Faraoni: ***“Me të vërtetë pejgamberi që u është dërguar ju, është i çmendur”.***

Musai: ***“Zoti i lindjes dhe i perëndimit dhe gjithë ç’ka ndërmjet tyre nëse kupton”.***

Faraoni: “Nëse ti merr tjetër Zot, përveç meje, me siguri do të futi në burg”.

Musai: “A edhe nëse të sjellë ndonjë argument të qartë”.

Faraoni: “Sille pra nëse e thua të vërtetën”.

Atëherë Musai i hodhi shkopin e tij, e ai u shndërrua në gjarpër të qartë dhe e nxori dorën e tij dhe ajo u duk e bardh për shikuesit.

Faraoni i tha parisë që e kishte për rreth vetes. “Me të vërtetë ky qenka magjistar i dijshtëm (i aftë). Ky dëshiron me magjinë e tij t’ju dëboj nga toka e juaj, prandaj çka më propozoni ju”? (Esh-Shuara, 23-25).⁶

Paria i propozoj Faraonit që t’i tuboj magjistarët më të aftë të tij e të garonin me Musain a.s. Faraoni propozimin e tyre e përkrahu, e caktoi ditën në të cilën përveç magjistarëve u tubuan edhe masa e madhe e popullatës për të shikuar. Me atë rast ai atyre ju tha: “Unë jam Zoti më i lartë i juaji”. Mirëpo Musai a.s. me mrekullinë e shkopit të tij triumfoi, kurse magjistarët pësuan disfatë. “Atëherë magjistarët ranë në sexhde (u përkulën me krye në tokë). Dhe thanë na i besuam Zotit të botëve. Zotit të Musait dhe të Harunit”. (Esh-Shuara, 46-48).

Për shkak të kësaj humbje të dyfishtë Faraoni u tërbua sa që i kërcënoi magjistarët se do t’i dënoj, duke ju thënë se do

⁶ Me qëllim që ky dialog të bëhet më i kuptueshëm është bërë një ndërhyrje e vogël në tekst duke i theksuar protagonistët me emra, përkatësisht Musain dhe Faraonin.

tua pres duart dhe këmbët tërthorazi, mirëpo ata nuk hoqën dorë nga besimi.

Nga frika se njerëzit do t'i besojnë atij dhe do të shkaktonin trazira në vend, Faraoni me elitën e tij vendosën për ta mbytur Musain dhe popullin e tij. Ndërkaq, Musai a.s. me Beni Israilët, e lëshuan Egjiptin me urdhër të Allahut xh.sh. dhe kur arrijnë te deti, ai i ra me shkop dhe deti u nda dhe e kaluan pa problem. Ndërkaq, Faraoni me ushtri që u ishte vënë prapa për t'i kthyer, kur hyri në det, ai u mbyt më gjithë ushtrinë e tij. Në momentin e mbytjes ai deklaroi:

“Besova se nuk ka Zot tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilët. Edhe unë jam nga të dorëzuarit. A tani (tha Allahu), kurse më parë ke kundërshtuar dhe ke qenë nga shkatërruesit. Sot do ta shpëtojme (vetëm) trupin tënd (të vdekur) që të jetë si argument (mësim) për ata që vijnë pas teje, por shumica e njerëzve janë të pakujdesshëm ndaj argumenteve tona”. (Junus, 90-92).

Faraoni kur u përballë me dënimin e Allahut, besoj se nuk ka Zot tjetër pos Tij, por atëherë ishte shumë vonë, kur nuk i pranohet njeriut më besimi.⁷

Nga familja e Faraonit, Musain e pasuan dy anëtarë të familjes së tij, gruaja e tij Asija dhe një burrë të cilit nuk i përmendet emri në Kur'an.

Musai a.s. me Beni Israilët duke udhëtuar për në Palestinë e takuan një popull që i adhuronte statujat e tyre në formë të lopës. Populli i tij kur i panë i thanë atij:

⁷ Thuhet se Faraoni i kohës së Musait ka qenë Ramzezi II, i cili gjendet i balsamosur në një piramidë të Egjiptit dhe vizitohet nga mbarë bota.

“O Musa na e bënë edhe neve një Zot si zotat që i kanë ata. Ai u tha më të vërtetë ju jeni popull injorantë. Më të vërtetë ata janë të shkatërruar në atë që bëjnë dhe është e kotë ajo që veprojnë. Tha: A përveç Allahut të kërkoj për ju Zot tjetër, ndërsa Ai ju ka dalluar nga tërë bota”. (A’rafë, 138-140).

Populli Beni Israil kishin jetuar me shekuj në Egjipt ku adhuroheshin idhujt të ndryshëm, dhe ishte vështirë të hiqnin dorë nga një traditë e tillë. Andaj, deri sa ishte Musai a.s. në Turi Sina duke pranuar shpalljen e Tevratit prej Allahut xh.sh., njeri prej tyre me emrin Samirij e tuboi arin e stolitë që i kishte populli me vete dhe i shkriu në zjarr dhe prej tyre e punoi një statujë në figurë të viçit, nga i cili kur frynte era dilte një zë sikur pallë. Me gjithë tërheqjen e vërejtjes nga Haruni a.s. i cili e zëvendësoi Musain a.s. deri te kthehet, populli filluan ta adhurojnë. Kur u kthye Musai a.s. nga Turi Sina dhe e pa popullin që kishte kaluar në idhujtari u dëshpërua shumë dhe u hidhërua. Andaj, fillimisht e qortoi Harunin pse nuk i ka penguar, e pastaj edhe popullin pse e kanë thye besën, dhe më në fund e kritikoi ashpër Samirin dhe i tha:

“...Shikoje Zotin tënd që e ke adhruar me përkushtim. Ne do ta djegim atë dhe do ta hedhim hirin e tij në det. Ai e ndau atë nga populli dhe e dëboi nga vendi përgjithmonë. Ndërsa popullit i tha: Padyshim Zoti juaj është Allahu, I Cili nuk ka tjetër përveç Tij. Ai e ka përfshi çdo gjë me dituri”. (Ta-Ha, 97-98).

Thirrja e Isait a.s. për besim në Një Zot

Isai a.s. u krijua nga Allahu në mënyrë të jashtëzakonshme pa baba, vetëm me nënë. Ai lindi në Jerusalem dhe i takonte popullit Beni Israil. Thirrja e Isait a.s. në besim ishte si e të gjithë pejgamberëve tjerë. Ai i thirri popullin e tij për të besuar në njëshmërinë e Allahut dhe vetëm Atë ta adhurojnë për Zot. Allahu xh.sh. Isain a.s. e përforcoi me mrekulli për të vërtetuar se është i dërguar i Tij. Lidhur me këtë flasin këto ajete kuranore:

“Pra kur erdhi Isai me argumente tha: U kam ardhur me urtësinë (pejgamberinë) dhe për t’u sqaruar një pjesë të asaj, për të cilën po kundërshtoni. Frikësohuni Allahut dhe më binduni mua. Me të vërtetë Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuronie (vetëm) Atë. Kjo është rruga e drejtë”. (Ez-Zuhruf, 63-64).

Edhe pse Isai a.s. mësoi se është rob dhe pejgamber i Zotit, ithtarët pas tij u përçanë, sepse disa menduan drejtë për Isain si rob dhe i dërguar i Zotit, disa thanë se është djalë i Zotit e disa shkuan edhe më larg e thanë për të se është vet Zoti.⁸

Allahu i madhërishëm këto trillime të tyre i gjykon dhe i demanton në disa ajete kuranore duke theksuar se Isai a.s. ka thirr për të besuar dhe adhuruar vetëm Atë për Zot. Në vazhdim po sjellim disa prej këtyre:

“Jahudinjtë thonë: Uzejri është djali i Zotit, kurse të krishterët thonë Mesihu-Isai është djalë i Zotit, këto

⁸ H. Sherif Ahmeti, Kur’ani – përkthim me koment, Prishtinë, 1988

janë fjalë të tyre (të dala) nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e mohuesve (idhujtarëve) të mëparshëm, Allahu i vraftë si shpifin.” (Et-Tevbe, 30).

“Kanë mohuar (të vërtetën) ata që thonë Mesihu (Isai) biri i Merjemes është zot, kurse Mesihu ka thënë: O bijtë e Israilit, adhurone Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, kush i shoqëron (në adhurim diç) Allahut, atij Allahu ia ka ndaluar Xhenetin dhe vendi i tij është Xhehenemi”. (El-Maide, 72).

Thirrja e Muhamedit a.s. për besim në Një Zot

Muhamedi a.s. i takonte fisit Kurejsh, që jetonte në Meke dhe ishte pasardhës i Ismailit djalit të Ibrahimit a.s. Derisa peygamberët tjerë Allahu xh.sh. i dërgoi për të thirrur popullin e tyre në besim të drejtë, kurse Muhamedin a.s. e dërgoi peygamber për mbarë njerëzimin.

Para shpalljes së fesë Islame arabët besonin në shumë zota, në dukuritë natyrore dhe në trupa qiellor, të cilët i personifikonin në idhuj të ndryshëm të ndërtuar prej ari, argjendi, gurëve të çmuar etj. Ata i adhuronin duke besuar se do të ndërmjetësojnë dhe do t’iu ndihmojnë te Zoti i madh. Disa prej tyre i adhuronin xhinët, e disa besonin se melaiket janë vajzat e Zotit.

Edhe pse nga injoranca dhe primitivizmi, ata besonin në shumë zota, ideja e besimit në Allahun si krijues suprem, gjithmonë ka qenë e pranishme tek ta. Zoti i madhërishtë në një ajet kuranor thotë:

“Nëse i pyet ata (politeistët) kush i ka krijuar qiejt dhe tokën, me siguri do të thonë: i ka krijuar Allahu...”

(Zumer, 38).

Gjithashtu, edhe ata që ishin ehli-kitab (ithtarë të librave Hyjnorë) kishin devijuar duke kombinuar fenë me filozofi dhe besëtytni. Jehuditë pretendonin se Zoti (Jehova) është vetëm i tyre dhe se ata janë popull i zgjedhur i Tij, ku si të atillë janë të krijuar si sundues të botës. Ata veten e quanin se janë të dashurit e Zotit, ndërsa H. Uzjejriri e besonin për djalë të Zotit. Nasranit – të krishterët, ndërkaq, të cilët e përbënin Perandorinë Bizantine në atë kohë, edhe ata kishin devijuar nga mësimet e vërteta të H. Isait a.s. Ata pohonin se Zoti është një, por besonin se është i përbërë nga tre anëtarë: Zoti, biri i Tij dhe shpirti i shenjtë. Pasi që H. Isaji u krijua dhe lindi në mënyrë të jashtëzakonshme pa baba, ithtarët e tij më vonë e konsideruan për bir të Zotit dhe filluan ta adhurojnë.

Zoti i madhërishtë nga mëshira e Tij e pakufishme, duke dëshiruar që t’i udhëzojë njerëzimin në besim të vërtetë në një Zot, e dërgoi për peygamber Muhamedin a.s. Ai përmes Kuranit që ai shpalli Allahu solli argumente bindëse për ekzistimin e një Zotit, Krijuesit të gjithësisë, që vetëm Ai është i meritueshëm për tu adhuruar. Ai përmes Kuranit u njoftua nga Zoti xh.sh. mbi rrugën e gabueshme të idhujtarëve dhe revidimet që i kishin bërë ithtarët e librave të shenjta, në fenë e vërtetë e cila ishte dërguar nga Ai me anë të peygamberëve të mëparshëm.

Në bazë të argumenteve të shpallura në Kur’an, vërtetohet se ekziston një Zot, i Cili është krijues, edukues, rregullues, sundues dhe mbikëqyrës i përhershëm i kësaj gjithësie

me të gjitha krijesat që gjenden në të. Zoti i Madhërishëm ka thënë:

“Thuaj, Ai Allahu është një i vetëm. Allahu është i përhershëm. Nuk ka lindur as nuk është i lindur. Dhe Atij nuk i përngjet askush”. (El-Ihlas, 1-4).

Meqenëse në gjithësi zhvillohet gjithçka në kuadër të një rendi dhe harmonie të plotë, kjo dëshmon se ekziston vetëm një sundues, i cili qeverisë dhe vepron sipas dëshirës së Tij absolute. Në të kundërtën, sikur të ekzistonin shumë zota, atëherë secili do të vepronte sipas dëshirës së vet dhe në gjithësi do të shkaktonin çrregullime e katastrofa të ndryshme.⁹

Allahu xh.sh. në këtë ajet kur'anor ka thënë: ***“Sikur të kishte në qiell dhe tokë zota tjerë përveç Allahut, ato do të ishin shkatërruar”. (Enbija, 22).***

Përveç kaptinës së lartpërmendur në Kuran, ekziston edhe një numër jashtëzakonisht i madh i cili flet për çështjen e besimit dhe adhurimit të Allahut, për Zot duke mos i bashkangjitur Atij asgjë në adhurim. Me këtë rast po i përmendim vetëm disa prej tyre në të cilat Allahu xh.sh. ka thënë:

“Allahu ka dëshmuar se nuk ka Zot tjetër pos Tij, (dëshmuar) edhe melaqet dhe dijetarët...” (Ali Imran, 18).

“Thuaj (Muhamed) unë jam vetëm njeri sikur ju, mua më është shpallur se me të vërtetë Zoti juaj është Një Zot. Kush është që shpreson në takimin e Zotit të tij le të bëjë vepra të mira dhe le të mos i shoqëroj Zotit të tij në adhurim askënd”. (El-Kehf, 10).

⁹ H. Hoxha, Besimi dhe adhurimi ndaj Zotit të Madhërueshëm, Takvim, Prishtinë, 2012, fq. 139.

Në disa ajete kuranore Allahu xh.sh. e ka porositur Muhamedin a.s. për t'i thirr në besim të vërtetë në Një Zot edhe ithtarët e librit – jahuditë dhe të krishterët. Në mesin e këtyre ajeteve është edhe ky ajet me të cilin Ai i thotë Muhamedit a.s.:

***“Thuaju o ithtarë të librit (Jahudi e të krishterë) ejani te një fjalë që është e njëjtë (e barabartë) mes nesh dhe jush, të mos adhurojmë tjetër pos Allahut e të mos i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim), të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin për zota, në vend të Allahut. E në qoftë se ata refuzojnë, thoni dëshmoni pra se ne jemi myslimanë”.* (Ali Imran, 64).**

Edhe pse ata ishin me besim më afër besimit Islam se sa idhujtarët ngase ishin ithtarë të shpalljeve hyjnore (Tevratit dhe Inxhilit), për shkak të fanatizmit dhe xhelozisë, me përjashtim të një numri të vogël prej tyre, ata nuk besuan.

Muhamedi a.s. edhe si pejgamberët tjerë të lartpërmendur u kundërshtua dhe u maltretua nga populli i tij, sa që u detyrua të shpërngulet në Medine dhe të përballet me luftën kundër tyre, ai me ndihmën e Allahut me sukses të plotë e kreu misionin e tij. Këtë më së miri e vërteton fakti se për të gjallë të tij i erdhën delegacionet e shumta të fiseve arabe nga të gjitha viset e Gadishullit arabik dhe e pranuan Islamin. Vet fjala “la ilahe il-lallah”, “*ska Zot tjetër përveç Allahut*” është bazament i besimit Islam,

E lusim Zotin e Madhërishëm që të na mundëson që të jetojmë dhe të vdesim me besim se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij. Amin!

Kasim GËRGURI

ÇËSHTJA E IMANIT DHE DEFINICIONI I TIJ*

Termi *Iman* nënkupton: Besimin me zemër dhe deklarin me gjuhë - gojë. Shprehja me gojë, sipas disa dijetarëve të drejtimit maturidi, është pjesë e Imanit, ndërsa sipas pjesës dërmuese të tyre është kusht për aplikimin e dispozitave të Islamit.

Kush beson me zemër dhe nuk e shpreh me gojë, ai është besimtar te Allahu xh.sh., jobesimtar te njerëzit. Në anën tjetër, deklarimi i besimit me gojë, e mosbesimi me zemër, do të thotë besimtar te njerëzit e jobesimtar te Allahu. Në Botën tjetër, ky person do të jetë prej atyre që meritojnë dënimin e Allahut.

* Shkëputur nga libri *Akaidi sipas imam Maturidiut*, Kasim Gërguri, bot. Kryesia e BI-së të Kosovës, Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, Prishtinë, 2015.

Besimi i vërtetë është besimi që besohet me zemër dhe deklarohet me gojë. Asnjë njeri nuk e ka besimin e plotë në Allahun xh.sh. përderisa të mos besojë bindshëm, duke eliminuar çdo dyshim, në gjashtë themelet kryesore të besimit, të cilat janë:

1.	أَمَنْتُ بِاللَّهِ	<i>Amentu bi 'l-Lahi</i>	Unë besoj Allahun
2.	وَمَلَائِكَتِهِ	<i>Ve melaiketih</i>	Melaiket e Tij
3.	وَكُتُبِهِ	<i>Ve kutubih</i>	Librat e Tij
4.	وَرُسُلِهِ	<i>Ve rusulih</i>	Pejgamberët e Tij
5.	وَالْيَوْمِ الْآخِرِ	<i>Ve 'l-jevmil'-ahiri</i>	Ditën e Fundit (ringjalljen pas vdekjes)
6.	وَبِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ مِنَ اللَّهِ تَعَالَى	<i>Ve bi 'l-kaderi hajrihi ve sherr-rrihi mina 'll-Llahi teal</i>	Kaderin (përcaktimin) se e mira dhe e keqja janë nga Allahu.

1. **Të besuarit në Zotin xh.sh.**, në Cilësitë e Tij të larta dhe në Emrat e Tij të bukur.
2. **Të besuarit në melaiket e Tij**, të cilat veprojnë me lejen dhe Urdhrin e Allahut.
3. **Të besuarit në librat e shpallur nga i Madhi Zot xh.sh.**, libra që kanë dalluar të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e padrejta, të mirën nga e keqja, të lejuarën nga e ndaluara etj..
4. **Të besuarit në të dërguarit (Pejgamberët) e Allahut xh.sh.**, të cilët, Allahu i dërgoi që të udhëzojnë njerëzimin në të vërtetën e kërkuar, duke i nxjerrë ata nga hum-

nera drejt dritës, nga shkatërrimi në shpëtimin e përher-shëm në këtë botë dhe në botën tjetër.

5. **Të besuarit në Ditën e Fundit (Kiametin)**, e cila përfshin ringjalljen pas vdekjes, llogaridhënien, shpërblimin dhe ndëshkimin, Xhenetin dhe Xhehenemin etj..
6. **Të besuarit në caktimin (Kaderin dhe Kadanë) e Allahut xh.sh.**, sipas të cilit ekziston çdo gjë, e mirë apo e keqe, e ëmbël apo e hidhur.

Imam Ebu Hanifeja, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: **Imani-besimi nuk shtohet e as nuk pakësohet.**

Ky është mendimi i Ebu Hanifes dhe i nxënësve të tij. Thotë Imami, Allahu qoftë i kënaqur me të: “Për arsye se nuk mund të përfytyrohet pakësimi i imanit-besimit, veçse me shtimin e mosbesimit -kufrit, dhe nuk përfytyrohet shtimi i besimit përveçse me pakësimin e mosbesimit, si mund të jetë një person në të njëjtën kohë besimtar dhe jobesimtar”? Bashkimi i tyre në një vend dhe në të njëjtën gjendje është i pamundshëm dhe kjo për arsye se mosbesimi është kundër besimit.¹

Imam Ebu Hanifja, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij *El-Fikhu-l-Ekber* thotë: “Imani është deklarimi me gjuhë dhe besimi me zemër. Besimi i banorëve të qiellit (melaikeve dhe xhinëve) dhe të Tokës (përfshirë pejgamberët, evliatë dhe besimtarët e sinqertë e jo të sinqertë) nuk shtohet e as nuk pa-

¹ Mula Husejn Ibn Iskender El-Hanefij, *El-Xheveheretu'l-Munifetu fi sherhi vesijeti'l imamil-a'dham Ebi Hanife*, Indi 1980, fq. 3.

kësohet. Dhe besimtarët janë të barabartë në shkallën e besimit dhe Njesisë. Po janë të ndryshëm në vepra”.²

Nëse thuhet fjala e Allahut xh.sh. **لِيُزَادُوا إِيمَانًا** - **“për ta shtuar ata bindjen”**³ (e versete të tjera dhe hadithe të Muhamedit a.s. do të përgjigjemi: Në të vërtetë kjo është për shokët e Pejgamberit a.s., për arsye se Kurani ishte duke zbritur gradualisht, rrjedhimisht edhe parimet e besimit. Çdo pikë besimore të zbritur, Muhamedi a.s. ua transmetonte shokëve të tij, të cilët i besonin pa asnjë hezitim dhe kjo përbënte një pikë më shumë nga ajo që ishte më parë. Nga ky aspekt, brezit të ashabëve u shtoj besimi, me vetë shtimin e objektivave të besimit. Kurse për ne nuk është kështu dhe kjo për shkak të përfundimit të Shpalljes.

Esenca e Imanit nuk ndryshon, besimi është një, i pandryshueshëm. Njerëzit ndryshojnë nga aspekti i veprave, prandaj njeriu mund të jetë i devotshëm ose mëkatar.

Imani - besimi i mukalidit (imituesit) është i pranuar dhe i vërtetë. Të gjithë dijetarët janë të mendimit se imani i mukalidit është i drejtë dhe i pranuar te Allahu xh.sh.. Pejgamberi a.s. ka pranuar gjithherë besimin e beduinëve, për ta ka mjaftuar besimi edhe nëse nuk e kishin argumentuar, po vetëm kishin shprehur shehadetin, siç ka thënë: *“Thoni s’ka zot tjetër pos Allahut, do të jeni të shpëtuar”*.

² Mul-la Alij El-Karij El-Hanefi, *Sherh Kitabi’l Fikhil-Ekber, Lil Imam Ebi Hanifeh En-Nuaman bin Thabit El-Kufi*, botimi i parë, Bejrut-Liban, 1984, fq. 124-129.

³ El-Fet’h, 4.

Imani i *mukalidit* është i drejtë, me argumentet e vërtetuara si shkëlqimi.⁴

Imani dhe Islami

Iman dhe Islam, në esencë janë një, në aspektin gjuhësor ka një dallim në mes tyre, kurse baza është e njëjtë.

Islam është dorëzim dhe pranim i urdhreve të Allahut xh.sh., kurse Iman është besimi në tërë atë që buron nga Kurani dhe nga hadithet e Muhamedit a.s..

Prandaj imani nuk ndahet nga Islami nga aspekti i dispozitës, pra nuk ndryshojnë. Kushdo që konfirmon ndryshim, atij i thuhet: Cila është dispozita ndaj atij që ka besuar e nuk është dorëzuar, ose është dorëzuar po nuk ka besuar? Nëse nuk e vërteton dispozitën e njëjtë për secilin prej tyre, atëherë përgjigjja e tij nuk është tjetër përveçse e pavlefshme.⁵

Shumë nga dijetarët e kohëve të ndryshme bëjnë dallimin në mes Imanit dhe Islamit duke u bazuar në ajetin kuranor, ku Allahu xh.sh. thotë:

قَالَتِ الْأَعْرَابُ آمَنَّا قُلْ لَمْ تُؤْمِنُوا وَلَكِنْ قُولُوا أَسْلَمْنَا ...

“Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thua: “Ju nuk keni besuar ende, por thoni: Ne jemi dorëzuar...”⁶

⁴ Nurud-din Ali Bin Sultan Muhamed El-Herevi El-Karij, *Dovu'l meali li Bedi'l-Emali*, redaktuar nga Muhamed Adnan Dervish, Daru Ikre, Damask, 2002, fq. 83.

⁵ Imam Nured-din Es-Sabuni, *Akaidi Maturidij*, përkthyer nga Orhan Bislimaj, Boton: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011, fq. 163-164.

⁶ El-Huxhurat, 14.

Ky ajet ka zbritur për beduinët e fisit Beni-Esed. Imam Maturidiu në Tefsirin e tij *Te'vilat Ehli Suneh*, ajetin në fjalë e komenton kështu: Ky ajet, edhe pse flet në mënyrë të përgjithshme, ka për qëllim një grup të caktuar beduinësh, sepse, po ta kuptonim këtë ajet si përgjithësim, në këtë rast do të kuptohej si përgënjeshttrim i asaj që është zbritur nga Allahu xh.sh., ngase jo të gjithë beduinët pohuan një gjë të tillë, dhe as duhet t'u thuhet të gjithë beduinëve një gjë e tillë (lem tu'minu) - nuk keni besuar, mirëpo u thuhet atyre (eslemna) - jemi dorëzuar, e kjo çështje i rikthehet grupit specifik a të caktuar të beduinëve. Kjo na argumenton se është tërheqje e vërejtjes ndaj mynafikëve, sepse ata pohuan se kishin besuar, po në të vërtetë nuk kishin besuar. E, meqë Allahu xh.sh. nxori në shesh të vërtetën e tyre, duke njoftuar Pejgamberin a.s. se ata nuk kishin besuar, po në fakt ishin dorëzuar dhe nënshtruar ndaj besimtarëve vetëm sipërfaqësisht, nga frika e forcës që posedonin myslimanët, kjo ishte arsyeja që Allahu xh.sh. i ndaloi të thoshin: “kemi besuar”, sepse zemrat e tyre nuk ishin të bindura me Iman, po i urdhëroi të thoshin “jemi dorëzuar”. Kjo na argumenton atë që kemi thënë më herët, se qëllimi i tyre ishte se ishin nënshtruar dhe ishin dorëzuar vetëm që të shpëtonin nga ndëshkimi.

Nuk mund të quhet argumentim i mirëfilltë, bazuar vetëm në këtë ajet, se Islami dhe Imani janë të ndryshëm, sepse në fakt dallimi është bërë kur i ka ndaluar të thonë: “Amena” - “kemi besuar”, dhe i ka urdhëruar të thonë: “Eslemna” - “jemi dorëzuar”. Sikur të ishin njësoj, nuk do të ishte reale të thuhej se ky Islam është feja dhe Imani që kuptojmë ne, mirëpo është synuar “el-Istislam”- “dorëzimi”, i cili, ndonëse

quhet “el-Iman”, është vetëm iman sipërfaqësor apo bindje e jashtme.

Islami dhe imani te Ehli Suneti janë sikurse shpina me barkun, pra nuk ndahen. Kush është mumin, është edhe mysliman, dhe kush është mysliman, është edhe mumin. Nëse mungon njëra, mungon edhe tjetra.⁷

Në të vërtetë, Imani dhe Islami burojnë nga një bazë. Imani është të besuarit dhe të dëshmuarit për ekzistencën e Allahut Një, kurse Islami është dorëzimi i çdo gjëje te Allahu, dorëzim i plotë dhe pa kurrfarë rivaliteti.⁸

Imani dhe Islami janë sinonime, sepse çdo mumin është muslim dhe çdo muslim është mumin, këtë e vërtetojnë ajetet kuranore:

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ
الْخَاسِرِينَ

“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurr-sesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit”.⁹

Dhe:

⁷ Ebi El-Jusr Muhamed El-Bezdevij, *Usulu'd-Din*, me redakturë të Hans Peter Lens, Mektebetu el-Ez'herijeh lit-turath, Kajro, 2003, fq. 228.

⁸ Ebu Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud El-Maturidi Es-Samar-kandi El-Hanefi, *Te'vilatu Ehli-Suneh*, redaktuar nga Fatimeh Jusuf El-Hajmi, botim i parë, Bejrut-Liban, 2004, vëll. V, fq. 549.

⁹ Ali Imran, 85.

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ...

“Feja e pranueshme te Allahu është Islami.”¹⁰

Edhe Imam Taberiu në Tefsirin e tij, në lidhje me ajetin në fjalë, thotë: Beduinët pohuan: I kemi besuar Allahut dhe Pejgamberit dhe ne jemi besimtarë. Allahu xh.sh. i thotë Pejgamberit a.s.: Thuaju atyre, o Muhamed: Nuk keni besuar dhe nuk jeni besimtarë (mu'minin), por thoni: jemi myslimanë-jemi dorëzuar.

مَنْ قَالَ رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا، وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولًا وَجَبَتْ لَهُ الْجَنَّةُ

“Pejgamberi a.s. ka thënë:”Kush thotë: “Jam i kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe, dhe me Muhamedin a.s. për pejgamber, atij i obligohet Xheneeti.”¹¹

Në mesin e dijetarëve ka pasur mospajtime rreth termave Iman dhe Islam. Lidhur me këtë, është urdhër i Allahut xh.sh. për Pejgamberin a.s. që t’ua përkujtonte beduinëve, për arsye se ata kishin pohuar me gjuhët e tyre se ishin besimtarë, por në të vërtetë ishte e kundërta, e kishin thënë këtë nga mosdija dhe nga frika.¹²

Nëse Imani do të ishte tjetër nga Islami, atëherë ai është i papranuar, kur dihet se imani është vetë feja - *Ed-din* (besimi

¹⁰ Ali Imran, 19.

¹¹ Ebu Davudi, *Es-Sunen*, vëll. I, fq. 290, hadithi nr. 525; Po ashtu, shih: Et-Tirmidhi, *Es-Sunen*, vëll. V, fq. 465, hadithi nr. 3389.

¹² Imam Taberiu, *Xhamiul bejan fi tefsiril Kur'an*, sipas: www.altafsir.com.

në Allahun), dhe kjo është e padiskutueshme. E, në anën tjetër, nëse feja (besimi në Allahun) është tjetër nga Islami, ajo nuk mund të jetë prej Allahut, dhe, si e këtillë është e paprnuar te Ai.¹³

Një vlerësim të njëjtë Imam Maturidiu jep edhe për ajetet 35 e 36 të sures Edh-Dharijat, ku Allahu xh.sh. thotë:

فَأَخْرَجْنَا مَنْ كَانَ فِيهَا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ فَمَا وَجَدْنَا فِيهَا غَيْرَ بَيْتٍ
مِنَ الْمُسْلِمِينَ

“Dhe kush ishte aty nga besimtarët, Ne i nxorëm (i larguam). Po nuk gjetëm aty pos një shtëpie muslimane.”¹⁴

Ajeti i parë paraqet vendbanimin e Lutit a.s., kurse **“Ne i nxorëm (i larguam). Po nuk gjetëm aty përveç një shtëpie muslimane”**, bëhet fjalë për shtëpinë e Lutit a.s.. Në këtë formë melaiket i paraqitën ata si *mu'mininë* dhe *musliminë* për faktin se Islami dhe Imani janë një.¹⁵

Një sqarim të njëjtë jep Imam Maturidiu në librin e tij të njohur *Kitabut-Tevhid*, dhe si përfundim thotë:

“Ata që bëjnë dallimin në mes Imanit dhe Islamit, bëjnë shpikje nga larg”.¹⁶

¹³ Xhemalu-din Ahmed bin Muhamed El-Gaznevij el-Hanefij, *Kitabu usuliddin*, redaktuar dhe trajtuar nga Omer Vefik Ed-Dauuk, Dar El-Beshair el-Islamijeh, Bejrut-Liban 1998, fq. 261-263.

¹⁴ Edh-Dharijat, 35-36.

¹⁵ Ebu Mensur El-Maturidi, po aty, vëll. V, fq. 582.

¹⁶ Imam Ebu Mensur El-Maturidi, *Kitabut-Tevhid*, po aty, fq. 401.

Imam Muslimi në Sahihun e tij e transmeton hadithin e njohur si hadithi i Xhibrilit, se Omeri r.a. ka thënë:

بينما نحن جلوس عند رسول الله ذات يوم، إذ طلع علينا رجلٌ شديدُ بياضِ الثيابِ، شديدُ سوادِ الشعرِ، لا يُرى عليه أثرُ السفرِ ولا يعرفه منا أحدٌ، حتى جلس إلى نبي الله، فأسند ركبتيه إلى ركبتيه، ووضع كفيه على فخذيه، و قال : يا محمدُ أخبرني عن الإسلام؟ فقال رسول الله: الإسلام أن تشهد أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسولُ الله، وتقيم الصلاة وتؤتي الزكاة، وتصوم رمضانَ، وتحجَّ البيتَ إن استطعتَ إليه سبيلاً. قال: صدقتُ فعجبنا له يسأله ويصدِّقه، قال: فأخبرني عن الإيمان، قال: أن تؤمن بالله وملائكته وكتبه ورسله واليوم الآخرِ تأمن بالقدر خيره وشره، قال: صدقتُ. قال: فأخبرني عن الإحسان، قال: أن تعبد الله كأنك تراه فإن لم تكن تراه فإنه يراك، قال: فأخبرني عن الساعة، قال: ما المسؤول عنها بأعلم من السائل قال: فأخبرني عن أماراتها، قال: أن تلدَّ الأمة ربتها وأن ترى الحفاة العراة العالة رعاء الشاء يتطاولون في البنيان، ثم إنتلق فلبث ملياً ثم قال: يا عمرُ أتدري من السائل قلْتُ: الله ورسوله أعلم، قال: فإنه جبريلُ أتاكم يعلمكم دينكم.

“Ishim duke ndenjur te Pejgamberi i Allahut kur erdhni një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zinj, te ai nuk dukeshin shenjat e udhëtarit dhe askush nga ne nuk e njihnim, derisa u ul pranë Pejgamberit a.s. duke i mbështetur gjunjët e vet në

*gjunjët e Pejgamberit a.s. i vendosi duart e veta në kofshën e tij dhe tha: O Muhamed, më trego **ç'është Islami?** Pejgamberi a.s. tha: Islami është të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përpos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin, ta kryesh Haxhin nëse ke mundësi. Tha: Të vërtetën e the, e ne u habitëm po pyet dhe po e vërteton. Vazhdon e thotë: Më trego **ç'është Imani?** Pejgamberi a.s. përgjigjet: Të besosh Allahun, melaiket e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, ta besosh Ditën e Fundit, të mirën dhe të keqen që është prej Tij. Të vërtetën e the, dhe vazhdoi: Më trego **ç'është Ihsani?** Pejgamberi a.s. tha: Ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh, sepse, edhe nëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty. Tha: Më trego **kur është Kiameti,** Pejgamberi a.s. tha: Për këtë i pyeturi nuk di më shumë sesa pyetësi. Tha: Më trego për shenjat e tij? Pejgamberi a.s. tha: Kur robëresha të lindë zotërinë e saj, kur barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë, ndërtojnë ndërtesa të larta. Pastaj ai shkoi, kurse unë (Omeri r.a.) mbeta për një kohë. Pastaj Pejgamberi a.s. tha: O Omer, a e dite se kush ishte pyetësi? Thashë: Allahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë më së miri. Tha Pejgamberi a.s.: “Me të vërtetë ishte Xhib-rili, erdhi t’jua mësojë fenë tuaj.”¹⁷*

¹⁷ Imam Neveviu, *Sherhu Sahihi l' Muslim*, Kitabul iman, hadithi nr.8, vëll. I, Bejrut, pa vit botimi, fq. 36.

Nëse analizojmë hadithin e Pejgamberit a.s., i cili flet mbi Islamin, Imanin, Ihsanin dhe Kiametin, të cilin e kemi cekur më lart, vërejmë këto: Njëshmëria, dituria, Islami dhe Imani nuk janë as një e as të ndryshme, nëse bashkohen bëhet Din-Fe e kompletuar dhe gjen shprehjen ajeti kuranor:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ...

“Feja e pranueshme te Allahu është Islami.”¹⁸

Islami është konsideruar si flamur i fesë, me të cilin është dërguar bartësi i mesazhit më të madh, Muhamedi a.s., dhe këtë të vërtetë e kanë kuptuar të gjitha gjeneratat.

Kur përmendet Islami, vetvetiu kuptohet adresa që është e përqendruar në Kuran dhe në Synetin e Pejgamberit a.s., prandaj le të hyjë kush të dojë në këtë derë të madhe e fisnike me kushtet e imanit dhe normat e tjera që dalin nga burimet e fesë islame.¹⁹

Gjashtë kushtet e Imanit të cilat i kemi përmendur më lart dhe pesë kushtet e Islamit që do t'i përmendim në vazhdim e përbëjnë një tërësi të pandashme, ku njëra pa tjetrën nuk qëndron. Në këtë mënyrë dhe me këtë besim si tërësi kompletohet feja e Allahut.

Si përfundim, Imani dhe Islami janë të njëjtë, njëri pa tjetrin nuk mund të qëndrojë dhe nuk kanë kuptim të plotë, sepse vetëm duke i marrë si një, kompletohet feja e Allahut si fe e vetme e pranuar, e përsosur, e zgjedhur dhe e kompletuar, siç thotë edhe Allahu i Madhëruar:

¹⁸ Ali Imran, 19.

¹⁹ Muhamed Gazali, *Akidetul-muslim*, Darul-Kalem, Damask, 1989, fq. 123.

... الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتِمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا ...

*“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhu-
ntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin fe”.²⁰*

Përrjashtimi në Iman

Në mesin e dijetarëve ka pasur dhe ka kundërthënie nëse bën ose jo të përdoret thënia *Insha Allah* kur bëhet fjalë për çështje të besimit.

Nëse njeriu beson dhe deklaron sinqerisht shehadetin-dëshminë: “Eshhedu en la ilahe il-lAllah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”, e që do të thotë: **“Dekla-
roj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Mu-
hamedi është rob dhe i dërguar i Tij”**, lirisht mund të thotë: “Unë jam besimtar i vërtetë” dhe nuk preferohet të thotë: “Unë jam besimtar, nëse Zoti dëshiron (inshaAllah)”.

Sipas Imam Ebu Hanifes: Besimtari është i vërtetë, bazu-
ar në ajetin kuranor:

أُولَئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا ...

“Të tillët janë besimtarë të vërtetë...”²¹

Dhe kafiri është i vërtetë:

²⁰ El-Maide, 3.

²¹ El-Enfal, 4.

أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا ...

“Të tillët lanë jobesimtarë të vërtetë”²²

Nuk ka dyshim në besim (Iman) sikurse nuk ka dyshim në mosbesim (kufër), sepse përjashtimi dërgon në dyshim.

Dyshimi në Iman nuk konsiderohet i drejtë për atë që pohon: Dëshmoj se Allahu është një, dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i Tij, besoj në melaiket, në librat, në pejgamberët, nëse do Zoti - inshaAllah.²³

Përjashtimi (el-istithna) në këtë formë anulon besimin, nëse përdoret përjashtimi kur thuhet: insha Allah.

Besimi-Imani është një lloj kontrate në mes robit dhe Zotit, kontratë e pashkruar po e besuar me zemër dhe e shprehur me gjuhë - se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

Kurse, për sa u përket çështjeve të ndryshme që besimtari planifikon t'i bëjë në të ardhmen, duhet të thotë patjetër “Insha Allah”, duke u bazuar në ajetin kuranor:

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَيْءٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَلِكَ غَدًا. إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ وَادْكُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَى أَنْ يَهْدِيَنِّي رَبِّي ...

“Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: “Unë do ta bëj këtë nesër!” Vetëm (nëse i shton): “Në dashtë Allahu!” E, kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe

²² En-Nisaë, 151.

²³ Husejn bin Abd El-Muhsin i njohur si: Ebi Adhbetu, *Err-Rrevdatu'l behijjetu fi ma bejne'l eshairetu ve'l maturidijetu*, Redaktuar, paraqitur dhe trajtuar nga: Dr. Abd Err-Rahman Umejreh, botim i parë, 1989, fq. 9-10

thua: “Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim...!”²⁴

Besimi dhe falënderimi

Besimi Islam është esenca e çdo pune. Të gjitha veprat e tjera me të cilat na ka obliguar Allahu xh.sh., janë degë të besimit, e besimi është esenca e tyre. S’ka dyshim se esenca është më e vlefshme sesa dega. Atëherë puna e mirë buron nga besimi - kthehet në esencë.

Imani- besimi jep frytin e punës, e puna nuk jep frytin e imanit. Prandaj, njeriu pa besim - iman në Allahun xh.sh., është jobesimtar - qafir, pa marrë parasysh se çfarë pune punon.

Imani-besimi është të besuarit me zemër dhe të shprehurit me gojë se: **S’ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.**

Allahu xh.sh. është i Vetëm dhe kërkon nga njeriu që të mos i shoqërojë asgjë. Ai në Kuran thotë:

وَالْهُكُمُ إِلَهُ وَاحِدٌ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ...

“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, Allahu, nuk ka zot pos Atij.”²⁵

²⁴ El-Kehf, 23-24.

²⁵ El-Bekare, 163.

Atij nuk i përngjan asgjë nga krijesat.

... لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

“...asnjë send nuk është si Ai; Ai është Dëgjuesi dhe Shikuesi i çdo gjëje.”²⁶

Në anën tjetër, ai njeri që beson Zotin Një, kurse në vepra është i mangët, nuk është jobesimtar, nuk i themi qafir, po i themi hipokrit, prandaj përfundojmë se besimi është më i vlefshëm se puna.

Nuk ka dyshim se imani është çështje e zemrës dhe atë nuk e di askush përveç Allahut, mirëpo kjo nuk do të thotë se veprat nuk kanë rëndësi, po veprat janë kusht për fitore të madhe në këtë dhe në botën e amshueshme dhe për grada të Xhenetit. Njeriu besimtar duhet të besojë pesë kushtet e Islamit, që janë:

- 1. Shehadeti dëshmia;**
- 2. E falmja e namazit;**
- 3. Agjërimi i muajit të Ramazanit;**
- 4. Dhënja e Zekatit;**
- 5. Kryemja e Haxhit.**

Përveç këtyre pesë kushteve të Islamit që u përmendën më lart, besimtari obligohet edhe me obligime të tjera që dalin nga Kurani dhe hadithet e Pejgamberit a.s., sepse Imani kushtëzohet me pranimin e të gjitha dispozitave të Sheriatit.

Duke filluar nga:

Gusli (pastrim i detyruar), abdesi (me rastin e faljes së namazit, leximit të Kuranit, Tavafit rreth Qabesë etj.), tejemumit

²⁶ Esh-Shura, 11.

(në rastet kur nuk gjendet uji), mes'hi mbi meste (mbathje që e mbulon këmbën deri në zogun e saj), namazi i xhumasë, namazi me xhemat, ezani, ikameti, xhihadi (përpyekje që bëhet në forma të ndryshme, mund të bëhet me trup, me pasuri, dije - shkencë etj.), falja e namazit të xhenazes, namazi i dy bajrameve, urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Ruajtja e lidhjeve familjare, respektimi i prindërve. Mosofendimi i fqinjëve (sjellja e mirë me fqinjët), dhe i të gjithë njerëzve në përgjithësi, ne i besojmë se janë të vërteta dhe jemi të obliguar t'i zbatojmë në jetën tonë.

Kamata është e ndaluar, e poashtu edhe ngrënia e pasurisë së jetimit, kurse gënjeshtër, përgojimi, bartja e fjalëve, shpifja, dëshmia e rreme janë fitne dhe ndezje e zjarrit në mesin e myslimanëve në veçanti e të njerëzve në përgjithësi, dhe si të tilla janë rreptësisht të ndaluara dhe ne e besojmë këtë.

Njeriu është krijuar në këtë botë për sprovë. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ
الْعَزِيزُ الْغَفُورُ

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi.”²⁷

Të llogarisim se të gjithë njerëzit në rruzullin tokësor do të jenë në një sallë të madhe të provimit, e cila përfaqëson

²⁷ El-Mulk, 2.

tërë gjithësinë dhe në të cilën gjenden mbikëqyrës precizë, të cilët regjistrojnë çdo vepër, e mirë a e keqe qoftë. Allahu xh.sh. thotë:

إِذْ يَتَلَقَّى الْمُتَلَقِّيَانِ عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ قَعِيدٌ مَا يَلْفِظُ مِنْ
قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ

“Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.”²⁸

Koha e këtij provimi fillon qysh nga çasti kur njeriu hyn në moshën madhore dhe përfundon me vdekjen e tij.

Nëse një nxënës a student e di sa kohë ka mbetur deri në fund të vitit shkollor, ne nuk mund ta dimë se sa na ka mbetur deri në fund të jetës sonë, prandaj duhet të jemi të përgatitur në çdo çast me besim dhe falënderim për Zotin e Madhëruar. Nxënësi a studenti në provim përdor lapsin, mjet i tij pra është lapsi, kurse njeriu mjet për provimin e kësaj bote ka: trupin e tij, kohën, pasurinë, diturinë dhe çdo gjë që i është dhënë atij nga forca dhe mundësitë.

Pasuritë që i ka dhënë njeriut Allahu xh.sh. janë të shumta dhe nuk ka mundësi që të numërohen. Allahu xh.sh. thotë:

وَإِنْ تَعُدُّوا نِعْمَةَ اللَّهِ لَا تُحْصُوهَا ...

“Në qoftë se ju përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni ato.”²⁹

²⁸ Kaf, 17-18.

²⁹ En-Nahl, 18.

Sikundër që janë: Besimi-Imani, mendja, të dëgjuarit, të parët, shëndeti, fëmijët, pasuria, mirëpo të mirat që i ka dhënë Allahu njeriut janë më shumë se këto, sepse në çdo pjesë të trupit ka të mira që s'kanë të numëruar.

Tregohet se një njeri i varfër ankohet te një dijetar për varfërinë e tij, që Allahu nuk i kishte dhënë asgjë tjetër përveç shëndetit. Dijetari i tha: A po e shet të parët tënd (sytë e tu) për qindra para? Thotë (i varfri) jo. Vazhdon dijetari duke e pyetur: A po e shet të dëgjuarit për qindra para? A po e shet dorën tënde? A po e shet këmbën tënde? A po e shet mendjen tënde për qindra para? E ai (i varfri) thoshte: jo. Atëherë dijetari u kthye e i tha: Ankoresh për varfëri, kurse ti posedon qindra mijëra para!!!.³⁰

Nga kjo i varfri kupton se pasuria e trupit të tij ishte më e madhe se pasuria në të holla (para).

Kurse ne nga ky shembull duhet të kuptojmë se pasuritë që na i ka dhuruar Allahu xh.sh., nuk kanë të numëruar dhe se shëndeti dhe gjymtyrët e trupit nuk shiten për para.

Allahu xh.sh. në një ajet të Kuranit thotë:

فَإِذَا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ
وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ

“E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar!” Por, kur,

³⁰ Dr. Sheref El-Kudah, *El-Hedju 'n-nebevij fir-rrekaik*, Daru'l Furkan, botimi i tretë, pa vend të botimit, 1992, fq. 14-15.

për ta sprovuar, ia pakëson furnizimin (e varfëron), ai thotë: “Zoti im më ka nënçmuar!”³¹

Sikur të ishte pasuria nderim, pejgamberët e Zotit do të ishin më të pasurit e botës, dhe e gjithë pasuria do t’u takonte myslimanëve, kurse në dorën e jobesimtarëve nuk do të kishte asgjë.

Për këtë do të sjellim një shembull: Një mësues i shpërndan secilit nxënës nga një libër, disave u shpërndau libra të mëdhenj, disave të mesëm e disave të vegjël. Ata që morën librat e mëdhenj, u gëzuan, kurse u hidhëruan ata që morën libra të mesëm dhe të vegjël. Pasi i shpërndau librat, profesori iu drejtua nxënësve: provimin do ta keni nga këta libra, dhe kështu ata që kishin marrë librat e vegjël u gëzuan, e ata që kishin marrë librat e mëdhenj dëshironin t’i ndërronin me ata që i kishin të vegjël. Nga ky shembull mund të kuptojmë se pasuria nuk është nderim, po provë për njeriun.³²

Prandaj, pasanikët duhet ta dinë se ku dhe si ta përdorin pasurinë, sepse do të japin llogari për atë pasuri para Krijuesit të tyre. Pasuria që ka njeriu, nuk shton grada te Zoti xh.sh., po besimi i vërtetë dhe falënderimi i sinqertë, punët e mira dhe shfrytëzimi i pasurisë në rrugën e Allahut xh.sh., - këto janë që rrisin gradën te Allahu xh.sh..

Në fenë Islame të gjithë njerëzit janë të barabartë. Allahu i Madhëruar ka bërë një barazi të plotë në mes të njerëzve. Në fenë Islame nuk ka shtresa njerëzish, që të gjithë janë të barabartë në obligime dhe drejtësi, nuk ka dallim në asnjë

³¹ El-Fexher, 15-16.

³² Dr. Sheref El-Kudah, po aty, fq. 15-16.

formë në mesin e njerëzve përveçse për nga devotshmëria. Kush bën më shumë ibadet, vepra të mira në interesin e përgjithshëm të Islamit dhe të myslimanëve, ai është më i vlefshëm. Për këtë mbështetemi te Fjala e Allahut:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ
*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli e një femre, ju bëmë popuj e fise, që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i Dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.*³³

Thamë se pasuria është një provim për njeriun e kalimi me sukses në këtë provim është shfrytëzimi i saj në rrugë të drejtë dhe shprehja e falënderimit. Falënderimi ndahet në tri lloje: 1. Falënderimi me zemër; 2. Falënderimi me gjuhë; dhe 3. Falënderimi me vepra - punë.

1. Falënderimi me zemër: Bëhet me besim të singertë në Allahun xh.sh. dhe me kushtet e tjera të Imanit, të cilat janë: të bsuarit në melaiket, në librat e shpallur, në pejgamberët, në Ditën e Fundit dhe në Kaderin e Kadanë e Allahut.

Besimi me zemër plotësisht - se gjithë pasuria nuk vjen nga askush tjetër përveçse nga Krijuesi i gjithësisë, i Cili nuk ka asnjë rival, - është besim dhe falënderim.

³³ El-Huxhurat, 13.

Allahu xh.sh. thotë:

وَمَا بِكُمْ مِنْ نِعْمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ...

“Dhe çdo të mirë që keni, ajo është prej Allahut...”³⁴

Pejgamberi a.s. në një hadith thotë:

واعلم أنَّ الأُمَّةَ لو اجتمعتْ على أن ينفعوك بشيءٍ لم ينفعوك إلا

بشيءٍ قد كتبه الله لك

*“Dije se, nëse i gjithë populli tubohen që të të bëjnë dobi (të shpenzojnë) për ndonjë çështje, nuk do të të bëjnë dobi (të shpenzojnë) asgjë përveç asaj që të ka caktuar Allahu”.*³⁵

2. Falënderimi me gjuhë: Ky lloj falënderimi bëhet duke e përmendur Allahun shpesh dhe duke thënë: الحمد لله - Falënderimi i takon Allahut. I Lartëmadhërishmi thotë:

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ

“E për të mirat që të dha Zoti yt, trego (udhëzo njerëz)! ”³⁶, por duke u ruajtur nga mendjemadhësia.

Nga falënderimi me gjuhë është edhe leximi i Kuranit, urdhërimi për të mirë e ndalimi nga e keqja, dhe të gjitha fjalët e mira, nga të cilat kanë dobi njerëzit.

³⁴ En-Nahl, 53.

³⁵ Et-Termidhij, El-Xhamiu, 4/67, Kitabu'l-kijameh, hadithi nr. 2635.

³⁶ Ed-Duha, 11.

3. Falënderimi me punë - vepër: Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë:

...اعْمَلُوا آلَ دَاوُدَ شُكْرًا وَقَلِيلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّكُورُ

“...Veproni duke falënderuar, o familje e Davudit, e nga robërit e Mi, pak janë mirënjohës.”³⁷

Falënderimi me punë është i llojllojshëm. Atë që e begaton Allahu me drejtëudhëzim, ai duhet t’i thërrasë njerëzit në atë rrugë të drejtë. Atë që e begaton Allahu me mendje - logjikë të shëndoshë, ai duhet ta shfrytëzojë atë aftësi mendore për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë. E kë e furnizon Allahu me pasuri, ai duhet ta shpenzojë atë për hir të Zotit dhe në rrugë të Tij, fshehtas dhe haptas. E kë e furnizon Allahu me trup të shëndoshë, të zhvilluar dhe të fortë, ai duhet ta shfrytëzojë për hir të Allahut xh.sh. dhe për të mirën e njerëzimit.

Prandaj, të tri llojet e falënderimit shtojnë të mirat e kësaj bote. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

لَئِنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ وَلَئِنْ كَفَرْتُمْ إِنَّ عَذَابِي لَشَدِيدٌ

“Nëse e falënderoni, do t’jua shtoj të mirat, e nëse e përbuzni, s’ka dyshim se dënimi Im është i vështirë!”³⁸, d.m.th. falënderimi që i bëhet Zotit xh.sh. për të mirat që na i ka dhënë, i shton edhe më tepër ato dhe jemi nën mbrojtjen e Allahut e nën hijen e kënaqësisë së Tij, kurse në botën tjetër na gradon me Xhenet dhe me shpërblime të veçanta.

³⁷ Sebe’, 13.

³⁸ Ibrahim, 7.

... وَسَنَجْزِي الشَّاكِرِينَ

“Kurse mirënjohësit Ne do t’i shpërblejmë.”³⁹

Besimi - Imani në Allahun, përfaqëson fisnikrinë më të madhe në mes njeriut dhe Krijuesit, për arsye se njeriu është krijesa më e nderuar mbi sipërfaqen e tokës, kurse nderi më i madh i njeriut është zemra e tij, e nderi tjetër është imani në zemrën e tij, siç thotë Allahu në suren El-Huxhurat:

...وَلَكِنَّ اللَّهَ حَبَّبَ إِلَيْكُمُ الْإِيمَانَ وَزَيَّنَهُ فِي قُلُوبِكُمْ وَكَرَّهَ إِلَيْكُمُ الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ أُولَئِكَ هُمُ الرَّاشِدُونَ . فَضْلًا مِّنَ اللَّهِ وَنِعْمَةً وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

“...por, Allahu juve jua bëri të dashur besimin dhe jua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, jua bëri që ta urreni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë. Kjo është dhuratë dhe begati prej Allahut, e Allahu është i Dijshëm dhe i Urtë.”⁴⁰

Ndërsa Pejgamberi a.s. thotë:

وَإِنَّ فِي الْجَسَدِ مُضَغَةً، إِذَا صَلَحَتْ صَلَحَ الْجَسَدُ كُلُّهُ وَإِذَا فَسَدَتْ، فَسَدَ الْجَسَدُ كُلُّهُ . أَلَا وَهِيَ الْقَلْبُ .

“Me të vërtetë në trupin e njeriut gjendet një copë mi-shi, nëse ajo është e shëndoshë, krejt trupi është i shëndoshë. E nëse ajo pjesë e trupit është e infektuar (e

³⁹ Ali Imran, 145.

⁴⁰ El-Huxhurat, 7-8.

*prishur), krejt trupi është i prishur, e ajo është zemra.*⁴¹

Ky hadith na tregon se në trupin e njeriut gjendet një mbret që e udhëheq atë e ai është zemra. Trupi i njeriut përbëhet prej katër gjërave:

1. Trupi - puna e tij është vetëm zbatimi.
2. Shpirti - është një fuqi që e bën trupin të aftë për të zbatuar veprën, shpirti është sikur rryma për aparatet elektrike.
3. Mendja - puna e saj është paraqitja e propozimeve që i sheh të mira a të këqija.
4. Zemra - puna e saj është dëgjimi i propozimeve të paraqitura për të zgjedhur prej tyre, pastaj jep urdhrin në trup dhe shpirt që të zbatohen ato.

Sipas ajeteve të Kuranit, zemrat janë tri llojesh:

1. Zemra të shëndosha: zemër e shëndoshë është zemra që zgjedh të mirën dhe urdhëron për të. Allahu xh.sh. thotë:

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ . إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ .

“Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (Bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”⁴²

2. Zemra të sëmura: zemrat që zgjedhin të këqijat dhe urdhërojnë për to. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

⁴¹ El-Askalanij, po aty, *Kitabul iman*, nr. 52, vëll. 1, fq. 126; En-Nevevij, *She-rhu Sahihi-l-Muslim*, po aty, Kitabu-l-mesaka, nr. 1599, vëll. III, fq. 1219.

⁴² Esh-Shuaraë, 88-89.

فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا ...

“Në zemrat e tyre kanë sëmundje e Allahu ua shton sëmundjen”⁴³

Allahu xh.sh. në këtë ajet zemrat e atyre që nuk besojnë i quan të sëmura dhe këto zemra nuk shërohen ndryshe vetëm nëse besojnë. Prandaj, vendi i besimit dhe mosbesimit është zemra. Pejgamberi a.s. thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَنْظُرُ إِلَى صُورِكُمْ وَلَا إِلَى أَمْوَالِكُمْ وَلَكِنْ يَنْظُرُ إِلَى قُلُوبِكُمْ

*“Me të vërtetë Allahu nuk shikon në fizionomitë tuaj dhe as në pasuritë tuaja, por shikon në zemrat tua-ja”.*⁴⁴

3. Zemra të vdekura a të forta: këto lloj zemra janë të vdekurra nga mosbesimi dhe janë larg ringjalljes. Allahu xh.sh. thotë:

...فَوَيْلٌ لِلْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُمْ مِنْ ذِكْرِ اللَّهِ أُولَئِكَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ.

“Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk përmendin Allahun, të tillët janë në humbje të qartë.”⁴⁵

Feja Islame i kushton një rëndësi të veçantë zemrës së shëndoshë dhe ruajtjes së saj nga sëmundjet e dyshimeve, të inatit, xhelozisë, koprracisë, mendjemadhësisë, lakmisë e të ngjashme me këto.

⁴³ El-Bekare, 10.

⁴⁴ En-Nevevi, *Sherhu Sahihil Muslim*, po aty, nr. 2564, vëll. IV, fq. 1986.

⁴⁵ Ez-Zumer, 22.

Bahri ALIU

BAMIRËSIA (IHSÂNI) NË ISLAM

Bamirësia në Kuranin fisnik dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. përmendet me termin “*el-ihsân*”, ndërsa shkencëtarët e akaidit (besimit), *ihsânin* e përkufizojnë me kuptime të shumta, aq sa atë e vendosin në derexhenë më të lartë të imanit.

Hadithi i Pejgamberit a.s., të cilin e transmeton hazreti Ymeri r.a., *ihsânin* e shpjegon kështu: “*Ihsâni (bamirësia) është të adhurosh Allahun sikur ta shohësh Atë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.*”¹

Nëse njeriu e arrin këtë derexhe, kjo praktikisht do të thotë se ai i zbaton të gjitha dispozitat (hukmet), dhe veten e mban larg gjynaheve, sepse atë e vëzhgon Allahu xh.sh., qof-

¹ E përmendin “*Dy Sahihet*” (Buhariu dhe Muslimi), te kapitulli “*Imani*”.

të për gjynahet e mëdha, qoftë për ato të vogla, qoftë për ato që i bën fshehurazi, qoftë për ato që i bën haptazi.²

Nëse besimtari arrin në këtë nivel të imanit, pra që ta adhurojë Allahun xh.sh. sikur ta shohë Atë, ai është i vetëdijshëm dhe i bindur në plotni se Allahu xh.sh. e sheh në të gjitha lëvizjet dhe punët që bën ai. Kjo thuhet qartë në shumë ajete kuranore, si:

“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, dhe ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”³

Dhe në ajetin: ***“Allahu është i kënaqur me myslimanët e parë, muhaxhirët dhe ensarët dhe të gjithë ata që i pasuan në të mira, por edhe ata janë të kënaqur me Të; Allahu për ta ka përgatitur kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj, ku ata do të jetojnë vazhdimisht dhe përgjithmonë. Kjo është fitore e madhe!”⁴***

Dhe në ajetin: ***“S’ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës.”⁵***

² Sejjid Kutub, *Fî dhilâl el-Kurân*, “Dârush-shurûk”, Bjerut, botimi i dytë 1975/1395, f. 192.

³ Kuran, En-Nahël, 90. Kryesia e Bashkësisë Islame për RS të Serbisë - Prishtinë, Kuran-i përkthim me komentim. Përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti. Prishtinë, 1988.

⁴ Kuran, Et-Tevbe, 100. *Kurani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe*. Mbështetur në përkthimin e prof. Hasan I. Nahi. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2010.

⁵ Kuran, En-Nahël, 128.

Po ashtu edhe në ajetin tjetër: **“Nëse bëni mirësi, bëni për vete. E, nëse bëni keq, i bëni vetes.”**⁶

Nga hadithet në të cilët përmendet bamirësia (*ihsâni*) do të veçojmë hadithin e gjatë kur Xhibrili kishte vajtur te Pejgamberi a.s. dhe e kishte pyetur për “*imanin*”, “*islamin*”, “*ihsânin*” dhe “*për Ditën e Kiametit*”, dhe të cilin hadith e transmeton Ebu Hurejre r.a., ku thuhet: “Ndërsa një ditë Pejgamberi a.s. ishte në xhami me disa njerëz, erdhi një burrë me flok të zinj, i veshur me rroba të bardha. Nuk kishte asnjë shenjë nëse vinte nga larg. U ul para Pejgamberit a.s. dhe e pyeti:

- *Më thuaj ç’është imani (besimi)?*

- *“Iman është të besosh në Allahun, në melaqet e Tij, në qitapet e Tij, në pejgamberët e Tij, në Ditën e Ahiretit dhe se gjithçka që ndodh, ndodh sipas përcaktimeve të Allahut”, - iu përgjigj Pejgamberi a.s..*

- *E the të vërtetën!* - i tha pyetësi dhe vazhdoi:

- *Po, ç’është Islami?*

- *“Islami është të adhurosh Allahun dhe të mos i bësh Atij ortak, të falësh namazin, të japësh zeqatin, të agjërosh Ramazanin dhe të shkosh në haxh nëse ke mundësi”.*

- *E the të vërtetën!* - i tha ai dhe vazhdoi të pyeste:

- *Më thuaj çfarë është ihsâni (bamirësia)?*

- *“Ihsân (bamirësi) është të adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty”. - iu përgjigj Pejgamberi a.s.*

⁶ Kuran, El-Isra, 7.

Dhe, pasi e pyeti edhe për Ditën e Kiametit dhe mori përgjigjen nga Pejgamberi a.s., burri që pyeste u largua, kurse Pejgamberi a.s. tha:

- *“Kthejeni në xhami atë burrin!”*

Shokët e Pejgamberit a.s. e kërkuan burrin që pyeste, por nuk e gjetën. E kur hynë në xhami, Pejgamberi a.s. iu drejtua Ymerit r.a.:

- *“O Ymer! A e di se kush ishte ai?!”*

- *“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri”*. - u përgjigj Ymeri.

- *“Ky ishte Xhibrili. Erdhi që t’jua mësojë fenë tuaj.”* - tha Pejgamberi a.s.⁷

El-ihšanu (bamirësia) në kuptimin etimologjik:

El-ihšanu (bamirësia) në kuptimin etimologjik është e kundërta e fjalës “keq, bërja keq”. Ndërkaq, dallimi në mes të fjalës *ihšan* dhe *in’âm* (nimet)⁸ është se *ihšani* nënkupton personin, por dhe të tjerët, kurse *in’âmi* (nimeti) nënkupton vetëm tjetrin. Në këtë kuptim e përmend ajeti kuranor: ***“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi,...”***. Bamirësia të cilën e përmend ajeti ka për qëllim bamirësinë që është më shumë se drejtësia. Me drejtësi kuptojmë atë të cilën njeriu ia jep tjetrit atë që i takon. Ndërkaq, nocioni *ihšan* (bamirësi) është kur njeriu i jep më shumë nga ajo që i takon, kurse për vete merr

⁷ Imam Haxher Askilânî, *“Fet’hul-bârî sherh Sahîhul-Buhârî”*, vëll. I, Shtëpia botuese “El-Me’ârif”, Bejrut, pa vit botimi, f. 114.

⁸ *Nimet-i (mirësi)*, ata çka lypset për të kaluar një jetë të mirë; shujtë, bereqet që të siguron gjallërinë.

më pak. Sipas kësaj, kuptojmë se *ihsâni* (bamirësia) është të bësh dhe të japësh më shumë për shkak të drejtësisë. Përkufizimi i fjalës *ihsân* nga Pejgamberi a.s. ka kuptimin e *ihlâsit* (sinqeritetit), e që është shart nëse imani dhe islami do të jenë së bashkë.

Kuptimi i *el-ihsânu* në aspektin terminologjik:

Ihsâni në kuptimin terminologjik nënkupton që besimtari ta adhuroj Allahun xh.sh. në jetën e kësaj dynjaje, me bindjen: Allahu është gjithmonë i pranishëm, është mbikëqyrës, Ai e sheh zemrën e besimtarit, e sheh kur bën ibadet në vetmi dhe në bashkësi, e di kur mediton, e di kur flak gjynahet të cilat ia dridhin zemrën nëse e bën gjynahun. Sipas këtij përkufizimi, del se *ihsâni* është sinonim i *ibadetit* (adhurimit), që nënkupton se ka domethënie më të gjerë dhe nuk përkufizohet vetëm në kuptimin tekstual të fjalës bamirësi.

Ebu Xhafer Taberiu thotë se *bamirësia* është ajo të cilën besimtari e bën jo nga detyrimet të cilat i ka urdhëruar Allahu xh.sh., por nga ibadetet nafie (vullnetare), përmes të cilave përpiqet që t'i afrohet Allahu xh.sh. dhe të kërkojë razinë e Tij⁹ dhe në anën tjetër, përpiqet që të ikë nga ndëshkimet e Tij.¹⁰

Nocionin *ihsân* në Kuran e hasim në shumë ajete në të cilat ka kuptime varësisht nga përmbajtja apo porosia e ajetit kuranor. Por, meqë ato janë shumë, ne do të mjaftohemi me

⁹ Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. Tiranë, 2005.

¹⁰ *Xhâmiul-bejân fî te'vîlil-Kurân, Tefsîrut-Tabarîj*. Botimi i parë, Shtëpia botuese *Darul-hixhre lit-tabâ'a ven-neshr vet-teuzî'i*, vëll. 8, f. 665.

ato ajete që i kemi përmendur më sipër, ndërsa këtu do të shtonim se nëse njeriu dëshiron që të jetë bamirës në vepra dhe në sjellje, fillimisht duhet ta njohë Allahun xh.sh. ashtu siç duhet, pastaj ta ndiejë se Ai e mbikëqyr pandërprerë pavarësisht gjendjes dhe momentit. Besimtari duhet ta dijë se Allahu xh.sh. ka qasje në gjithçka, se Ai di gjithçka, se Atij nuk mund t'i ikë asgjë në qiej e në Tokë, se Ai e di besimtarin që mëton të arrijë rahmetin, kënaqësinë dhe dashurinë e Tij duke bërë punët me devocion dhe përgjërë, sikur Ai e sheh dhe në anën tjetër, besimtari gjithmonë përpiqet që t'i flakë ndalesat dhe të mos bëjë gjynahe.

Kategoritë e ihsânit

Dijetarët islam *ihsânin* kryesisht e ndajnë në dy shkallë:

E parë - prezenca: njeriu ta adhurojë Zotin e vet sikur ta shohë vërtet Atë. Kështu e adhuron që t'i afrohet sa më afër, nga dashuria e madhe që ta takojë Atë. Nga dashuria që ta besojë, ta respektojë dhe ta adhurojë. Kjo është derexheja më e lartë.

E dytë - mbikëqyrja: njeriu të adhurojë Allahun xh.sh. me besim të paluhatshtëm se Ai e sheh. Kështu, ai e adhuron nga frikërespekti që ka, i përkushtuar dhe i nënshtruar ndaj Tij, dhe njëkohësisht mëton të fitojë rahmetin dhe faljen e Tij.

Dallimi në mes të bamirësisë dhe detyrave

E përmendëm më lart se bamirësia në kuptimin terminologjik nënkupton punët që nuk janë të detyruara, por që i bën sipas dëshirës në mënyrë vullnetare që ta përmbushë zemrën me besim dhe njëkohësisht ta falënderojë Allahun xh.sh. për nimetet që ia ka falur Ndërkaq, detyrimet duhet të zbatohen në bazë të përkatësisë dhe obligimeve që dalin nga burimet e Sheriatit.

Se bamirësia dallon nga detyrat e tjera, e mbështesim në këtë ajet kuranor: ***“E mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër, e të bëhesh i qortuar i papërkrahur. Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve.”***¹¹

Allahu xh.sh. pra, urdhëron që vetëm Ai të adhurohet e jo edhe tjetërkush. Muxhahidi thotë se ajeti prerazi përmend testamentin e Allahut xh. që ia ka zbritur njeriut.¹²

Ajetet na mësojnë sjelljen, kulturën, obligimet vetanake dhe shoqërore, duke përfunduar me besimin në Një Zot. Fjala *kadā* - (ka urdhëruar) - tregon urdhrin e paluhatshëm që të adhurohet vetëm Allahu.¹³ Kështu, Allahu xh.sh. vendon gurin themeltar të shoqërisë njerëzore dhe individuale.

Në vazhdim ajeti prerazi e veçon bamirësinë ndaj prindërve, që nënkupton se *ihsâni* nuk është sikur *imani* dhe

¹¹ Kuran, El-Isra, 22, 23.

¹² Muhammed Ali Es-Sâbûnî, *Safvetut-tefâsîr*, vëll. II, Dârul-Kurânîl-kerîm, Bejrut, f. 157.

¹³ Sejjid Kutub, *Fî dhilâli el-Kurân*, po aty, vëllimi IV. f. 2221.

detyrimet e tjera që dalin nga Sheriati. Kjo në kuptimin etimologjik, ndërkaq në kuptimin përmbajtjesor, kuptohet se njeriu ka detyra ndaj prindërve, detyra këto që përmenden në ajetet kuranore dhe Synetin e Pejgamberit a.s. Kjo do të thotë se ndaj prindërve kemi obligime dhe detyra të caktuara, por meqë kjo nuk është objekt yni, megjithatë, po përmendim porosinë e Lukmanit të urtë që ia dha birit të tij, e që e ka përjetësuar ajeti kuranor: ***“Dhe, Ne, e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka bartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetëve. (Dhe i kemi thënë njeriut): “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Te Unë do të ktheheni të gjithë”.***¹⁴ Allahu xh.sh. urdhëron që t’i falënderojmë prindërit, mirëpo, para kësaj e përmend falënderimin ndaj Tij, duke thënë: ***“Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!”***

Ajeti na jep të kuptojmë se haku ndaj Allahut është më i madh nga haku i prindërve, falënderimi ndaj Tij është i detyruar dhe më i nevojshëm, sepse Allahu xh.sh. është Zotëruesi i vërtetë, ka përparësinë ndaj robve për nimetet që na ka falur. Kurse falënderimi ndaj prindërve është pjesë e falënderimit ndaj Zotit. Allahu xh.sh. është sebeb i vërtetë për krijimin e tyre, kurse prindërit janë sebeb i dukshëm. Atëherë sebebi i vërtetë duhet të ketë përparësinë ndaj sebeit të dukshëm.¹⁵

¹⁴ Kuran, Llukman, 14.

¹⁵ Muhammed Ali Es-Sâbûnî, *Revâiul-bejân fî tefsîri ‘l ajâtil ahkâm*, vëllimi II, Shtëpia botuese Mektebetu-l-Gazâlî, Damask.

Ibadeti dhe bamirësia janë virtyte dhe attribute engjëllore, kurse të gjitha të kundërtat e këtyre janë attribute djallëzore. Ndaj, Allahu xh.sh. fillimisht gjykon dhe përcakton që vetëm Atij t'i kushtohet ibadeti, e krahas kësaj, përmend bamirësinë dhe respektin ndaj prindërve.

Problemet fetare e morale të krijesat u paraqitën që në krijimin e tyre. Kështu na e shpjegojnë mësimet kuranore. Allahu xh.sh. parashtroi krijimin e njeriut para melaqeve dhe u tha: ***“Kur Zoti yt u tha melaqeve: “Unë po krijoj në tokë një zëvendës”! Ato thanë: “A do të vësh në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjacket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë”! Ai tha: “Unë di atë që ju nuk dini”!”***¹⁶

Komentuesit e Kuranit parashtrojnë pyetjen: Prej nga e dinin melaqet se njeriu do të këtë natyrë, pra natyrën e hairit dhe të sherrit? Sipas tyre përgjigjja është se Toka ka qenë e populluar para se të krijohej njeriu. Kundër djajve dhe xhindëve që bënin turbullirat në Tokë, Allahu xh.sh. kishte dërguar një grup melaqesh që t'i luftonin ata. Sipas kësaj, nga vetë natyra e njeriut që Allahu xh.sh. e krijoi në mes të dy energjive, të hairit dhe të sherrit, dhe meqë i dha mundësinë që të zgjedhë sipas dëshirës, melaqet kuptuan natyrën e *“krijesës së re”* - njeriut. Melaqet nuk kundërshtuan, por shprehën habinë e tyre, prandaj dhe kur Allahu krijoi Ademin dhe i urdhëroi të gjitha krijesat që t'i përulën atij, melaqet sakaq iu përgjigjën kësaj, kurse Iblisi nuk iu bind Urdhrit të Allahut

¹⁶ Kuran, El-Bekare, 30.

xh.sh. dhe tha: ***“Unë jam më i mirë se ai (Ademi). Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej baltës”.***¹⁷

Kështu, njeriu pranoi që të jetë bartës i *Amanetit* të Allahut xh.sh. në Tokë. Ndaj, besimtar i mirë është ai që çon në vend zotimin që mori para Allahut xh.sh. që do të bartë Misionin Hyjnor në Tokë.

Megjithëkëtë, nëse njeriun e sundon energjia pozitive, e hairit, ai padyshim do të përmbushë zotimin e tij para Allahut, para prindërve, para familjes, para shoqërisë dhe para vetes. Ai që ka energjinë negative, të sherrit - djallëzore, do të krijojë sebepe, arsye time që të mos i bindet e të mos e adhurojë Allahun xh.sh., të mos jetë bamirës ndaj prindërve, familjes, shoqërisë dhe vetes.

Përfundimisht bamirësia - *ihsâni*, edhe pse në kuptimin etimologjik ndryshon nga *ibadeti* - adhurimi, në kuptim terminologjik nënkupton përmbushjen e zotimit ndaj *Amanetit* që kemi pranuar nga Allahu xh.sh.

¹⁷ Kuran, Sad, 76.

KONTRIBUTE

Qazim QAZIMI

E VËRTETA MBI SHPËRBLIMET PËR LEXIMIN E KUR'ANIT

Sipas përkufizime të dijetarëve myslimanë, Kurani është fjalë hyjnore, ligjërimit i All-llahut, libër qiellor, i mrekullueshëm, i pasfidueshëm, i paimitueshëm, i paarritshëm as në përmbajtje e as në aspektin artistik. Pra, është “*mu'xhizetun*” që i është zbritur Muhamedit a.s. përmes Xhibrilit, i përcjellë besnikërisht nga ai, i shkruar që atëherë kur zbriti, i tubuar në një përmbledhje të quajtur “Mus'haf”, i ruajtur, i kultivuar e i mësuar përmendsh dhe leximi i tij është adhurim-ibadet për myslimanët.¹

¹ Es-Salih, Dr. Subhi, “*Mebahithu fi Ulumi El-Kur'an*”, fq. 21, botimi i pestë, Bejrut, 1968.

- shih, Es-Sabunij, Muhammed Alij, “*Et-Tibjanë Fi Ulumi El-Kur'an*”, botimi dytë, fq. 6, 1980/ 1400 h., pa vend botimi.

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا *

“Vërtet, ky Kuran udhëzon kah ajo që është më e drejtë dhe i përgëzon besimtarët që punojnë vepra të mira se ata, me të vërtetë, do të kenë shpërblim të madh”.²

Kurani është Fjala e All-llahut, përmes së cilës adhurohet Ai deri në Ditën e Kiametit.

Për ta mësuar e njohur Kuranin, nuk mjafton vetëm përcaktimi fetar, vetëm trashëgimia, vetëm dëshira apo vullneti sa për të lexuar diçka.

Kurani e fton njerëzimin që ta pranojë mesazhin e tij hyjnor vullnetarisht, pa imponim, me bindje, por edhe në mënyrë racionale e shkencore.

وَيَرَى الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ الَّذِي أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقُّ وَيَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ *

”Ndërsa ata që u është dhënë dijenia, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti, është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqiplotit, të Lavdishmit”.³

Meqë Kurani është burimi themelor dhe kryesor i fesë, predikimit dhe qytetërimit islam, mesazhi kuranor është që të lexohen ato pjesë të Kur’anit që janë më të lehta dhe më të kapshme për lexuesin, ngase leximi i tij është detyrim fetar dhe ibadet (adhurim).

² Kur’ani, sureja El-Isra', ajeti 9.

³ Kur’ani, sureja, Sebe', ajeti 6.

Kur'ani i shenjtë nuk është vetëm sure dhe ajete që i lexojmë ose i dëgjojmë. Ai është manifestimi shpirtëror, që adhurojmë, gijkojmë me leximin e tij. Me këto veprime All-llahu e ngre gradën e besimtarëve shumë lart dhe e vë në pozicionin e thirrësit për të besuar në Njëshmerinë e Tij, si i Vetmi që meriton të adhurohet në forma të ndryshme, po edhe përmes të leximit të Kur'anit.

Duke i çmuar vlerën dhe sevapet e leximit të Kuranit siç e cekëm edhe më lartë, All-llahu i Lartmadhërishëm e bëri të obligueshme leximin e Kur'anit dhe të praktikuarit e ligjeve sheriatike kur thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ
سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تِجَارَةً لَّن تَبُورَ *

“Ata që lexojnë librin e All-llahu, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e hap-tazi, ata shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet.”⁴

Do theksuar se ishte Xhibrili a.s. meleku që ia përcolli dhe ia mësonte Pejgamberit a.s. Kur'anin në vazhdimësi. Në vitin kur po ndërronte jetë Pejgamberi a.s., në muajin e Ramazanit, Muhamedi a.s. e lexoi Kur'anin dy herë nën përcjelljen e Xhibrilit a.s..

Edhe vetë Pejgamberi a.s. kishte kërkuar nga Ibni Mes'udi që, për kënaqësinë e tij dhe të të tjerëve, të lexonte Kur'an para tij.

⁴ Kur'ani, sureja, Fatir, ajeti 29

طلب النبي صلى الله عليه وسلم من ابن مسعود أن يقرأ عليه القرآن، فقرأ سورة النساء، فلما بلغ قوله تعالى: **”فكيف إذا جئنا من كل أمة بشهيد وجئنا بك على هؤلاء شهيداً.”** قال له عليه الصلاة والسلام: **حسبك الآن قال: فنظرت فإذا عيناه تذرفان.**

*Me një rast, Pejgamberi a.s. kishte kërkuar nga Ibni Mes'udi që t'i lexojë pjesë nga Kurani, dhe ai - siç tregon vetë, kishte lexuar nga sureja “En-Nisa” deri sa kishte arritur te ajeti: **“Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull e ty do të sjellim dëshmitar mbi ata (që nuk të besuan)”**⁵ Më tha: “Mjaft tani! E, kur e shikova Muhamedin, a.s., nga sytë e tij i rridhnin lot.*

Othman ibni Affani All-llahu qoftë i kënaqur me të, e ka përmbyllur leximin e Kur'anit (e ka bërë hatme) për çdo ditë një herë. Disa ashabë e përmbyllnin leximin e Kur'anit në Ramazan në çdo tri net, e disa prej tyre në çdo shtatë, por ka pasur prej tyre që përmbyllnin leximin e Kur'anit në çdo dhjetë net. Selefët (gjenerata e Pejgambeit a.s.) e lexonin Kur'anin gjatë muajit të Ramazanit në namazet e tyre dhe e përfundonin në çdo gjashtë net.

⁵ Kur'ani, sureja, En-Nisa, ajeti 41

Hadithet e Muhamedit a.s. që inkurajojnë për leximin e Kur'anit

Vetë Pejgamberi a.s. ka paralajmëruar për grada dhe shpërblime të mëdha për ata që lexojnë Kur'an kur ka thënë:

1. Transmetohet nga Abdullah Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Me të vërtetë atij që e lexon një shkronjë nga Kur'ani, i takon një e mirë, kurse një e mirë shpërblehet me dhjetëfish. Nuk them se Elif-Lamë- Mimë është një shkronjë, por Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë.”*⁶ Pra ai i cili i lexon vetëm këto tri shkronja i ka 30 sevape.
2. Transmetohet nga Othmani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Më i miri prej jush është ai që mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve.”*⁷
3. Transmetohet nga Aisheja, All-llahu qoftë i kënaqur me të se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Ai i cili e lexon Kur'anin pa gabime (e me lehtësi), ai do të arrijë gradën e engjëjve të pastër dhe të nderuar, ndërsa ai i cili e lexon Kur'anin me vështirësi, ai i ka dy shpërblime.”*⁸
4. Transmeton Abdullah ibni Amri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“(Në Ditën e Gjykimit) Do t'i thuhet atij që e lexon*

⁶ Shënuan: Tirmidhiu: 11/34 (Kapitulli mbi vlerat e leximit të Kur'anit) dhe thotë se është hasen sahih.

⁷ Shënuan: Buhariu: 67/9/68 (kapitulli mbi vlerën e leximit të Kur'anit), Tirmidhiu: 11/32 (kapitulli mbi shpërblimin e leximit të Kur'anit), Ebu Davudi: 1439 (kapitulli mbi namazin).

⁸ Shënuan: Buhariu: 8/691 (kapitulli mbi tefsirin), Muslimi: 6/84 (kapitulli mbi namazin e udhëtarit), Ebu Davudi: 1441 (kapitulli mbi namazin), Tirmidhiu: 12/29 (Vlerat e leximit të Kur'anit).

*Kur'anin: "Lexo dhe ngrihu, lexo ashtu siç ke lexuar në dynja, se me të vërtetë vendi yt është në ajetin e fundit që do të lexosh."*⁹

5. Ebu Hurejreja r.a. transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Atyre njerëzve që tubohen në njërën prej shtëpive të All-llahut (xhami), që të lexojnë Librin e All-llahut dhe ta studiojnë në mes vete, do t'u vijë atyre paqja (qetësia) e plotë e All-llahut dhe do t'i mbulojë mëshira e Tij, dhe melaiket do të kujdesen për sigurimin e tyre e All-llahu do t'i lavdërojë."
6. I Dërguari i All-llahut ka deklaruar: "*Shejtani largohet nga shtëpia ku lexohet sureja El-Bekare*".¹⁰
7. Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Sureja Tebareke të mbron nga dënimi i varrit*".¹¹
8. Transmeton Ebu Hurejra r.a. se i Dërguari i All-llahut-a.s. ka thënë: "*Kul huv All-llahu ehad është e barabartë me një të tretën e Kur'anit*".¹²
9. Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë: "*Nuk është prej nesh ai që nuk e zbukuron zërin e tij gjatë leximit të Kuranit*".¹³
10. Transmetohet nga Muhamedi, a.s. se duhet të "*Bëhet imam ai që më së miri lexon Kur'an*."

⁹ Tirmidhiu nr. 2914 dhe ka thënë se ky hadith është hasen-sahih.

¹⁰ Transmeton Hakimi, shiko: "Silsiletu sahiha", nr.588)

¹¹ Transmeton Hakimi, shiko "Silsiletu sahihatu", nr.1140)

¹² Transmeton Muslimi

¹³ Transmeton Ebu Davudi

11. Muhamedi, a.s. ka thënë: *“Prej madhërimit të Zotit është respekti i atij që është thinjur në Islam, respekti i atij që mëson Kur'anin dhe i përmbahet atij dhe respekti i udhëheqësit të drejtë.”*
12. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Nuk duhet të ketë xhelozizmi (gibtah) përveç ndaj dy kategori njerëzish; Ndaj një njeriu që All-llahu ia ka dhënë Kur'anin dhe ai çohet natën, fal namaz me Kur'an dhe e përsërit atë ditën dhe ndaj një njeriu që i ka dhënë Zoti pasuri dhe ai jep lëmoshë (sadaka) ditën dhe natën.”*¹⁴
13. *“Lexoni Kur'anin, se ai do të vijë ndërmjetësues në Ditën e Kiametit (për ata që e kanë lexuar dhe kanë punuar me të)”*¹⁵
14. *“Vihet Ditën e Kiametit me Kur'an dhe lexuesve të tij të cilët kanë punuar me të në këtë botë, u prin surja Bekare dhe Ali Imran. Ndërmjetësojnë për lexuesin dhe praktikuesit e tyre.”*¹⁶
15. *“Me të vërtetë All-llahu i ngre disa popuj me këtë Kur'an dhe i përul disa të tjerë.”*¹⁷
16. Uthman Ibni Affani, -r.a. ka thënë: *“Po t'u pastronin zemrat tuaja, kurrë nuk do ngopeshin nga fjala e Zotit tuaj (nga leximi i Kur'anit).”*
17. Abdullah Ibn Mes'udi, r.a. ka thënë: *“Kush prej jush dëshiron ta dijë se a e do All-llahun, atëherë le t'ia ekspo-*

¹⁴ Transmeton Buhari dhe Muslimi.

¹⁵ Transmeton Muslimi. nr. 804.

¹⁶ Transmeton Muslimi.

¹⁷ Transmeton Muslimi.

zgjë vetes Kur'anin (le ta shikoj se a e do Kur'anin), dhe nëse e do Kur'anin ai e do All-llahun, sepse Kur'ani është fjala e All-llahut.”

18. Habab Ibni Mundhiri r.a. ka thënë: “Afrohu te All-llahu sa të kesh mundësi. Por, dije se nuk ke mundësi të afrohesh te All-llahu me diçka që është më e dashur te Ai sesa Fjala e Tij (Kur'ani Famëlartë).”
19. Transmetohet nga Ibni Abasi, r.a., se Muhamedi a.s. ka thënë: “*Shembulli i atij që në gjoksin e tij nuk ka diç nga Kur'ani, është sikur një shtëpi e vjetër, e braktisur.*”¹⁸
20. H. Ymeri, r.a. e ka pasur zakon që në tubimet e tij të mbante hafëzë të Kur'anit po edhe fukarenj.

Në Luftën e Uhudit, kur i varrosnin nga dy apo më shumë dëshmorë në një varr, Muhamedi, a.s. pyeste se kush dinte më shumë Kur'an prej tyre dhe e varroste para të tjerëve.

Besohet se atij që lexon në këtë botë Kur'an, në Ditën e Gjykimit, do t'i ngrihet grada në xhenet me aq Kur'an sa ka mësuar në dynja (përmendsh) dhe sa më shumë që di përmendsh aq më shumë do t'i rritet grada në xhenet.

Kapitali i pashtershëm dhe mrekullia më e vlefshme që na e ka lënë All-llahu pas vdekjes së Pejgamberit a.s. pa dyshim se është vetë Kur'ani, ndërsa suksesi dhe lumturia e myslimanëve në të dy botët është i lidhur ngushtë me atë se sa ne jemi të lidhur me Kur'anin.

¹⁸ Transmeton Tirmidhiu.

Bazuar nga e tërë ajo që u tha gjer me tani mbi inkurajimin, vlerat dhe sevapet që fitohen me leximin e Kur'anit Fisnik mund të konkludojmë se:

- Duhet ta mësojmë e lexojmë Kur'anin sa më shumë, pasi që ai është rruga unikate, e vetme e drejtë e ndritshme.
- Duhet ta mësojmë e studiojmë Kur'anin ngase ai është ligj hyjnor për të pasur mirëqenie në të dy botët.
- Duhet ta mësojmë e lexojmë Kur'anin sepse aty gjendet krenaria e ymetit tonë.
- Duhet ta mësojmë e lexojmë Kur'anin në mënyrë që ai të jetë ndërmjetësim për ne në Ahiret.
- Duhet ta mësojmë e lexojmë Kur'anin se ky Kur'an është ai që do të na i ngrejë gradat në xhenet, lart e më lart.

Pra, Kur'ani nuk ka ka ardhur dhe prandaj nuk duhet të mbahet në shtëpitë tona vetëm sa për të zbukuruar sirtarët e dhomave tona. Por, Kur'ani ka zbritur që të lexohet, të studiohet, të kuptohet, të meditohet rreth tij, të punohet sipas tij, sepse vetëm kështu arrihet qëllimi i leximit, suksesi dhe lumturia e përhershme.

Përgatitjet dhe rregullat që duhen aplikuar për të lexuar Kur'an janë:

1. Leximi i Kur'anit duhet të bëhet me abdest.
2. Para leximit preferohet pastrimi i dhëmbëve me misvak (ose brushë).
3. Kur'ani të lexohet në vende të pastra ose në xhami.
4. Është mirë të lexohet Kur'ani ulur, i kthyer kah kibla, por lejohet edhe ndryshe.

5. Leximi fillohet duke kënduar “isteidhu billahin”, kurse fillimi i sures fillohet me “Bismilahi Er-Rrahmani Er-Rrahim”.
6. Kur’ani të lexohet duke menduar për domethënien e tij me devotshmëri.
7. Është sunnet të përsëritet ndonjë ajet disa herë që të kuptohet sa më mirë.
8. Kur’ani duhet të lexohet me tertilë (me lexim të ngadalshëm) duke shqiptuar sa më mirë dhe duke përfillur çdo rregull të mirëleximit.
9. Gjatë leximit të Kur’anit apo përsëritjes së tij duhet përqëndruar vetëm në leximin e tij.
10. Gjatë leximit të Kur’anit, duhen përsëritur edhe pjesët e memorizuara (përmendsh).
11. Është e pëlqyeshme që gjatë leximit të Kur’anit të zbukurohet e stilizohet zëri.
12. Është i preferuar kërkimi i leximit nga ai që e ka zërin e bukur.
13. Duhet pasur kujdes që gjatë leximit të mos bëhet ndalja-përfundimi në numrin e ajetit, por leximi të përfundojë aty ku mbaron ajeti me kuptim të plotë.
14. Lejohet leximi grupor si dhe ngritja e zërit nëse nuk bëhet vetëm për sy e faqe.
15. Duhet të bëhet “Sexhdetu Et-tilaveti” (sexhdja e detyrueshme) pas leximit të disa ajeteve të posaçme të Kur’anit, të kërkuara për të bërë sexhde.
16. Është i lejuar, bile është sunnet shërimi me Kur’an, e posaçërisht nëse këtë kërkim të shërimit e bën personi vetë, duke mos kërkuar nga dikush tjetër. Në Kur’an thuhet:

وَنُزِّلَ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ۚ وَلَا يَرْدُّ
الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا *

“Ne të shpallëm Kur’anin, që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshpërim.”¹⁹

17. Nuk bën të lexohet Kur’an kur hapet goja, sepse ashtu nuk mund të bëhet shqiptimi i duhur dhe se ky veprim është i nxitur nga shejtani, siç transmetohet në hadith.
18. Ndërpritet leximi i Kur’anit për ta kthyer selamin.
19. Është e ndaluar që gjatë leximit të Kur’anit të lexohet surja nga ajeti i fundit te i pari, kurse mosradhitja e sureve është e papëlqyer.
20. Është e ndaluar të lexohet Kur’an duke qenë i papastër (xhunub).

Pra, është detyrë jona dhe duhet ta lexojmë Kur’anin Fisnik me përkushtim të madh dhe me devotshmëri, madje dhe duke menduar dhe duke medituar në thellësinë e përmbajtjes së tij, ngase është një arsye e madhe që me lexim të përkushtuar arrijmë për të siguruar mirëqenie në të dy botët duke i ndritur zemrat tona, me fuqinë e besimit dhe dëbimin e djallit të mallkuar nga hapësirat tona, gjithnjë, me lexim të Kur’anit.

Myslimani duhet të lexojë Kur’an në vazhdimësi e posaçërisht gjatë muajit Ramazan, ngase mu ky është muaji në të

¹⁹ Kur’ani, sureja EI-Isra, ajeti 82.

cilin është shpallur Kur'ani. Çdo mysliman do të duhej t'i shfrytëzonte këto të mira në këto kohë të vyeshe, veçanërisht në këtë muaj, sepse një natë e këtij muaji është më e mirë dhe më e vlefshme se një mijë muaj jashtë Ramazanit. Është humbje e madhe madje edhe e pakompensueshme vlera dhe sevapi i leximit të Kur'anit për të gjithë ata që kalojnë përmes Ramazanit dhe nuk përfitojnë atë që duhet përfituar nga të mirat e leximit.

Kur'ani duhet të jetë shpirti i zemrave tona, drita që ndriçon rrugën e jetës me premisa hyjnore në të dy botët.

Leximi i Kur'anit për të vdekurit

Lejohet apo nuk lejohet të lexohet Kur'an për të vdekurit?

Këtë çështje e ka shtjelluar dhe zgjidhur fetvaja e nxjerrë nga Universiteti i El-Ez'herit me nr. 2288, qysh në vitin 2005, me titull: *"A ka shpërblime (sevabe) për atë që i lexohet dhe i dhurohet leximi i Kur'anit?"*

Adaptimi i teksti të fatvasë në shqip:

Falënderimi i qoftë All-llahut. Salavatet dhe pagja qoftë mbi të Dërguarin e All-llahut.

Fatvaja e El-Ez'heri - Sherifit:

Tema: *"Leximi i Kur'anit dhe dhurimi i sevapit-shpërblimit të tij për të vdekurit"!*

Më datë: 21/06/2005

E kemi parë pyetjen e regjistruar me numrin 1599, të vitit 2005, ku thuhej:

Pas vdekjes të njërit prej të afërmeve të mi, unë me një grup kolegësh ia lexova atij (të vdekurit) Kur'anin e Shenjtë në tërësi, dhe i dhuruam sevapin e leximit- shpërblim për të vdekurin. Atëherë, leximi i Kur'anit në këtë formë, pas vdekjes, a është risi "bid'atun" novacion dhe, a është e vërtetë se, shpërblimi i leximit nuk i arrin të vdekurit? Madje, cili është gjykimi-vendimi, po qëse i lexojmë te varri disa sure të Kur'anit të Shenjtë, menjëherë pas varrimit, siç janë suret: Jasinë, El-Melik, Ajetu-l-Kursiji, El-Felek, En-Nas?

Përgjigje e lëshuar: Nga sekretariati i Fetvave të Ez'heri-Sherifit:

Leximi i Kur'anit të shenjtë, absolutisht, është vepër e ligjshme dhe e preferuar. Argumentet për leximin e Kur'anit famëlartë janë argumente të përgjithshme dhe gjithë përfshirëse, andaj, është e domosdoshme që këto argumente të përdoren në të gjitha vendet, kohërat, personat dhe rastet. Dhe, nuk lejohet që këto argumente gjithëpërfshirëse të përdoren, të kufizohen dhe të vijnë në konsideratë vetëm për raste specifike, përveç nëse argumentet e vërtetojnë të kundërtën. Përndryshe, ky kufizim do të ishte risi në fenë islame dhe ngushtim e vështirësim i asaj që All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi a.s. e kanë lehtësuar.

Nisur nga këtu, nënkuptohet se leximi i Kur'anit të Shenjtë, te varri, gjatë varrimit dhe pas tij është legjitim dhe i lejuar sipas sheriatit islam, duke u bazuar në faktet dhe tekstet e përgjithshme që argumentojnë legjitimitetin e leximit të Kur'anit të Shenjtë. Për më tepër, kur këtyre argumenteve u

bashkëngjiten edhe hadithe të thëna nga Pejgamberi a.s. po edhe thënie të tjera nga brezi i sahabëve r.a..

Madje, ka edhe shumë informata dhe të dhëna nga tradita e paraardhësve tanë të ndershëm që preferojnë leximin e Kur'anit te varri. Si specifikë po përmendim atë që është thënë nga Imam Ebu Bekr El-Hanbeli, (311 vd. h.), në seksionin “*Leximi në varreza*” nga libri “El-Xhami”. Po ashtu edhe prononcimin e Hafidh Shemsu Ed-Din bin Abdul Vahid El-Makdisi El-Hanbeli, i cili ka shkruar një kapitull të veçantë për këtë çështje. Në favor të leximit ka shkruar edhe Imami El-Kurtubi El-Maliki (671 vd. h.) në librin e tij, “*Et-Tedhkiretu fi ahvali el-mevta ve umuri el-ahirti*”. Po, leximit i ka thënë edhe El-Hafidh Es-Sujuti Esh-Shafi'i (911 vd. h.) në librin e tij “*Sherhu es-suduri bi sherrhi hali el-mevta ve el-kuburi*”. Edhe Hafidh Abdullah ibni Es-Siddik El-Gimari (1413, vd. h.), ka trajtuar këtë çështje në librin e tij “*Tevdihu el-bejani li vusuli thevabi El-Kur'an i*”. Por, ka edhe shumë dijetarë të tjerë të cilët kanë shkruar në lidhje me këtë çështje.

Nga hadithet e Pejgamberit a.s. lidhur me këtë çështje po përmendim:

فمن الأحاديث الصحيحة الصريحة في ذلك:

1. رواه عبد الرحمن بن العلاء بن اللّجلاج ، عن أبيه قال : قال لي أبي اللّجلاج أبو خالد - : يا بُنَيَّ ! إذا أنا مُتُّ فَأَلْحِدْنِي ، فإذا وَضَعْتَنِي فِي لَحْدِي فَقُلْ : بِسْمِ اللَّهِ ، وَعَلَى مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ ، ثُمَّ سَنُ عَلَى التُّرَابِ سَنًا - أي ضَعَّهُ وَضْعًا سَهْلًا - ، ثُمَّ اقْرَأْ عِنْدَ رَأْسِي

بفاتحة البقرة وخاتمتها ؛ فَإِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ ذَلِكَ . أَخْرَجَهُ الطَّبْرَانِيُّ فِي الْمَعْجَمِ الْكَبِيرِ .

1-Hadithi që ka transmetuar Abdurrahman bin El-'Ala bin El-Lexhlaxhi nga babai i tij i cili rrëfen: Më ka thënë babai im -El-Lexhlaxhi ebu Halidi: *“O biri im, kur të vdes më vendos në varr dhe kur të më vendosësh në varr thuaj: “Bismillah ve ala mileti resulil-lah” (Me Emrin e All-llahut, dhe nga Ummeti i të dërguarit të All-llahut), pastaj më mbulo me dhe ngadalë dhe lehtë. Më pas lexoje te koka Fatihan dhe ajetet e fundit të sures El-Bekare, meqë, unë kështu e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. të këtë thënë”*.²⁰

2 . عن ابن عمر رضي الله عنهما قال : سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول : « إذا مات أحدكم فلا تحبسوه ، وأسرعوا به إلى قبره ، وليُقرأ عند رأسه بفاتحة الكتاب ، وعند رجله بخاتمة سورة البقرة في قبره » . أَخْرَجَهُ الطَّبْرَانِيُّ وَالْبَيْهَقِيُّ فِي شُعَبِ الْإِيمَانِ ، وَإِسْنَادُهُ حَسَنٌ كَمَا قَالَ الْحَافِظُ فِي الْفَتْحِ ، وَفِي رَوَايَةٍ « بفاتحة البقرة » بدلاً من « فاتحة الكتاب »

2- Në një transmetim të Ibni Ymerit r.a. thuhet: e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. që thoshte: *“Kur të vdes dikush nga*

²⁰ Hadithin e ka nxjerrë Et-Taberani në “El-Muë'xhemu El-Kebirë” vëll.19, fq. 220. Neveviu dhe Ibni Haxheri këtë hadith e kanë vlersuar të kategorisë “Hasen”.

ju mos e burgosni (mos e mbani gjatë pa e varrosur), shpejtoni që ta dërgoni në varr, dhe lexojeni te koka e tij Fatihan dhe te këmbët e tij (te varrit) fundin e Sures Bekare (dy ajetet e fundit të kësaj sureje)”.²¹

3. منها حديث علي بن أبي طالب رضي الله عنه وكرم وجهه عن النبي صلى الله عليه وآله وسلم قال: « من مر على المقابر ، وقرأ {قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ} إحدى عشرة مرة ، ثم وهب أجره للأموات ، أُعْطِيَ من الأجر بعدد الأموات » . خرَّجه الخلال في "القراءة على القبور" والسمرقندي في "فضائل قل هو الله أحد" والسَّلَفِي .

3-Rreth kësaj çështjeje është prononcuar edhe Aliu r.a. duke transmetuar nga Pejgamberi a.s. i cili ka thënë: *“Kushdo që kalon pranë varreve, ta lexojë **“Kul Huve All-llahu Ehad”** njëmbëdhjetë herë, pastaj sevapet e atij leximi t'i dedikojë për të vdekurit në ato varre, do t'i jepen sevape aq sa ka të varrosur në atë vend.*²²

²¹ Hadithin e ka nxjerrë Et-Taberani dhe El-Bejhikij në kapitullin e “El-Imanë” (Besimi).

- shih edhe: Xhamiu El-Ehadithi vëll. 4 fq. 65, Ed-Durru El-Menthurë vëll.1 fq.28, Fet-hu El-Bari - Ibni Haxher vëll. 3 fq.184.

²² Hadithin e kan xjerrë El-Halal në “El-Kiraetu ala El-Kuburi”, Es-Semerka-ndi, El Fedailu “Kul Huvallah e had” -Fikhu El-Islamijju ve Ediletuhu vëll. 2 fq.680.-Shih, Fetava El-Ez-heri vëll.5 fq.471.

4.ومنها حديث أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: «مَنْ خَلَ المقابر، ثُمَّ قرَأَ فاتحة الكتاب و﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ﴾ و﴿الْحَاقُّمُ التَّكَاثُرُ﴾، ثُمَّ قال: اللهم إني قد جعلتُ ثوابَ ما قرأتُ من كلامِكَ لأهل المقابر من المؤمنين والمؤمنات ، كانوا شُفَعاءَ له إلى الله تعالى .» خرَّجه أبو القاسم الزنجاني في " فوائده " .

4- Në favor të kësaj çështjeje është hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejrete, ku thuhet se ka thënë Pejgamberi a.s.: “Kush hyn në varr dhe e lexon Fatihan pastaj Kul HuvAll-llahu ehad dhe El-Hakum Et-Tekathuru, pastaj thotë: O Zoti im, sevapet për leximin e fjalëve të Tua ua dedikoj besimtarëve dhe besimtareve që janë në këto varre, ato (leximet e Kur’anit)) do të ndërmjetësojnë te All-llahu xh.sh. për të”.²³

2-Sunneti mbi leximin e sures Ja-Sinë për të vdekurit

السنة بقراءة سورة (يسن) على الموتى

Sunneti - ka (hadithe) dhe informacione të shumta për leximin e sures Ja-Sinë për të vdekurit.

5.حديث معقل بن يسار رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وآله وسلم قال : « اقْرَءُوا (يس) عَلَى مَوْتَانِكُمْ » رواه أحمد وأبو داود وابن ماجه وصححه ابن حبان والحاكم .

²³ Hadithin e kanë nxjerrë: Ebu El-Kasim Ez-Zenxhanij në “El-Fevaid”, shih edhe “Metalib Uli En-Nuha”, kapitulli Zijaretu El-Kubur vëll.5 fq.9, “Tuhfetu El-Ahvedhij” vëll.3 fq.275, “Hashijetu El-Xhumel” vëll.7 fq.252,

5. Transmetohet nga Mu'kal ibni Jesari nga Pejgamberi a.s. të këtë thënë: *“Lexojeni Suren Ja-Sinë për të vdekurit tuaj”*.²⁴

6. ومنها حديث أنس رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم قال : « مَنْ دَخَلَ الْمَقَابِرَ ، فَقَرَأَ سُورَةَ (يَس) ، خَفَّفَ اللَّهُ عَنْهُمْ ، وَكَانَ لَهُ بَعْدُ مِنْ فِيهَا حَسَنَات » . خَرَّجَهُ عَبْدُ الْعَزِيزِ صَاحِبُ الْحَلَالِ .

6. I kësaj natyre është edhe hadithi i transmetuar nga Ene-si r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush hyn në varre dhe e lexon Suren Ja-Sinë, All-llahu xh.sh. do t'ua lehtësojë atyre që janë në varre, dhe ai (lexuesi) do të ketë të mira aq sa është numri i personave në ato varre”.²⁵

3- Leximi e sures El-Fatihatu te xhenazja

قراءة سورة الفاتحة على الجنازة

Në sheriatin islam kemi argumente të shumta që dëshmojnë për leximin e Fatihës te xhenazja, sepse kjo sure përmban në vete shumë vlera dhe sjell dobi për të vdekurin, me

²⁴ Hadithin e kanë transmetuar: Ahmedî, Ebu Davudî “Kitab El-Xhenaizi hadithi nr. 2714, Ibni Maxheh, Ibni Habani, Hakimi etj.

- Shih edhe tefsirin El-Menar vëll.8 fq.234, Musned Et-Tajalisij vëll.2 fq.224, Fetava El-Ez-her vëll.5 fq.471

²⁵ Hadithin e ka nxjerrë Abdu El-Azizi, autori i veprës “El-Halal”.

- shih edhe: Fetava El-Ez-her vëll.5 fq.471.

qw përmban në vete kërkim mëshire, falje mëkatesh e veçori të tjera që nuk gjenden në suret e tjera :

عن عبادة بن الصامت رضي الله عنه قال : قال رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم : « أُمُّ الْقُرْآنِ عَوْضٌ عَنْ غَيْرِهَا ، وَلَيْسَ غَيْرُهَا عَوْضًا عَنْهَا » رواه الدارقطني وصححه الحاكم ، وبُؤِبَ لذلك الإمام البخاري في صحيحه بقوله (باب قِرَاءَةِ فَاتِحَةِ الْكِتَابِ عَلَى الْجَنَازَةِ)

Transmetohet nga Ubadetu bin Es-Samit se Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Ummu-l-Kur’ani* - (surja Fatiha)-*mund t’i zëvendësojë suret e tjera, kurse suret e tjera nuk mund ta zëvendësojnë atë*”.²⁶

Nga hadithi i sipërcituar kuptohet se kjo sure është gjithëpërfshirëse dhe lexohet në të gjitha namazet, madje lexohet edhe në namazin e xhenazes po edhe jashtë saj. Ka hadithe të tjera që argumentojnë se kjo sure lexohet edhe gjatë varrimit ose pas varrimit siç transmeton Ibni Umeri në hadithin e lartpërmendur në Taberani dhe të tjerët.

حديث أم عفيف النهدي رضي الله عنها قالت: «بايعنا رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم حين بايع النساء ؛ فأخذ عليهن أن لا تُحَدِّثَنَّ الرَّجُلَ إِلَّا مُحَرَّمًا ، وَأَمَرَنَا أَنْ نَقْرَأَ عَلَى مَيِّتِنَا بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ» رواه الطبراني في المعجم الكبير ، وحديث أم شريك رضي الله عنها

²⁶ Hadithin e kanë transmetuar: Daru -l-Kutni, e ka verifikuar Hakemi, po edhe Buhariu në pjesën e quajtur “Leximi i Fatihës te xhenazja”.

قالت : « أَمَرَنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنْ نَقْرَأَ عَلَى الْجَنَازَةِ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ » رواه ابن ماجه .

Transmetohet nga Ummu Afif En-Nehdije të këtë thënë:
“Na ka urdhëruar Pejgamberi a.s. të lexojmë suren Fatiha te të vdekurit tanë”.²⁷

Në një transmetim tjetër nga Ummu Shyrejk thuhet: *“Na ka urdhëruar Pejgamberi a.s. që ta lexojmë suren Fatiha te xhenazja”*.²⁸

واستدل العلماء على قراءة القرآن عند القبر 4

Dijetarët janë për leximin e Kur'anit te varri-

- واستدل العلماء على قراءة القرآن عند القبر أيضاً بحديث ابن عباس رضي الله عنهما قال : مَرَّ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَى قَبْرَيْنِ فَقَالَ : « إِنَّهُمَا لَيُعَذَّبَانِ وَمَا يُعَذَّبَانِ مِنْ كَبِيرٍ » ثُمَّ قَالَ : « بَلَى ؛ أَمَّا أَحَدُهُمَا فَكَانَ يَسْعَى بِالنَّمِيمَةِ ، وَأَمَّا أَحَدُهُمَا فَكَانَ لَا يَسْتَتِرُ مِنْ بَوْلِهِ » قَالَ : ثُمَّ أَخَذَ عُودًا رَطْبًا فَكَسَرَهُ بِاِثْنَيْنِ ، ثُمَّ غَرَزَ كُلَّ وَاحِدٍ مِنْهُمَا عَلَى قَبْرِ ، ثُمَّ قَالَ : « لَعَلَّهُ يُخَفَّفُ عَنْهُمَا مَا لَمْ يَبْسَسَا » متفق عليه .

²⁷ El-Ahmad ve El-Methanij vëll.5 fq.464, Esedu El-Gabe vëll.1 fq.1470, Mevsuatu Etraf El-Hadith vëll.1 fq.5104.

²⁸ Hadithin e transmeton Ibni Maxheh, vëll.4, fq.445; Subul Es-Selam, vëll.2, fq.104, Mevsuatu Et-Tahrixh, vëll.1, fq.13033.

Dijetarët islamë kanë argumentuar me hadithin e transmetuar nga Ibni Abbasi i cili ka thënë: *“Kaloj Pejgamberi a.s. pranë dy varreve e tha: Vërtet këta dy janë duke u dënuar por, nuk janë duke u dënuar për ndonjë mëkat të madh”, e pastaj tha : “Po, sa i përket njërit nga ata dy, po dënohet sepse përgojonte, ndërsa tjetri nuk i ka kushtuar kujdes urinimit”, pastaj ka thënë (Ibni Abbasi): “E mori Pejgamberi a.s. një degë të njomë dhe e e theu në dy pjesë, pastaj i mbolli ato te secili varr nga një e pastaj tha: Shpresohet që të ketë lehtësim të dënimit për ata dy derisa të thahen këto dy degë”.*²⁹

Dijetarët islamë e kanë pëlqyer leximin e Kur'anit te varri duke u bazuar në hadithin e më sipërm, sepse nëse ka shpresë për lehtësimin e dënimit për të denuarit përderisa të thahen degët e njoma, është më e logjikshme që leximi i Kur'anit të jetë më meritues dhe më i arsyeshëm për lehtësim dënimi.³⁰

El-Hitabij, duke komentuar këtë hadith, ka thënë: “Ky është argument se pëlqehet të lexohet Kur'an te varri, sepse, nëse shpresojmë se do t'u lehtësohet dënimi atyre dy personave në varre për shkak të tesbihut që bën ajo degë e njomë, atëherë me leximin e Kur'anit shpresojmë edhe më shumë për bereqet dhe mëshirë”.³¹

Kurtubiu, në librin e tij “Et-Tedhkiretu” thotë: “Disa dijetarë kanë argumentuar për leximin e Kur'anit famëlartë te

²⁹ Hadithin e transmetojnë dy kolosët: Buhariu në Kitab El-Xhenaiz, nr. i hadithit 1289, Muslimi në Kitab El-Xhenaiz, nr. i hadithit 2041.

³⁰ Shih edhe Sherhu En-Nevevij ala Sahih Muslim vëll.3 fq.202.

³¹ Umdetu El-Karii Sherh Sahih El-Buhari vëll.4 fq.497.

varri me hadithin në të cilin tregohet se Pejgamberi a.s. ka këputur degën e njomë dhe e ka mbjellë te varri”. Nisur nga këtu, dijetarët kanë thënë: “Nga kjo kuptohet se është i pëlqyer leximi i Kur’anit. Meqë do t’u lehtësohej dënimi atyre në varre për shkak të pemës së njomë e cila bënë tesbihë, atëherë si qëndron çështja me leximin e Kur’anit nga një njeri besimtar mysliman?”, ka thënë: “Për këtë arsye dijetarët e kanë konsideruar të pëlqyeshme vizitën në varre, sepse leximi i Kur’anit lehtëson dënimin e të vdekurit nga vizita që bën njeriu në varre”.³²

Në lidhje me këtë çështje është prononcuar edhe Hafidh Shemsudin ibni Abdulvahid El-Makdesi El-Hanbeli në librin e tij në kapitullin i cili ka të bëjë me këtë çështje, thotë: “Këto hadithe edhe sikur të ishin të dobëta, vetë numri i madh i transmetimeve që i argumenton, kësaj çështjeje do t’i vihet bazë në fenë islame. Në anën tjetër myslimanët vazhdojnë të jenë unikë në lidhje me këtë çështje në çdo kohë e në çdo vend, duke lexuar Kur’an për të vdekurit e tyre pa asnjë hamendje. Do theksuar se në mesin e dijetarëve për këtë çështje ka qëndrim me konsensus - Ixhma.

El-Kurtubi, në veprën e tij “*Ettehdhkiretu*” thotë: “Leximi (i Kur’anit) mund të jetë bërë për të ndjerin me rastin e vdekjes së tij, por ka gjasa që ai të jetë bërë te varri i tij.”

Ndërsa, Hafiz Es-Sujtiu në veprën e tij “Sherrhu Es-Sudur” thotë: “Mendimi i parë u përkrah nga publiku siç është paraqitur në librin e parë. I dyti, është mendimi i Ibni Abdi

³² Et-Tedhkiretu Lil Kurtubij vëll.1 fq.84, Et-Tedhkireti fi Ahval El-Mevta ve Umur El-Ahiretu vëll.1 fq.92.

El-Vahidit El-Makdisi që e përmendi në pjesën që ai i referoj. Mendohet se, në mënyrë të përgjithësuar në të dyja rastet, është mendim i Taberit dhe përkrasësve të tij të mësonshëm.”

5. وقد صلى النبي صلى الله عليه وسلم صلاة الجنازة

Pejgamberi a.s. ka falur namazin e xhenazes në varre

Transmetohet në dy librat e hadithit Sahih (Buhari dhe Muslim) se Pejgamberi a.s. në shumë raste ka falur namazin e xhenazes në varre. Vetë namazi përmban edhe leximin e sures Fatiha dhe salavat mbi Pejgamberin a.s., dhikër e dua. Atëherë, nëse lejohet që ndonjë pjesë e Kur'anit të lexohet te varri, logjikisht duhet të jetë i lejuar edhe i tëri. Dijetarët islamë konsiderojnë se sevapet i arrijnë të vdekurit duke u bazuar në lejimin e të bërit haxh për tjetrin dhe arritja e sevapeve të haxhit për të vdekurin, haxhi përmban në vete edhe namaze dhe në namaz lexohet surja Fatiha dhe sure të tjera, ky është kuptimi përfundimtar, edhe nëse disa ngrenë dyshime mbi këtë, ai dyshim është i pavlerë sepse asnjë nga dijetarët islamë nuk është kundër asaj se nëse një njeri bën dua dhe lexon Kur'an për të vdekurin dhe atë lexim dhe atë dua ia dedikon të vdekurit sevapet do t'i arrijnë të vdekurit me lejen e All-llahut xh.sh..³³

³³ Fetava El-Bejt El-Muslim fq.182.

6-Traditë e përcjellë brez pas brezi

جری عمل المسلمین جیلاً بعد جیل وخلفاً عن سلف

Kështu kanë vepruar myslimanët, kanë lexuar Kur'an te varri, brez pas brezi, pa e kundërshtuar këtë veprim askush. Ky mendim është i pranuar te të gjitha medhhebet, madje El-Hafidh Shemsudin bin Abdulvahid El-Makdesij El-Hanbelij ka thënë se për këtë çështje ka edhe konsensus të dijetarëve islamë (Ixhma). Transmeton Esh-Shejh El-Othmanij në librin e tij *“Rahmetu El-Umeti Fi Ihtilaf El-Eimeti”* në të cilin thotë: *“Dijetarët janë të pajtimit me konsensus se kërkimfalja, duaja, lëmosha, haxhi, lirimi i robit, u sjellin dobi të vdekurve, dhe sevapet arrijnë te i vdekuri, leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer”*.³⁴

Traditë e përcjellë edhe nga gjenerata e ndritshme

ومن الآثار في ذلك عن السلف الصالح

Ka argumente të shumta nga tradita dhe lajmet e të dhënat nga Selefi- es-Salihin (Gjenerata e ndritshme) për pëlqimin e leximit të Kur'anit te varri, transmeton Ibni Ebi Shejbe nga Imam Shafiu të ketë thënë: *“Ensarët (medinasit) lexonin Suren Bekare për të vdekurin”*, sikundër transmeton El-Halali në librin e tij *“El-Kiraetu Ala El-Kubur”* në të cilin thotë: *“Kur u ka vdekur dikush Ensarëve (medinasve), ata janë shpërndarë te varri i tij dhe kanë lexuar Kur'an”*.³⁵

³⁴ Po aty, Rahmetu El-Umeti fi Ihtilaf El-Eimeti.

³⁵ El-Vasitij fi Tarih Vasit vëll.1 fq.190.

Transmeton El-Halali nga Ibrahim En-Neh'ij i cili ka thënë: *“Nuk ka asnjë problem nëse lexohet Kur'an në varre”*, po ashtu transmetohet nga El-Hasen bin Es-Sabah Ez-Zaferanij i cili thotë: *“E kam pyetur Imam Shafiun r.a. për leximin e Kur'anit në varre, ai ka thënë se:”Nuk ka të keqe në këtë”*.³⁶

Transmetohet nga Alij bin Musa El-Hadad, i cili thotë: *“Kam qenë me imam Ahmed bin Hanbelin r.a. dhe me Kudame El-Xhevherij në një varrim të një xhenazeje, kur e kemi varrosur të vdekurin, një njeri i verbër është ulur pranë varrit dhe ka lexuar Kur'an., Imam Ahmed i r.a. atij i ka thënë: Or ti, leximi i Kur'anit te varri është “bid'atun”. Kur dolëm nga varret, Muhamed bin Kudame i ka thënë Imam Ahmed ibni Hanbelit: “Çka thua për Mubeshir El-Halebij (çfarë njeriu ishte)?”, ai tha: “ishte njeri i drejtë, i vendosur dhe pa gabime në hadith”, Imam Ahmed i tha: “a mos ke shkruar diçka për këtë person?”, ai tha: “po, me ka treguar Mubeshir nga Abdurrahman bin El-Alae bin El-Lexhaxh nga babai i tij se ai e ka porositur të birin e tij që kur të varroset të lexohet te koka e tij surja Fatiha dhe fundi i sures Bekare (dy ajetet e fundit të sures Bekare), kam dëgjuar nga Ibni Umeri r.a. që ka porositur kështu”, atëherë Imam Ahmed i tha: *“kthehu dhe thuaj atij njeriu që të lexojë Kur'an te varri”*”.*³⁷

³⁶ El-Emru Bil Marufi ve En-Nehju An El-Munkeri Li Ebi Bekër vëll.1 fq.294.

³⁷ El-Mugni ibni Kudame vëll. 2 fq. 224.

Me këtë hadith ka argumentuar Jahja bin Muin kur është pyetur nga El-Abas bin Muhamed Ed-Durij për leximin e Kur'anit te varri.

7-Qëndrimi i prijësve të medhhebeve

قد نص أصحاب المذاهب المتبوعة على ذلك

Leximi i Kur'anit te varri sipas Imamëve të medhhebeve.

Medhhebit Hanefi

Në “El-Fetava El-Hindije”: thuhet: “Është e pëlqyer që kur të varroset i vdekuri, të ulen njerëzit te varri për një kohë sa mund të therret një kafshë dhe të shpërndahet mishi i saj, e të lexojnë Kur'an dhe të bëjnë dua për të vdekurin”, transmetohet se këto fjalë janë të Muhamed bin El-Hasanit r.a., këtë mendim e kanë pranuar të gjithë dijetaret e medhhebit Hanefi.³⁸

Medhhebit Maliki - Sipas dijetarëve të medhhebit maliki, leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer, në librin Hashije Ed-Desuki në “Esh-Sherh El-Kebir” thuhet: “Ibni Habibi është i mendimit se leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer, po ashtu El-Lahmiju është i të njëjtit mendim, madje në disa vende Ibni Habibi thotë se është i pëlqyer leximi i sures Ja-Sin të varri”.³⁹

³⁸ El-Fetava El-Hindije vëll.1, fq.177, El-Xhevheretu En-Nejiretu vëll.1, fq.429.

³⁹ Hashijetu Ed-Desuki vëll.1 fq.423, Hashijetu Ed-Desuki ala Esh-Sherh El-Kebir vëll.4 fq.173.

I vdekuri përfiton nga leximi i Kur'anit pa marrë parasysh a lexohet Kur'ani te varri apo lexohet në shtëpi. Ndërsa Muhamed bin Ahmed El-Merurizij thotë: “Kam dëgjuar Ahmed bin Hanbelin të këtë thënë: Kur të hyni në varre këndojeni Fatihan, Meudhetejini (Kul Eudhu Birabi El-Felek dhe Kul Eudhu Birabi En-Nas) dhe Kul HuvAll-llahu Ehad dhe këtë lexim dërgojeni për ata që janë në varre sepse atyre u arrijnë sevapet”.⁴⁰

Medhhebit Shafi-ij -Sipas dijetarëve të medhhebit shafi është e pëlqyer përshëndetja me selam për të vdekurit në varre nga ai i cili i viziton ato, dhe në të bëjë dua për të vdekurit në varre. Po ashtu, është e pëlqyer të lexohet nga Kur'ani aq sa di përmendsh personi. Me këtë mendim janë të pajtuar me konsensus dijetarët e medhhebit Shafi-ij.⁴¹

Është e pëlqyer që të ulet afër varrit një kohë, afërsisht një orë e të lexohet Kur'an, të bëhet dua, të mbahet ligjëratë, dhe të tregohen tregime të njerëzve të devotshëm, Imam Shafi'u r.a. thotë: “Është e pëlqyer që të këndohet Kur'an te varri, kanë thënë edhe nëse këndohet tërë Kur'ani do të ishte më mirë”.⁴² Është e pëlqyer që të këndohet Kur'an te varri, e nëse këndohet i gjithë Kur'ani do të ishte më mirë.⁴³

- Transmeton El-Hafidh Edh-Dhehebij se kur ka vdekur Ebi Xhafer El-Hashimi El-Hanbeli i cili ishte njëri nga dijetarët autoritativë të Hanbelive, është varrosur afër varrit të

⁴⁰ Et-Tedhkiretu fi Ahvali El-Mevta ve Umur El-Ahiretu vëll.1 fq.274.

⁴¹ El-Mexhmuatu Sherh El-Muhdhib vëll.5 fq.311.

⁴² El-Edhkaru vëll.1 fq.162.

⁴³ Fetava El-Ez-her vëll.7 fq.458.

Imam Ahmed Hanbelit r.a., xhemati kanë qëndruar te varri i tij një kohë të gjatë, madje, thuhet se te varri i tij është bërë hatme Kur'ani famëlartë 10 mijë herë.⁴⁴

Sevapet e leximit të Kur'anit do të jenë për lexuesin, ndërsa sevapet për dëgjimin e leximit do të jenë për të vdekurin në varr, i vdekuri do të mëshirohet në varr duke u bazuar në ajetin kur'anor i cili është gjithëpërfshirës dhe jo specifik, All-llahu xh.sh. thotë:

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ.

“Kur lexohet Kur'ani, ju dëgjojeni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë”⁴⁵.

Nuk është e pa logjikshme dhe nuk është jo e arsyeshme që ta kaplojë mëshira dhe t'i arrijnë sevapet të vdekurit nga leximi i Kur'anit edhe nëse nuk e ka dëgjuar, sevapet për lëmoshën i arrijnë të vdekurit, ai nuk e përjeton lëmoshën, pastaj lutja dhe kërkimfalja i sjellin dobi, sepse Kur'ani është lutje dhe kërkimfalje, është një vepër e cila të afron te All-llahu xh.sh..

Pejgamberi a.s. thotë: *“Kur të vdesë njeriu këputet (ndërprietet) puna e tij përveç nga tri gjëra: Lëmosha, dituria që ka lënë dhe nga e cila kanë dobi të tjerët, ose fëmijët e devotshëm të cilët luten për të”,* Kur'ani është edhe lutje dhe është lëmosh nga fëmijët e devotshëm, nga shokët e devotshëm dhe nga besimtarët e singertë, të cilët ia dërgojnë sevapet e

shih edhe: Dhejl Tabakat El-Hanabile vëll.1 fq.17,22,23, El-Bidajetu ve En-Nihajetu vëll.12 fq.129.

⁴⁵ Kur'ani, sureja El- A'raf, 204

leximit të Kur'anit të vdekurit në varr.⁴⁶ Dhe All-llahu e di më së miri.

Këtu përfundon përshtatje fetvasë së El-Ez'herit.

Të shtojmë se leximi i Kur'anit është një adhurim me vlerë, shumë i rëndësishëm dhe më shumë sevape ashtu siç e ka përshkruar vetë Pejgamberi a.s., që për një shkronjë të lexuar të fitohen dhjetë sevape-shpërblime. Tani çështja shtrohet se nëse dikush do të dëshironte t'ia dhuronte sevapet e leximit të Kur'anit dikujt nga të afërmit e vdekur, të cilët, gjithsesi se kanë nevojë për shpërblime, pasi veprat e tyre kanë përfunduar me vdekjen e tyre.

Nisur nga këtu, fukahatë (juristët islamë) kanë dy mendime rreth kësaj çështjeje:

1. Mendimi i pare është se: Shpërblimi i leximit të Kur'anit u arrin të vdekurve e ky është mendim i shumicës dërrmuese të dijetarëve myslimanë, një numër i konsiderueshëm nga ata janë përmendur më lart në Fetvanë e Ez'harit, por ka edhe të tjerë- klasikë dhe bashkëkohorë që e përkrahin dhe përvetësojnë këtë mendim.

Të shtojmë se edhe **tradita-zakonore** është e përligjshme dhe e pranuar në shariatin Islam.

⁴⁶ “Et-Tedhkireti fi Ahval El-Mevta ve Umur El-Ahiretu” vëll.1, fq.288.

Tradita-zakonore - العرف

Leximi i Kur'anit dhe dhurimi i leximit të tij të vdekurve është një praktikë shekullore e njohur në të gjitha kohët dhe këtë gjë e kanë bërë myslimanët gjithmonë edhe në trevat tona. Refuzimi i kësaj tradite është mohim i një realitetit të pranuar në praktikë të shumica e myslimanëve. Tradita zakonore në këtë rast është veprim i cili nuk bie ndesh me buri-met parësore të islamit (Sheriatit) e të cilin njerëzit e kanë pranuar si të vetin dhe i njëjti ka zënë vend të thellë në shpirt-trat e besimtarëve. Ibni Kudame thotë: "...ka konsensus (ixhma) te myslimanët në këtë praktikë. Ata në çdo kohë dhe vend mblidhen, këndojnë Kur'an dhe ua dhurojnë të vdekur-ve të tyre pa i qortuar askush." ⁴⁷

Mendimi i dytë se: Shpërblimi i leximit të Kur'anit nuk u arrin të vdekurve.

Këtë qëndrim e mbështetin: Mufesiri i njohur Ibni Kethiri,⁴⁸ El Iz Bin Abduselami⁴⁹, Shevkani⁵⁰, Muhamed Reshid Rida⁵¹, Abdulaziz bin Bazi⁵², Muhamed Nasirudin Albani,⁵³ po edhe të gjithë dijetarët e Komisionit të Përhershëm për

⁴⁷ Mugni", Ibni Kudame, vëll. III, f. 522

⁴⁸ "Tefsiri i Ibën Kethirit", vëll.VII, f. 46

⁴⁹ "Fetava Iz Bin Abduselami", f. 43.

⁵⁰ Shevkani në tefsirin e tij vërehet se anon nga ky qëndrim, "Fet'hul kadir", vëll. V, f. 114.

⁵¹ "Tefsiru menari" vëll.VIII, f. 256.

⁵² "Fetava bin Bazi", vëll.XIII, f. 260

⁵³ "Ahkamul xhenaizi", f. 221.

Studime dhe Fetva “Lexhne daime”⁵⁴, si dhe një numër i konsiderueshëm i dijetarëve bashkëkohorë, të njohur si “Selefij” pasues tradicionalistë.

Sipas këtyre dijetarëve, bamirësia ndaj të vdekurit duhet të jetë përmes duave (lutjeve) dhe sadakasë për të, pavarësisht se a bën për të haxhin apo umren, apo ia shlyen ndonjë borxh. Kjo është ajo që i bën dobi të vdekurit, thonë ata, dhe vetëm për këto veprime janë transmetuar hadithet e sakta (autentike): sadakaja për të, lutja drejtuar All-llahut për falje dhe mëshirë ndaj tij, shlyerja e borxhit të tij, si dhe kryerja e haxhit dhe umres për të. Kurse, sipas tyre, që të lexohet Kur’an për të, apo të lexohet surja Jasin apo Tebareke (për të vdekurin), në çdo vend apo te varret, kjo sipas tyre nuk ka bazë dhe nuk duhet të veprohet (sepse nuk është e ligjësuar). Ajo që ligjësohet është leximi i sures Jasin për atë që është në shtratin e vdekjes, domethënë para se të vdesë, që ai të përfitojë, të këshillohet dhe kujtohet prej këtij leximi. Pra, Kur’ani i lexohet njeriut para se të vdesë. Kjo i bën dobi atij. Kurse pasi që të vdesë përfundon çdo gjë dhe krejt këto gjëra të më vonshme, dhurimi i shpërblimit të leximit të Kur’anit për të vdekurit janë risi “bidatun” të cilat i kanë shpikur njerëzit.

Nëse gjykohet me këtë logjikë që të refuzohet çdo ribërje “bidatun” inovacion, që nuk është aplikua në kohën e Pejgamberit a.s., atëherë praktikantët radikalë (dogmatikët), nuk

⁵⁴ Komisioni i Përhershëm për Studime dhe Fetva është organi më i lartë shkencor pranë Ministrisë së Fesë në Arabinë Saudite. “Fetava lexhne daime”, vëll. IX, f. 34

do të duheshin të praktikojnë në jetën e tyre asgjë që nuk është e që e ka praktikuar Pejgamberi a.s. dhe selefët e parë. Nuk do të duhej të ushqeheshin me atë që nuk ka pasur rast ta shijonte Pejgamberi a.s.. Nuk do të duhej të veshëmbathe-shin me atë veshje moderne që nuk e ka praktikuar Pejgamberi a.s.. Nuk do të duhej të faleshin në xhamitë bashkëkohore me kupola dhe arkitekturë supermoderne, dhe shtrojë të shkëlqyeshme, me elektronikë të efektshme, karshi xhamisë së ndërtuar nga vetë Pejgamberi me sehabët e tij, që materiali ndërtimor ishin lloçi dhe qerpiçët prej lloçi, ndërsa kulmbulesa ishte me dru dhe gjethe të palmave.

Për fund ta themi edhe këtë se përfitimet nga njohja e shkakut apo arsyes për thënien e ndonjë hadithi janë të dobishme edhe për shkencëtarin e angazhuar në fushën e fikhut dhe të jurisprudencës islame. Njohja e shkakut të thënies së hadithit përcaktohet edhe nga rrethanat për të cilat përmendet hadithi dhe rrethanat mbi të cilat vëzhgohet hadithi. Kjo fushë e dijes është e dobishme edhe për çështjen e *ixhtihadit* (angazhimi i pavarur i bazuar në burimet bazore të Islamit-Kur'an dhe Sunnet), në shkarkimin dhe marrjen e vendimeve mbi faktet dhe citimet.

Kjo që themi vërtetohet nga praktika dhe interpretime të shumta dhe, një nga ata është prononcimi i Muadh ibni Xhebelit me rastin e dërgimit të tij në Jemen në cilësinë e të deleguarit të të Dërguarit a.s. dhe kur iu tha se: *“Me çfarë do të gjykosësh o Muadh?”* Përgjigjja e tij ishte: Me Librin e Allahut. *“E nëse nuk do ta gjesh në librin e Allahut?”* Tha: *“Me Sunetin e të Dërguarit të Tij”*. - *“E nëse nuk do ta gjesh në Sunetin e tij?”* Tha: *“Do të përpiqem të gjykoj me mendimin*

tim dhe për këtë nuk do të hezitoj". Pejgameri a.s. tha: "*Falënderimi i takon Allahut, i Cili i jep sukses lajmëtarit të të Dërguarit të Tij për atë që dëshiron i Dërguari.*"⁵⁵

Nisur nga këtu, myslimanët doemos duhet të ecin me kohën në shtruarjen, nxjerrjen e ligjeve dhe aplikimin e traditës Islame, madje, duhet përvetësuar edhe ndonjë risi e dobishme "bid'atun hasene", që shpie në arritjen e qëllimit të dispozitës së shtruar nga Ligjdhënësi, por pa rënë ndesh me burimet themelore të islamit.

⁵⁵ Muhamed Nasirudin El Albani, "*Pozita e Sunnetit në Islam*", f. 25-26, Tiranë 2012.

Miftar AJDINI

DISA THEKSIME TË DREJTËSISË ISLAME - trajtim gjuhësor dhe sociologjik -

Allahu i Plotfuqishëm, në Kuranin famëmadh, ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا
يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَا نُ قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ
وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٨﴾

“O ju të cilët keni besuar! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë. Dhe frikësohuni Allahut se Allahu di hollësisht për atë që veproni.”¹

¹ Kuran, surja el-Maide, 8.

Në gjuhën arabe, drejtësia nënkuptohet me fjalën ***el-adl***, e cila ka një gamë të gjerë kuptimesh. Disa nga kuptimet e saj janë: drejtësi, paanësi, gjykim pa pasione, ndershmëri, drejtpeshim, barazi,² mbrojtje e të drejtave të të tjerëve, largim nga ajo që nuk është në përputhje me natyrën e njeriut, do të thotë, të qenët i balancuar, të mos jesh i ndikuar nga pasioni, të heqësh dorë përkohësisht nga një pjesë e sovranitetit për të mirën e përgjithshme etj.

Nga fjala ***el-adl***, rrjedh edhe njëri nga emrat e bukur të Allahut ***El-Adil (الْعَادِلُ) - I Drejti***.

Allahu i Plotfuqishëm ka urdhëruar drejtësinë në të gjitha gjërat, segmentet dhe situatat e jetës njerëzore. Pavarësisht, nëse njeriu është i kënaqur apo jo, nëse është i zemëruar apo jo, a bëhet fjalë për dikë që është i afërm i tij apo jo, njeriu duhet ta shfaqë dhe ta zbatojë drejtësinë.

Allahu i Plotfuqishëm në suren en-Nisa urdhëron e thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰ
 أَنْفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدِينَ وَالْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَاللَّهُ
 أَوْلَىٰ بِهِمَا ۖ فَلَا تَتَّبِعُوا الْهَوَىَٰ أَنْ تَعْدِلُوا ۚ وَإِنْ تَلَوُّوا أَوْ تَعْرِضُوا
 فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١٣٥﴾

“O ju të cilët keni besuar, jini përherë të drejtë, dëshmoni për Allahun, edhe nëse është kundër jush, ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për

² Sulejman Tomçini, Fjalor arabisht - shqip, fq. 577.

ata më parësori. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! E, nëse ju e shtrembëroni dëshminë ose tërhiqeni (prej saj), Allahu vërtet është i njoftuar se çka punoni.”³

Përdorimi i thirrorit në gjuhën arabe nënkupton njërën nga dy gjëra ose të dyja në të njëjtën kohë. Këto dy gjëra janë: ***dashuria (el-hubb) dhe tërheqja e vëmendjes së dikujt në diçka (iltifatun-nedhar).***

Allahu i Plotfuqishëm, si Krijuesi i njeriut, e do shumë atë dhe nuk e ka lënë që të endet e ta kërkojë të vërtetën, por i ka dërguar peygamberë me udhëzime, të cilat, nëse i ndjekë do të jetë i lumtur edhe në këtë botë kalimtare (në dynja), edhe në botën tjetër të përjetshme (në Ahiret). Meqenëse Allahu e do robin e Tij, Ai dëshiron t’ia tërheqë vëmendjen për diçka që do ta bëjë atë të lumtur. Në këtë ajet, mendohet për të dyja, dmth. Allahu e do robin e Tij, andaj dëshiron t’i ndihmojë për ta gjetur rrugën e drejtë, duke ia treguar gjërat të cilat do t’i ndihmojnë atij, jo vetëm për të arritur grada më të larta si besimtar, por edhe në kërkimin e së Vërtetës.

Folja **‘amenu’** në ajetin e mësipërm, është në vetën e tretë shumë, folje e llojit të tretë. Rrënja e fjalës është **‘el-enn’**, që do të thotë: sigurim, qetësi, siguri, mbrojtje, protektorat, besnikëri, besueshmëri. Pra, ata që ***kanë besuar - ‘amenu’***, janë të mbrojtur, të sigurtë dhe kanë Mbrojtësin, i Cili nuk do t’i lërë vetëm. Pra, formulimi kuranor: **‘Ja ejjuhel-ledhine amenu’** - në një përkthim të lirë do të thotë: **“O ju, të cilët i**

³ Kuran, surja en-Nisa, 135.

do Allahu! O ju, të cilëve Allahu dëshiron t'ju tregojë diçka që është e mirë për ju! Ai është i Cili ju mbron dhe ju jep siguri."

1. Jini përherë të drejtë, edhe nëse është kundër jush

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) para se të kalonte në botë e amshuar ka thënë:

"Shokë të mi! Më në fund edhe unë njeri jam. Ndosh-ta më ka shpëtuar nga vëmendja haku i ndonjërit prej jush.

Kë të kem prekur në trup, të vijë ta kërkojë hakun e vet e të më prekë edhe ai!

Kë të kem qëlluar në shpinë, të vijë edhe ai të më qëllojë e ta marrë hakun e vet!

Nga malli i të cilit kam marrë gabimisht, ja ku është malli im, le të vijë ta marrë!

Allahu im! Unë jam njeri! Cilit nga myslimanët që t'i kem thënë një fjalë të rëndë ose ta kem mallkuar, ktheje atë në të mirë për të, në mëshirë dhe shpërblim për të!

Allahu im! Po që se për një besimtar kam thënë një fjalë të rëndë, bëje atë fjalë në ditën e kiametit pretext për afrim të atij robi me Ty!"⁴

I udhëzuar me Shpallje, Pejgamberi (s.a.v.s.) e dinte se stabiliteti i bashkësisë njerëzore mbështetet në drejtësi. Pa drejtësi nuk ka as lumturi, as përparim dhe as prosperitet.

⁴ Osman Nuri Topbash, Vargu i profeteve nën dritën e Kuranit 4, fq. 289.

Prandaj, duke ndjekur urdhrin e Allahut të Plotfuqishëm në Medinë mbretëroi një drejtësi e përsosur. Pejgamberi (s.a.v.s.) me veprimet e tij dëshmoi dhe tregoi drejtësi në çdo aspekt. Ai, gjithashtu, këtë ua mësoi edhe sahabëve të tij, të cilët falë veprimeve të drejta ndaj banorëve të zonave të çliuara kontribuan në përhapjen e shpejtë të Islamit.

Drejtësia më e madhe në historinë e njerëzimit

Në vazhdim po paraqesim tregimin, i cili e mahniti botën me ngjarjen të cilën e përjetoi qyteti Samarkand. Samarkandi është qytet në Uzbekistan, numëron afër 400 mijë banorë. Banorët e atij vendi janë taxhikistanasit, flasin gjuhën taxhike. Në këtë qytet Islami ka arritur në vitin 87 h. (705 m.) Ky qytet u çlirua nga dora e komandantit të njohur Kutejbe bin Muslimi.

Pasi u çlirua ky vend dhe hyri ushtria myslimane në Samarkand, një ditë një djalë bërtiti: O Kutejbe! Ne me ty kemi një çështje në gjyq.

U mbledhën priftërinjtë e atij vendi, komandanti i myslimanëve dhe kadiu (gjykatësi) mysliman. Duhej të sqarohet një çështje, ajo ishte se - Kutejbe kishte hyrë në këtë vend pa i thirrur fare në Islam. Është dashur së pari ai t'i thirrë në Islam banorët e Samarkandit, e nëse nuk e pranojnë, t'u vihet atyre xhizje - tatim.

Ky djaloshi i tha kadiut: Kutejbe ka hy në vendin tonë pa na thirrur neve së pari në Islam.

Kadiu i çuditur, tha: O Kutejbe a është e vërtetë kjo çka po thotë ky djalë? Aty pranë ishin shumë priftërinj të mëdhenj që vetëm dëgjonin se çfarë do të ndodhë.

Kutejbe tha: E vërtetë, o kadi, nuk i kam ftuar së pari në Islam, por ti e di se lejohet mashtrimi në luftë.

Kadiu i tha: Ti ke bërë aq gabim të madh, sa që tash detyrohesh ti me gjithë ushtrinë tënde ta lëshoni Samarkandin, sepse i ke hyrë në hak këtij vendi.

Kadiu mysliman i tha: Të urdhëroj ta tubosh ushtrinë, ku e ke e ku se ke, të dilni menjëherë prej këtu, e bashkë me ju do të dal edhe unë. Priftërinjtë u çuditën nga ajo çfarë u dëgjonin veshët e tyre, kjo me siguri do të ishte drejtësia më e madhe në historinë e njerëzimit.

E në mbrëmjen e asaj nate u dëgjuan vrapimet e kuajve dhe ecja e ushtrisë së madhe e cila e lëshonte Samarkandin. Ajo dilte prej këtij vendi, por mbrapa i la banorët e saj duke qarë e duke vajtuar se asnjëherë nuk kishin parë e as dëgjuar për një drejtësi të tillë.

U mbledhën të gjithë priftërinjtë dhe krerët e popullit të Samarkandit e shkuan në shatorët e ushtrisë myslimane që gjendeshin jo fort larg nga qyteti, dhe të gjithë dëshmuan La ilahe il-lallah Muhamedun resullullah.

Kjo ishte dhe është historia më e drejtë që njeh njerëzimi, fillimi është Islam por edhe fundi është Islam.⁵

⁵ <https://mjeksiaislame.com/drejtësia-e-madhe-ne-historine-e-njerezimit/>

Ky është një nga shembujt e panumërt se si shokët e të Dërguarit të Allahut, ishin sjellë me popullsinë vendase.

2. (Qoftë edhe) kundër prindërve dhe të afërmve tuaj

Në kohën e Pejgamberit (s.a.v.s.) ndodhi që një grua nga fisi Mahzum vodhi. Ndaj saj duhet të ekzekutohej masa ndëshkimore e përcaktuar për vjedhje. Njerëzit po flisnin rreth kësaj, mirëpo, askush prej tyre nuk guxonte të ndërmjetëson-te te Pejgamberi (s.a.v.s.), derisa Usame ibn Zejd e ndërmori këtë hap. Nga ky ndërmjetësim, Pejgamberi (s.a.v.s.) u zemërua shumë duke thënë: *“Te Benu Israilët ka qenë zakoni, që kur vidhte dikush me prejardhje të fışshme, ata e falnin atë, ndërsa, po të vidhte një i dobët e i mjerë, ata ia prisnin dorën. Nëse Fatimja (bija e Muhamedit) do të vidhte, Muhamdi do t’ia këpuste dorën.”*⁶

Te Benu Israilët, te arabët, dhe në të gjitha civilizimet përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, ligji zbatohet vetëm ndaj njeriut të dobët, të varfër e të pafuqishëm. Kurse ndaj të fortit, të pasurit dhe njeriut me pushtet ligji nuk funksionon, sepse shkopi është në dorën e Maliqit! Ndërkaq, në civilizimin islam, çdokush e merr atë që meriton. Pejgamberi (savs) kurrsesi nuk mund ta toleronte një padrejtësi të tillë. Nuk është ky kandari me të cilin njerëzit duhet të maten. Ligji është i barabartë për të gjithë, për të pasurin dhe të varfrin, për të fortin dhe të dobëtin. Si për ta përforcuar këtë princip

⁶ Buhariu (3733) dhe Muslimi (1690).

hyjnor, Pejgamberi (savs) thotë se edhe nëse Fatimja (bija e tij) do ta shkelë ligjin, ajo do të vendoset përpara drejtësisë për ta marrë atë që meriton. E ku ka drejtësi më të madhe se kjo?!

Duhet të jemi të drejtë edhe ndaj babait tonë, nënës, vëllait, motrës dhe ndaj çdo njeriu. E ka besimin e dobët një njeri, i cili vetëm për arsye familjare nuk është i drejtë. Në Islam nuk ka njerëz që janë mbi ligjin. Njeriu ndonjëherë e ka edhe më vështirë të jetë i drejtë ndaj ndonjë të afërmi, sesa ndaj vetvetes. Veçanërisht kur është fjala për fëmijët, çdo prind është pak a shumë i ndjeshëm dhe shpesh i padrejtë. Ben dallim në mes të fëmijëve, u jep përparësi fëmijëve meshkuj ndaj fëmijëve femra ose anasjelltas. Shpesh, me rastin e ndarjes së pronës, fëmijët femra lihen pas dore, edhe pse me sheriat u takon pjesa e tyre e pasurisë siç u takon edhe fëmijëve meshkuj. Thotë Allahu i Plotfuqishëm: ***“Allahu ju urdhëron juve në çështjen e trashëgimit për fëmijët tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave.”***⁷

Burri është i detyruar ta mbajë familjen e tij, ndërsa femra pas martesës ka të drejtë ta përdorë pasurinë e saj, të cilën ia kanë lënë prindërit e saj, si të dojë dhe nuk është e detyruar nëse nuk dëshiron, që të merr pjesë në mirëmbajtjen e familjes së saj. Kjo është e drejtë e saj dhe ajo mund ta shpenzojë atë pasuri ashtu siç dëshiron. Prandaj, janë të pajustificueshme kritikrat, nga ata që thonë se Islami u jep më shumë të drejta fëmijëve meshkuj sesa fëmijëve femra. Pasardhësit

⁷ Kuran, surja en-Nisa, 11.

mashkull i ka dhënë më shumë, sepse ai duhet ta mbajë familjen, ndërsa pasardhësja femër nuk është e detyruar ta bëjë këtë.

Gjithashtu, një formë e drejtësisë ndaj fëmijës është t'ia mësojmë fenë islame. Që ta mësojmë se si të jetë i nënshtuar ndaj Zotit të tij. Çdo fëmijë herëdo- kurdo do ta lërë prindin e tij, do të pavarësohet dhe do ta formojë familjen e vet. Që të mund të niset në këtë rrugë i vetëm, duhet t'ia vendosim një busull në duart e tij. Kjo busull është namazi, i cili e mbron, që mos të devijojë as majtas as djathtas, por të shkojë vetëm rrugës së vërtetuar, të drejtë, e cila me siguri do ta çojë në qëllimin e dëshiruar. Prindi duhet ta shikojë fëmijën e tij sikur lulen. Lulja është e bukur derisa të bie në baltë. Ndërsa kur bie dhe kur përlyhet, atëherë askush nuk e ngre dhe nuk i merr erë. Atëherë, edhe prindi, nëse dëshiron ta lajë lulen, ta lajë fëmijën e tij, duhet t'i përlyejë duart e veta. Prandaj, është shumë e rëndësishme që t'i "armatosim" fëmijët tanë me namaz, në mënyrë që të ecin sa më lehtë rrugëve të kësaj bote, dhe me atë rast ta fitojnë edhe kënaqësinë e Allahut të Plotfuqishëm.

3. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni)

Dikush do të thotë se kjo është utopi. Pothuajse nuk ka asnjë vend në botë, në të cilin ata që janë të pasur apo në pushtet, të mos jenë shpesh mbi ligjin. Mirëpo, shteti që është i bazuar në parimet e imanit nuk bën dallim midis të pasurve dhe të varfërve. Nuk ka frikë nga forca dhe ndikimi i të pasurve, as nuk ndjen mëshirë dhe dhembshuri për keqbërësin. Allahu i Plotfuqishëm na e kujton ngjarjen kur dy palë erdhën për tu gjykuar te Davudi (a.s.). Kështu Davudi (a.s.), dyshimin e hodhi te ai që kishte 99 dele, përkatësisht, se ai e kishte marrë padrejtësisht nga vëllai i tij një dele. Ai as nuk e kishte dëgjuar mbrojtjen e tij. Prandaj, në Islam nuk ka gjykim vetëm në bazë të dëshmisë së njërës palë, qoftë paditës apo i paditur. Davudi (a.s.) veprooi kështu nga dhembshuria për të varfrin, i cili e kishte vetëm një dele për çka u qortua nga Allahu i Plotfuqishëm, me fjalët:

يَا دَاوُودُ إِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ فَاحْكُم بَيْنَ النَّاسِ
بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوَىٰ فَيُضِلَّكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ إِنَّ الَّذِينَ
يَظْلُمُونَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ بِمَا نَسُوا يَوْمَ
الْحِسَابِ ﴿٢٦﴾

“O Davud, Ne të kemi bërë sundimtar në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me të drejtë dhe, mos shko pas pasionit tënd, se ai (pasioni) të largon nga

rruga e Allahut!⁸ Davudi (a.s.), në atë moment u pendua dhe e luti Allahun e Plotfuqishëm për falje.

Historia e Islamit na tregon se edhe sahabët më të shquar të Pejgamberit (savs) kanë dalë para gjykatësit, madje edhe si halifë. Kështu, transmetohet se Ymeri (r.a.), kishte shkuar në treg dhe e kishte parë një kalë që i kishte pëlqyer. E kishte pyetur pronarin për ta provuar kalin dhe, pasi e kishte lejuar pronari, ky kishte shkuar me të në shkretëtirë. Kur ishte kthyer, ia kishte dorëzuar kalin pronarit, duke i thënë se kali po çalonte. Pronari i kalit i thotë se ia kishte dhënë kalin të shëndoshë dhe kishte kërkuar nga Ymeri (r.a.) ose t’ia paguajë kalin ose t’ia kthejë siç kishte qenë! Pasiqë nuk kishin arritur të merren vesh, e kishin thirr gjykatësin Shurejh (r.a.) për ta gjykuar rastin. Pasiqë i kishte dëgjuar të dy, Shurejhu (r.a.) kishte gjykuar në dëm të halifit! Ymeri (r.a.) ia kishte paguar kalin pronarit, kurse gjykatësin që kishte qenë i paanshëm në gjykim, e kishte shpërblyer duke e emëruar Kadi të Kufes.⁹

4. Allahu është më Parësori

Çdo njeri që mendon për madhështinë e Allahut të Plotfuqishëm, kudo që të jetë, që beson se Allahu i Plotfuqishëm e sheh çdo vepër të tij dhe di gjithçka që bën dhe që mendon e koncepton, ai do t’i kryejë urdhrat e Allahut të Plotfuqishëm. Allahu i Plotfuqishëm e ka urdhëruar atë për të mirën

⁸ Kuran, surja Sad, 26.

⁹ قصة مواقف من حياة القاضي شريح - (<https://www.qssas.com/story/9542>)

tonë. **“O besimtarë! Ruane veten tuaj...”**¹⁰ (Që t’ia siguronit të ardhmen shpirtit tuaj, i cili nesër do të del nga trupi). Ne do të kujdesemi për veten nëse iu bindemi urdhrave të Allahut, sepse Ai është më parësori. Ai neve na do dhe na dëshiron të mirën. Ai dëshiron që ne të kthehemi në vendin nga i cili kemi ardhur, pra, në xhenet.

Allahu i Plotfuqishëm na mëson se drejtësia është pika fillestare, themeli i të gjitha veprimeve tona. Shpesh herë nga drejtësia varen edhe fatet njerëzore. Kjo është një linjë karakteristike e cila duhet të ushqehet në edukimin e njeriut, dhe në asnjë moment të jetës së njeriut nuk guxon të neglizhohet. Vlera e jashtëzakonshme e saj e bën atë të obligueshme për çdo besimtar që dëshiron ta arrijë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.), prosperitetin dhe shpëtimin për të dy botët.

¹⁰ Kuran, El-Maideh, 105.

Bajrush AHMETI

QËNDRIMI ISLAM PËR PJESËMARRJEN E GRUAS NË PUNË TË PËRGJITHSHME

Gruaja nga këndvështrimi islam është partnere e rëndësishme në jetë. Andaj, sikurse burri, edhe ajo ka obligime e të drejta të plota. Nisur nga kjo, Sheriati i ka kushtuar vëmendje të thellë gruas dhe të drejtave të saj. Kurse në shumë sure dhe ajete të Kuranit flitet në veçanti për gruan dhe të drejtat e saj, qoftë si njeri, si bashkëshorte, si nënë etj.. Disa prej këtyre ajeteve do t'i përmendim në vazhdim.

Kurani ka folur për rolin e gruas që ka pasur ajo në shoqëritë e mëhershme dhe kjo për t'ia tërhequr vëmendjen shoqërisë myslimane për rolin, i cili e bëri gruan si pjesë të formimit të ymetit dhe qytetërimit islam.

Kështu në kohën e Musait a.s., sipas Kuranit, kuptojmë se pjesëmarrja e gruas së faraonit ishte edhe në punët shtetërore:

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّ مُوسَىٰ أَنْ أَرْضِعِيهِ فَإِذَا خِفَتْ عَلَيْهِ فَأَلْقَاهُ فِي
 السَّمِّ وَلَا تَخَافِي وَلَا تَحْزَنِي إِنَّا رَادُّوهُ إِلَيْكَ وَجَاعِلُوهُ مِنَ
 الْمُرْسَلِينَ (٧) فَالْتَقَطَهُ آلُ فِرْعَوْنَ لِيَكُونَ لَهُمْ عَدُوًّا وَحَزَنًا إِنَّ
 فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَجُنُودَهُمَا كَانُوا خَاطِئِينَ (٨) وَقَالَتِ امْرَأَةُ
 فِرْعَوْنَ قُرَّةُ عَيْنٍ لِي وَلَكَ لَا تَقْتُلُوهُ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ نَتَّخِذَهُ
 وَلَدًا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ (٩)

“Ne nënën e Musait e inspiruam: t’i japë atij (Musait) gji, e kur të kesh frikë për të, atëherë atë hidhe në lumë, e mos u frikëso as mos u pikëllo, se Ne do ta kthejmë atë ty dhe do ta bëjmë atë nga të dërguarit. E atë e gjeti familja e faraonit, ashtu që në fund ai t’i bëhet atyre armik e dëshpërim. Vërtet, faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë (gabonin me qellim). E gruaja e faraonit tha: “Shpresë gëzimi për mua dhe për ty, mos e mbytni atë, ndoshta do të na sjellë dobi ose do ta adoptojmë për fëmijë”. (Kasas, 7-9).

Rasti i gruas së faraonit, Asijes, e ilustron bindshëm se si ajo ndikoi te bashkëshorti për ta marrë fëmijën nga arka në Nil e për ta dërguar në pallat.

Më tutje, në Kuran flitet edhe për pjesëmarrjen e gruas në shoqërinë e peygamberit të Allahut, Shuaibit a.s.. Aty thuhet:

وَلَمَّا وَرَدَ مَاءَ مَدْيَنَ وَجَدَ عَلَيْهِ أُمَّةً مِنَ النَّاسِ يَسْقُونَ وَوَجَدَ مِنْ
 دُونِهِمُ امْرَأَتَيْنِ تَذُودَانِ قَالَ مَا خَطْبُكُمَا قَالَتَا لَا نَسْقِي حَتَّى
 يُصَدِّرَ الرِّعَاءَ وَأَبُونَا شَيْخٌ كَبِيرٌ (٢٣) فَسَقَى لَهُمَا ثُمَّ تَوَلَّى إِلَى

الظِّل فَقَالَ رَبِّ إِنِّي لِمَا أَنْزَلْتَ إِلَيَّ مِنْ خَيْرٍ فَقِيرٌ (٢٤)
 فَجَاءَتْهُ إِحْدَاهُمَا تَمْشِي عَلَى اسْتِحْيَاءٍ قَالَتْ إِنَّ أَبِي يَدْعُوكَ
 لِيَجْزِيَكَ أَجْرَ مَا سَقَيْتَ لَنَا فَلَمَّا جَاءَهُ وَقَصَّ عَلَيْهِ الْقِصَصَ قَالَ
 لَا تَخَفْ نَجَوْتَ مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ (٢٥) قَالَتْ إِحْدَاهُمَا يَا
 أَبَتِ اسْتَأْجِرْهُ إِنَّ خَيْرَ مَنِ اسْتَأْجَرْتَ الْقَوِيُّ الْأَمِينُ (٢٦)

“E kur (Musai) e arriti ujin e Medjenit, aty gjeti një grumbull njerëzish që po i jepnin bagëtisë ujë, e pak më larg prej tyre vërejtí dy gra që po i ndalnin (kafshët e tyre) e u tha: “E ç’është puna e juve dyjave?” Ato i thanë: “Ne nuk u japim ujë deri sa të largohen barinj-të, kurse babai ynë është shumë i vjetër!”. Atëherë ai u dha ujë (kafshëve) të atyre, pastaj u largua anash nën një hije e tha: “O Zoti im, unë kam nevojë për çka do që të më japësh!”. E njëra prej tyre erdhi te ai, ecte e turpëruar, e tha: “Babai im të thërret që të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!”. E kur shkoi (Musai) te ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullum-qar!”. Njëra prej atyre dyjave tha: “O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!” (Kasas: 23-26)

Gjithashtu, edhe mbretëresha e Sebeit, Belkiza, e cila, ndonëse u kundërshtua nga këshilltarët e saj, megjithatë vendosi që t’i nënshtrohej Sylejmanit a.s. pa luftë dhe në paqe,

sepse ajo e dinte mirë fundin në qoftë se do të rezistonin, andaj dhe tha:

“Në qoftë se hynë Sylejmani me forcë, do të jetë më keq për ne”.

Ja si e përshkruan këtë Kurani fisnik:

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ إِنِّي أُلْقِيَ إِلَيَّ كِتَابٌ كَرِيمٌ (٢٩) إِنَّهُ مِنْ
سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (٣٠) أَلَا تَعْلَمُونَ عَلَيَّ
وَأَتُونِي مُسْلِمِينَ (٣١) قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي أَمْرِي مَا
كُنْتُ قَاطِعَةً أَمْرًا حَتَّى تَشْهَدُونِ (٣٢) قَالُوا نَحْنُ أَوْلُو قُوَّةٍ
وَأُولُو بَأْسٍ شَدِيدٍ وَالْأَمْرُ إِلَيْكِ فَانْظُرِي مَاذَا تَأْمُرِينَ (٣٣) قَالَتْ
إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً أَفْسَدُوهَا وَجَعَلُوا أَعْرََّةَ أَهْلِهَا أَذِلَّةً
وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ (٣٤) وَإِنِّي مُرْسَلَةٌ إِلَيْهِمْ بِهَدِيَّةٍ فَنَاظِرَةٌ بِمَ
يَرْجِعُ الْمُرْسَلُونَ (٣٥)

“Ajo (Belkisa) tha: “O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!”. (E lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!” (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!). (Në vazhdim shkruante) “Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (dhe besimtarë)!”. Ajo tha: “O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timen se unë nuk do të vendos asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!”. Ata (paria) i thanë: “Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh!” Ajo tha: “Kur sunduesit e pushtojnë ndo-

një vend, ata e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrajnë. Kështu ata veprojnë!” Po unë do t’u dërgoj atyre një dhuratë (të madhe), e do të shoh se çka do të na sjellin të dërguarit (me dhuratë)”.
(Neml: 29 - 35).

Pjesëmarrja e gruas në punë të përgjithshme

Nuk është e mundur që njeriu i mençur të mohoj rolin e gruas si partnere themelore me rëndësi në ndërtimin e popujve dhe përparimin e mbarëvajtjen e tyre, ngase jeta nuk është e qëndrueshme pa këtë pjesëmarrje.

Për pjesëmarrjen-partneritetin e gruas në bërjen e jetës dhe ndërtimin e vatanit ka folur Kurani Kerimi në sferën e partneritetit ndërmjet burrave dhe grave.

Gruaja është pjesa familjare, e cila është bërthama, themeli i parë në ndërtimin e pastër të ymetit dhe qelizë kryesore në thurjen e shoqërisë njerëzore. Dhe për lidhjet e partneritetit ndërmjet burrit dhe gruas, sikurse u tha, Kurani ka folur në shumë vende, si p.sh. për besën e fortë natyrore e cila i lidhë ndërmjet veti dy bashkëshortët. Allahu xh.sh. thotë:

وَكَيْفَ تَأْخُذُونَهُ وَقَدْ أَفْضَىٰ بَعْضُكُم إِلَىٰ بَعْضٍ وَأَخَذْنَ مِنْكُم مِّيثَاقًا غَلِيظًا (٢١)

“Dhe si mund të merrni atë kur njëri-tjetrit iu keni bashkuar (në një shtrat) dhe kur ato kanë marrë prej jush një besë të fortë”. (Nisa: 21).

Xhabiri r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. në fjalimin Lamtumirës ka thënë: *“Ju porosisë që të silleni mirë me gra, ngase ju i keni marrë ato me amanetin e Allahut (d.m.th. i keni amanet)”*. (Muslimi)

Dhe nga llojet e partneritetit të ngushtë e me ndikim, ato lidhje të ngrohta ndërmjet burrit dhe gruas së tij, Kurani i ka shprehur me dashuri e mëshirë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ

بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَعْتَكَرُونَ (٢١)

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji i juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Rrum: 21)

Për ngritjen dhe formimin e familjes në shoqëri e cila bazohet në konsultë, këshillim dhe bashkëpunim për të bërë familje të lumtur e të sigurt, që të jetë e dobishme për pasardhësit dhe shoqërinë, në Kuran thuhet:

وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُتِمَّ

الرِّضَاعَةَ وَعَلَى الْمَوْلُودِ لَهُ رِزْقُهُنَّ وَكِسْوَتُهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ لَا

تُكَلِّفُ نَفْسٌ إِلَّا أَوْسَعَهَا لَا تُضَارَّ وَالِدَةٌ بِوَلَدِهَا وَلَا مَوْلُودٌ لَهُ

بَوْلَدِهِ وَعَلَى الْوَارِثِ مِثْلُ ذَلِكَ فَإِنْ أَرَادَا فِصَالًا عَنْ تَرَاضٍ

مِنْهُمَا وَتَشَاوُرٍ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا وَإِنْ أَرَدْتُمْ أَنْ تَسْتَرْضِعُوا

أَوْلَادَكُمْ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِذَا سَلَّمْتُمْ مَا آتَيْتُم بِالْمَعْرُوفِ وَاتَّقُوا
اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ (٢٣٣)

“Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjë dhënien, janë të obliguara t’u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota (hixhrije). I ati i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregulli. Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa ka mundësinë e tij. As një nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Po ashtu është i obliguar edhe trashëgimtari (i fëmijës). E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) e gjirit, nuk është ndonjë mëkat për ta. Nëse (ju baballarët) për fëmijën tuaj dëshironi gjidhënsë tjetër me kusht që pagesën t’ia bëni në mënyrë të duhur, nuk është ndonjë mëkat. Kini frikë nga Allahu dhe dine se Allahu sheh çka punoni”. (Bekare: 233).

Kush e lexon kuptimin e këtyre ajeteve me vëmendje, vëren se ato kanë përmbajtje dashurie, bashkëpunimi ndërmjet bashkëshortëve, në përkujdesjen e fëmijëve dhe interesimin në çështjet e tyre. Të gjitha ato bien në një binar në bërjen apo formimin e familjes dhe lumturinë e saj.

Kurani ka folur edhe për bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet burrit dhe gruas në të drejta dhe obligime. Aty thuhet:

... وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ وَلِلرِّجَالِ عَلَيْهِنَّ دَرَجَةٌ

وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ (٢٢٨)

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe për-gjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një për-parësi ndaj tyre. Allahu është i gjithëfuqishëm, i urtë.”

(Bekare: 228).

Ky ajet flet për partneritet e bashkëpunim në sferën e familjes. Siç u përmend edhe më lartë, Kurani fletë në shumë vende për punët e familjes dhe dispozitat e saj, madje 17 ajete që përbëjnë një tërësi të kaptinës “el-Bekare” (221-237), flasin për fejesën, kurorëzimin, menstruacionet, pastërtinë (prej tyre), gjidhënien (fëmijës), ndërprerjen e gjirit fëmijës, zgjidhjen e martesës (shkurorëzimin) etj., pra për çështje që kanë të bëjnë me dhe për gruan.

Qëllimi i ngjashmërisë e cila është përmendur në ajetin kuranor, nuk është ngjashmëri ndërmjet mashkullit dhe femrës në natyrshmërinë që ka krijuar Allahu, sepse aty ka dallim ndërmjet atyre dyve, siç ka thënë Allahu xh.sh.: “*Nuk është mashkulli si femra*”. Por synimi i ngjashmërisë është në të drejta dhe obligime ndërmjet bashkëshortëve në sferën e shoqërisë familjare, e cila i bënë këto të drejta dhe obligime të njëjta.

Duhet që ta kuptojmë drejtë faktin i cili përmendet në Kuran se: “Burrrat kanë një shkallë mbi gratë”. Kjo shkallë është kulmi i nderimit të gruas, sepse ajo është një përgjegjësi dhe barrë e madhe e burrit ndaj gruas së tij dhe atë, burri duhet t'i siguroi gruas gjërat elementare për jetë të dinjitet-

shme, si ushqimin, veshmbathjen, banimin etj. Kjo është e shprehur në Kuran:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ
وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ ... (٣٤)

“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase Allahu i ka graduar disa mbi disa të tjerët dhe ngase ata kanë shpenzuar nga hisja e tyre.” (Nisa: 34)

Kjo gradë nuk është për çdo burrë më e lartë ndaj çdo gruaje, ngase mund të ndodhë që një grua të jetë më me vlerë se (disa) burra, por kjo merret në përgjithësi. Kjo përgjegjësi mund të jetë për gruan në raste të bartjes së barrës së familjes. Ajo ndodhë kur burri e ka të pamundur t’i kryej obligimet e veta familjare, atëherë bëhet realitet partneriteti dhe plotësimi ndërmjet dy llojeve. Pejgamberi a.s. në një hadith të cilin e përcjellë Abdullah ibni Ymeri r.a., i cili thotë, se Pejgamberi a.s. ka thënë: “E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut duke thënë: “Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për grigjën tuaj. Imami (kryetari) është ruajtës dhe përgjegjës (për tërë shtetin). Burri është ruajtës i familjes së tij, dhe ai është përgjegjës për të. Edhe gruaja është baresh-ruajtëse në shtëpinë e burrit të saj dhe përgjegjëse për të. Shërbëtori është bari-ruajtës i pasurisë së zotërisë të tij dhe përgjegjës për të. Më duket se ka thënë edhe që fëmija është bari në pasurinë e babait të tij dhe ai është përgjegjës për ruajtjen e tij dhe të gjithë ju jeni barinj dhe përgjegjës për ato që ua janë lënë në ruajtje.” (Buhariu, Muslimi dhe Termidhiu)

Pjesëmarrja e gruas në themelimin e shoqërisë së parë islame

Shoqëria islame u themelua në supet e burrave dhe grave nën udhëheqjen e Pejgamberit të fundit. Roli i gruas në këtë drejtim ka qenë evidentë në bartjen e barrës në thirrjen islame dhe veprimet në përhapjen e saj në rruzullin e tokës. Kurani ka folur për besën e veçantë me të cilën i ka veçuar Allahu gratë, e jo edhe burrat. Për të vërtetuar atë që duhet të bëjë gruaja thirrëse në Islam, Allahu xh.sh. ka thënë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا جَاءَكَ الْمُؤْمِنَاتُ يُبَايِعْنَكَ عَلَى أَنْ لَا يُشْرِكْنَ
بِاللَّهِ شَيْئًا وَلَا يَسْرِقْنَ وَلَا يَزْنِينَ وَلَا يَقْتُلْنَ أَوْلَادَهُنَّ وَلَا يَأْتِينَ
بِبُهْتَانٍ يَفْتَرِينَهُ بَيْنَ أَيْدِيهِنَّ وَأَرْجُلِهِنَّ وَلَا يَعْصِيَنَّ فِي مَعْرُوفٍ
فَبَايِعُهُنَّ وَاسْتَعْفِرْ لَهُنَّ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ (١٢)

“O Pejgamber, kur të vijnë besimtares që të të japin besën se: nuk do t’i shoqërojnë asnjë send Allahut; se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë kurvëri; se nuk do t’i mbysin fëmijët e tyre; se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për (fëmijën e huaj që kanë marrë) se është i tyre; dhe se nuk do të të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë prano zotimin e tyre dhe lute Allahun t’i falë ato, se Allahu është mëkatfalës dhe mëshirues”. (Mumtehinë: 12)

Dhe me këtë besë të bekuar, Pejgamberi a.s. ua hapi dyert grave në hapësirën e pjesëmarrjes në punë të përgjithshme (publike) që të kryejnë misionin e tyre në jetë, qoftë në mësim, qoftë në edukim dhe qoftë si partnere në të gjitha aktivi-

tetet e tjera në jetë dhe që janë në proporcion me mundësinë dhe shkathtësinë e gruas dhe nuk bien ndesh me natyrshmërinë e saj.

Është pikërisht bashkëshortja e Pejgamberit a.s., Hatixhja r.a., e cila që në ditët e para të zbritjes së Kuranit do t'i gjendet pranë dhe do ta ndihmojë Pejgamberin a.s. dhe misionin e tij dhe njëherësh pikërisht kjo u bë besimtarja e parë në fenë islame. Me një fjalë, shoqëria islame fillon me një grua, fillon me Hatixhen r.a.. Këtë fakt Pejgamberi a.s. shpeshherë e ka vënë në dukje dhe ia njohur e pranuar publikisht këtë meritë bashkëshortës dhe shoqes së tij, Hatixhes r.a..

Për sa i përket përkrahjes që hazreti Hadixhja r.a., i ka dhënë Pejgamberit a.s., ua tejkalon të gjithëve, pra edhe burrave që ishin përreth të Dërguarit a.s. Ajo iu gjet dhe e ndihmoi Pejgamberin a.s. në të gjitha aspektet, si bashkëshort, si Pejgamber, si në aspektin shoqëror, ekonomik etj., deri në fund të jetës së saj. Madje kur ajo ndërroi jetë, duke ditur se ka humbur shokun dhe përkrahësen më të madhe të mundshme, këtë vit e ka quajtur “Viti i pikëllimit”, pikërisht për shkak të vdekjes së saj.

Shembullin e Hatixhes r.a., ndonëse jo në këto përmasa, do ta ndjekin edhe bashkëshortet e tjera të Pejgamberit a.s. dhe edhe shumë besimtare të tjera ndër breza e gjenerata...

Gruaja ka obligime fetare dhe shoqërore sikur që kanë burrat, duke e konsideruar atë si partnere të burrit, prandaj ajo merr pjesë edhe ibadete. Në Kuran thuhet:

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنْتَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيَاةً
طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ (٩٧)

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërbli-min më të mirë për veprat e tyre”. (Nahl: 97)

Gruaja është pjesëmarrëse me burra në të gjitha rregullat e Haxhit dhe Umres që nga fillimi i Islamit në të gjitha aktivitetet, qofshin adhurime që kryhen në xhami apo jashtë saj.

Gratë myslimane kanë luajtur rol të rëndësishëm mbrojtjen e vendit dhe të atdheut, sikurse edhe burrat, madje duke u shquar për trimërinë, sakrificën dhe vendosmërinë e tyre, deri edhe në rënien dëshmorë.

Feja islame, po ashtu, i ka garantuar gruas të drejtën e saj të shpreh mendimin haptazi, dhe kjo që nga ditët e para të paraqitjes së Islamit. Gratë besimtare shkonin personalisht te Pejgamberi a.s. për ta pyetur për të gjitha gjërat që u interesonin atyre. Shpeshherë ato kanë diskutuar me Pejgamberin a.s. për raportet e tyre në familje, me bashkëshortët e tyre. Për këtë flitet edhe në Kuran, siç është rasti me Havle bint Thalebe e cila që ankua te Pejgmaberi a.s. për bashkëshortin e saj:

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ
وَاللَّهُ يَسْمَعُ تَحَاوُرَكُمَا إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ (١)

“Vërtet, Allahu dëgjoji fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te Allahu; Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë.” (Muxhadele: 1)

Gruaja myslimane ka qenë partnere me ndikim në paq dhe luftë, po edhe në anën politike. Me këtë rast po përmendi rolin e bashkëshortes së Pejgamberit a.s., Umu Seleme, e cila me urtësinë dhe zgjuarsinë e saj e ka shpëtuar ymetin islam nga kriza politike në ditën e traktatit të lidhur mes Pejgamberit a.s. dhe idhujtarëve kurejsh në Hudejbi. Me traktatin në fjalë nuk ishin të kënaqur disa ashabë të Pejgamberit a.s. Pejgamberi a.s. u kishte thënë ashabëve të tij pas nënshkrimit të marrëveshjes që u bë në Hudejbi që të çoheshin e të thernin kurban. Por meqë ata nuk ishin të kënaqur me përmbajtjen e marrëveshjes së lidhur, nuk u ngutën që t'i thernin kurbanet. Kur e pa këtë, Umu Sleme, i tha Pejgamberit a.s.: *“O i Dërguar i Allahut, a donë që ata t’i therin kurbanet? Atëherë dil ti dhe pa i folur asnjërit, there kurbanin tënd.”* Pejgamberi a.s. veproi kështu siç e këshilloi bashkëshortja e tij dhe kur ashabët e panë këtë, u ngritën që të gjithë dhe i therën kurbanet e tyre. Kjo këshillë e Umu Selemes, u tregua mjaftë efektive në qetësimin e ashabëve, por njëherësh tregon edhe përmendimin e lirë dhe dhënien e këshillave të gruas myslimane në fillet e formimit të shoqërisë islame.

Shembuj të tillë ku mendimi i gruas ka qenë vendimtarë ka shumë në historinë islame. Prandaj si përfundim, mund të themi se nuk ka dyshim, se të gjitha këto ajete që i përmendem dhe që nuk i përmendëm dhe këto ngjarje historike, tregojnë dhe dëshmojnë katërçipërisht për partneritetin dhe pjesëmarrjen e gruas në të gjitha punët jetësore dhe ibadeteve në shoqërinë myslimane. Rugë e bashkëpunimit ndërmjet dy llojeve-gjinive, partneritet në punë të përgjithshme, në përputhje me normën e sheriatit islam, i cili lartëson vlerën e bash-

këpunimit dhe ruan ekzistencën njerëzore. Këtu duhet kërkuar edhe kundërpërgjigjen më të mirë ndaj të gjithë atyre që thonë se gjoja feja islame nuk ia njeh të drejtat gruas!

Literatura e shfrytëzuar:

- Përkthimi i ajeteve kuranore është marrë nga përkthimi i Kuranit nga H. Sherif ef. Ahmeti, Prishtinë, 1988.
- Muhamed ibni Ahmed Bashmil, “*Mevsuatu*” *El-Gazevatul-Kubra*, botimi i tretë, 2006.
- Revista “*Minberul-Islam*”, nr. 6, qershor-korrik, Kajro 2007.
- Bajrush Ahmeti, *Historia e pejgamberëve*, botimi i tretë, Prishtinë 1997.
- Revista “*El-Vajul-Islami*”, gusht 1973.
- Revista “*Edukata Islame*”, nr. 19 dhe nr. 20, Prishtinë, 1977.

Dr. Sedat ISLAMI

SOLIDARITETI SHOQËROR VËSHTRUAR SIPAS MËSIMEVE ISLAME

Hyrje

Globalizimi kulturor është duke u kthyer në një asgjësues kulturash dhe zhdukës të tyre. Prania e tij ka vënë në pikëpyetje ekzistencën e botëkuptimit tradicional të vlerave dhe institucioneve shoqërore. Familja, farefisi, rrethi, janë duke humbur gjithnjë e më shumë fuqinë dhe prestigjin që dikur kanë pasur. Për pasojë, *‘e mira e përbashkët’*, si koncept dhe praktikë tradicionale, është përmbysur nga individualizmi. Pavarësisht se të mirat materiale janë shtuar, hendeuku ndërmjet të pasurve dhe të varfërve është thelluar. Gjithnjë e më shumë të pasur me interesim gjithnjë e më të vogël për të varfrit. Vazhdimi i një gjendjeje të këtillë nuk është se i bën nder dikujt. Për këtë shkak, institucione të ndryshme shken-

core janë duke u marrë me hulumtime rreth vlerave shoqërore në kohën tonë¹.

Një nga vlerat e hulumtuara shumë është edhe *solidariteti shoqëror*. Siç dihet, njeriu nga vetë natyra e tij është shoqëror, andaj ka nevojë për të tjerët siç këta të fundit kanë nevojë për të. Por, duke qenë se ka botëkuptime të ndryshme rreth solidaritetit, atëherë kërkohen edhe kontribute të tjera, respektivisht ai i fesë. Ky punim është menduar pikërisht si një kontribut dhe përgjigje konkrete për solidaritetin nga perspektiva islame:

1. Çfarë nënkuptojmë me solidaritetin shoqëror nga perspektiva islame?
2. Cilat janë tiparet dalluese të solidaritetit nga perspektiva islame?, dhe
3. Cilat janë format e manifestimit të tij dhe objektivat, për realizimin e të cilave mëton ky institucion shoqëror islam?

Qëllimi i tij themelor është të zbardhë dhe të ndriçojë konceptin islam për solidaritetin shoqëror, kuptimet e tij të thella, shtrirjen e tij të gjerë dhe aplikimin e tij të lehtë. Solidariteti sipas Islamit nuk është teori e thatë. Nuk është as aplikim formal. Solidariteti përfshin anën shpirtërore dhe atë materiale. Po kështu ai nuk aplikohet vetëm në raste fatkeqësisht por edhe gëzimesh. Ai është, para së gjithash, reflektim i lidhjeve të forta fetare, i vëllazërisë, e pastaj edhe i lidhjeve të tjera dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Këto janë vetëm

¹ Ky punim është prezantuar në konferencën shkencore të organizuar nga Universiteti Marin Barleti në Shqipëri, në nëntor 2017.

disa prej elementeve që dallojnë solidaritetin në Islam. Dhe këtu qëndron rëndësia e këtij punimi, i cili ofrohet si një alternativë e dobishme për të ruajtur dhe kultivuar vlerat tradicionale në këtë kohë të zbehjes së tyre. Metodologjia e ndjekur në punim është përshkruese. Punimi është i shtrirë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë kemi shkruar për vlerat shoqërore nën efektin e globalizimit kulturor, ndërsa në të dytën për solidaritetin nga perspektiva islame, duke e shpjeguar fillimisht si koncept, për t'u ndalur më pas te dy format e tij kryesore, të shoqëruara edhe me shembuj përkatës.

I. GLOBALIZIMI KULTUROR DHE KULTURAT LOKALE

Shekujt XX dhe XXI kanë përjetuar një zhvillim të madh teknologjik. Mjetet e transportit dhe teknologjia e komunikimit kanë afruar më shumë se kurrë më parë individët, organizatat, qeveritë dhe shtetet². Kjo ka bërë që kontaktet të jenë më të shpeshta, më të shumta dhe më të ndryshme. Lëvizja e njerëzve dhe mallrave ka shkaktuar një ndryshim, i cili ka prekur pothuajse çdo aspekt të jetës së njerëzve. Është krijuar një klimë e re e cila ka tendencë të bëjë ndryshime rrënjësore, jo vetëm në tregje por edhe në kulturë e tradita, për ta shndërruar botën në një fshat, perëndimor, apo edhe më saktë amerikan. Së këndejmi, jo të gjithë i kanë duartrokitur globalizimit dhe jo të gjithë e kanë pritur mirë. Janë jo vetëm shte-

² Ky konstatim është i Antoni Giddensit (Anthony Giddens). Shih: Nuruddin Zimam, “*Avlemetu-th-thekafeti - el-mustehil ve-l-mumkin*”, Revista El-ulum el-insanijje, Universiteti Biskra, Algjeri, nr.1, nëntor 2001, f. 135.

tet e vogla dhe të pafuqishme ato që kanë shfaqur frikën nga globalizimi. Kohë më parë, diplomacia greke, ajo franceze dhe ajo kanadeze ankoheshin për efektet shkatërruese të globalizimit kulturor³.

1. Çfarë është globalizimi kulturor dhe cili është gjykimi i shkollarëve myslimanë për të?

Globalizimi kulturor nënkupton takimin e kulturave dhe traditave të ndryshme botërore. Ky takim nuk është krejtësisht miqësor, pasi që dimensionin kulturor të globalizimit, siç do të shprehej Ragnar Müller, nuk është vetëm sfidues por edhe zhdukës i kulturave lokale nga amerikanizmi kulturor. Laramania dhe diversiteti nën efektin e globalizimit kulturor zhduken për të ardhur një kulturë e re, kulturë botërore e hegjemonizuar⁴. Për këtë shkak, globalizimi është parë më shumë perëndimorizim (westernizim) i kulturave sesa bashkëpunim me to⁵.

Kultura e re globale, e importuar në vendet e tjera, është imponuese do të thoshte dr. Jusuf Kardavi⁶. Ajo po kështu ka efekte asimiluese⁷. Globalizimi mëton një lloj riidentifikimi

³ Shih: Grup autorësh, *El-muslimune fi muvaxheheti el-betth-thi el-mubashir*, (Rijad: Dar Tuvejk, 2000), f. 42-42.

⁴ Shih: Ali Pajazit, *Fjalor i Sociologjisë*, Shkup: Logos-A, 2009, f.212.

⁵ Shih: Ebu Bekir Refik, "*Mehatir el-avlemeti ala el-huvijejti eth-thekafijjiti li-l-alemi-l-islamij*", Dirasat - Universiteti Ndërkombëtar Islamik, Chitagon, Bangladesh, vëll. 4, dhjetor 2007, f. 8.

⁶ Po aty, f. 9.

⁷ Shih: Muhammed Ammare, *Bejne el-alemijjiti el-islamijje ve-l-avlemeti el-garbijje*, Kajro: Mektebetu El-Imami El-Buhari, 2009, f. 51.

kulturor, një stil të ri jetese, një modelim sipas mënyrës amerikane. Për pasojë, ajo që dikur ka qenë traditë e një populli sot mund të jetë harruar fare. Këtë “modelim” disa studiues e konsiderojnë jo vetëm si mjet me të cilin Perëndimi po përhap vlerat liberale perëndimore në tërë botën⁸, por edhe një lloj komploti ndaj kulturave tjera⁹. Globalizimi kulturor është luftë kulturore, që nënkupton dominimin e kulturës të të fortit ndaj kulturës së të dobët¹⁰. Se çfarë ndikimi ka pushtimi nga aspekti shpirtëror dhe kulturor na flet edhe Ibn Halduni, i cili në “Mukaddime”, në një kapitull të veçantë, kapitullin 23, thotë: *‘I pushtuari është gjithmonë i dhënë pas pushtuesit duke e pasuar atë në dukje dhe bindje dhe në çdo gjë tjetër. E shkak është se, njeriu, nga vetë natyra e tij, beson në përsosmërinë e atij që e ka pushtuar dhe të cilit i është nënshtruar.’*¹¹ Bile, dr. Ammare konsideron se nuk është duke ndodhur vetëm përmbysja e kulturave, por edhe e feve. Ai konsideron se globalizimi është duke i krishterizuar mysli-manët¹².

Këtë ndryshim, Muhammed Esedi e sheh të rrezikshëm, madje edhe e quan “fe” e cila njerëzve po ua zëvendëson fe-

⁸ Shih: Ebu Bekir Refik, “*Mehatir el-avlemeti*”, op. Cit., f. 6.

⁹ Shih: Ali bin Ibrahim Nemle, *Haxhisu-l-muamereti fi-l-fikri-l-arabij bejne et-tehvini ve-t-tehvil*, Bejrut: El-merkez eth-thekafij el-arabij, 2009, f. 109-111.

¹⁰ Shih. Xhelal Emin, *El-avlemeh*, Kajro: Dar el-mearif, 2002, f. 48.

¹¹ Ibn Haldun, *Tarihu Ibn Haldun*, ver. Halil Shehadeh, Bejrut: Dar El-Fikr, ed.2, 1988, 1/184.

¹² Shih: Muhammed Ammare, *Bejne el-alemijeti el-islamijje ve-l-avlemeti el-garbijje*, op.cit., f. 54.

në, kulturën, traditat e gjithëka tjetër. Ky ndryshim ndodh nëpërmjet rrugës së kulturës dhe ekonomisë. Tekstualisht thotë: *‘Tempujt e kësaj feje (globalizimit) janë fabrikat e monedhës, kinematë, laboratorët kimikë, sallat e vallëzimit, fabrikat e prodhimit të rrymës, ndërsa priftërinjtë e saj janë financierët, inxhinierët, yjet e kinematografisë, komandantët e industrisë dhe heronjtë e aeroplanëve.*¹³

Por, përhapja e globalizimit kulturor nuk ka ndodhur vetëm me teknologji (tv, radio, internet) dhe presionet ekonomike. Disa studiues numërojnë edhe kërcënimet ushtarake si forma me të cilat globalizimi kulturor është përhapur¹⁴.

2. Megjithatë, globalizimi kulturor nuk refuzohet tërësisht

Por, globalizimi kulturor -siç thotë Gidensi- është proces i dyanshëm¹⁵, është diçka të cilën edhe ne mund ta përdorim për t’iu kundërvënë globalizimit kulturor dhe jo vetëm. Globalizimi as nuk është e keqe absolute, as e mirë absolute¹⁶.

¹³ Shih: Abdul Kadir bin Muhammed Ata Sufi, *Athar el-avlemeh ala akideti-sh-shebab*, (Muslim World League: Davetu-l-hakk: v. 23, nr. 215. 1427 h.), f. 13.

¹⁴ Shih: Xhafer Shejh Idris, *Sirau-l-hadarat bejne avlemetin garbijjetin ve ba'thin islamij*, (Rijad: Mexhel-letu El-Bejan, 1433 h.), f. 14; Ebu Bekir Refik, *“Mehatir el-avlemeti*, op.cit., f. 8.

¹⁵ Shih: George Ritzer dhe Douglas J. Goodman, *Teoria sociologjike*, për. Grup përkthyesish, (Tiranë: UFO Press, 2008), f. 592. .

¹⁶ Shih: Abdul Aziz Berguth, *Esh-shuhud al-hadarij li-l-ummeti el-vesat fi asri-l-avlemeh*, (Kuvajt: Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame, 2007), f. 129.

Ne, nisur nga roli ynë misionar, globalizimin mund ta vëmë në shërbim të përhapjes së fesë në Perëndim¹⁷. Prof. dr. Xhafer Shejh Idrisi, përmend disa gjëra me rëndësi të cilat mund t'i përfitojmë nga globalizimi kulturor, prej të cilave, si më të rëndësishme, do të veçoja:

- njohja me kulturat e tjera, e domosdoshme për t'ua përcjellë fenë dhe për të diskutuar me ta;
- njohja me kulturat perëndimore ka ndikuar që një pjesë e myslimanëve t'i rikthehen fesë seriozisht. Kjo kur kanë kuptuar se në terren gjendja nuk është ashtu siç u përshkruhet, dhe
- kulturat perëndimore kanë të mira që nuk mohohen. Refuzimi i tyre nga ana jonë do të ishte veprim i gabuar¹⁸.

Këtë synim e ka edhe ky punim. Globalizimi ka të mira të shumta, ndër të cilat edhe mundësia që të kontaktojmë me të tjerët dhe ta prezantojmë “mallin” tonë. Në pjesët në vazhdim do ta trajtojmë solidaritetin, si vlerë që po vyshket në shoqëritë perëndimore, për të dëshmuar se vlerat islame i duhen botës moderne.

¹⁷ Shih: Ebu Bekir Refik, “*Mehatir el-avlemeti*, op.cit., f. 7.

¹⁸ Shih: dr. Xhafer Shejh Idris, *Vesail el-ittisal ve alakatuna bi-th-thekafat el-uhra*, op.cit., f. 72-73.

II. ISLAMI PËR SOLIDARITETIN SHOQËROR

II.1. Koncepti i solidaritetit në përcaktimin fetar

Solidariteti shoqëror -përgjithësisht- nënkupton lidhjet në kuadër të një bashkësie, marrëdhëniet shoqërore që i lidhin njerëzit, që krijojnë raporte të afërsisë, të ndihmës reciproke, të komunikimit konstruktiv, të bashkëndjesisë¹⁹. Ahmed Ymer Hashim, solidaritetin e përkufizon si angazhim kolektiv të atyre që kanë mundësi materiale për të ndihmuar njerëzit në nevojë ose për t'ua mbuluar detyrimet që ata vetë nuk kanë mundësi t'i mbulojnë²⁰. Me pak fjalë, solidariteti është përgjegjësia shoqërore e individit²¹.

Në Islam, solidariteti dallon si për nga motivi, si për nga format e manifestimit. Motivi për solidaritet është fetar, pra synohet para së gjithash përfitimi i kënaqësisë së Allahut²², e jo politik e racor. Solidariteti është imazhi lëvizës dhe faktografik i vëllazërisë fetare²³. Roli i tij në shoqëri, figurativisht,

¹⁹ Ali Pajaziti, *Fjalor i Sociologjisë*, op.cit., f. 603.

²⁰ Shih: Ahmed Ymer Hashim, *Et-tedamun fi muvaxheheti et-tehaddijjat*, (Kajro-Bejrut: Dar Esh-shuruk, 2001), f.9.

²¹ Shih: Sejjid Hashim Mevsevi, *En-nidham el-ixhtimaij fi-l-Islam*, (Bejrut: Dar esh-shuruk, 1992), f. 52.

²² Shih: Kur'ani: Insan: 9: "Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! 10. Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura."

²³ Shih: Kur'ani: Enfalë: 62-63: "Ai të ka forcuar me ndihmën e Tij dhe me besimtarët, duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

krahasohet me rolin e gjymtyrëve në trup...Solidariteti nuk është bamirësi dhe ndihmë, por detyrë dhe përgjegjësi. Nga kjo perspektivë, solidariteti është obligim që duhet të përmbushet nga të gjithë veç e veç: kryefamiljari me familjen, i pasuri me të varfrin, fqinji me fqinjin, farefisi ndërmjet vete, i forti me të dobëtin, e kështu me radhë²⁴. Solidariteti nuk është krejt vullnetar. Në Islam është i rregulluar shtetërisht dhe edhe në mënyrë të obliguar. Shembull për këtë kemi zekatin²⁵.

Solidariteti është i rregulluar me tekste nga Kurani dhe Sunneti. Dr. Hashimi përmend disa sosh²⁶, si: ajetet:

- ***“...Ndihmoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armi-qësi!...”*** (Maide: 2)
- ***“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”*** (Asr: 1-3)

Hadithet:

- ***“Besimtari për besimtarin është sikur godina pjesët e së cilës mbajnë njëra tjetrën.”***²⁷

²⁴ Shih: Sejjid Hashim Mevsevi, *En-nidham el-ixhtimaij fi-l-Islam*, op.cit., f. 56; 57.

²⁵ Për më shumë rreth zekatit si ligj që rregullon solidaritetin shoqëror shih: Ahmed Mustafa Hatir, *El-hidmetu el-ixhtimaijje - nadhretun tarihijjetun - menahixh el-mumareseh- el-mexhalat*, (Aleksandri: El-mekteb el-xhami el-hadith, ed. 2, 1995), f. 45.

²⁶ Shih: Ahmed Ymer Hashim, *Et-tedamun*, op. cit., f.9.

²⁷ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

- *“Shembulli i besimtarëve në dashurinë dhe mëshirën e ndërsjellë është sikur shembulli i një trupi të vetëm, i cili vuan edhe atëherë kur vetëm një gjymtyrë e tij vuan.”*²⁸
- *“Nuk ka besuar (plotësisht) ai që për vëllanë e vet nuk do atë që do për vete.”*²⁹

Natyrisht, ka edhe tekste të tjera të shumta që trajtojnë solidaritetin shoqëror, por këto ishin vetëm sa për ilustrim³⁰. Siç mund ta vërejmë, solidariteti ka principe të përgjithshme, të cilat përfshijnë të gjitha aspektet e jetës. Solidariteti nuk ndodh vetëm në vështirësi, por edhe në gëzime. Myslimani është vëllai i myslimanit dhe me të ndan të mirën dhe të keqen³¹.

II.2. Solidariteti moral

Solidariteti moral nënkupton lidhjen shpirtërore me njëri tjetrin duke ndarë jo vetëm momentet e vështira së bashku por edhe ato të mirat. Siç do të shohim, në kuadër të obligi-

²⁸ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

²⁹ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

³⁰ Shih hadithet: *‘Aq shumë më porositi Xhibrili për fqinjin sa që mendova se do të më trashëgoj.’* [Buhariu dhe Muslimi]; *‘Kush i ndihmon vëllait të vet kur është në nevojë, Allahu do t’i ndihmon atij kur të ketë nevojë!’* [Buhariu dhe Muslimi]; *‘Nuk ka besuar në Mua ai që flenë ndërsa fqinji i tij është barkzbraur...’* [Taberaniu]; *‘Unë dhe kujdestari i jetimit jemi bashkë në Xhennet...’* [Buhariu]; *‘Kush kujdeset për gruan e vejë dhe të ngratin (miskinin) është sikur luftëtari në rrugën e Allahut ose ai që falet natën dhe agjëron ditën.’* [Buhariu]; *‘...Kur ta rrjepësh kurbanin, fillo me fqinjin tonë çifut...’* [Ebu Davudi dhe Tirmidhiu].

³¹ Parafrazuar nga: Ahmed Umer Hashim, *Et-tedamun*, op. cit., f. 32.

meve ndërmjet besimtarëve është edhe përgjigjja në ftesë për gëzim. Nga këtu, solidariteti moral, siç do të shprehej edhe Imam Gazaliu, është fryt i moralit të mirë³². Me këtë kuptim e manifestim, solidariteti moral është më i rëndësishëm se ai material, jo vetëm për shkak të ndjenjave dhe emocioneve, por edhe për shkak të anës praktike³³.

Karakteristikë e solidaritetit, qoftë ai moral, qoftë material, është se ai nuk është i tkurrur vetëm ndërmjet myslimanëve. Format në vazhdim do të na zbulojnë më shumë detaje për konceptin e solidaritetit moral dhe imazhet e manifestimit të tij.

II.2.1. Solidariteti me myslimanët

II.2.1.1. Manifestimi i solidaritetit ndërmjet myslimanëve

Baza e solidaritetit moral ndërmjet myslimanëve është lidhja e tyre në baza fetare. Në tekste të shumta në Kuran dhe Sunnet është theksuar kjo vëllazëri, format dhe rëndësia e saj. Allahu thotë: ***“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...”*** (*Huxhurat: 10*); ***“...Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por***

³² Alevi Ebu Bekir Muhammed Seffaf, *Muhtesar Ihjai Ulumi-d-Din*, (Xhakar-ta: Dar el-kutub el-islamijje, 2004), f. 89.

³³ Pejgamberi Muhammed a.s. ka thënë: *‘Ju nuk mund të tregoheni zemërgjerë me pasuritë (ndihmat, lëmoshat) tuaja ndaj të gjithë njerëzve (sepse nuk mjaftojnë), por tregohuni zemërgjerë duke u shfaqur fytyrëçelur para tyre dhe duke treguar moral të mirë me ta.’* Hadithi është hasen li-gajrihi. Shih: Sahihu-t-Tergibi ve-t-Terhib, nr. 2661.

Allahu i bashkoi ato...” (*Enfalë*: 63); **“...e të mëshirshëm midis tyre...”** (*Fet’h*: 29). Mustafa Sibai, duke iu referuar ajetit të parë, thotë: ‘*Shpallja e ‘vëllazërisë’ nga Kur’ani nënkupton solidaritet jo vetëm në aspektin material por edhe në atë moral...*³⁴’

Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Myslimani është vëlla i mysli-manit...*³⁵”; “*Shembulli i besimtarëve në dashurinë dhe mëshirën e ndërsjellë është sikur shembulli i një trupi të vetëm, i cili vuan edhe atëherë kur vetëm një gjymtyrë e tij vuan*³⁶.”; “*Nuk ka besuar (plotësisht) ai që për vëllanë e vet nuk do atë që do për vete.*³⁷” Dr. Umer Hashimi duke folur për imazhet e vëllazërisë dhe reflektimin e saj thotë: ‘*Vëllazëria fetare parasheh drejtësinë ndërmjet njerëzve, përkrahjen e të dëmtuarit, largimin e brengave dhe fatkeqësive.*³⁸’

Nisur nga këto kuptime të gjera që përfshin solidariteti moral, dijetarë dhe hulumtues mysli-manë kanë përmendur disa forma se si manifestohet ky solidaritet³⁹, disa prej të cilave do t’i veçojmë në vijim: urdhërimi për të mirë dhe ndalimi

³⁴ Parafrazuar nga: Mustafa Sibai, *Ishtirakijetu-l-Islam*, (Egjypt: Eddar el-kavmijje li-t-tibaati ve-n-neshr, ed. 2, pa vit botimi), f. 111.

³⁵ Hadithin e shënon Muslimi.

³⁶ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

³⁷ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

³⁸ Ahmed Umer Hashim, *Et-tedamun*, op. cit., f. 32.

³⁹ Shih: Ahmed Umer Hashim, *Et-tedamun*, op. cit., f. 32 e tutje; AbduRrahim bin Muhammed El-Mugadh-dhevi, *Ed-da`vetu ve siletuha bi-l-hajat*, (Rijad: Mektebetu-rr-Rushd, pa vit botimi), f. 222-239; Abdul Aziz bin Muhammed Selman, *Min mehasini-d-dini el-islamij*, (Botim privat: ed. 3, 1983), f. 10-11; 17; 18.

nga e keqja⁴⁰; ndarja e drejtësisë ndërmjet vete; ruajtja e nderit të njëri-tjetrit⁴¹; pajtimi në rast të prishjes; bashkimi dhe uniteti⁴²; ikja nga bojkoti i njëri tjetrit - dhënia selam si imazh konkret⁴³; ikja nga konflikti fizik dhe lufta me njëri tjetrin; ndihma ndaj vëllait kur është i drejtë dhe kur është i padrejtë⁴⁴; largimi i brengave; mostallja dhe mosnënçmimi; falja dhe tolerimi; ikja nga zilia dhe urrejtja; përgjigjja në ftesë; ngushëllimi (duke e vizituar në sëmundje, duke ia falur dhe përcjellë xhenazen); mbulimi i të metave në të gjallë dhe pas vdekjes, etj.

⁴⁰ Shoqëria islame është e ngritur mbi baza fetare andaj prej imazheve më të theksuara të saj është se vazhdimisht e urdhërojnë njëri tjetrin për të mirë dhe e ndalojnë nga e keqja [Shih kaptinën Teube, ajeti: 71]. Se sa e rëndësishme është kjo mësojmë nga një hadithi i njohur profetik, i cili urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja e sheh si organ që garanton ekzistencën e kësaj shoqërie në tokë.

⁴¹ Duke mos ia shkelë nderin familjar por as duke mos e përgojuar.

⁴² Si mjet i realizimit të kësaj është edhe namazi me xhemat. Me faljen e namazit me xhemat përfitohet njohja ndërmjet besimtarëve, përforcohen lidhjet, shtohen dashuria, butësia dhe mëshira e ndërsjellë. Ngjashëm trajtohen edhe zekati, agjërimi dhe haxhi që i shërbejnë kësaj lidhje dhe këtij bashkimi. Shih: Abdul Aziz bin Muhammed Selman, *Min mehasini-d-dini el-islami*, op.cit., f. 10-11; 17; 18.

⁴³ Dhënia selam konsiderohet si formë që tregon se nuk ka bojkot dhe as lëçitje ndërmjet vëllezërve.

⁴⁴ Kjo ndihmë manifestohet duke i ndihmuar nëse i bëhet padrejtësi dhe duke i ndihmuar nëse bën padrejtësi, respektivisht duke e ndalur nga padrejtësia.

II.2.1.2. Kategoritë e solidaritetit⁴⁵

Solidariteti nuk është koncept i shthurur. Myslimanit nuk i konsiderohet për burrëri, e aq më pak për fetari, të interesohej për të tjerët, e të braktisë ata për të cilët duhet kujdesur në radhë të parë për ta, familjen në këtë rast. Nga këtu, solidariteti i mirëfilltë fillon me familjen, respektivisht me prindërit⁴⁶, gruan⁴⁷ dhe fëmijët⁴⁸, fqinjët⁴⁹, farefisin⁵⁰, shoqërinë dhe njerëzit në përgjithësi. Secilit i kushtohet hapësirë dhe vëmendje sipas rregullit *‘Jepi atij atë që e meriton.’*

II.2.2. Solidariteti me jomymslimanët

II.2.2.1. Baza e solidaritetit moral me jomymslimanët

Siç përmendëm, karakteristikë e solidaritetit në Islam, moral apo material qoftë, është se ai nuk është i tkurrur vetëm ndërmjet besimtarëve myslimanë. Natyrisht, kur e themi këtë, nuk kemi për qëllim zhdukjen e dallimeve që ekzistojnë

⁴⁵ AbduRrahim bin Muhammed El-Mugadh-dhevi, *Ed-da'vetu ve siletuha bil-hajat*, op.cit., f. 222-239.

⁴⁶ Shih urdhrin kur'anor për mirësjellje me prindërit, Isra: 23. Po kështu, shih hadithin profetik: *‘Kujt i takon mirësjellja ime së pari? Nënës...Pastaj babait.’* Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

⁴⁷ Shih ajetin: Nisa: 19; Tahrim: 6; hadithin *‘Silluni mirë me gratë!...’ Sahihul-xhami'*, nr. 960.

⁴⁸ Shih ajetet: Tahrim: 6; Nisa: 11.

⁴⁹ Shih ajetin: Nisa: 36; hadithin e shënuar nga Buhariu dhe Muslimi: "Xhib-rili më porosi aq shumë për fqinjin sa që mendova se do të më trashëgoj".

⁵⁰ Shih ajetin: Nisa: 36; hadithin e shënuar nga Buhariu dhe Muslimi: *‘Në Xhennet nuk hyn ai që shkëput lidhjet farefisnore.’*

në shprehjen e këtij solidariteti ndaj myslimanëve dhe të tjerëve. Megjithëkëtë, ekzistojnë lidhje të njohura e të aprovuara nga feja, të cilat na bëjnë të kultivojmë solidaritetin me jomyslimanët, veçmas atë material. Këto lidhje janë humane⁵¹, familjare⁵², farefisnore⁵³, misionare⁵⁴ e tj.

⁵¹ Të gjithë njerëzit, në origjinë, janë prej një babai dhe një nëne. Jo vetëm kaq. Besimtari dallohet për nga aktiviteti human që bën. Pejgamberi a.s. ka thënë: *‘Njeriu më i mirë është ai më i dobishmi për të tjerët.’* Në këtë angazhim të tij për të qenë i dobishëm nuk është përjashtuar jomyslimani paqësor⁵¹, veçmas nëse marrim parasysh udhëzimin në rrugën e drejtë, si formë e solidaritetit, të cilën patjetër besimtari duhet ta manifestojë me të tjerët. Dije-tarët, duke iu referuar ajetit: **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”** [Mumtehinë: 8] kanë thënë se nuk ka ndalesë që myslimani të sillët mirë me jomyslimanin⁵¹. Në ajet nënvizohet *drejtësia* si formë e zhvillimit të raporteve, e që, siç kemi shënuar më lartë, është trajtë e solidaritetit moral. Sigurisht, ka specifika që duhet marrë parasysh me rastin e shprehjes së solidaritetit moral, në mënyrë që të mos veprohet diç që nuk miratohet nga ana e fesë. Shih fetvanë nr. 178077: *‘A shpërblehet besimtari nëse ndihmon jobesimtarët.’*, e publikuar më 22.4.2012 në www.islamweb.net. Në fetva janë edhe të dhënat për hadithin e cituar. Shih edhe: Ismail bin Umer bin Kethir, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-Adhim*, (Rijad: Dar Tajjibe li-n-neshr ve-t-teuzië, ed. 2, 1999), 8/90.

⁵² Si imazh konkret i kultivimit të solidaritetit me jomyslimanët është lidhja familjare. Buhariu dhe Muslimi shënojnë hadithin e Esmasë r.a., e cila kishte kërkuar leje nga Pejgamberi a.s. për të mbajtur apo jo lidhjet me të ëmën e saj, e cila atëbotë ishte idhujtare. Pejgamberi a.s. e kishte lejuar.

⁵³ Hadithin që e shënuam më lartë për mirësjelljen me fqinjët e që përfshin dhe fqinjin jomysliman.

⁵⁴ Besimtari, siç e do për vete udhëzimin, duhet ta do edhe për të tjerët, për këtë shkak duhet t’i thërret në fe. Vet udhëzimi është një nga format e solidaritetit moral.

II.2.2.2. Manifestimi i solidaritetit moral me jomyslimanët

Solidariteti moral me jomyslimanët manifestohet në disa forma, si: ndarja e drejtësisë me jomyslimanët, duke mos ua shkelur të drejtat që u takojnë, dëshirimi i udhëzimit për në rrugën e drejtë, vizita e tyre në rast sëmundjeje me qëllim që t'u përfitohet zemra⁵⁵. Pejgamberi a.s., siç shënon Buhariu, kishte vizituar një fqinj të tij çifut, të cilit në momentet e fundit të jetës ia kishte prezantuar fenë dhe ai e kishte pranuar.

II.2.3. Synimet e solidaritetit moral

Besimtari me solidaritetin moral synon fillimisht fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe shpërblimin e Tij⁵⁶, realizimin e vëllazërisë fetare, e cila është objektiv i kësaj feje⁵⁷, forcimin e lidhjeve shoqërore⁵⁸, lumturinë dhe mirëqenien⁵⁹, dhe udhëzimin në rrugën e Zotit.

⁵⁵ Ibn Tejmije është pyetur për vizitën e jomyslimanëve dhe ka thënë se lejohet sepse mund të ketë dobi në të, respektivisht vizita të bëhet shkak që të udhëzohet në Islam. Shih: Ahmed bin Abdul Halim bin Tejmije, *Mexhmuatu el-fetava*, ver. AbduRrahman bin Muhammed bin Kasim, (Medine Munevvere: Kompleksi Mbreti Fehd për botimin e Kur'anit, 1995), 24/265.

⁵⁶ Kush mbulon të metat e vëllait të tij, Zoti ia mbulon të metat atij. Pra, edhe kënaqësi e Zotit, edhe shpërblim prej Tij. Shih hadithin e saktë në Sahihu Ibni Maxhe, 2078.

⁵⁷ Përmendëm se afrimi i zemrave të besimtarëve ndërmjet vete, sipas ajetit 63 nga kaptina Enfal, është meritë e fesë.

⁵⁸ Vizitat, ngushëllimet, ndarja e gëzimit me të tjerët fiton dashurinë e tyre. Madje, edhe lidh gjeneratat ndërmjet vete. Shih: Abdul Aziz bin Muhammed Selman, *Min mehasini-d-dini el-islamij*, op.cit., f. 10-11.

⁵⁹ Shoqëritë ku ka solidaritet janë më të lumtura dhe më pak vuajnë nga urrejtja, smira, inati.

II.3. Solidariteti material

Në Islam anëtarët e shoqërisë kanë edhe detyrime materiale karshi njëri-tjetrit. Kjo bën që solidariteti material të mos jetë thjesht bamirësi por edhe detyrim dhe përgjegjësi. Allahu i Madhëruar kërkon nga besimtarët e pasur që të japin nga pasuria që Ai u ka dhënë. Po kështu, na mëson se në pasuritë e të pasurve ka pjesë të caktuar, e cila i takon të varfërve⁶⁰. Nga këto mësojmë se pronar i vërtetë i pasurisë është Allahu ndërsa njeriu është shfrytëzues, andaj duhet të veprojë konform rregullave që i përshkruhen, respektivisht duhet të përmbushë detyrimet karshi të varfërve.

Dijetarët dhe studiuesit myslimanë kanë përshkruar format se si manifestohet solidariteti material, se cilat janë qëllimet e tij dhe cila duhet të jetë etika që duhet përfillur gjatë kohës sa ndihmojmë të tjerët.

Në vazhdim do të ofrojmë një përmbledhje rreth çështjeve në fjalë.

II.3.1. Llojet e solidaritetit material

Siç përmendëm, solidariteti ka rëndësi të madhe në fe, andaj, edhe nuk është lënë krejtësisht çështje vullnetare. Solidariteti material merr trajtë edhe të obliguar. Se si manifes-

⁶⁰ Shih ajetet: *“...jepuni diçka nga pasuria juaj, të cilën ju ka dhuruar Allahu...”* [Nur: 33]; *“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.”* [Dhariat: 19]; dhe hadithin: *‘...bëjua me dije se Allahu ua ka obliguar dhënien e një pjese të pasurisë, e cila merret nga të pasurit dhe iu kthehet të varfërve.’* Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

tohet vullnetarisht dhe në mënyrë të obliguar, do të mësojmë në vazhdim:

II.3.1.1. Solidariteti vullnetar

Solidariteti vullnetar mund të quhet ndryshe edhe qytetar. Pra, është participim individual dhe krejtësisht i vullnetshëm. Është kjo ajo që e quajmë sadaka (lëmoshë). Në Kuran dhe Sunnet gjejmë tekste të shumta të cilat na nxisin të japim e të ndihmojmë të tjerët. Në Kuran Allahu na urdhëron të sillemi mirë me të afërmit⁶¹, pra t'i ndihmojmë, sikur që na tregon se Ai e do lëmoshën dhe e rrit përfitimin e saj⁶², në ndërkohë që urren format e tjera jolegjitime të përfitimeve, siç është kamata. Po kështu na flet për besimtarët e devotshëm që japin duke synuar fitimin e kënaqësisë së Tij⁶³. Edhe Pejgamberi a.s. u ka kushtuar rëndësi të madhe lëmoshës dhe vlerave të saj duke nxitur për dhënie dhe duke na i përmendur disa prej përfitimeve në botën tjetër⁶⁴.

⁶¹ *“Silluni mirë me fqinjin e afërt dhe atë të largët.”* [Nisa: 36].

⁶² *“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë.”* [Bekare: 276]

⁶³ *“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”* [Bekare: 274]; *“Ne po ju ushqejmë për Allahun, nuk duam prej jush shpërblim dhe as falënderim.”* [Insan: 9].

⁶⁴ Shih disa nga tekstet: *“Kur të gatuash gjellë, shtoji ujë më shumë që t'i japësh dhe fqinjit tënd.”* Hadithin e shënon Muslimi.; *“Kur njeriu vdes, i ndërpriten veprat e tij, përveçse nga tre gjëra: sadakaja e rrjedhshme...”* Hadithin e shënon Muslimi.; *“Cili është islami më i mirë? Tha: “T'i ofrosh ushqim dikujt...”* Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi. Aisheja r.a., siç transmeton Tirmidhiu në Sunen, rrëfen se kishin therur një dele ndërsa Pejgamberi

Në Islam është kultivuar një formë e rrallë e lëmoshës që është karakteristikë vetëm jona. Fjala është për vakëfin, një pronë e lënë për të varfrit dhe për nevoja shoqërore, destinimi i të cilës nuk mund të ndryshohet. Ajo si pronë i dedikohet Allahut, si përfitim i të varfërve dhe nevojtarëve. As nuk mund të shitet dhe as të lihet në trashëgim⁶⁵.

II.3.1.2. Solidariteti i obliguar

Ndryshe mund të quhet shtetëror. Në Islam, shteti obligon të pasurit që për të varfrit të ndajnë pjesë të pasurisë që kanë. Është kjo ajo që fetarisht njihet si zekat. Allahu thotë: ***“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!...”*** (Teube: 103); ***“Në pasuritë***

a.s. pasi që kishte urdhëruar të shpërndahej lëmoshë për hir të Allahut, e kishte pyetur Aishen: *“Çfarë ka mbetur prej saj? Asgjë, me përjashtim të një krahu - iu përgjigj Aisheja. Paska mbetur e tëra, me përjashtim të atij krahu - ia ktheu ai.”*⁶⁴ Abdullah in Mes’udi r.a., siç shënon Buhariu në Sahihun e tij, transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë: *“Cili prej jush e ka më të dashur pasurinë e trashëgimtarit të vet se sa pasurinë personale? O i Dërguari i Allahut, nuk ka njeri që të mos e dojë pasurinë e vet më shumë - iu përgjigjën. Atëherë, pasuria e tij është ajo që e jep ndërsa pasuria e trashëgimtarit është pasuria që e lë -tha.”* Tirmidhiu transmeton në Sunen nga Ebu Këbshe el-Ennemariu r.a. se ai ka dëgjuar Pejgamberin r.a. duke thënë: *“Për tri gjëra iu betohem dhe ua them një hadith, andaj mbajeni në mend: Pasuria e rob-it nuk pakësohet nga lëmosha!...”* Hadithi është autentik.; *“Një dërrhem është më i vlefshëm se njëqind mijë dërrhem. Sahabët të habitur thanë: E si është e mundur kjo? Tha: “Një person kishte vetëm dy dërrhemë, e dha sadaka njërin prej tyre, ndërsa një tjetër shkoi te pasuria e tij e shumtë, mori prej saj njëqind mijë dërrhem dhe i dha sadaka.”* Hadithin e shënon Nesai.

⁶⁵ Për më shumë, shih: Ahmed Mustafa Hatir, *El-hidmetu el-ixhtimaijje*, op.cit., f. 47-48.

e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat: 19). Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘...bëjua me dije se Allahu ua ka obliguar dhënien e një pjese të pasurisë, e cila merret nga të pasurit dhe u jepet të varfërve.’⁶⁶

Reshid Rida duke folur për Zekatin dhe rëndësinë e tij në luftimin e varfërisë ka thënë: ‘Islami dallon nga të gjitha fetë me urdhrin për të dhënë Zekatin. Sikur myslimanët ta aplikonin, nuk do të mbetej i varfër në mesin e tyre.’⁶⁷ Zekati i shërben fillimisht luftimit të varfërisë në nivel lokal, e më pas edhe në rrafsh më të gjerë. Imam Gazaliu thotë se nuk bartet zekati nga një vend në tjetrin⁶⁸. Megjithatë, ka edhe forma të tjera me të cilat shprehet solidariteti i detyruar material. Prej këtyre formave do të veçonim dhënien e Sadakatu-l-Fitrit në fund të Ramazanit, therjen e kurbanit për ata që kanë mundësi në Kurban Bajram, shpagimet për gabimet gjatë adhurimeve të caktuara (kefareti), zotimet⁶⁹, etj.

II.3.2. Kategoritë përfituese

Në përgjithësi, solidariteti material i detyruar, ose zekati me theks të veçantë, jepet për kategoritë që Allahu i ka përshkuar në Kuran: ***“Lëmosha (zeqati) është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe***

⁶⁶ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

⁶⁷ AbduRrahim bin Muhammed El-Mugadh-dhevi, *Ed-da’vetu ve siletuha bi-l-hajat*, op.cit., f. 67.

⁶⁸ Shih: Muhammed Xhemaluddin Kasimi, *Tehdhibu meuidhati-l-mu’minine*, (Aleksandri: Dar Ibn Haldun, pa vit botimi), f. 46.

⁶⁹ Për më shumë, shih: Ahmed Mustafa Hatir, *El-hidmetu el-*, op.cit. f. 46-47.

administrimin e tij, për lirim të skllëvërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur në rrugë. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.” (Teube: 60)

Solidariteti material është një e mirë që mbulon të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, pavarësisht fesë që kanë. Në fakt, dije-tarët myslimanë kanë thënë se zekati u jepet vetëm myslimanëve, por janë burime të tjera, si lëmosha vullnetare, ajo me të cilën ndihmohen jomyslimanët.

Nëse do të bënim ndonjë klasifikim të njerëzve që mbulohen nga solidariteti material, vullnetar dhe i detyruar, atëherë një ndarje do të mund të bëhej edhe sipas mënyrave vijuese:

- 1) Kategoritë sipas fesë, ku bëjnë pjesë myslimanët dhe jomyslimanët⁷⁰.
- 2) Kategoritë sipas afërsisë, ku fillohet me ata për të cilët e ke për detyrë të kujdesesh materialisht⁷¹, pra familjen⁷², pastaj farefisin⁷³, fqinjët e më gjerë⁷⁴.

⁷⁰ Më parë kemi shpjeguar për këtë çështje të solidariteti moral.

⁷¹ Pejgamberi a.s. ka thënë: “Fillo me ata që i ke nën përgjegjësi.” Hadithin e shënon Nesai.

⁷² Pejgamberi a.s. ka thënë: “...Më i miri i këtyre dinarëve është dinari që njeriu shpenzon për familjen.” Hadithin e shënojnë Muslimi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh.

⁷³ Pejgamberi a.s. ka thënë: “Sadakaja ndaj të varfrit është njëherë sadaka, ndërsa ndaj të afërmit është dy herë: Është sadaka dhe mbajtje e lidhjeve familjare.” Hadithin e shënon Buhari.

⁷⁴ Për më shumë shih: Ahmed Umer Hashim, *Et-tedamun*, op. cit., f. 11.

- 3) Kategoritë sipas nevojës, të cilat u përshkuan më lart në ajetin 60 të kaptinës Teube. Këtu hyjnë edhe jetimët, gratë e veja, të moshuarit e varfër, etj.
- 4) Kategoritë sipas vendit, e që fillohet së pari me të varfrit lokalë për të vazhduar më pas me të tjerët⁷⁵.

II.3.3. Synimet e solidaritetit material

Solidariteti material në Islam ka synime shumë madhore, prej të cilave do të veçonim:

- 1) Në radhë të parë, si për çdo vepër tjetër, me të synohet arritja e kënaqësisë së Allahut⁷⁶.
- 2) Fitimin e shpërblimit, sepse, duke qenë në shërbim të krijesave, Allahu të shpërblen. Në Kuran Allahu e përshkuan këtë si një formë huaje që robi e jep për Zotin e Zoti ia kthen shumëfish: **“Kush do t’i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t’ia kthejë shpërblimin shumëfish?...”** (Bekare: 245) Natyrisht, huaja është përdorur në kuptimin alegorik, pra, ai që ndihmon robërit e Allahut, ka shpërblimin e Allahut⁷⁷.
- 3) Përmbushjen e detyrimeve karshi familjes, farefisit dhe shoqërisë.

⁷⁵ Po aty, f. 11.

⁷⁶ **“...jepuni diçka nga pasuria juaj, të cilën ju ka dhuruar Allahu...”** [Kur’ani: Nur: 33]; **“Ne po ju ushqejmë për Allahun, nuk duam prej jush shpërblim dhe as falënderim.”** [Kur’ani: Insan: 9]

⁷⁷ Shih: Ebu A’la Mevdudi, *Parimet e Islamizmit*, përktheu: Vehbi Sylejman Gavoçi, (Tiranë: Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi, 2000), f. 160.

- 4) Përfitimim e zemrave dhe dashurisë. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Sadakaja ndaj të varfrit është një herë sadaka, ndërsa ndaj të afërmit është dy herë: Është sadaka dhe mbajtje e lidhjeve familjare.”*⁷⁸
- 5) Luftimin e varfërisë. Ndihma solidare nuk përfshin thjesht zgjidhjen e përkohshme të varfërisë por zgjidhjen afatgjate⁷⁹.
- 6) Luftimin e dukurive që vijnë si pasojë e varfërisë.
- 7) Kultivimin e vlerave dhe virtyeteve⁸⁰. Për pikat 5, 6 dhe 7 lexo këtë argument. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Ka thënë një njeri: Sonte do të kontribuoj me një lëmoshë! Doli me lëmoshën e tij dhe lëshoi në dorën e një hajni. Njerëzit u gdhinë ndërsa flisnin: Natën - mbrëmë i është dhënë lëmoshë një hajni. Tha: O Allahu im! Ty të takon falënderimi për hajnin! Do të jap sonde (prapë) një lëmoshë. Doli me lëmoshën e tij dhe e lëshoi në dorën e një gruaje të pandershme. Të nesërmen njerëzit flisnin se si një gruaje të pandershme mbrëmë i ishte dhënë lëmoshë. Tha: O Allahu im! Ty të takon falënderimi për gruan e pandershme. Sonte (për të tretën herë) do të jap lëmoshë. Doli dhe e lëshoi sadakanë e tij në dorën e një të pasuri. Në mëngjes njerëzit flisnin se si mbrëmë i ishte dhënë sadaka një të pasuri. Tha:*

⁷⁸ Hadithin e shënon Buhariu.

⁷⁹ Për më shumë rreth kësaj shih mendimet e juristëve myslimanë të cituara nga Dr. Kardavi në veprën e tij ‘Fikhu-z-Zekat’ f. 560-570,

⁸⁰ Abdul Aziz bin Muhammed Selman, *Min mehasini-d-dini el-islamij*, (op.cit., f. 11.

O Allahu im! Ty të takon falënderimi për hajnin, gruan e pandershme dhe të pasurin! I erdhi (frymëzimi ose meleku nga ana e Allahut) dhe i tha: Sa i përket lëmoshës tënde ndaj vjedhësit, ndoshta me të e ruan nderin dhe e braktis vjedhjen; sa i përket gruas së pandershme, ndoshta e ruan moralin dhe i largohet amoralitetit; sa i përket të pasurit, ndoshta merr mësim dhe shpenzon nga ajo që i ka dhënë Allahu.⁸¹”

- 8) Investimin në shkencë dhe dije. Dr. Jusuf Kardavi përmend se juristët myslimanë kanë paraparë ndarjen e zekatit edhe për atë që i përkushtohet dijes në ndërkohë që nuk e kanë paraparë këtë për atë që i përkushtohet adhurimit. Kjo për shkak se adhurimi nuk ka nevojë që t'i përkushtohemi tërësisht, e madje edhe po ta bënim është çështje private, në ndërkohë që dija kërkon përkushtim dhe nuk është private. Për këtë shkak, Dr. Kardavi citon Imam Ebu Hanifen, ta ketë lejuar bartjen e zekatit nga një vend në tjetër, përkundër rregullave, nëse fjala është për investimin në studentë dhe kërkues të dijes⁸².

⁸¹. Shih për më shumë: Ebu A'la Mevdudi, *Parimet e Islamizmit*, op.cit, f.160.

⁸² Jusuf Kardavi, *Fikhu-z-Zekat*, (Bejrut: Muessesetu-rr-Rrisale, ed. 2, 1973), f. 560-561; 569-570. Në faqet 856-878 mund të gjeni më shumë rreth objektivave të Zekatit.

II.3.4. Etika e solidaritetit material

Në Islam, duke qenë se me solidariteti synohet fitimi i kënaqësisë së Zotit, atëherë gjërat e tjera kanë pak rëndësi. Po kështu, me ndihma synohet të ruhet morali i të varfërve dhe privatësia e tyre, e jo të zbulohen. Për këtë shkak preferohet shumë që ndihmat të jepen në fshehtësi. Allahu na mëson: ***“T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njëj mirë çdo vepër që ju bëni.”*** (Bekare: 271). Kur përmend robërit e sinqertë, përmend se tipar i tyre është dhënia në fshehtësi: ***“Ne po ju ushqejmë për Allahun, nuk duam prej jush shpërblim dhe as falënderim.”*** (Insan: 9)

Pejgamberi a.s. aq shumë na ka porositur që ta ruajmë këtë detaj saqë ka thënë që kur të japim ‘...të mos dijë e majta se çfarë dha e djathta⁸³.’

Përfundim

Pas prezantimit të solidaritetit shoqëror nga perspektiva e fesë islame, si rezultate kryesore dhe të gjetura të rëndësishme të tij, mund t’i veçojmë:

- 1) Rolin më aktiv të shoqërive tradicionale në raport me globalizimin kulturor, duke mos lejuar shkrirjen në vorbullën e tij.

⁸³ Hadithin e shënon Buhariu.

- 2) Shfrytëzimin e mundësive që ofron globalizimi për të përcjellë vlerat tona te të tjerët, në mënyrë që globalizimi të jetë proces i drejtë në marrëdhënie.

Plasimin e ideve fetare në ambiente të ndryshme, që të dihet se roli i fesë, veçmas në çështje që kanë të bëjnë me lidhjet shoqërore, është i pazëvendësueshëm.

Ejup HAZIRI

DITURIA FORMË E EDUKIMIT, NGRITJES DHE AVANCIMIT

Hyrje

Në këtë punim do ta trajtojmë rëndësinë dhe vlerën që ka dituria, për të cilën Zoti i Madhërishëm zbriti qindra ajete, madje fjalët e para të revelatës hyjnore ishin inkurajim i qartë për rëndësinë e dijes dhe ngritjes së vetëdijes intelektuale. Këto ajete ishin thjesht një revolucion i paparë deri në atë kohë, që vetëdijesuan një shoqëri beduine totalisht të paditur, ngritën ndërgjegjen njerëzore të tyre dhe nga injorantë të shkallmuar u shndërruan në prijatar të dijes që për shekuj të shumtë përhapën dije e kulturë në pjesën më të madhe të globit. I Dërguari i Allahut që shembulli më brilant në kuptimin e dijes dhe nxitjes për të. Ai nga një analfabet që nuk dinte shkrim e lexim, bëri lutje te Zoti që t'ia shtojë dijen. Ai gjatë 23 viteve të fundit rrezatoi dije të mirëfilltë dhe njohuri

të mëdha që me sukses të jashtëzakonshëm i përcolli te shkëlqet e tij. Ai përgatiti një plejadë dijetarësh nëpër fusha të ndryshme që ndriçuan mbarë rruzullin tokësor me dijen dhe njohuritë e tyre.

Rruga e dijes është rruga e ngritjes së ummetit dhe avancimit të tij. Ummeti islam avancoi atëherë kur seriozisht iu qas dijes dhe njohurive. Atëherë kur në rend të parë vendosi dijen ishte prijatarë në çdo gjë. Shembull për këtë kemi një pjesë të periudhës së Abasidëve dhe periudhën kur myslimanët e udhëhiqnin Andaluzinë, ku kjo e fundit që shndërruar në një parajsë të dijes për myslimanët dhe jomyslimanët. Ajo ishte bërë ëndërr për secilin njeri që mund të arrinte atje!

Rëndësia e dijes

Islami i ka dhënë rëndësi të madhe dijes dhe edukimit. Mjafton fakti që në Kuranin Famëlartë dija përmendet në qindra raste. Ka dijetarë që kanë numëruar fenomenin e dijes dhe diturisë të ardhur në Kuran dhe kanë aritur në përfundim se ajo përmendet në treqind e shtatëdhjetë e nëntë ajete kur'anore.¹ Si e tillë ajo përfshin të gjitha format e njohjes, prej së cilave arrihet deri te njohjet e caktuara dhe kuptimi i gjërave të ndryshme. Përmes dijes largohet muri i injorancës, zhduket dyshimi, ngrihet individi, forcohet dhe avancohet

¹ Grup autorësh. *Mevsuatu Nadretu-n Neim fi mekarimi ahlaki-rr rresul el-kerim*. Bot. I-rë, "Daru-l vesileh", 1418h. v.VII, f.2911.

shoqëria.² Dija ndikon që njeriu të pranojë atë që nuk e njihje më parë; të pajiset me gjëra që më parë nuk i dinte.

Për pozitën e dijes mjafton që ajeti i parë i zbritur për njerëzimin ndërlihet direkt me dijen, saqë nxit ummetin për lexim, njohje dhe studim, në mënyrë që t'i kuptojë gjërat dhe të mos mbetet peng i injorancës. Fjalët e para të Kuranit nuk iu drejtuan njeriut që ai t'i kushtojë rëndësi ushqimit apo pijes, e as ndërtimit të banimit, por pikërisht dijes si vlerë e jashtëzakonshme, përmes së cilës njeriu kalon nga një stad në një tjetër më të lartë. Kjo pa dyshim që është një shenjë e qartë se kjo fe e lartëson tej mase vlerën e dijes dhe thërret ithtarët e saj t'i japin rëndësinë e duhur asaj nëpërmes leximit, shkrimit, vërtimit dhe studimit.³ Vetëm kështu ata mund të dallohen nga të tjerët dhe të avancojnë. Përndryshe vështirë të dallohen nga injorantët që pandehin lartësimin dhe njohjen, ndonëse në realitet nuk njohin asgjë, madje as veten e tyre!

Nuk është e rastësishme përse shpallja hyjnore rrugëtimin e saj e filloi me fjalët e dijes dhe njohjes, ngase njohja është parahyrje në qytetërim dhe civilizim, bazament i ngritjes dhe qëllim i lartë edukativ.⁴

² Jusuf El-Kardawî. *El-aklu ve-l Ilmu fi-l Kur'ani-l kerim*. Bot. I-rë, Mektebetu-l-Vehbeh, Kairo, 1416. F. 149.

³ AbdulKerim Bekkar. *El-Muslimune bejne-t tehadidi ve-l muvaxhehe havle-l terbijeti ve-t talimi*. Bot.I-rë. Daru-l kalem. Damask. 2011m. f.131.

⁴ Mina Ali es-Salus. *El-Hukuk et-talimijeh lil mer'eti fi-l islam min vakii-l Kur'ani ve-suneti*. Bot.I-rë. Daru-neshr. Kairo. 2002. F.68; Kutb Mustafa Sanu. *En-Nudhum et-ta'limijeh el-vafideh fi Efrikija*. Kitabu-l Ummeh. Bot.I-rë. Vizaretu-l Evkaf. Katar. 1419. Nr. 63. F.16.

Në vende të caktuara të shpalljes hyjnore, kur flitet për vlerën e dijes, e lartëson atë tej mase, duke i trajtuar dijetarët si njohësit më të mirë dhe të vetmit që realisht ia kanë frikën Zotit, gjegjësisht si njohësit më të mirë të Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ.

“...Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës.”

(Fatir: 28).

Jo vetëm kaq, por dijetarëve iu shtua pozita e tyre te Allahu deri në atë masë saqë i Madhërishmi e krahasoi përmendjen e dijetarëve në një vijë me emrin e Tij të Madhëruar dhe me engjëjt e Tij në kontekstin e njohjes:

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَانِمًا
بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ.

“Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dhe engjëjt dhe ata që kanë dijeni, se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqiplotit, të Urtit.”

(Ali Imran: 18).

Në këtë kontekst, i Dërguari i Allahut kishte treguar për vlerën e madhe që bart një dijetar i mirëfilltë, kur ai kishte pohuar se vlera e një dijetari ndaj një adhuruesi është sikurse vlera ime ndaj njerëzve të tjerë. Askush nuk mund të krahasohet me të Dërguarin e Allahut, në asnjë prej segmenteve, përveç njerëzores. Kështu është edhe me dijetarin, ku asnjë adhurues, sado i njohur të jetë në adhurimin e tij, nuk mund të krahasohet me një dijetar të mirëfilltë. Madje, i Dërguari i

Allahut kishte skicuar në detaje dallimin mes dijetarit dhe adhuruesit, duke sjellë një krahasim të çuditshëm, se si djalli i mallkuar shkon te një adhurues i madh, por që nuk kishte dije. Atë e pyet: “A mundet Zoti ta krijojën botën në formë e madhësi të vesë?” Adhuruesi duke menduar se kjo gjë nuk i përket Zotit, ia ktheu: “Jo, nuk është e mundur!” Djalli rru-gën e tij e vazhdoi te një dijetar që nuk shquhej shumë për adhurim, atij ia bëri të njëjtën pyetje, por përgjigjja e tij ishte krejtësisht e kundërt me përgjigjen e adhuruesit. Ai tha: “Për Zotin, çdo gjë është e mundur.” Djalli këtë rrugëtim e kishte bërë si mësim për djajtë e tjerë, në mënyrë që t’ua shpjegojë atyre se ndaj cilit grup duhet shtuar mundin dhe aktivitetin. Nga ana fetare, i pari nëse i thotë ato fjalë me qëllim del nga Islami, mirëpo adhuruesi as që ia kishte idenë se kishte gabuar. Ai thjesht kishte menduar se një gjë e tillë është e pamundur duke u nisur nga veja, e jo nga fuqia dhe vullneti i Zotit. Ndërsa dijetari ishte nisur nga fuqia dhe vullneti i Zotit dhe se kur diçka do Zoti, urdhri i Tij është vetëm një fjalë “bëhu” dhe gjithçka bëhet!

Dija i ngre dhe i lartëson njerëzit, ata falë dijes së mirë-filltë meritojnë një vend të lartësuar te Allahu i Madhëruar. Për çastet e tyre që i kaluan në kërkimin e dijes dhe në shpërndarjen e saj, mund ta fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe xhennetin e tij:

يَرْفَعُ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ وَاللَّهُ
بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ.

“...Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.

Allahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (*Muxhadele: 11*).

Allahu i Madhëruar në një ajet në Kuran shtron një pyetje retorike interesante, kur thotë se a janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë.

أَمَّنْ هُوَ قَانِتٌ آنَاءَ اللَّيْلِ سَاجِدًا وَقَائِمًا يَحْذَرُ الْآخِرَةَ وَيَرْجُو رَحْمَةَ رَبِّهِ ۖ قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْلَمُونَ وَالَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ۗ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٩﴾

“(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimet të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (*Zumer: 9*)

Parashtrimi i pyetjes brenda këtij konteksti është shumë interesant, për faktin se përgjigjja e saj është e njohur nga të gjithë. Të gjithë e dinë se mes atyre që dinë dhe atyre që nuk dinë ka dallim dhe dallimi është i madh. Por, Allahu pasi që parashtron pyetjen, vjen me një përgjigje interesante, kur thotë: “Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” Ngre njerëzit e dijes dhe u jep epitetin atyre se ata janë të zotët e mendjes dhe ata marrin mësim falë përgatitjes së tyre dhe diturisë që posedojnë.

I Dërguari i Allahut mësues i njerëzimit

Mësuesi më i madh që njohu njerëzimi është i Dërguari i fundit, Muhamedi a.s., i cili nuk e kishte lutur Zotin që t'i shtonte diç tjetër ashtu siç e kishte lutur Zotin që t'ia shtojë dijen e tij, ashtu siç Allahu i Madhëruar e përmendi këtë fakt në librin e Tij:

وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

“...dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!” (Taha: 114).

Nuk ka si të mos kërkonte një gjë të tillë i Dërguari i Allahut, kur atij i ishin zbritur vargje rreth penës e dijes, madje vet Allahu i Madhëruar ishte betuar në lapsin që nënkupton dijen:⁵

ن وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ

“Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!”

(Kalem: 1).

Ndonëse i Dërguari i Allahut nuk kishte patur fatin të mësonte para se t'i vinte shpallja hyjnore, mirëpo pas shpalljes ai ishte njëri prej atyre që më së tepërmi thërriste për dije e njohuri. Madje, ai aplikoi në praktikë këtë që po e themi në raste të caktuara siç bie fjala pas luftës së Bedrit, kur një pjesë e kundërshtarëve të tij ishin zënë robër dhe pas luftës kishte mendime të ndryshme se si të veprohej me ta. I Dërguari i Allahut ndoqi një metodë efikase që nuk do ta ndiqte askush pos tij. Ai u dakordua që nëse një i zënë rob di shkrim

⁵ Halil el-Hudari. *Menhexhijetu-t tefkir el-ilmij fi-l Kur'ani-l kerim ve tatbika-tuha et-terbevi-jeh*. F.76.

e lexim, duhet t'i mësojë dhjetë myslimanë dhe me këtë ai ta fitojë lirinë. Ky mendim nuk përkonte me atë kohë. Ishte një risi që asnjëherë nuk qe praktikuar. Thjesht ishte mendim që përkonte me qytetërim dhe civilizim, e që askush para tij nuk e kishte praktikuar. Ky është indikacion i qartë se i Dërguari i Allahut e donte dijen, e luftonte injorancën në çdo formë. E donte paqen dhe e urrente luftën. Ai tërë kohën ia kushtoi arsimimit, ngritjes dhe avancimit. Në çdo vend e në çdo çast i mësonte shokët e tij me butësi, urtësi dhe përmes këshillave të vyeshme.

Ndonëse armiqtë dhe kundërshtarët e Islamit janë munduar që Pejgamberin a.s. ta paraqesin si një njeri të dhunshëm, destruktiv, prishës i paqes dhe njeri që kishte luftuar apo dhënë urdhra. Mirëpo, realiteti është krejtësisht ndryshe, nga se ai pjesën më të madhe ia kushtoi dijes dhe avancimit të shoqërisë, ndërsa luftërat janë një pjesë e vogël, për të cilat ai nuk bëri përpjekje, por qe i detyruar. Edhe nëse flasim për luftëra, ato ndonëse ka disa beteja, por ato zgjatën shumë pak dhe se numri i të vrarëve nga të dyja palët mbase është dukshëm i vogël.

Numri i dëshmorëve myslimanë gjatë kohës së Pejgamberit a.s. nga të gjitha betejat gjatë periudhës dhjetë (10) vjeçare, ishte përafërsisht 262, gjersa numri i të vrarëve nga armiqtë e tij ishte përafërsisht 1022. E, në total numri i përgjithshëm nga të vrarët e të dyja grupeve është vetëm 1284 persona.

Për të mos menduar dikush se numri i ushtarëve pjesëmarrës në ato beteja ka qenë shumë i vogël, janë bërë hulumtime dhe statistikat e nxjerra të mahnitin.

-Numri i dëshmorëve myslimanë arrin shifrën vetëm 1% nga pjesëmarrësit në luftë, përderisa numri i të vrarëve nga radhët kundërshtarë arrin shifrën vetëm 2%. Shifra mesatare nëse mbledhen këto dyja, del të jetë vetëm 1.5%.

Ky numër i të vrarëve është shumë i vogël, përderisa fjala është për 25 apo 27 luftëra (gazveh), 38 ekspedita dhe 63 beteja (mearekeh). E kjo padyshim që është argumenti më i vërtetë se luftërat gjatë kohës së Pejgamberit a.s. nuk kanë qenë gjakatare.

E, për të qenë ky fragment më i qartë, unë po sjell statistikat e të vrarëve të luftës së dytë botërore, vetëm si një rast të luftërave (të civilizimeve) bashkëkohore, e nga këto statistika del se numri i të vrarëve është 351% në raport me numrin e atyre që kanë marrë pjesë në luftëra. Shifrat nuk gënjejnë, ngase në luftën e dytë botërore morën pjesë 15.600.000 ushtarë, e megjithëkëtë numri i të vrarëve arriti në 54.800.000.

Për kërkuesin e dijes lutet çdo gjë

Nëse flasim për kohën ditore të të Dërguarit të Allahut, atëherë shumicën e saj e gjejmë se i Dërguari i Allahut qëndronte me shokët e tij, i mësonte, i këshillonte dhe i edukonte ata në forma dhe mënyra të ndryshme. Vetë thëniet e tij që janë me mijëra apo me qindra mijëra, janë indikacione të qarta se ai kishte synim paqen dhe në çdo formë e luftonte injorancën. Ai një rast e qortoi shokun e tij duke i thënë se ke veprime të kohës së injorancës, vetëm pse ai bëri një veprim. Në disa tekste të tij theksohej se veprimet e kohës së injorancës i kishte varrosur, që nënkuptonte se askush nuk ka të drejtë t'i rikthej ato. Ai kohën e injorancës dhe paditurisë e

ktheu në kohë të dijes dhe ngritjes. Ai një popull të tërë të paditur, e ktheu në një popull që përhapën dije të mirëfilltë. Thuajse në çdo çast këshillonte të tjerët që t'i rreken dijes dhe të mos mbesin të paditur. Dikush në mesin e tij një herë i përmendi dy njerëz, njëri prej tyre adhures e tjetri dijetar e ai tha:

فَضَّلَ الْعَالِمَ عَلَى الْعَابِدِ كَفَضْلِي عَلَى أَدْنَاكُمْ. ثُمَّ قَالَ رَسُولُ
اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ وَأَهْلَ السَّمَوَاتِ
وَالْأَرْضِينَ حَتَّى الثَّمَلَةِ فِي جُحْرِهَا وَحَتَّى الْحَوْتَ لَيُصَلُّونَ عَلَى
مُعَلِّمِ النَّاسِ الْخَيْرِ.»

“Vlera e dijetarit ndaj adhuresit është sikurse vlera ime ndaj jush, e më pas tha: “Me të vërtetë Allahu, engjëjt e Tij, banorët e qiejve dhe tokave, madje edhe milingonat në vrimat e tyre si dhe peshku, luten mirë për mësuesin e njerëzve.”⁶

Shumica e njerëzve të asaj kohe nuk dinin shkrim e lexim, prandaj i Dërguari i Allahut shfrytëzonte rastin dhe i nxiste të tjerët në nxënien e njohurive dhe në avancimin e tyre. Ai u tregonte atyre se për atë që kërkon dije lutet çdo gjë, ashtu siç përmendet në hadithin që e transmeton Ebu Derdaja, i cili thotë:

إِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ سَلَكَ
طَرِيقًا يَلْتَمِسُ فِيهِ عِلْمًا، سَهَّلَ اللَّهُ لَهُ طَرِيقًا إِلَى الْجَنَّةِ، وَإِنْ

⁶ Transmeton Tirmidhiu në Sunen. V.IV, f.347. numri i hadithit 2685 dhe thotë se hadithi është autentik.

الْمَلَائِكَةُ لَتَصْنَعَنَّ أَجْحِدَهَا رِضًا لِطَالِبِ الْعِلْمِ، وَإِنَّ طَالِبَ الْعِلْمِ
يَسْتَغْفِرُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ، حَتَّى الْحَيَاتَانِ فِي الْمَاءِ، وَإِنَّ
فَضْلَ الْعَالِمِ عَلَى الْعَابِدِ كَفَضْلِ الْقَمَرِ عَلَى سَائِرِ الْكَوَاكِبِ، إِنَّ
الْعُلَمَاءَ وَرَثَةُ الْأَنْبِيَاءِ، إِنَّ الْأَنْبِيَاءَ لَمْ يُورَثُوا دِينَارًا وَلَا دِرْهَمًا، إِنَّمَا وَرَثُوا
الْعِلْمَ، فَمَنْ أَخَذَهُ أَخَذَ بِحِظٍّ وَافِرٍ»

Thotë Ebu Derdaja: “E dëgjova të Dërguarin e Allahut alejhi selam duke thënë: “*Ai që ndjek një rrugë për kërkim dije, Allahu do t'ia lehtësojë atij rrugën për xhenet. Pa dyshim se engjëjt i vendosin krahët e tyre si shenjë kënaqësie ndaj kërkuesit të dijes, e për kërkuesin e dijes kërkon falje çdo krijesë në qiell e në tokë, gjersa edhe peshku në ujë. Vlera e dijetarit ndaj adhuresit është sikurse vlera e hënës ndaj planeve të tjera. Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, e pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinar e as dërrhem, por ata lënë trashëgim dijen. E ai që e merr atë, ka marrë një hisë të çmuar.*”⁷

Kjo është vlera e dijes në Islam, ku që nga banorët e qielit e deri te ata të tokës, duke përfshirë të gjitha krijesat, luten dhe kërkojnë falje për kërkuesin e dijes. Rruga e dijes kërkon mund, angazhim dhe sakrificë. Asgjë nuk arrihet pa mund, prandaj edhe në hadith është përmendur rruga e dijes, që nënkupton se nëse dëshiron ta ndryshosh veten, duhet të

⁷ Ibn Maxheh në Sunen. V.I, f.81. numri i hadithit: 223. Hadithi është autentik.

lëvizësh nga vendi yt. Duhet të largohesh nga shtëpia jote, sepse rruga e dijes nënkupton lëvizjen, angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme. Në këtë kontekst kur dikush e ftoi imam Malikun ta mësojë djalin e një princi në shtëpinë e tij, ai tha fjalën e tij të mirënjohur: *“Ti duhet të shkosh te dituria se ajo nuk vjen vetë te ti!”* Ai thjesht deshi t’ia jap një mësim princit se nëse dëshiron që djali të thellohet në dituri, atëherë ai duhet të bëjë përpjekje për dituri. Në të kundërtën, askush s’mund t’ia sjellë diturinë brenda mureve të pallatit. Ngjashëm kishte vepruar edhe imam Buhariu, kur guvernatori i Buharasë i kishte kërkuar atij të vinte t’ia mësonte fëmijën e tij, Buhariu iu përgjigj se nëse ka interesim mund t’i ndjekë mësimet, por jo unë të vij ashtu. Madje, kjo përgjigje e Buhariut e kishte hidhëruar tej mase guvernatorin e Buharasë.

E personalisht Buhariu nuk kishte qëndruar në shtëpi që të priste se kush do ta mësonte atë, por ai shëtititi pjesën më të madhe të vendeve në kërkim të dijes. Madje disa prej atyre vendeve ai i vizitoi me dhjetëra herë, jo për turizëm, por duke ndjekur gjurmët e fjalëve dhe veprave të Pejgamberit a.s.

Buhariu kur flet për vendet që i vizitoi në kërkim të dijes, vetëm për Kufën si njërën ndër qendrat kryesore të dijes, thotë: *“Nuk mund ta llogaris sa herë kam vajtur në Kufë në kërkim të hadithit”*.⁸

Buhariu nga vendlindja e tij kaloi në Hixhaz e Sham me dhjetëra herë. Madje, raportohet se ai mori një rrugë të gjatë

⁸ Muhamed Zahid Kevtherij, *Fikhu Ehlul Iraki ve Hadithuhum*, me recenzurë të AbdulFetah Ebu Gude, el-Mektebetu Ezherijetu lit-turath, Kairo-Egjypt, pa vit botimi, f.52.

e shumë të mundimshme vetëm pse kishte dëgjuar se filan personi e dinte një hadith që ky nuk e dinte. Ai ishte shembulli i një dijetari të mirëfilltë se si duhet kultivuar dija, që nga marrja e njohurive e deri te shpërndarja e tyre. Ndonëse bonjak e me kushte të vështira ekonomike, kurrë nuk u ndal nga kërkimi i diturisë. Ai bëri një punë të madhe saqë u bë model për të tjerët. Nuk u njoh me vizitat e tij, por me dijen e tij të madhe dhe me angazhimin e tij jashtëzakonisht të madh që i shërbeu kauzës së *ymmetit*!

Dija lartëson njerëzit

Sa njerëz të padijshëm e injorantë, falë rrugës së dijes dhe dituritë që morën u shndërruar në yje që shndritën mbarë globin. Ata ishin krejtësisht të panjohur gjersa nuk kishin dije, e kur u pajisën me dije, ata i njohu e tërë bota.

Mjeshtri i madh i penës Ibn Sejidi ishte i panjohur. Atë askush nuk e njihte. E kur u pajis me dije, atë e njohën të gjithë. Ai shkroi një libër në fushën e gjuhës (*Muhassas*), libër voluminoz në nëntëmbëdhjetë vëllime, saqë njeriu mezi e lexon atë gjatë tërë jetës së tij. Por, si e ka shkruar ai tërë atë libër? Po ta dije se Ibn Sejidi ka qenë i verbër dhe ai diktoi tërësisht nga mendja e tij, pa iu referuar asnjë libri, imagjinoje çfarë kapaciteti ka qenë! Mendoni se ky mjeshtër i madh nuk kishte vuajtje?! Gaboheni, ngase ai si i verbër që ishte natyrisht se kishte edhe vuajtje, por megjithatë, ai nuk mbeti në vuajtje, vuajtjen e shndërroi në lumturi, sepse kënaqej kur ai diktonte për librin në fjalë. Ai u bë inspirim për njerëzimin, se edhe në vuajtje mund t'i shërbesht njerëzimit.

Ai nuk u njoh për nga vuajtja e tij, por nga ajo që i ofroi njerëzimit e që janë veprat e tij të shkruara.

Po Serahsiun kush e njihte para se të merrej me shkrimet e tij të jashtëzakonshme? Ai u bë i njohur kryesisht falë librit të mirënjohur *“Mebsut”*, libër voluminoz që hyri në analet e jurisprudencës islame, saqë ata që i referohen kësaj lëmie të shkollës hanefite, e kanë si referencë librin e tillë. Sikurse Serahsiu janë me mijëra e mijëra dijetarë që u bënë të njohur kryesisht falë angazhimit të tyre në dituri. Ata nuk njiheshin nga askush, por ishte dija e tyre që i bëri që t'i njohë e tërë bota. Vepra e tyre kolosale mbeti gjurma e tyre më e madhe pas vdekjes së tyre, me të cilën ata gjithnjë përmenden e kujtohen. Ata vdiqën, por pas vetes lanë një veprimtari të madhe saqë ata gjithnjë kujtohen me respekt e admirim nga njerëzimi. E, në këtë kontekst i Dërguari i Allahut me një rast kishte thënë:

إذا مات الإنسان، انقطع عمله إلا من ثلاث، صدقة جارية أو

علم ينتفع به، أو ولد صالح يدعو له

“Kur vdes njeriu, punët e tij ndërpriten me përjashtim të tri prej tyre: Lëmosha e vazhdueshme, dija që përfitohet prej saj dhe një fëmijë i mirë që lutet për të.”

Ky është thesari i pashtershëm prej të cilit vlера nuk shkëputet e as që pakësohet as me vdekjen e individit. Ai vdes, por vepra e tij e lënë e bënë në një farë forme të padekshëm. Shpërblimi i tij vazhdon t'i shkojë atij ndonëse ai e ka lënë këtë jetë. Kjo është dija dhe vlера e saj e jashtëzakonshme që i shërben individit edhe pas vdekjes së tij.

Sa e sa njerëz ishin të panjohur, por dija i shndërroi në mbretër të dijes. Po kush do ta njihnte Abdullah Ibn Mes'udin, kur ruante bagëtinë e që në takimin e parë me të Dërguarin e Allahut dhe Ebu Bekrin përderisa ai po ruante bagëtinë, i Dërguari i Allahut i tha: “Ti je një fëmijë i mençur.” Ky njëherit ishte fillimi i rrugëtimit të tij në Islam. Nuk vonoi shumë dhe ai u bë mysliman, ku nga një bari i thjeshtë do të shndërrohej në shërbëtor të denjë ndaj të Dërguarit të Allahut. Abdullah ibn Mes'udi ishte prej njerëzve të parë që pranoi Islamin. Ai ishte shprehur se jam i gjashti në renditje nga ata që pranuan Islamin, në kohën kur mbi shtresën e tokës nuk kishte myslimanë përveç nesh.⁹

E shoqëroi të Dërguarin e Allahut ashtu siç hija e shoqëron bartësin e saj, ku nuk u nda prej tij as në vend e as jashtë vendit, në shtëpi e as jashtë shtëpisë. Ai në çdo moment mësonte prej tij dhe gjithnjë shfrytëzonte ndjenjat me të. E zgjonte të Dërguarin kur ai flinte, e kur nisej ia mbathte të mbathurat, e kur vinte ia hiqte ato. Shkopin dhe misvakun e të Dërguarit i bartte ky njeri.¹⁰ Hynte në shtëpi të Pejgamberit kur të dëshironte, sikur të ishte shtëpia e tij. I dinte sekretet dhe fshehtësitë e të Dërguarit, madje edhe njëhej si shoqëruesi i fshehtësive të Pejgamberit. Ebu Musa Esh'ariu kishte thënë: “Së bashku me tim vëlla erdhëm nga Jemeni, e Abdullah ibn Mes'udin dhe nënën e tij nuk i llogarisnim ndryshe

⁹ Dhehebiu, *Sijer A'lamun Nubela*, bot.III-të, Muessesetu Rrisaletu, 1985, v. I, f. 464.

¹⁰ Dhehebiu, *Te'rihu-l Islam*, bot. I-rë, 1990, dar el-kutub el-arebij, Bejrut-Liban, v. III, f. 382.

përveç prej familjes së Pejgamberit a.s., për shkak të hyrjes dhe daljes së shpeshtë të tyre te ai.”¹¹ Ndërsa sipas një transmetimi tjetër ai kishte thënë: “Qëndrova kohë të gjatë e Abdullah ibën Mesudin së bashku me nënën e tij nuk konsideroja ndryshe përpos prej familjes së Pejgamberit a.s., për shkak të hyrjes dhe daljes së shpeshtë nga familja e Pejgamberit a.s.”¹² I përmenda gjitha këto gjëra për të treguar se rruga e dijes nuk është e lehtë, përkundrazi ajo do mund, sakrificë e angazhim të madh.

Ibn Mes'udi u edukua në shtëpinë e Pejgamberit a.s., u udhëzua sipas udhëzimit profetik, ndoqi dhe pasoi të gjitha veprimet dhe virtytet e të Dërguarit gjersa për të u tha: “Njeriu më i afërt me Pejgamberin për nga udhëzimi dhe vlerat morale.” Ai u edukua në shkollën profetike, ndaj ishte njëri nga njohësit më të mëdhenj të Kuranit, më i dituri për kuptimet e tij dhe më i njohuri për ligjin e Zotit.¹³ Ishte recitues i njohur i Kuranit, saqë i Dërguari i Allahut dëgjoji Kuran prej tij, gjë që ishte e pazakontë të dëgjonte Kuran nga të tjerët, madje përderisa dëgjonte Kuran prej tij, lotët e kishin përshkuar fytyrën e tij. I Dërguari i Allahut për të qe shprehur: “Ai që dëshiron të lexojë Kur'an ashtu siç është zbritur le të lexojë sikur që është leximi i Abdullah ibn Mes'udit.”¹⁴ Për

¹¹ Buhariu në Sahih, nr. 2460, 3763 dhe 4384.

¹² Buhariu në Fedail, nr.3763.

¹³ Abdurrahman Rafet el-Basha, *Suver min Hajati-s Sahabeh*, bot.I-rë, Dar el-edebul Islami, 1997, f.101-102.

¹⁴ Taberaniu në Mu'xhemul Kebir, nr. 8338; Ibn Huzejme në Sahih, nr. 1156; Tahaviu në Mushkilul Athar, nr. 5593.

dituritë e tij rreth Kur'anit, protagonistin në fjalë që shprehur: “Pasha Allahun përveç të Cilit s'ka Zot tjetër, nuk ka zbritur ndonjë ajet nga libri i Allahut e që unë mos ta di ku ka zbritur dhe për çfarë ka zbritur, e sikur ta dija se ndokush është më i ditur se unë rreth librit të Zotit, po të jetë e mundur të arrija te ai, do të shkoja.”

Islami bëri revolucion

Ai që lexon historinë dhe e kupton atë, bindet se koha para se të zbriste Kur'ani dhe para Muhamedit a.s. ishte kohë e errët, kohë e injorantëve e assesit e dijes. Islami që në momentin e parë të zbritjes së shpalljes proklamoi dije, urtësi e shkencë. Ai sqaroi se urtësia është një gjë e humbur për besimtarin, e kudo që ta gjejë besimtari atë, duhet ta marrë. Fjala e parë e kësaj shpallje ishte “Lexo! (studjo, hulumto, merru me shkencë”.

Kjo shpallje nuk parapriu me fjalët “adhuro”, e as me fjalët “falu”, apo me fjalë tjera të kësaj natyre, mirëpo i parapriu me fjalën “lexo!” Fjalë që thërriste atë komunitet në lexim, ndonëse ata nuk kishin lidhje me lexim, mirëpo kjo ishte një pëlqim dhe vendosmëri se ky *ummet* që është i ngarkuar me udhëzim, edukim dhe mësim, nuk do të jetë vetëm një *ummet* i lidhur me mësim, përkundrazi do të jetë mësim (ndriçim) për botën përmes përhapjes së mësimin, ngritjes së edukimit dhe lartësimit të tij¹⁵.

¹⁵ Nedevi, Ebu-l Hasen, *Muhaderatun Islamijetun fi-l fikri ve-d Da'veti*, bot. I-rë. Dar ibën Kethir, Damask-Siri, 2001, v.I, f.572-573.

Shpallja hyjnore që i zbriti të Dërguarit të paarsimuar, i erdhi në mënyrë që ta forconte lidhjen me Krijuesin e tij. Erdhi shpallja dhe emrin “dije” e përmendi bashkë me emrin e Zotit, në mënyrë që ta mësonte njerëzimin se pikënisja dhe fillimi i dijes, mësimit dhe leximit të bëhet në emër të Zotit...ky ajet (ajeti i dijes) për të cilin po flasim, është ajeti i një revolucionit të madh në meditim, mendje dhe shpirt...

Këtu duhet të kemi kujdes, sepse kjo shpallje hyjnore e vërtetoi se natyra e kësaj feje nuk do ta braktis asnjëherë dijen, ngase shkëndijat e para të kësaj shpallje po i drejtohen njerëzimit duke i urdhëruar për lexim, prandaj si mund të justifikohet e të mbeten myslimanët injorantë që nuk dinë lexim.

A ka dikush që lartësoi më tepër vlerën e penës në tërë historinë njerëzore se sa kjo shpallje? Kjo shpallje e përmend vlerën e saj, madje që në parahyrje të revelatës hyjnore, pikërisht në mëvetsimin që i Dërguari e bënte në shpellën Hira, në zbritjen e parë të saj nga qielli, e përmend penën që ndoshta edhe nuk mund ta gjeshe edhe një penë të vetme nëpër shtëpitë e Mekës, apo ndoshta do ta gjenit atë në shtëpinë e Vereka ibën Nufel-it, apo të ndonjë njeriu tjetër që leximin e kishte mësuar në ndonjë vend tjetër, apo ndoshta penën nuk mund ta gjeni as si përmendje në divanet e poetëve arabë të kohës së injorancës, sado që i shfletoni fletat dhe sado që lexoni.¹⁶

¹⁶ Nedevi. *Muhaderatun Islamiyetun fi-l fikri ve-d Da'veti*. v.1, f.573-574.

Nga ummeti i leximit në ummet të braktisjes së leximit

Njëra prej veçorive të ummeti mysliman është edhe ajo se ky *ummet* është *ummeti* i leximit (ikres), ngase Xhibrili në kontaktin e tij të parë me të Dërguarin Muhamed shpalli ajetin e leximit, që nënkupton se ky *ummet* është *ummeti* i leximit, andaj në asnjë rrethanë nuk duhet ta braktisë leximin. Pra, i Madhërishmi që në rrugëtimin e parë të shpalljes, nga mesi i mijëra tematikave që flet Kurani, zgjodhi pikërisht dijen, për t'i treguar njerëzimit pikënisjen e reformimit të tij dhe rrugën që duhet të ndjekë.

Ummeti që nuk lexon, vdes. Leximi është çelësi i avancimit dhe dritarja e përfitimit të njohurive të reja. Pa të *ummeti* nuk mund të avancojë. Përderisa myslimanët lexonin dhe merreshin me dituri, sundonin botën. Në momentin që iu larguan leximit ata mbetën të sunduar nga të tjerët!

Sot, bota islame është shndërruar në *ummet* të analfabetizmit dhe paditurisë. Një pjesë e madhe e shoqërisë islame nuk dinë fare shkrim-lexim. Në statistikën rreth leximit, bota arabe renditet e fundit, krahas asaj afrikane. Statistikat e botës arabe janë me të vërtetë të tmerrshme dhe kjo tregon më së miri për gjendjen e tyre. Hapja e shkollave nënkupton zhdukjen e injorancës dhe leximi nënkupton hapjen e një dritareje të re të panjohur gjër atëherë dhe pasuron mendjen me informata të rëndësishme.

Rruga e kthimit të krenarisë së dikurshme është pasimi i rrugës së gjeneratave të hershme, të cilat gjenerata i dhanë rëndësi të madhe dijes, saqë edhe armiqtë e Islamit ia kishin lakmi. Mirëpo, gjeneratat e mëvonshme lëshuan atë rrugë, iu

shmangën leximit e njohjes dhe në vend se ta avanconin *ixh-tihadin* (mendimin personal dhe kolektiv), u mjaftuan me *ta-klidin* (pasimin e të tjerëve) dhe kështu i mbyllën dyert para problematikave të kohës. Thjesht u mjaftuan me ato që i gjetën, e nuk u munduan për alternativa të reja. Madje edhe ata pak dijetarë që u munduan ta ngjallnin *ixhtihadin*, u baltosën, sepse në pyetje ishte një kauzë tjetër dhe dikush nuk dëshironte që ky *ummet* të avanconte e të shkonte përpara. Në vend të *ixhtihadit* të mirëfilltë të dijetarëve u ngritën disa individë që u njohën brenda nate përmes shtypjes së butonit me një mini-ligjërata emocionuese të shoqëruar me një “muzikë vajtuese” dhe ata që s’i njihte askush, brenda nate u bënë dijetarët të njohur dhe fituan simpatinë e popullit.

Zhvillimi i shtetit përmes ngritjes së dijes

Mësimi i Kuranit dhe ruajtja me fanatizëm e traditave profetike zgjoi një frymë konkurruese të dijes, ku njerëz nga profile të ndryshme iu qasën dijes në tërësi. Kjo gjë hapi rrugën për krijimin dhe hapjen e bibliotekave më të hershme në botën islame. Në fillim qenë xhamitë vatra të dijes dhe arsimimit. Dijetarët arrinin majat më të larta në dije e kulturë falë mësimave që i ndiqnin nëpër tubimet e njohura nëpër xhami. Pas vdekjes së Profetit a.s. myslimanët përhapën më të madhe mësimet e Kuranit dhe traditën e tij që përbëhej kryesisht nga fjalët dhe veprat e tij.

Nën sundimin e dinastisë së hershme, Abasidëve, myslimanët i dhanë rëndësi të madhe dijes. Ata krijuan një qytetërim që solli ndryshime të mëdha në historinë njerëzore. Ata u

nisën nga motoja: *“Ngjyra e dijetarit është e barabartë me gjakun e dëshmorit”* dhe krijuan një ambient të dijes e kulturës, të panjohur gjer atëherë. Hapën biblioteka të shumta, përkthyen dituritë e popujve të tjerë dhe përhapën mësimet islame në të gjitha anët e botës. Gjatë kësaj periudhe, bota myslimane u bë qendra intelektuale e pakrahasueshme për shkencën në përgjithësi, ndërsa për filozofinë, mjekësinë dhe teologjinë në veçanti. Aty u krijuan akademi *“Daru-l-hik-meh”*, e cili u nda në dy seksione, njëra ishte e lidhur me punën e përkthimit dhe tjetra në lidhje me mbledhjen e librave dhe strehimin e një biblioteke të madhe. Bagdadi u bë qendra kryesore e dijes për të gjithë, jo vetëm për myslimanët. Sytë e globit në atë kohë ishin drejtuar kah Bagdadi. Gjatë kohës së Harun Reshidit, iu bë ftesë të gjithë dijetarëve e ulemave, nga treva të ndryshme, që të punojnë edhe më tepër dhe punimet t’i sillnin në *“Akademi”*, e nga aty do të merrnin shpërblime jashtëzakonisht të mëdha.

Përveç bibliotekës së Akademisë, në Bagdad kishte edhe biblioteka të tjera në kuadër të shkollave fetare (që njiheshin si El-Medaris); e që posedonin mijëra libra dhe dorëshkrime. Kishte edhe biblioteka individuale private, të cilat nuk ishin të hapura për publikun e gjerë, por ishin në dispozicion të shkencëtarëve, filozofëve, studiuesve dhe shkrimtarëve. Në të njëjtin model, në qytetet e krahinave lindore të botës islame, disa *“Shtëpi të Dijes”* (Darul-Ilm) u krijuan në shekujt e IX dhe X për të imituar atë të Bagdadit. Qytetet e tilla përfshijnë Mosulin, Basrën, Shirazin, Rayyn etj. Kishte biblioteka të ngjashme në Kajro, Halep dhe qytetet kryesore të Iranit dhe Azisë Qendrore. Vetëm Spanja kishte shtatëdhjetë bibli-

oteka publike. Për shkrimin në bibliotekat spanjolle mysli-mane Scott (1904) do të shkruante: “As bibliotekat nuk duhet të hiqen nga kjo listë e atyre faktorëve të progresit, të cilat në mënyrë sinjifikative kontribuan në ndriçimin publik dhe në formimin e karakterit kombëtar. Nuk kishte asnjë qytet të rëndësishëm pa të paktën një nga këto shtëpi thesari të letërsisë. Raftet e tyre ishin të hapura për çdo aplikant. Katalogët lehtësuan ekzaminimin e koleksioneve dhe klasifikimin e lëndëve të ndryshme. Shumë nga vëllimet u pasuruan me ndriçime me bukuri të mrekullueshme; më të çmuar ishin të lidhur në lëkura dhe pyjeve aromatik; disa ishin të mbështjella me ar dhe argjend. Këtu do të gjendeshin të gjitha mësimet e së kaluarës dhe të gjitha zbulimet e kohës së tanishme, filozofia e Athinës, astronomia e Babilonisë, shkenca e Aleksandrisë, rezultatet e vëzhgimit dhe eksperimentit të zgjatur në kullat dhe në laboratorët e Kordobe-s dhe Seville-s.

Një risi kryesore e kësaj periudhe ishte letra, fillimisht një sekret i ruajtur fort nga kinezët. Arti i prodhimit të letrës u sigurua nga të burgosurit e marrë në Betejën e Talas-ë, duke rezultuar në ndërtimin e mullinjve të letrës në Samarkand dhe Bagdad. Deri në fund të shekullit të 9-të, kishte qindra dyqane që punësonin për libra në Bagdad dhe madje filluan të krijohen edhe bibliotekat publike, duke përfshirë bibliotekat e para të kreditimit. Prej këtu letra u përhap në Perëndim në Andaluzi dhe nga atje në Evropë në shekullin e 13-të.

Mackensen dhe Pinto (1929) kanë shkruar gjerësisht mbi bibliotekat islame të mesjetës, duke theksuar vendin dhe rolin e tyre në shoqërinë islame. Kaq të përhapur ishin koleksi-

onet e librave publikë, saqë ishte e pamundur të gjente një xhami apo institut mësimi të çdo lloji, në të gjithë vendin e Islamit, pa një koleksion të librave të vendosur në dispozicion të studentëve apo lexuesve.

Në shekullin e 10-të, Kordoba kishte 70 biblioteka, më i madhi prej të cilave kishte 600,000 libra, ndërsa rreth 60,000 traktate, poema, polemikë dhe përmbledhje u botuan çdo vit në Al-Andalus. Biblioteka e Kajros kishte më shumë se 100,000 libra, ndërsa biblioteka e Tripolit thuhet se ka pasur deri në tre milionë libra, përpara se të digjej gjatë kryqëzatatave.

Gjatë këtyre periudhave, myslimanët ishin prijatarë dhe model. Ata krahas diturisë, merreshin me zbulime të shumta. Spanja qe shndërruar në një vend ku ishte nder i madh të ndiqesh mësimet aty. Shumë spanjollë, gjermanë, francezë, italianë dhe kombësi tjera ia kishin mësyre Spanjës së dikurshme për dituri. Ajo ishte bërë një qendër kozmopolite e njohur në tërë botën. Universiteti i parë evropian ishte themeluar nga myslimanët në vitin 841, në qytetin e Salermos, në Itali. Pastaj u hapën universitete të shumta në Toledo, Seville, Granada dhe në vende tjera. Kur studentët evropianë, jo myslimanë mësonin dhe diplomonin nga universitetet myslimane në Spanjë (Andaluzi), ata vishnin rrobat arabe, e ajo veshje konsiderohet zanafilla e rrobave të diplomimit të kohës moderne. Këtë e potencon edhe autori i njohur jo-mysliman Jack Goody në librin e tij “Islam in Europe”, ku thotë: “Rroba arabe (lloj këmishe e gjatë thuajse deri në fund të këmbëve) konsiderohej si shenja më e pastër për integritetin e

shkollarëve...veçanërisht gjatë ngjarjeve si mbrojtja e temës së diplomës.”¹⁷

Kjo frymë Islame që lartëson dhe kultivon dijen u bart gjeneratë pas gjenerate, e derisa myslimanët i jepnin rëndësi dijes dhe njohurive, ata ishin prijatarë dhe udhëhiqnin një pjesë të madhe të botës. E, në momentin kur ata lanë dijen dhe u përçanë, atëherë të tjerët i sunduan ata dhe aty filloi e keqja që as sot e kësaj dite nuk është ndalur.

Popujt që i kushtuan rëndësi arsimimit dhe dijes, kurrë nuk pësuan, përkundrazi u ngritën dhe u lartësuan. Shembull kemi sot shtetet evropiane dhe ShBA-në, të cilat shtete i japin një rëndësi të veçantë arsimit dhe dijes, por sot këto gjendet në majat më të larta dhe universitetet e tyre janë bërë ëndërr thuajse për secilin.

Le ta demonstrojmë vlerën e dijes, kultivimin e saj dhe ngritjen e një vendi përmes saj me një shembull modern. Singapori nga viti 1959 deri më 1963 kishte një administrim vetanak. Varfëria e madhe dhe gjërat e tjera e shtyn kryemnistin e asaj kohe Lee Kuan Yew që të kërkonte konfederatë me Malajzinë. Konfederata nuk zgjati shumë, kështu që më 1965 ajo u prish pas një sërë incidentesh mes kinezëve singaporian, indonezianëve dhe malajzianëve. Lee Kuan Yew bëri paraqitjen para popullit duke qarë. Çfarë të bëjnë me popullin që s'mund të flinte nga mushkonjat? Vendi i tij llogaritej nga vendet e botës së tretë. Nuk kishte rezerva të naf-tës e gazit. Madje as ujë të pijshëm, por atë e importonte nga

¹⁷ Jack Goody. *Islam in Europe*. Cambridge: Polity Press. 2004. Fq.150 e tutje.

Malajzia. Ai formoi një ekip ku pikat e para të zhvillimit të shtetit, caktoi të jetë arsimimi dhe edukimi. Ai me lot në sy porositi popullin e tij për dy gjëra: “Arsimohuni dhe mos u merrni me politikë.” Vetëm tetë vjet më vonë ai do të merrte edhe një hap tjetër në dobi të arsimit: “Djemtë e shkolluar të mos martohen me vajza të paarsimuara.” Ndonëse ishte bërë debat i madh rreth atyre fjalëve, por ai arriti që brenda një periudhe të shkurtër nën pushtetin e tij, Singaporin nga vendet e botës së tretë ta shndërronte në vendet e botës së parë, brenda një gjenerate të vetme, duke u bërë si vendi i parë në botë i këtij lloji.

Me të vërtetë ia arriti qëllimit, ngase për një kohë të shkurtër Singapori theu të gjitha parashikimet, duke u bërë njëri ndër vendet më të zhvilluara në botë. Për nga niveli i arsimit dhe edukimit, Singapori dhe Finlanda ndajnë vendet e para në botë. Singapori ka mbi 80 mijë studentë të huaj, apo thënë në përqindje 20%. Mbi 5 mijë studentë janë vetëm nga Malajzia. Në Azinë Juglindore studentët kanë ëndërr studimin në Singapor. Sot, Singapori renditet në vendet e larta për inovacion dhe teknologji. Dikur një shtet që s’mund të bëhej i vetëm, por në konfederatë me të tjerët, sot jo vetëm që është shtet i fuqishëm, por pasaporti i Singaporit është pasaporti më i fuqishëm në botë, para atij Gjerman që zë vendin e dytë. Vendi ka pesë milionë banorë, dy milionë prej tyre të huaj, përderisa brenda një viti e vizitojnë jo më pak se 17 milionë banorë të huaj. Prandaj, nuk është thënë kot se një vend që i jep rëndësi arsimit, nuk vdes! Vlen të përmendet se Singaporin e udhëheq një presidente myslimane Halimah Jakub.

Përfundim

Në këtë punim jam munduar ta elaboroj vlerën dhe rëndësinë që ka dituria në Islam. Përmes ajeteve dhe haditheve që i kam përzgjedhur, vërehet qartë se ajo është shumë e rëndësishme, sepse fjalët e para të shpalljes ishin për dije. Pas-taj, jam munduar që të bëj një paralele mes vlerësimit të dijes dhe njohurive nga e kaluara islame dhe dekadencës aktuale, ku të parët sundonin botën dhe merreshin me zbulime, përde-risa sot myslimanët janë shndërruar si robër ndaj të tjerëve dhe thuajse mungojnë zbulimet në tërësi prej tyre. Me shpre-së se ndryshimi do të vijë dhe ai nuk do të mungoj gjatë e myslimanët do ta kuptojnë se avancimi i tyre si individual ashtu edhe shoqëror vjen nga reformimi i tyre shkencor e akademik.

Literatura e përzgjedhur:

- * AbdulKerim Bekkar. *El-Muslimune bejne-t tehadidi ve-l muvaxhe-heh haule tterbijeti ve-t talimi*, Bot.I-rë, “Daru-l kalem”, Damask, 2011.
- * Abdurrahman Rafet el-Basha, *Suver min Hajati-s Sahabeh*, bot.I-rë, Dar el-edebul Islamij, 1997.
- * Dhebebiu, *Te'rihu-l Islam*, bot. I-rë, dar el-kutub el-arebij, Bejrut-Liban. 1990m.
- * Dhebebiu, *Sijer A'lamun Nubela*, bot.III-të, Muessesetu Rrisaletu, 1985.
- * Jack Goody. *Islam in Europe*. Cambridge: Polity Press. 2004.
- * Jusuf Kardawi. *El-aklu ve-l Ilmu fi-l Kur'ani-l kerim*. Bot. I-rë, Mektebetu Vehebeh, Kairo, 1416.

- * Grup autorësh. *Mevsuatu Nadretu-n Neim fi mekarimi ahlaki-rrresul el-kerim*. Bot. I-rë, daru-l vesileh, 1418h.
- * Kutb Mustafa Sanu. *En-Nudhum et-ta'limijeh el-vafideh fi Efrikija*. Kitabu-l Ummeh. Bot.I-rë. Vizaretu-l Evkaf. Katar. 1419. Nr. 63.
- * Halil el-Hudri. *Menhexhijetu-t tefkir el-ilmij fi-l Kur'ani-l kerim ve tatbikatuha et-terbevijeh*. Bot.I-rë. Dar alemu-l fevaid. Mekke. 2005.
- * Mina Ali es-Salus. *El-Hukuk et-talimijeh lil mer'eti fi-l islam min vakii-l Kur'ani ve-suneti*. Bot.I-rë. Daru-neshr. Kairo. 2002.
- * Muhamed Zahid Kevtherij, *Fikhu Ehlul Iraki ve Hadithuhum*, me recenzurë të AbdulFetah Ebu Gude, el-Mektebetu Ezherijetu liturath, Kairo-Egjipt, pa vit botimi.
- * Nedevi, Ebu-l Hasen, *Muhaderatun Islamijetun fi-l fikri ve-d Da'veti*, bot. I-rë. Dar ibën Kethir, Damask-Siri, 2001.

KURANI DHE SHKENCA

Ali F. ILJAZI

STRESI NGA KËNDVËSHTRIMI I KURANIT, HADITHIT DHE SHKENCËS

Jeta është përplot stresse dhe secili prej nesh është i ekspozuar një lloj shtypjeje. Presioni psikik në vete nuk është i dëmshëm, por mënyra se si ballafaqohemi me këto presione, ndonjëherë është e gabuar.

Shumë autorë në bibliografinë botërore, janë munduar ta definojnë fjalën stres si dhe faktorët stresues me sindromën e përgjithshme të adaptimit individual, por ende si term ka ngelur enigmatik. Duke e shfletuar literaturën, gjendjet afektive stresuese i takojmë me emra të ndryshëm, si: emocion i padëshiruar, emocion i pakontrolluar, frikë, bllokim, jotolerancë, shqetësim dhe traumë e jashtme psikike.

Pra, vetë fjala stres, është traumë e kohës sonë, e te ne, gjithmonë evokon emocione ose sensacion, në lidhshmëri me ndonjë ngjarje ose gjendje të padëshiruar, paraqet pjesën integrale të jetës sonë të përditshme, por sipas shumë stresolo-

gëve stresi është epidemia bashkëkohore numër një e civilizimit tonë.

Shkaktarët e paraqitjes të stresit kanë karakter shumëdimensional.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka bërë renditjen e sëmundjeve të ndryshme të cilat janë të lidhura me stresin kronik. Në atë renditje vend të parë zë ulkusi gastrointestinal (i thati në lukth), sëmundje tipike psikosomatike, edhe pse këtë mund ta shkaktojë edhe Helikobakter pilori. Pastaj vijnë gjendjet shokante me etiologji të ndryshme. Vijnë amenorrea stresoidë nëse femra gjendet e ekspozuar stresit, për shembull të ftohtit me acar, ose maltretimit fizik; riniti si rezultat i infeksionit viral në proporcion linear me stresin psikologjik; migrena, dhembjet migrenoze të kokës janë direkt të lidhura edhe me stresorë të ndryshëm. Çrregullimet gastrointestinale, sipas literaturës, 20% janë lidhje direkt me ndonjë stresor, në plan të parë paraqiten obstipacioni, fryerja e barkut, dhembjet e barkut, diarrea, etj. Në planin biologjik, stresi akut mental, e rrit nivelin e kolesterolit në organizëm. Edhe obeziteti (mbipesha) te popullata e re është rezultat i stresit. Në fund ngelin sëmundjet psikosomatike, ku individ ka incidencë të paraqitjes së sëmundjeve psikosomatike për shkak të mungesës së aftësisë dhe pamundësisë që t'i adaptohet stresit.

Lodhja e tepërt në punë krijon stres dhe anksozitet.

Jashtë nga profesionet të cilat lodhja fizike është stresori kryesor, ekzistojnë profesione që janë anksoze për shkak të hyrjeve enorme dhe përmbajtjes me motive tensioni, e cila sjell me vete natyrën dhe kryerjen e procesit dhe të de-

tyrave të punës pa pasur aktivitet fizik ose sjell rrezik nga kryerja e ndonjë aktiviteti tjetër. Në mesin e këtyre profesioneve vend të lartë zënë: kontrollorët e fluturimeve, gazetarët, mjekët e mjekësisë familjare si derë e parë e kontaktit me pacientin e sëmurë, kirurgu, kardiologu dhe mjekët e specializimeve të ndryshme, forcat e rendit publik, policia, FSK, zjarrfikësit, hoxhallarët, etj.

Njerëzit nuk janë njëlloj të qëndrueshëm në vështirësi dhe presione psikike. Disa adaptohen dhe e kontrollojnë situatën në të cilën gjenden dhe të përgatitur ballafaqohen me probleme. Disa me humor të keq përballen me situatën, duke ndier version ndaj saj.

Disa dorëzohen dhe binden në rrethana të reja (submission).

Ata që përballen me kriza të rënda, rëndom kanë dhembje koke në muskujt e qafës dhe në shpinë. Nuk mund të flenë qetë. Disa ankohen në marramendje, barkqitje apo kapsllëk.

Stresori është burim i stresit por mund të jetë gati edhe çdo gjë tjetër nëse nuk i qasemi jetës në mënyrë të planifikuar mirë. Dita e bukur e vjeshtës përplot nuanca të ndryshme dhe natyrës së qetë para tejrritjes mund të jetë burim i stresit nëse njeriu e sheh si “ditë të vrenjtur dhe të zymtë në të cilën flihet”. Rrebeshin me re të dendura e me erë të fortë personi mund ta definojë si “si një mot i keq” apo “katastrofë”. Dikush tjetër do ta shikojë këtë ditë si një mundësi për të përjetuar kënaqësinë e një shfaqjeje në të cilën paraqitën dy aktorë (përfaqësues) karizmatikë: shiun impresiv e altruist, i cili nuk pyet (kursen) pikat e dhuruara dhe era e paparashikuar për të cilën nuk paguhet energjia e harxhuar për të ujitur çdo gjë në natyrë.

Për më tepër! Njerëzit mund ta shohin edhe namazin (salat-lutje) si burim të stresit nëse këtë e shohin si barrë të përditshme mbi supe, andaj në fund të ditës thonë: “E fala namazin e jacisë, tani jam i qetë (rehat)!” Dikush tjetër do t’i shohë pesë kohët e përditshme të namazit si një pauzë kreative në të cilat fuqizon dhe freskon trupin dhe shpirtin dhe thith një forcë të madhe psikofizike.

Njëri nga burimet më të mëdha të stresit për të cilin ankohen njerëzit sot janë marrëdhëniet e këqija ndërnjerëzore. Kështu p.sh. njerëzit në vendin e punës më tepër ankohen për atmosferën në punë që e krijojnë kolegët sesa që ankohen për punën e rëndë.

Shumë njerëz të ndershëm dhe naiv nervozohen për shkak të mendimit të tyre që janë të detyruar ta ndajnë të njëjtën hapësirë të punës me personin (personat) i cili ka treguar një formë të caktuar të armiqësisë së pamerituar (p.sh. përgojim, dashakeqësi, fshehje të informatave, goditje pas shpine, etj.) dhe shumë shpejtë mund t’i vërejnë ndryshimet e qarta fiziologjike në organizmin e vet (djersitje e duarve, shpejtim i ritmit të zemrës, ngushtesë në fyt, djersë të ftohta, etj.).

Mirëpo, situata ndryshon në mënyrë radikale nëse vetit i shpjegon me mënyrën kur secilin kontakt dhe takim me personat që duan të thurin rrjetën e ligësive të vogla, i shikon me realizëm dhe nga afër proceset e shtrembëruara dhe të devijuara morale.

Është rregull që nëse personi lejon që individët lehtë ta zhgënjëjnë, entuziazmi i shpejtë me diç apo me dikënd flet për naivitete dhe mosinformim.

Marrëdhëniet e këqija ndërnjerëzore po ashtu janë të kush-tëzuara me qasjen naive të llojit njerëzor dhe bindjen që miq-të tanë janë 100% të mirë ndërsa armiqtë tanë 100% të këqij. Të shpeshtë janë shembujt e njerëzve të cilët një periudhë të gjatë kanë treguar nivel të lartë të respektit dhe dashurisë, që për një ngjarje të vetme të largohet përherë.

Problemi i kësaj qasjeje në mos lërjen e hapësirës në të cilën miqtë tanë mund të na zhgënjëjnë, ndërsa miqtë të mos na zhgënjëjnë. Ngase, nëse disa njerëz i definojmë si 100% të mirë dhe ata papritur na zhgënjëjnë, vijmë në situatë që ri-shtazi duhet t'i definojmë dhe rëndom shkojmë në skajshmë-rinë tjetër, d.m.th. ata bëhen të këqij.

Kjo tregon fragmentimin fetar e politik brenda shoqërive myslimane në formë të gjeneralizuar, me veçanti shoqërinë tonë, e cila është rezultat i kurtheve të kushtëzuara të ideali-zimit dhe satanizimit.

Kështu, p.sh. djaloshi i cili idealizon vajzën e caktuar duke mos supozuar në vetë fillimin e lidhjes së tyre që kjo vajzë me kohë do të bëjë gjëra të caktuara për të cilat do të bie në sy në momentin e demonstrimit të saj të një dobësie njerëzore më të rëndomtë, ajo fillon të ngecë së ekzistuari si qenje e mirë më sytë e tij.

Për këtë nuk habitë shpejtësia e vajzës moderne në vetë-dijen e shumë meshkujve kalon rrugën nga princesha deri te shtriga. Mirëpo, nëse miratojmë një qasje shumë realiste d.m.th. balancimin e nyjansuar të shikimit në jetë duke e për-caktuar dikënd me 70% me të mira në vetën e tij, në të njëj-tën kohë i kemi lënë këtij personi 30% hapësirë për zhgënjim eventual.

Njeriu postmodern në shoqërinë e sotme ankohet në obligime të shumta, termine, detyra, punë të pakryera duke mos kuptuar që burimi i stresit të tij nuk janë obligimet e shumta në përditshmërinë e stuhishme, por kuptimi negativ që i ka dhënë këtyre obligimeve. Në anën tjetër kemi njerëz të cilëve burimi më i madh i stresit është i kundërt me të përmendurën më lartë, e kjo është mungesa e çfarëdo pune qoftë me anën e së cilës do të kishin ndjenjën e qenësisë personale dhe kontributit në vendin dhe kohën e tyre. Natyrisht, burimi i stresit të tyre nuk është mungesa e punës por kuptimi negativ që i kanë dhënë kohës së lirë të tyre. Më tragjike në gjithë këtë është e vetmja pengesë në rrugën e definimit pozitiv në rrugën e dhënë të jetës personale - mungesa e shpirtit dhe imagjinatës.

Poashtu kemi persona që janë të shpërqendruar për shkak të brengës që e kanë bashkangjitur me ardhmërinë personale, por jo për shkak të vetë ardhmërisë të cilës kanë mundur me i dhënë ngjyra shumë më të ndritshme.

Allahu i Madhërishëm e potencon edhe këtë fenomen:

“Ata që ju adhuronin përveç Allahut nuk janë tjetër vetëm se emra që pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuronin tjeër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”¹

¹ Jusuf, 40.

Rëndësia e idhujve të djeshëm, natyrisht nuk ka qenë në format e tyre, peshën dhe materialin nga i cili janë gdhendur dhe formësuar, por e vetmja “vlerë” e tyre ka qenë në kuptimin të cilin na kanë dhënë njerëzit. Dëshmitari i Lartësuar pa perifrachim demaskon psikologjinë e fshehur pas idhujtarisë së përmendur, duke theksuar që idhujtarët, në realitet janë vetëm adhurues të emrave, kuptimeve dhe definicioneve të cilët vetë ua kanë dhënë fenomeneve dhe sendeve të prekshme, pa pasur për këtë argument valid. Kështu që përkushtimi dhe frikërespekti i tyre para idhujve jokarizmatik të formës së shëmtuar është rezultat direkt i iluzionit të cilin ideologjikisht vetë e kanë përpunuar.

Idhujtarët modern janë mutacione në forma të ndryshme, por kanë mbetur sakrificë tërësisht i të njëjtit gabim. Qoftë nëse ka të bëjë me frikën nga njerëzit funksionet e të cilëve, titujve apo petkut ia kanë përshkruar tërësisht status të pamerituar dhe janë bërë robër të kuptimeve që i kanë gjetur apo u kanë dhënë. Ose ka të bëjë me fobitë e ndryshme për shkak të cilave u dridhen këmbët, ngushtohen gjoksat dhe për shkak të cilëve ndihen si qyqarë dhe të paaftë, duke mos ditur që këto janë frikë fantome të cilët do të avulloheshin vetëm nëse nisen me trimëri në ballafaqim dhe i definojmë realisht.

Ibn Abbasin, r.a., e kanë pyetur se a më shumë e dëmton trupin hidhërimi apo pikëllimi? Ai tha: “Të dy shkojnë në rrugë të njëjta, por kuptimi është i ndryshëm. Kur lufton me atë që është më e fortë se ti, kjo të frikëson dhe të shkakton pikëllim. Ndërsa kur lufton me atë që është më e dobët se ti, kjo shkakton hidhërim.”

Qoftë i kënaqur Allahu me Ibn Abbasin, r.a., sa i mençur ka qenë! Është e vërtetë se edhe njëri edhe tjetri lëvizin në të njëjtën rrugë. Të dyja gjendjet ngritin nivelin e adrenalinit në gjak. Ngritin shtypjen e gjakut dhe veprojnë dëmshëm në zemër.

Shumica e njerëzve i është ekspozuar një lloj stresi ose brengave të përditshme. Është vërtetuar se 18% e amerikanëve besojnë se nuk është e nevojshme t'i zvogëlojnë streset që i përcjellin në jetë.

Ekzistojnë njerëz që hidhërohen në situata të rënda të krizave. Pejgamberi, s.a.v.s., e përshkruan hidhërimin si prush i cili ndizet në zemër:

*“Hidhërimi është prush që ndizet në zemër.”*²

Pejgamberi, a.s., na nxit në mënjanimin e hidhërimit:

*“Kush e mbizotëron hidhërimin kur mund të hakmerret, Allahu do t'ia mbushë zemrën me siguri dhe besim.”*³

Allahu i Madhëruar thotë:

“Të cilët japin edhe kur janë të çliruar, edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”⁴

Pejgamberi, a.s., e përshkruan ilaçin për hidhërim:

*“Nëse dikush prej jush zemërohet, le të ulet; nëse zemërimi nuk e lëshon, le të shtrihet!”*⁵

² Tirmidhiu.

³ Shënon Ibn Ebi Dunja.

⁴ Ali Imran, 134.

⁵ Shënon Ebu Davudi, Ahmedi dhe Ibn Hibbani në “Sahih el-Xhamius-sagîr”, 694.

Këtë psikologët bashkëkohorë e quajnë ndryshim i “gjedjes trupore” dhe besojnë se ky ndryshim sjell deri te dobësimi i reaksionit dhe flakja e zemërimit.

Gjithashtu, shkenca bashkëkohore ka vërtetuar se hormoni adrenalin rritet shumëfish gjatë zemërimit. Ky nivel është më i lartë kur njeriu qëndron në këmbë, ndërsa zvogëlohet kur ulemi ose shtrihemi, mu sikur i këshillon Pejgamberi, a.s., ata të cilëve u ndodh pikëllimi ose brengosja.

Pejgamberi, a.s., ka thënë:

*“Zemërimi është shejtani. Shejtani është krijuar nga zjarri. Ai shuhet me ujë. Për këtë, kur të zemëroheni merrni abdest.”*⁶

Kur Pejgamberin, s.a.v.s., e brengoste ndonjë gjë, siguri në e kërkonte në namaz. Madje, me një rast ai ka thënë:

“Gëzimin gjeje në namaz!”

Lloji tjetër njerëzor i dorëzohet presionit psikologjik dhe ngulfatet në pikëllim, mbyllje ne vetvete dhe brengosje.

Simptomat më të shpeshta të kësaj gjendjeje janë: ndjenja e depresionit dhe pikëllimit, ndjenja e pafuqisë dhe e pashpresës dhe dëshira për të qarë. Këta njerëz mund të ndiejnë përzierjen e depresionit dhe brengës. Kjo gjendje mund të lë gjurmë në trup, duke shkaktuar ndryshime të përkohshme apo afatgjate. Njeriu në këtë gjendje ankohet në dhembje koke, marramendje, dhimbje të ndryshme, vjellje, etj.

Kjo bën që këta njerëz të tërhiqen në vetmi dhe të largohen nga njerëzit.

⁶ Shënon Ebu Davudi.

Në këtë situatë njeriu duhet të pyesë: a mund t'i bart të gjitha obligimet e ditës? A do t'i përpij emocionet dhe ndjenjat e mia, apo do t'i ndaj me dikë që do të më ndihmojë në zgjidhjen e problemit ?

Si mundet të shpëtojë njeriu nga këto brenga dhe të zvogëlojë presionin psikik?

A mundemi me fuqinë e dëshirës t'i përballojmë streset ?

Njeriu i mençur e ka mekanizmin, i cili refuzon streset dhe i thyen në copëza.

Nuk ka dyshim se besimi në Allahun dhe kërkimi i ndihmës nga Ai, paraqet mekanizmin mbrojtës më të mirë. Besimi në Zotin na nxit në durim ndaj vështirësive dhe në përparim. Durimi është të përballesh me problemin, e jo t'i nënshtrohesh atij.

Pasi që stresin e presim të përgatitur, njeriu mundohet ta eliminojë dhe ta shërojë. Ndonjëherë nevojitet ndihma e personit tjetër dhe mu ky është qëllimi i ndihmesës, vëllazërisë dhe dashurisë. E tërë kjo ndihmon që të forcohet mekanizmi i thithjes së stresit.

Dr. Adil Sadik thotë: “Njerëzve të cilët sëmuren nga kripa psikike, u mungon dashuria në jetë. U mungon përkrahja dhe kuptimi i personit tjetër. Askush nuk dëshiron të sakrifikohet për ta në momentet e rënda.”

Besimi në Allahun, durimi, dituria, përvojat e kaluara dhe dashuria e njerëzve tjerë krijojnë mekanizmin më të fuqishëm për thithjen e stresit dhe zvogëlimin e tendosjes psikike.

Pejgamberi, a.s., tërheq vërejtjen në rrezikun e grumbullimit të brengave:

*“Kush ka shumë brenga, i sëmuret trupi.”*⁷

Ai këshillon lutjen dhe kërkimin e faljes si ilaç për këtë gjendje Ibn Abasi, r.a., transmeton se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

*“Kush bie istigfarë pa ndërprerë, Allahu do t'ia mënjanojë çdo brengë, do t'i japë rrugëdalje nga çdo situatë dhe do ta furnizojë nga nuk shpreson.”*⁸

Në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit shënohet se Pejgamberi, a.s., në vështirësi ka thënë:

“La ilahe il-llallahu-halimul adhim La ilahe il-llallahe rabul arshil adhim La ilahe il-llallah rabbis-semavati vel-erdi ve rabbil arshil kerim.”

Nuk ka Zot, përveç Allahut, të Butit dhe Madhështorit. Nuk ka Zot, përveç Allahut, Zotit të Arshit madhështor. Nuk ka Zot, përveç Allahut, Zotit të qiejve dhe Tokës dhe Zotit të Arshit Fisnik.”

Në Sunenin e Ebu Davudit transmetohet nga Ebu Bekri se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

اللَّهُمَّ رَحْمَتَكَ أَرْجُو فَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طَرْفَةَ عَيْنٍ وَأَصْلِحْ لِي شَأْنِي كُلَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ.

“Allahumme rahmeteke erxhu fela tekilni ila nefsi tarfete ajnin ve aslih li she`ni kul-lehu la ilahe il-la ente.”

⁷ Ahmedî, 5/388.

⁸ Shënon Ibn Sunni dhe Ebu Nu`ajmi.

“O Zoti im, të lutem për Mëshirën Tënde, mos lejo që t’i lëshohem vetes sime asnjë moment dhe bëje gjendjen time më të mirë. Nuk ka Zot tjetër përveç Teje.”

Esma bin Umejri ka thënë: “I Dërguari i Allahut, s.a.v.s., më ka pyetur: “A dëshiron të t’i mësojë fjalët që do t’i thuash në vështirësi - Allahu është Zoti im dhe askush nuk është i barabartë me Të!”¹⁰

Imam Ahmedi në Musned shënon transmetimin e Ibn Mes`udit se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

“Kur njeriu në vështirësi thotë këto fjalë:

اللَّهُمَّ إِنِّي عَبْدُكَ وَابْنُ عَبْدِكَ وَابْنُ أَمَتِكَ نَاصِيَتِي بِيَدِكَ مَاضٍ فِي حُكْمِكَ عَدْلٌ فِي قَضَائِكَ أَسْأَلُكَ بِكُلِّ اسْمٍ هُوَ لَكَ سَمِيَتْ بِهِ نَفْسٌ أَوْ عَلَّمْتَهُ أَحَدًا مِنْ خَلْقِكَ أَوْ أَنْزَلْتَهُ فِي كِتَابِكَ أَوْ اسْتَأْذَنْتَ بِهِ فِي عِلْمِ الْغَيْبِ عِنْدَكَ أَنْ تَجْعَلَ الْقُرْآنَ رِبْعَ قَلْبِي وَنُورَ صَدْرِي وَجَلَاءَ حُزْنِي وَذَهَابَ هَمِّي.

“Allahumme inni abduke vebnu abdike vebnu emetike. Nasijeti bijedike madin fijje hukmuke adlun fijje kadauke, es`eluke bi kul-li ismin huve leke sem-mejte bihi nefseke eu al-lemtehu ehaden min halkike eu enzeltehu fi Kitabike eu iste`therrte bihi fi ilmil gajbi indeke en texh`alel Kur`ane rabi’a kalbii ve nura sadrii ve xhela huznii dhe dhehabe hemmii.”

⁹ Shënon Ebu Davudi, Ahmedi dhe Ibn Maxhxeh.

¹⁰ Shënon Ebu Davudi (5090), Ahmedi, 5/42, Buhariu në “El-Edebul mufred”.

“Zoti ynë, unë jam robi Yt, i biri i robit Tënd, i biri i robërshës Sate! Fati im është në duart Tua, e kaluara ime në pronësinë tënde, drejtësia në mua është përcaktimi Yt. Të lutem me tërë Emrat Tu, me të cilët e ke quajtur Veten ose ia ke mësuar dikujt prej krijesave Tua ose i ke shpallur në Librin Tënd, apo i ke pronësuar për Vete, të bësh Kuranin pranverë të zerrës sime, dritë të gjoksit tim, duke larguar pikëllimin dhe brengën time” - Allahu do t’ia largojë pikëllimin dhe brengën duke ia zëvendësuar me gëzim.”¹¹

Një ditë i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., hyri në xhami. E pa një ensar me emrin Ebu Uname dhe i tha:

“Ebu Uname, përse të shoh në xhami jashtë kohës së namazit?”

“Bregat dhe borxhet më kanë kapluar, o i Dërguari i Allahut”, tha ai. Pejgamberi, a.s., i tha: “A do të t’i mësoj disa fjalë të cilat kur t’i thuash, Allahu do të mënjanojë brengën dhe do ta paguash borxhin tënd?” “Po, o i Dërguar i Allahut”,- tha ai. Pejgamberi, a.s., i tha: “Në mëngjes dhe në mbrëmje thuaj: “O Zot, më mbroj nga brenga dhe pikëllimi, më mbroj nga pafuqia dhe përtacia, më mbroj nga qyqaria dhe koprracia dhe më mbroj nga vështirësitë, borxhi dhe anashkalimi i njerëzve.”¹²

Ebu Uname më vonë tregon: “Kështu veprova dhe Allahu ma largoi brengën dhe më ndihmoi ta kthej borxhin tim.”

¹¹ Shënon Ebu Davudi (1525) dhe Ibn Maxhxeh (3882).

¹² Shënon Ahmedi në Musned 1/254 dhe 394.

Konkluzion

Burimet e islamit e trajtojnë stresin nëpërmes konceptit të “tevhidit” d.m.th. njëshmërisë së Krijuesit i cili i vetmi meriton 100% të dashurisë dhe besimit tonë, ndërsa krijesat në këtë çështje ndryshojnë dhe këto përqindje asnjëherë nuk janë statike dhe as të rumbullakosura.

Të kuptuarit drejtë dhe shembullueshëm i konceptit të njëshmërisë së Krijuesit në të gjitha segmentet e shoqërisë eliminon idhujtarinë moderne të përhapur, të përmendur, e me vetë këtë edhe me korrupsionin dhe padrejtësinë sociale. Me e mësuar njeriun që nuk ekzistojnë “problemet” por vetëm sfidat, pyetjet, kontekstet dhe pyetësorët, të cilat janë raste ideale për mësim dhe zhvillim.

Islami ofron edhe ventilimin shkarkues të stresit të grumbulluar nëpërmes praktikave të aktiviteteve të rekomanduara fizike (p.sh. notimi, gjuetia, alpinizmi agrikultura, etj.), udhëtime të organizuara (haxhi p.sh. imperativi “udhëzimi” është përmendur në tetë vende të ndryshme në Kur’an) dhe qarja dhe meditimi në të tretën pjesë të fundit të natës si proces i mënjanimi të gjërave toksike të grumbulluara në organizëm gjatë periudhës së stresit.

Praktika e vërtetë islame na mëson që myslimani praktikant për çdo ditë lufton kundër stresit me dhikër, d.m.th. me sistemin neurolinguistik të autoprogramimit të vetëdijes personale përmes përsëritjes së koordinuar të mesazheve sugjeshive me të cilat rekomandojmë:

*Allahu është më i madh se çdo frikë,
Allahu është më i madh se çdo pasiguri,
Allahu është më i madh se çdo armik,*

*Allahu është më i madh se çdo krizë,
 Allahu është më i madh se çdo sprovë,
 Allahu është më i madh se çdo dobësi,
 Allahu është më i madh se sfidat e çdo kohe,
 Allahu është më i madh se mentorët e të gjithë armiq-
 ve tanë së bashku,*

Allahu është më i madh se çdo detyrë të cilën mund ta paramendojmë, etj.

Ose i rekomandojmë vetit dhe të tjerëve dhikrin:

*el-hamdulil-lah në ditën e re,
 el-hamdulil-lah në reliefin e ri qiellor,
 el-hamdulil-lah në shqisat e uritura,
 el-hamdulil-lah në çdo nyje funksionale në trupin
 tonë,
 el-hamdulil-lah për miqtë nga të cilët mësojmë,
 el-hamdulil-lah për armët tanë që na forcojnë,
 el-hamdulil-lah për njerëzit me arsimime të ndryshme
 nga se arsimimi është interesant,
 el-hamdulil-lah për jetën në kohët tejet interesante
 etj, etj në pakufi.*

Allahu i Madhërishëm urdhëron e thotë:

**“Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zem-
 rat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur
 All-llahun zemrat stabilizohen.”¹³**

Ti o njeri, mendo realisht dhe pozitivisht, hulumto nevo-
 jat e tua shpirtërore e fizike pa emocione, bën gjumë dhe pu-

¹³ Er - Rra'd, 28

shim natyral, jeto dhe çmo vlerat tua, familjen, shokët dhe shoqërinë, mos e ngarko trurin pa limit, menaxho jetën tënde në të gjitha momentet e jetës pa STRES, duke kujtuar dhe praktikuar këshillat e Kuranit fisnik dhe rekomandimet e mësuesit tonë të dashur, Muhammedit, s.a.v.s.

Literatura:

1. Sherif Ahmeti: *Kur'ani - përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1988;
2. Xhelalud-din es-Sujuti: *Mjekësia e Pejgamberit, a.s.*, Gjakovë, 2011;
3. Edin Tule: *Kur'anski tretman stresa*, Sarajevë, 2011;
4. George J. Tamson: *World stress in English*, 2017;
5. Taylor Francis: *English world - stress*, 2016;
6. Terry F. Pettijohn: *Stresi - Psikologjia*, Pejë, 1977;
7. Arthur Guyton: *Textbook of Medical Physiology*, USA, 2010;
8. *Harrison's Principles of Internal Medicine*, USA, 2016;
9. Dr. Selim Cana: *Stresi*, Gjakovë, 2017;
10. Charls D. Forbes, William F. Jackson: *Mjekësia klinike - përkthim*, Shkup, 2003;

Dr. Genti KRUJA*

**BASHKËJETESA NDËRFETARE
NDËR SHQIPTARË,
SI FAKTOR STABILITETI SOCIAL**

Nevoja për dialog midis popujve dhe ithtarëve të besimeve dhe pikëpamjeve të ndryshme fetare, etnike, kulturore dhe politike është përforcuar shumë sidomos vitet e fundit. Dialogu, sidomos ai ndërfetar është parë si një prej alternativave për të shumëpërfolurën “përplasje e qytetërimeve”. Ata që nuk janë pajtuar me një teori të tillë, këmbëngulin në dialogun e qytetërimeve, kulturave dhe besimeve të ndryshme fetare.

Për sa i përket studimeve sociologjike shqiptare të periudhës postkomuniste është argumentuar se krahas vlerave kul-

* Dr. Genti Kruja, kryen detyrën e kreut të Departamentit të Shkencave Islame në Universitetin Bedër, si dhe gjithashtu është kryeredaktor i revistës shkencore “Zani i Naltë”.

turore të besës dhe mikpritjes, mirëkuptimi dhe bashkëjetesa ndërfetare të shqiptarët, përbëjnë disa nga profilet më të spikatura të modelimit psikokulturor të shqiptarëve në të gjithë historinë e tyre. Ndërkohë, në mjaft shoqëri më të urbanizuara, në rrjedhën e disa shekujve, madje edhe në ditët tona, konfliktet kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten një sfidë e rëndë problematike në shumë rrafshe, sociale e politike, fetare e psikokulturore. Në këtë sfond ndërkombëtar, ku rilevohen dukshëm konfliktet me karakter të ndryshëm, mirëkuptimi ndërfetar i shqiptarëve, përbën ndoshta një model, jo vetëm për Ballkanin dhe rajonin e trazuar, por një model edhe për Evropën, e pse jo edhe për botën. Vlera kulturore e mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve është pak e studiuar dhe pak e argumentuar, ndaj çdo përpjekje për depërtimin në thelbin e një vlere të tillë komplekse, shumëfunktionale, për ta evidencuar atë përmes strukturave konceptuale sociologjike, ka rëndësi të veçantë teorike e praktike, jo vetëm për shoqërinë shqiptare, por edhe më gjerë.

Shqiptarët janë gjithashtu një popull me densitet të lartë të multifetaritetit. Ndonëse të shpërndarë në disa komunitete fetare, shqiptarët nuk janë konfliktuar njëri me tjetrin për çështje fetare. Madje, në shumë aspekte, dallimet fetare kanë “funksionuar” si një faktor, që ka fashitur ose tejkaluar edhe konfliktet e provokuara për motive të tjera. Kështu, sikurse nuk ndodh në asnjë vend tjetër të botës; dallimet fetare në Shqipëri veprojnë si faktor kundërkonfliktues.¹

¹ Dervishi, Zyhdi, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Tiranë, Prizmi, 2008:9-11.

Në këtë punim shkencor do të mundohem të paraqes disa fakte të rëndësishme historike dhe një qasje sociologjike lidhur me sfidat e mirëkuptimit ndërfetar te shqiptarët dhe bashkëjetesën ndërfetare në Shqipëri, si faktor të stabilitetit social.

Hyrje

“Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të manifestuar fenë ose bindjet, vetëm për vetëm ose bashkërisht, si në publik ashtu edhe privatisht, nëpërmjet arsimit, praktikave, kultit dhe kryerjes së riteve.”²

I. Dialogu, domosdoshmëri globale

Dialogu ndërfetar sot paraqitet si një domosdoshmëri globale. Hapi i parë në vendosjen e tij është largimi prej argumenteve polemizuese dhe theksimi me përparësi i pikave të përbashkëta, të cilat janë më të shumta se kundërshtimet e ndërsjella.

Por si mund të jetë modeli ideal i dialogut ndërfetar? Cilat mund të jenë qëllimet e tij? Çfarë mund të arrihet? Për përgjigjen e pyetjeve të tilla, duhet në radhë të parë që njerëzit të dinë kufijtë në mes të dialogut teologjik dhe atij shoqëror. Sqarimi teologjik është diçka, që iu përket njerëzve të

² Deklarata universale e të drejtave të njeriut, neni 18.

kësaj fushe dhe jo opinionit të gjerë. Populli i thjeshtë duhet të përfshihet në dialog social. Detyra kryesore e dialogut sot duhet të jetë që problemet e shoqërisë t'i zgjidhin bashkë myslimanë e të krishterë, besimtarë dhe jo të tillë.

Nëse do të bëhej një interpretim i saktë i mjaft prej parimeve udhëheqëse të vlerave të vërteta njerëzore fetare, si: mëshira, qetësia shpirtërore, harmonia shoqërore, ndershmëria dhe besimi në një Zot, atëherë rezultati do të ishte mjaft pozitiv. Kudo në botë duhet të përforcohen thirrjet për diskutime mbi përmbajtjen e idealeve të përbashkëta.

Me profil ideologjik ose jo, globalizmi ka shkaktuar ndryshime të rëndësishme në të gjitha fushat, nga ato ekonomike dhe të shkencave shoqërore, në marrëdhëniet e politikës, në fushën e ligjeve, në historinë dhe gjeografinë e administrimit të shteteve. Në fakt, globalizmi ka vulgarizuar pasurinë, teknologjinë, pluralizmin demokratik, prodhimin dhe konsumin. Dhe pas kësaj, përsëri, ka ndihmuar të shpallosen të gjitha llojet e përdhosjes: njerëzore, mjedisore ose politike. Varfëria, ndotja ekologjike, armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi, dhuna dhe ekstremizmi janë globalizuar si kurrë më parë.³

Globalizimi i dijeve, pushteteve dhe teknologjive është pasuar prej teorisë së një konflikti të mundshëm midis kulturave dhe qytetërimeve. Për pasojë, të gjitha këto, që janë rezultat i modernizmit ose globalizmit, kanë vendosur një numër të madh konceptesh në rend të ditës. Një duzinë koncep-

³ Ergene, Enes, parathënie, "Drejt një qytetërimi botëror me dashuri dhe tolerancë", Prizmi, Tiranë, 2005:10.

tesh janë përcaktuar ose ripërcaktuar brenda kontekstit të modernizmit, demokracisë dhe pluralizmit: të qenët njerëzor, individualizmi, liria e të menduarit dhe feja, politika, shoqëria dhe toleranca ndërkulturore, konflikti me konkurrencën dhe dialogu.

Nuk ka dyshim se bota sot ka nevojë më shumë se kurrë më parë për dialog ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve. Shkenca dhe teknologjia e armatimeve priren në një masë të konsiderueshme për manipulime ideologjike. Ky lloj i manipulimit ideologjik të shkencës dhe teknologjisë përhap dhe përgjithëson kërcënimet fetare, kulturore, shoqërore, si dhe dallimet krahinore e etnike.

Nga njëra anë, për gati një çerek shekulli, platformat e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë dëshmuar një proces me diskutime të ashpra si përplasje qytetërimesh. Me ngjyrimet e tyre politike dhe ideologjike, këto janë teza, që kanë ardhur nga shekuj të trazuar. Tezat e Hantingtonit për konfliktin e qytetërimeve kanë qenë në qendër të vëmendjes ndërkombëtare dhe kanë zënë një vend të rëndësishëm në diskutimet globale të viteve të fundit. Jehona dhe ndikimet e kësaj teorie në marrëdhëniet ndërkombëtare janë akoma të pranishme.

Në anën tjetër, bashkë me problemet kronike të qytetërimit modern, të tilla si përhapja e terrorizmit global, përhapja e dhunës dhe e armëve të shkatërrimit në masë, nga të cilat, çdo njëra shkon në mbështetje të tezave të konflikteve, janë bërë edhe përpjekje serioze për të vënë në dukje përputhjet midis shoqërive me kultura të ndryshme, pjesëtare të qytetërimeve të ndryshme përmes demokracisë, tolerancës dhe dialogut. Iniciativa të tilla për dialog mes qytetërimeve dhe

kulturave janë miratuar gjithmonë prej shumicës së njerëzve në botë. Por gjithashtu mjaft media në botë, duke mos iu përmbajtur etikës dhe vlerave njerëzore, kanë popullarizuar pa maturi vetëm terrorizëm, dhunë, shkatërrim vlerash e rezultatesh dhe në këtë mënyrë fatkeqësisht kanë zmadhuar numrin e këtyre mbështetësve.

Reagimin e ashpër kundër tezave të Hantingtonit, në fakt, e shfaqti nevoja e zjarrit për konkurrencë dhe dialog, ndonëse veprimet konkrete, që janë marrë në drejtim të vënies së themeleve për konkurrencën dhe dialogun, janë fare pak për t'u përmendur, ose përpjekje të tilla nuk kanë pasur ndikim global.⁴

Kur vështrojmë degradimin e qytetërimit të sotëm, ajo që kuptojmë është - për çfarëdolloj arsye - se gjithçka përfundon te problemi i njeriut. Kur njerëzit janë destruktivë, të dëmshëm, armiqësorë dhe agresivë, atëherë ata skllavërojnë bashkësinë shoqërore dhe njerëzore, në të cilën bëjnë pjesë edhe vetë po me këta instinkte. Prandaj, është e qartë se ku dhe kur kanë qenë të nëpërkëmbura standardet njerëzore. Një nga rrugët kryesore për të shpëtuar shoqërinë bashkëkohore prej shkatërrimit të shpejtë është të riedukohen qeniet njerëzore në bazë të dashurisë, tolerancës dhe dialogut.

Dijetarë të shumtë, promovues të dialogut botëror, në mjaft shkrime e libra argumentojnë se shekulli XXI, do të jetë shekulli në të cilin njerëzimi do të dëshmojë lindjen e një force shpirtërore, që do të gjallërojë vlerat morale pas një

⁴ Po aty, 12.

përgjumje të gjatë, një shekull i tolerancës, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, që do të sjellë përfundimisht, përmes dialogut ndërkulturor dhe pjesëmarrjes së vlerave të njësua, qytetërimit gjithëpërfshirës.⁵

Megjithatë në botë janë të shumtë tiranët, që e urrejnë tolerancën dhe numri i atyre, që nuk duan dialog nuk është i vogël. Gjithashtu janë të shumtë njerëzit, që kërkojnë mënyra për të luftuar, për të nxirë emrin e njëri-tjetrit me shpifje e etiketime të ndryshme.

Është një përçarje e tmerrshme midis individëve, si edhe midis popujve. Gjykimet e shumë njerëzve fillojnë me fjalët “ne”, “ju”, dhe “të tjerët”. Qëndrimet e ftohta ndaj njëri-tjetrit që reflektojnë ftohtësi ose ndarje në çdo veprim, shkaktojnë veçse kaos.

Njerëzit, kohë pas kohe, tërhiqen me forcë nga drejtimi i së mirës, ose shtyhen me dhunë në drejtim të së keqes, nga forca e vullnetit të tyre dhe opinionet e shpërfillura. Kampe të reja ngrihen çdo ditë, çdo ekip lufton për perspektivën ose për urdhrat e tyre, çdo ideologji pasqyron një mënyrë jetese, që u shkon për shtat parimeve të tyre. Për më tepër, njerëzit janë detyruar të përshtaten në këtë kornizë të ngushtë dhe të jetojnë në përputhje me të.

Altruistët e vërtetë, në ndjekje të thënies profetike “*mos dëshironi për të tjerët çfarë nuk dëshironi për veten tuaj,*” përpiqen pa pushim më shumë për të tjerët. Prandaj të tjerët do të përfitojnë nga çfarë kanë krijuar të dobishme tashmë

⁵ Po aty, 17.

këta njerëz me zemër. Me horizontin e tyre të gjerë shpirtëror, ata janë në gjendje të ringjallin ndjenjën e mëshirës edhe në zemrat e tiranëve. Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim.

Njerëzit në përgjithësi dëshirojnë t'i referohen të kaluarës dhe të tashmes për klimën e tolerancës dhe të durimit që shpërndan, shndërron, qartëson dhe pastron. Atëherë ecin drejt së ardhmes me besim, pa asnjë ndjenjë ankthi. Njerëzit përgjithësisht nuk dëshirojnë që e kaluara të jetë e kritikueshme ose e ardhmja të jetë e errët për arsye të së tashmes. Shumica e njerëzve kërkojnë dashuri dhe respekt përgjatë gjithë jetës, shpresojnë për tolerancë dhe mirëkuptim dhe duan të jenë të përfshirë nga ndjenjat e bujarisë. Ne presim tolerancë dhe mirëkuptim prej prindërve tanë në shtëpi në përgjigje të djallëzisë, prej mësuesve tanë në përgjigje të gabimeve tona në shkollë, prej atyre viktimave të pafajshme ndaj të cilëve ne kemi vepruar dhe i kemi dhunuar pa të drejtë, prej prokurorëve dhe gjykatësve në gjykatë, prej komandantëve tanë në ushtri, prej inspektorëve të policisë, etj.

Ndërkaq, është shumë e rëndësishme që njerëzit ta meritojnë atë që kërkojnë. Dikush që nuk fal, nuk mund të ketë të drejtë të kërkojë mirëkuptim. Gjithsecili do të përballet me mungesë respekti në atë shkallë sa ai nuk respekton të tjerët. Ata të cilët nuk përqafojnë gjithçka për krijesat njerëzore me tolerancë dhe mirëkuptim kanë humbur vlerën e tyre për të pritur mirëkuptim dhe falje.

Në vendet ku mbizotëron korrupsioni, intolancia dhe mungesa e mëshirës, nocione të tilla si liria e mendimit, kriti-

ka e qytetëruar, shkëmbimi i ideve në përputhje me normat e drejtësisë dhe debati i paanshëm janë përgjithësisht të përjashtuara.

Në një vend ku nuk ka tolerancë, është e pamundur të flasësh për zhvillimin e mjeteve të komunikimit masiv, për mendimin e përparuar ose, për më tepër, për veprimtaritë kulturore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Në një kohë kur bota është bërë si një fshat i madh dhe në një moment kur shoqëria jonë është në prag të një ndryshimi dhe transformimi të rëndësishëm, nëse popujt dhe besimet e ndryshme nuk hyjnë në bisedime dhe dialog me njëri-tjetrin, atëherë nuk do të jetë e mundur të shpjegohen plotësisht mosmarrëveshjet midis tyre. Në këtë këndvështrim, toleranca është virtyt që ka nevojë të shpërblehet dhe për këtë arsye, toleranca duhet të depërtojë në të gjithë shoqërinë. Universitetet duhet të frymëzojnë tolerancë, politikanët duhet të diskutojnë rreth tolerancës, popujt në muzikën botërore duhet të shkruajnë lirika për tolerancën dhe mjetet e komunikimit masiv duhet të mbështesin për zhvillimet pozitive lidhur me tolerancën.

Tolerancë nuk do të thotë të jesh i ndikuar ose i lidhur me të tjerët, por t'i pranosh të tjerët siç janë dhe të dish si të ecësh përpara me ta. Shumica e njerëzve me mendime dhe qëllime të ndryshme ose do të kërkojnë rrugët për të ecur përpara me synimin për harmoni, ose do të luftojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin. Gjithmonë ka pasur njerëz që mendojnë ndryshe nga njëri-tjetri dhe kështu do të jetë përherë.

Të pranosh tolerancën, nuk do të thotë të anashkalosh traditat, që burojnë nga feja e secilit, nga historia e secilit, tole-

ranca është vlerë, që ka ekzistuar gjithmonë. Në emër të dialogut të gjithë mund të bashkohen në tokën e përbashkët dhe të shtrëngojnë duart me të gjithë.⁶

Dialogu ndërkulturor duhet të marrë një formë zhvillimi të vetë qytetërimeve dhe jo të jetë një mundësi e ushtrimit të hegjemonisë, imponimit të vlerave lokale, nëpërmjet mundësive që ofron një shoqëri globale. Sipas Eduard Said, *“...ne të gjithë notojmë në të njëjtat ujëra; perëndimorët, myslimanët, apo të tjerët. Përderisa ujërat janë pjesë e oqeanit të historisë, përpjekja për t'i çarë apo për t'i ndarë ato me pengesa është e kotë.”*⁷

Bota e sotme karakterizohet nga rritja e ndërvlarësive dhe e kooperimit ndërmjet popujve, grupeve, institucioneve dhe kombeve. Në të njëjtën kohë, konfliktet etno-fetare dhe ndërfetare, si dhe përdorimet e instrumentalizuara dhe politike të fesë janë në rritje në shumë rajone të botës.

Konfliktet e sotme nuk janë luftëra ose konflikte fetare, por, fatkeqësisht, ato përdorin justifikime fetare. Megjithatë, duhet theksuar se feja në vetvete nuk është shkak për konflikte, por mund të përdoret, si një faktor dhe si një simbol në konflikte. Krahës kësaj, duhet parë edhe pesha emocionale, që dallimet fetare mund të shtien në konflikt. Toleranca është diçka delikate dhe një shkëndijë e vogël mund të shkaktojë luftë, kur kushtet sociale, ekonomike dhe ushtarake nuk janë në rrugë të mbarë. Për më tepër, intoleranca fetare dhe shtyp-

⁶ Po aty, 76.

⁷ Said, Eduard, “Orientalizmi”, 1995:275.

ja, mund të favorizohen edhe nga pabarazitë në kushtet materiale.

Besimtarët praktikantë të çfarëdo lloj feje në botë, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të parandaluar, që feja të përdoret si burim konflikti. Në fakt, përdorimi i gjuhës dhe simboleve fetare mund të bëhet një nga “armët” më të fuqishme strategjike në një konflikt.

Historia na tregon se të gjitha kulturat e mëdha janë zhvilluar përmes shkëmbimeve me kulturat e tjera, përmes reciprocitetit të këtij shkëmbimi dhe jo përmes shtypjes dhe përbuzjes. Kurani shpall se një nga objektivat e krijimit është që popujt e ndryshëm të tokës të njihen ndërmjet tyre.⁸

Ne jetojmë në një botë që karakterizohet nga lëvizjet e popullsisë dhe përzierje kulturash të pashembullt. Në këtë kuptim, ne jemi të ndërruarur dhe kemi një përgjegjësi të përbashkët për mirëqenien e tërë botës. E kështu besimi fetar mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë periudhë kritike.

Kulturat i japin fesë gjuhën e tyre dhe fetë një kuptim të fundmë çdo kulture. Në këtë kuptim, pa pranimin e pluralizmit dhe pa respektimin e dallimeve nuk mund të ketë paqe. Por, as paqja dhe as feja nuk mund të reduktohen në koncepte unike dhe të ngurta, ashtu si tërë eksperiencia njerëzore nuk mund të shprehet vetëm përmes një gjuhe.

Për sa i takon autoriteteve laike dhe atyre fetare, detyrat fillojnë që nga familja, edukimi, reduktimi i dallimeve ekonomike, lufta kundër shfaqjeve të dhunës, urrejtjes dhe diskri-

⁸ Kur'an, 49:13.

minimit të çdo ngjyre, përballja me fenomenin e terrorizmit, indiferencës, korrupsionit dhe kriminalitetit.

Në këtë kontekst, fetë duhet të jenë të vëmendshme që të mos identifikohen me pushtetet politike, me qëllim që t'i kenë duart të lira për të punuar për drejtësinë dhe paqen. Së fundi, kërkohet një bashkëpunim ndërmjet feve në bazë të parimit se *“ajo që na bashkon është më e rëndësishme se ajo që na ndan”*.

Është e vërtetë që konceptet për demokracinë, paqen, dialogun dhe tolerancën janë përhapur kudo në botë edhe në sajë të zhvillimit të shpejtë e të shumanshëm të mjeteve të komunikimit masiv. E rëndësishme është që këto koncepte të shpalosen akoma më shumë dhe çdokush të përfitojë prej tyre dhe për këtë, përgjegjësitë, si ato personale, ashtu edhe ato shoqërore, bien mbi të gjithë njerëzit.

Në të vërtetë, asnjë fe nuk është bazuar kurrë në konfliktin, nëse ajo fe është përfaqësuar nga Musai (Moisiu), Isai (Jezusi) ose nga Muhamedi (a.s.). Në të kundërt, këto fe, janë rreptësisht kundër rrëmujës, tradhtisë, konfliktit dhe shtypjes.

Bashkëjetesa ndërfetare te shqiptarët

Si lindi harmonia fetare ndër shqiptarë?

Gjykuar në pikëpamjen horizontale-sinkronike, shqiptarët janë një popull ku bashkëjetojnë të dyja fetë abrahاميke, Krishtërimi dhe Islami. Secila nga të dyja besimet abrahاميke ekzistojnë së bashku me degëzimet përkatëse. Kështu popullsia shqiptare ka dy bashkësi të krishtera: krishtërimin

katolik dhe atë ortodoks. Po ashtu, kjo popullsi ka edhe dy komunitete të një bashkësie Islame: atë mysliman suni dhe myslimanë bektashian. Si në çdo vend tjetër në botë, edhe në Shqipëri ka ateistë (sipas censusit të fundit, 2.5%), po ashtu besimtarë, që nuk ushtrojnë rite dhe nuk janë praktikantë të ndonjë faltoreje, si dhe familje të përziera me shumë besime brenda tyre. Në gjysmën e parë të shekullit të XX-të ka ekzistuar dhe një bashkësi hebraike dhe fillesat e një bashkësie protestane (ungjillore). Vetë shteti shqiptar është shtet laik dhe sipas kushtetutës së vendit shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare, por kjo gjë nuk përjashton përgjegjësinë e shtetit për krijimin e kushteve për ringjalljen dhe zhvillimin e fesë dhe të institucioneve fetare, sidomos në tranzicionin postkomunist.

Në viset e brendshme të Shqipërisë malore ritmet e shtrirjes së krishtërimit, duket se qenë të ngadalshme, përderisa mbajtësit e objekteve, që u gjenden në varrezat e hershme mesjetare (Kultura e Komanit - shek. VI-VIII), në përgjithësi praktikonin rite varrimi pagan. Krishtërimi në ato vise fuqizohet pas krijimit të temës së Durrësit (shek. IX-X).⁹ Me ndarjen e kishës më 1054, nga treva arbërore vetëm peshkopatat e Tivarit, e Durrësit dhe e Shkupit mbetën në varësi të Romës. Durrësi gjatë shekujve XIII-XVI luhatet në mes të Kishës Perëndimore e asaj Lindore, sipas rrethanave politike. Kjo paqëndrueshmëri vërehet edhe te disa sundimtarë të Arbërit. Dhimitri së bashku me klerin, fisnikët e popullin më

⁹ Anamali, Skender, 'I lirët dhe shqiptarët' në "E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi", 1990:42-43.

1209 kthehen nga ortodoksë në katolikë. Me 1216 Grigor Kamona rikthehet në ortodoks. Në një përshkrim të vitit 1308 përmenden banorët e Kunavisë, Stefaniakës, Pultit e Dibrës, të cilët nuk ishin “thjeshtë katolikë, as thjeshtë skizmatikë”.¹⁰

Megjithatë feja dhe kultura te shqiptarët ishin elemente të pandarë të jetës së përditshme, që së bashku me gjuhën përbënin identitetin kombëtar.

Populli shqiptar me dy besime: islam dhe të krishterë, ka qenë, është dhe duhet të jetë shembull i veçantë dhe simbol i harmonisë fetare në historinë e popujve të Ballkanit dhe më gjerë. Myslimanë dhe të krishterë kanë jetuar në harmoni dhe kanë bashkëjetuar pa konfrontime përçarëse në mes vete, përkundrazi ata kanë plotësuar njëri-tjetrin. Vetë ekzistenca e objekteve të kultit, xhamive, kishave e teqeve, simbolizon historinë e vendit tonë. Edhe e ardhmja e Shqipërisë dhe e shqiptarëve do të jetë e lumtur, në qoftë se pjesëtarët e Islamit dhe të Krishterimit do të përqafojnë secili fenë e vet me dije dhe vepër dhe të respektojnë njëri-tjetrin.

Si vëllezër nga gjaku, por edhe si myslimanë e të krishterë, shqiptarët duhet të kuptojnë njëherë e përgjithmonë, se realiteti dhe fati, jo vetëm i tyre, por i gjithë botës, që nga fillimi deri në mbarim të saj, është larmi besimesh e bindjesh. Shqiptarët nuk do të kenë përçarje fetare përderisa të besojnë

¹⁰ Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1962:111; Xhufi, Pëllumb, “Shqipëria dhe bota mesdhetare në Mesjetë” (shek. XI-XIV), “Studime historike”, 2, 1990:183, si dhe Ulqini, Karaman, “Faktorë kulturorë e fetarë”, Shkodër 1999:8.

se fetë në Shqipëri janë pasuri, e jo fatkeqësi dhe se Krijuesi i vetëm është për të gjithë i njëjtë, për myslimanë e të krishterë.

Në shkrimet e mendimtarëve dhe udhëpërshkruesve jo-shqiptarë gjenden mjaft karakterizime për këtë çështje. Për shembull, Hugo Adolf Bernatzik-u për shoqërinë shqiptare të vitit 1929, kur ai vizitoi mjaft qytete e krahina të Shqipërisë, ka shkruar: “Katolikë, të krishterë ortodoksë dhe myslimanë jetojnë në paqe në këtë vend të vogël, madje, shpesh edhe në fshatra jetojnë së bashku. Luftërat fetare janë të panjohura dhe të pakonceptueshme për shqiptarin”.¹¹

Ndërsa Edith Durham ka shkruar se “një pjesë e shqiptarëve... kanë kaluar direkt nga paganizmi në Islam”.¹²

Studiuesi Dervishi konstaton se, ndjenja fetare e shqiptarëve nuk është e sipërfaqshme, por është e pamjaftueshme njohja e studiuesve dhe udhëpërshkruesve të huaj për një ndjenjë të tillë. Këtë përfundim e vërtetojnë fakte të shumta, të pakundërshtueshme të realitetit fetar në Shqipëri.

Kështu gjatë 3-4 shekujve të fundit, ndonëse mjaft i varfër, populli shqiptar ka pasur dëndësi të lartë të kishave, xhamive dhe teqeve.

Kështu, duke mos pasur instinktët e turmave, shqiptarët pothuajse asnjëherë nuk i kanë keqtrajtuar grupet shoqërore në pakicë, të formuar mbi baza racore, etnike, nacionale, fetare

¹¹ Bernatzik, Hugo Adolf, “Shqipëria-vendi i shqiptarëve”, botuar nga Uegen, Tiranë, 2003:154.

¹² Durham, Edith, “Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë edhe shqiptarët”, Sh.N. “8 Nëntori”, Tiranë, 1990:158.

etj. Historikisht dhe aktualisht grupet shoqërore në pakicë kanë qenë dhe janë të mbrojtur nga toleranca, prirja për mirë-kuptim dhe fryma humane e grupeve shoqërore në shumicë.

Madje sa më të shpërpjesëtuar të jenë raportet numeriko-demografike ndërmjet grupit të njerëzve me përkatësi fetare të njëjtë në pakicë dhe grupit me përkatësi tjetër fetare në shumicë, aq më e mirëkuptuar është pakica nga shumica.

Sipas sociologut Zyhdi Dervishi, me përjashtime fare të rralla, në shoqërinë shqiptare në shumë aspekte je më i favorizuar nëse je anëtar i grupeve shoqërore në pakicë, se sa anëtar i grupeve shoqërore në shumicë.¹³

Çështja e mirëkuptimit ndërfaqet të shqiptarëve shfaqet si rebus, gati i padeshifrueshëm në sfondin e dyfishtë të realitetit socialkulturor mbizotërues të shumë shoqërive të ditëve tona, të cilat përjetojnë konfliktime fetare problematike dhe të një mjegulle të dendur paragjykimesh, që vjen nga jashtë dhe deformon pamjen e vlerave të shoqërisë shqiptare.

Dallimet fetare te shqiptarët nuk “funksionojnë” si burim konfliktesh. Përkundrazi, dallimet fetare ndikojnë, që shqiptarët të jenë më të matur në marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe të jenë më të prirur të harmonizojnë interesat ndërmjet tyre.¹⁴

Shqiptarët lakojnë shumë togfjalëshin “harmoni fetare” dhe e kanë burim krenarie faktin se në shoqërinë shqiptare

¹³ Dervishi, Zyhdi, “Fakte rrjedhëse të mirëkuptimit ndërfaqet të shqiptarëve: një provë shpjegimore”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqet në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:156.

¹⁴ Po aty.

mbisundon kjo harmoni. Kohët e fundit gjetja e formulës “magjike” të harmonisë fetare nuk është temë vetëm e Shqipërisë, por e mbarë botës. Tradita e bashkëjetesës ndërfaqetare të shqiptarët nuk është diçka e formuar në kohët moderne, por është një traditë, që vjen nga thellësia e shekujve, por sigurisht këto vlera nuk janë të përvetshme, por duhen ruajtur e trashëguar në mentalitetin e njerëzve.

Sipas studiuesit Artan Fuga, ndryshimet në pikëpamjet fetare dhe në besimet mistike nuk e përjashtojnë bashkëpunimin midis bashkësive të ndryshme fetare. Kjo vjen për arsye se fetë e mëdha monoteiste, sado të dallueshme dhe kontraktore të paraqiten me njëra tjetrën, kanë përsëri gjëra të përbashkëta, të cilat mund të shtrojnë rrugët e bashkëpunimit për përsosjen morale të njerëzve, për të rritur shkallën e solidaritetit midis tyre, për të forcuar ndjenjat e humanizmit, të faljes, mëshirës, si dhe për të krijuar një sfond moral kundërshitues kundër vjedhjes, torturës, violencës, vrasjeve etj.

Të gjitha fetë e mëdha monoteiste bazohen në pranimin e idesë të së mbinatyrshmes. Adhurimi i Zotit dhe dashuria për të tjerët përbëjnë themelet e mësimave fetare. Mësimet morale për paqe, respektim të jetës, mirëkuptim etj., gjenden te të gjitha fetë monoteiste, që kultivohen në vendin tonë.¹⁵

Nga kjo pikëpamje, kjo metaforë na mëson se perspektivat e ndryshme fetare, morale ose shkencore mbi botën nuk ka përse të jenë aspak në vetvete burim konfliktesh dhe fana-

¹⁵ Fuga, Artan, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:26.

tizmach, por një motivim humanist për një hapje drejt tjetrit, për një njohje të tjetrit në kulturën e tij të veçantë, që sikurse thotë edhe Habermasi, përbën pikërisht konceptin e saktë mbi universalen. Universalja, pra, si tërësi dallimesh në komplementaritetin e tyre.¹⁶

Shqipëri: ruajta e mirëkuptimit mes komuniteteve fetare

Krerët e shtetit shqiptar herë pas here në panelet dhe konferencat ndërkombëtare i kanë bërë të ditur botës tolerancën dhe harmoninë fetare që ekziston në Shqipëri.

Presidenti Moisiu në Forumin e Oxfordit “Toleranca ndërfetare në traditën e popullit shqiptar”,¹⁷ në vitin 2005, ka shprehur se, emigrantët shqiptarë të viteve 1990 në përgjithësi përcollën në Perëndim një imazh të një Shqipërie të dhunshme, të vrazhdë, rrezikuese. Shumë shpejt, në mjediset politike dhe shkencore të Perëndimit doli pyetja: A ekziston një Shqipëri tjetër, një Shqipëri me fytyrë evropiane, një Shqipëri nga e cila mund të gjendeshin vlera të mbijetuara të qytetërimit?

Ishte pikërisht kjo pyetje, kjo gjendje, kjo nevojë për të ndryshuar imazhin e lënduar të vendit, për të përgënjeshtuar dhe disa prirje tendencioze të shtypit perëndimor, që nxitën studiuesit shqiptarë dhe kolegët e tyre në Evropë për të kërkuar vlera të ndritshme të identitetit shqiptar, si identitet i të

¹⁶ Po aty, fq. 28.

¹⁷ www.president.al, faqja zyrtare e Presidencës, 9.11.2005.

njëtitit klas me atë të vendeve të Perëndimit, pavarësisht se e keqja e kishte sjellë të njëhej për keq. Midis këtyre vlerave, toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa ndërfetare ishin cilësi, që tërhoqën menjëherë vëmendjen e të gjithë atyre dijetarëve dhe politikanëve, shqiptarë e të huaj, që besonin dhe kërkonin te populli shqiptar një imazh tjetër.

Ky model përbën një pasuri të çmuar për shqiptarët, por edhe një realitet pozitiv, me vlerë në rajonin ku jetojmë dhe më gjerë. Shoqëritë tona po shkojnë në mënyrë të pashmangshme drejt globalizimit dhe integritit, duke tentuar krijimin e një familje të madhe në të cilën ka vend për të gjitha vlerat dhe pasuritë e kombeve dhe popujve. Në botën globale vendet e vogla nuk pritët të konkurojnë me ekonomitë dhe pasuritë e tyre materiale. Megjithatë, me identitetin dhe vlerat më të çmuara të tyre, ato mund të kontribuojnë në pasurimin e shoqërisë globale, duke krijuar një mozaik të pasur vlerash, kulturash që njohin, respektojnë e zhvillojnë njëra-tjetrën.

“Rasti Shqipëri”, si një rast shembullor i bashkëjetesës së besimeve në rrugën e gjatë të historisë, shumë shpejt filloi të trajtohej si “Fenomeni Shqipëri”, i cili mori rëndësi jo vetëm si një çështje kulturore-historike, por, mbi të gjitha, si një përvojë e dobishme për njerëzimin, si një mundësi evokimi dhe inkurajimi në mjedise ndërkombëtare.

Shqipëria ka qenë zona ku takoheshin dhe ndaheshin dy perandoritë më të mëdha të mesjetës: Roma dhe Bizanti. Po ashtu, Shqipëria ishte vendi ku takohej dhe ndahej autoriteti i dy kishave: romane dhe bizantine. Dy perandoritë dhe dy kishat, megjithëse rivale dhe kundërshtarë të forta të njëra-tjetrës, te shqiptarët asnjëherë nuk u bënë shkak konflikti. “Vija e Teodosit” e ndau qysh në fundin e paleokrishtërimit

hapësirën shqiptare në dy pjesë, njëra nën pushtetin politik e fetar roman dhe tjetra nën pushtetin politik dhe fetar bizantin. Por kjo ndarje asnjëherë nuk u kthye në kufi midis vetë shqiptarëve. Islami në Shqipëri është një besim fetar, që bashkëjeton me Evropën prej shekujsh dhe është një prej feve përbërëse të saj.

Toleranca te shqiptarët nuk është vetëm fetare, por edhe gjuhësore dhe në shumë raste edhe etnike. Në vitet e Luftës së Parë Botërore në Shqipëri kishte ushtri të huaja të shumta në numër, gati sa në gjithë Ballkanin: austriake, franceze, italiane, greke, serbe, malazeze e bullgare. Kur lufta mori fund dhe këto ushtri nuk kishin as ushqim, as ilaçe, e mjete për t'u kthyer në atdheun e vet, populli shqiptar i mbajti nëpër familje, megjithëse e dinte mirë se shumica e tyre kishin bërë krime mbi vetë shqiptarët. Në periudhën pas 8 shtatorit 1943, kur Italia fashiste kapitulloi, në Shqipëri gjendeshin mijëra milicë dhe oficerë, që kishin ardhur në Shqipëri si ushtri pushtuese. Kjo ushtri u gjend brenda dy javësh e çarmatosur dhe e trajtuar si ushtri dezertore, e destinuar për t'u shfarosur nga ushtria naziste. Por populli shqiptar e shpëtoi këtë ushtri nga tmerri që e priste, megjithëse ajo ushtri kishte vrarë e djegur, kishte dhunuar e plaçkitur. Ushtarët italianë u veshën me kostume tradicionale shqiptare dhe u strehuan në familjet e shqiptarëve.

I pashembullt është qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Qeveritë shqiptare, që bashkëpunuan me autoritetet fashiste dhe naziste, si kudo në botën e asaj kohe, bashkëpunuan si qeveri vasale, por ato asnjëherë nuk ua dorëzuan ushtrive të huaja listat e hebrenjve.

Shqipëria është vendi i vetëm në botë ku, megjithëse në kushte pushtimi të dyfishtë, asnjë hebre nuk u dorëzua, asnjë hebre nuk përfundoi në kampe përqendrimi, asnjë hebre nuk u viktimizua. Dhe nuk është fjala për hebrenjtë e vetë Shqipërisë, shtetas të saj, por për afro 3.000 hebrenj të ardhur nga shtetet ballkanike, në arrati e sipër për t'i shpëtuar rrezikut të zhdukjes atje ku ishin.¹⁸

Toleranca përbën edhe një tipar etnotipik të shqiptarëve. Ndoshta kjo cilësi është e lidhur edhe me pozitën gjeopolitike të shtetit shqiptar. Ndërsa Perëndimi e ka parë Ballkanin dhe portën e tij - Shqipërinë - si një Lindje ekzotike; përkundrazi, Lindja e ka parë atë si Perëndim. Në kryqëzim të dy botëve, shqiptarët kanë marrë e dhënë me të dyja, duke ruajtur thelbin e vet identifikues, duke shërbyer si urë kalimi ndikimesh dhe duke përvetësuar edhe vetë prej tyre. Kështu u formua te shqiptarët bindja historike se dallimi, qoftë ky fetar, rajonal, racor, gjenetik, kombëtar, kulturor etj. nuk është rrezik, por pasuri. Një bindje e tillë ka formësuar tolerancën ndërfetare dhe më gjerë te shqiptarët, një bindje e tillë e ka bërë qytetërimin e saj një qytetërim të hapur.

Pluralizmi paqësor fetar ka shërbyer si element bashkues midis njerëzve, familjeve dhe grupeve të ndryshme në shoqëri. Komunitetet fetare mbeten besnike e frymëzimeve të tyre fillestare të së mirës dhe paqes, si dhe me përkushtim të madh luajnë rol aktiv në kapërcimin e problemeve sociale, shoqërizimin e të rinjve, forcimin e rolit të familjes, kulturës

¹⁸ Presidenti Moisiu, A., Londër, 9.11.2005, fjalim; Loloci, C., gazeta "Trepça", 4 gusht 2005.

dhe identitetit kombëtar. Me kontributin e tyre të veçantë Shqipëria përfaqëson edhe një nga rastet e rralla të një vendi me besime të ndryshme fetare, ku të gjithë faktorët politikë e shoqëror, përfshirë edhe komunitetet fetare, janë përkrahës të fuqishëm të integritit të vendit në Bashkimin Evropian. Vlerat nuk janë të përjetshme, ato duhen ruajtur e kultivuar në mentalitetin e qytetarëve dhe në kulturën demokratike. Në të njëjtën mënyrë është e nevojshme të shndërrohet kultura e dialogut midis besimeve dhe komuniteteve të ndryshme fetare, në urë bashkimi e komunikimi, shkëmbimi dhe lidhje më të fortë midis njerëzve e vendeve.

Dhe në fakt një vlerë e rëndësishme me të cilën Shqipëria sot krenohet është pikërisht bashkëjetesa mes komuniteteve të ndryshme fetare. Janë të shumtë ata që e konsiderojnë këtë si një pasuri pasi mund të jetë një rast unik, që në të gjithë historinë e vendit, nuk janë shënuar asnjëherë përplasje fetare. Megjithatë shembujt e kohëve të fundit në botë, por edhe në rajonin e Ballkanit kanë dëshmuar se ekuilibrat fetare janë shumë të brishtë dhe shpesh herë manipulimet me to kanë sjellë pasoja të rënda.

Myslimanët, ortodoksët, katolikët dhe bektashinjtë u kanë kërkuar autoriteteve shtetërore që të mbrojnë lirinë e të gjithë përfaqësuesve të autorizuar, apo udhëheqësve fetarë që të përmbushin misionin e tyre. Ato kanë kërkuar hartimin e rezolutës mbi statusin ligjor të komuniteteve fetare, si dhe kthimin e pronave të shtetëzuara, apo konfiskuara në kohën e komunizmit.

Kështu në një studim të tijin Fuga thekson gjithashtu se, mungesa e një debati për çështje themelore teologjike nuk

është një bazë e sigurt, që na garanton për të pasur gjithmonë paqe sociale dhe bashkekzistencë fetare, që i kemi trashëguar si pjesë përbërëse të thesarit kombëtar deri më sot. Konflikti social dhe ndasitë me bazë sociale dhe fetare mund të lindin nëse nuk trajtohen demokratikisht, edhe nga dallime të dorës së dytë, jo të mirëfillta fetare, por “mbi fenë”, për shembull lidhur me vendosjen e një monumenti në një rrugë qyteti, me formën e kangjellave, që rrethon një ndërtesë publike, me vendosjen e një simboli fetar në një kodër a në një buzë rruge, mbi një çështje varresh, dhe për çështje të tjera, që nuk kanë natyrë të mirëfilltë teologjike. Në këtë rast, konflikti, në të vërtetë, nuk e ka bazën e vet brenda fushës së mirëfilltë të dialogut ose të debatit, por e gjen burimin në lindjen dhe marrësin e disa konflikteve sociale, që e gjejnë pastaj shprehjen e tyre te divergjenca simbolike, gjuhësore ose alternativash për shpjegimin e historisë. Baza e këtij debati jo fort demokratik, që e kemi njohur kohët e fundit në disa raste, ka të bëjë më tepër me divergjenca sociale, rajonale, grupimesh shoqërore, gjeopolitike, të cilat i përdorin dallimet fetare ose historitë e marrëdhënies midis kombit dhe feve, si instrumente ideologjike veprimi në të sotmen dhe si objektiva për t’u arritur në të ardhmen.¹⁹

Qëllimi më i lartë i dialogut ndërfeetar, moral, politik është që ai ta mbajë gjithmonë të gjallë veten e vet, pa shkarë në fanatizëm dhe skajshmëri të të gjitha llojeve. Nëse deri më

¹⁹ Fuga, Artan, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfeetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:32.

tani në Shqipëri ai e ka ruajtur veten e tij, duke qëndruar pak në hije, në të ardhmen, ai me siguri që do të ndodhet përballë sfidash të reja, ku do t'i duhet ta pohojë veten e vet jo nëpërmjet mungesës, por nëpërmjet një filozofie, metode dhe kulture, që frymëzon tolerancë dhe bashkëjetesë.²⁰

Nga të dhënat sociologjike që janë mbledhur, gjykohet se në shoqërinë shqiptare përkatësitë fetare të besimtarëve të ndryshëm nuk i kanë mbyllur ata brenda një ndërgjegjeje dhe lidhjeje të ngushtë ekskluzive të përcaktuar nga feja e tyre.

Po të shikojmë në një rrafsh më të gjerë ndërkombëtar, do të vërejmë se brenda të gjitha llojeve të besimit ka diskutime dhe debate lidhur me interpretimin jo të bazave teologjike, por të zbatimit të tyre konkret lidhur me probleme shoqërore sikurse janë marrëdhëniet dhe sistemet politike, ose të problemeve që kanë të bëjnë me situatat e sotme bashkëkohore sikurse janë luftërat, paqja, planifikimi familjar, sëmundjet sikurse janë sida, ose edhe të mënyrës së realizimit të disa akteve jetësore sikurse janë, për shembull, ato martesore, familjare, mënyrat e ndërtimit të simbolikave fetare në formë veshjesh ose shenjash të tjera karakteristike, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, etj.

Dialogu ndërfaqetar nuk është një dukuri vetëm brendafetare. Ai përfshin edhe një debat të kuptueshëm dhe fare të natyrshëm edhe midis besimtarëve dhe jobesimtarëve, laikëve, ateistëve, për probleme, që kanë të bëjnë me kuptimin e botës, të shoqërisë dhe të vetë njeriut. Lidhur me këto probleme

²⁰ Po aty, 35.

as shkenca e as filozofia, nuk mund të pretendojë se kanë ekskluzivitetin e trajtimeve të sakta, pikërisht sepse ato nuk mund të jenë veçse gjykime interpretuese. Të gjitha këto forma të mendimit dhe të ndërtimit të vlerave shpirtërore kanë si qëllim human realizimin e kushteve të paqes, të mirëkuptimit dhe të konsolidimit të pozicionit të njeriut në botë dhe të përgatitjes së tij për të përballuar sfidat, që kanë të bëjnë me jetën ose edhe me vdekjen e tij. Dhe këtë rol i takon ta luajnë liderët fetarë.

Nuk duhet të harrojmë se nga pikëpamja filozofike-fetare, feja dhe shkenca, nuk konceptohen më si të ndara dhe armiqësore me njëra-tjetrën, por si dy regjistra të ndryshëm, komplementarë, të të kuptuarit të botës, si dy mënyra plotësuese të leximit të botës dhe të njeriut.

Sikurse del edhe nga studimet e ndryshme, fetë, pavarësisht dallimeve, kanë edhe tipare të përbashkëta. Besimi te i Gjithëfuqishmi, te pavdekësia e shpirtit, aq më shumë insistimi te ruajtja dhe konsolidimi i vlerave morale, sikurse janë ndershmëria, respekti ndaj tjetrit, dashuria dhe miqësia, toleranca, falja, etj., karakteristika të shumicës së besimeve fetare, përbëjnë atë bazë ku fetë e ndryshme, por edhe filozofët, gazetarët, sociologët, shkencëtarët, besimtarët, laikët, skeptikët apo edhe ateistët, kanë një hapësirë të gjerë jo vetëm dialogu të shëndoshë, por edhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të thellë.

Kuptohet qartë, sikurse e kanë vënë mirë në dukje teologë të shquar të kohëve tona ose të së kaluarës, ky bashkëpunim dhe dialog nuk përjashton dhe nuk cenon aspak besnikërinë e çdo besimtari, kleriku, filozofi, shkencëtari,

apo qytetari të thjeshtë ndaj parimeve të fesë së tij. Nuk është pra, aspak fjala për të shuar dallimet dhe diferencat në besime, sepse kjo do të na krijonte një botë uniforme shumë të trishtë, por është fjala për diçka tjetër, për atë parim të madh që personalitete të ndryshme e kanë shpjeguar aq bukur, pra të dialogut midis të ndryshmeve, të gjetjes së pikave të përbashkëta në diferencat në perceptimin e botës dhe të mistikës, të bashkëpunimit brenda dallimeve në perspektiva, të një hapësire publike të opinionit, ku secili duke ruajtur po të dojë edhe me fanatizëm parimet e botëkuptimit të tij të veçantë, di të shohë te tjetri pika që i bashkojnë në një të tërë unike, që iu shfaqet në forma të ndryshme.

Sociologu i njohur Durkheim thotë: *“Meqë të gjitha fetë janë të krahaseshme, derisa janë lloje brenda se njëjtës gjini, detyrimisht disa elemente thelbësore i kanë të përbashkëta”*²¹ dhe duke e vazhduar më tej mendimin e tij, autori nënvizon se *“...feja është një gjë thellësisht shoqërore”*²². Nisur edhe nga këto përcaktime, historia e bashkëjetesës ndërmjet shqiptarëve me përkatësi fetare të ndryshme, duhet vlerësuar si një fakt konkret, si një dukuri sa religjioze, po aq dhe shoqërore, si një formë e shprehjes së gjërave më thelbësore, të përbashkëta në universin fetar.²³

²¹ Durkheim, Emile, “Format elementare të jetës fetare”, Tiranë, 2000:20.

²² Po aty, 24.

²³ Gjoka, Rasim, “Tipologjia e konflikteve me natyrë fetare”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:83.

Historiani italian Roberto della Rocca, në një referim të tij, shprehet: *“Pluralizmi paqësor fetar i Shqipërisë është një vlerë për vendin, për Ballkanin, për Evropën. Ai mund të jetë një model i bashkekzistencës në një Evropë me shumë fe, e cila ka vështirësi për të kuptuar enën e saj shkrirëse.”*²⁴

Në përmasat e pluralitetit fetar shqiptar vërehet qartazi se bashkekzistenca dhe harmonia fetare ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri bëhet më e lehtë për faktin, se ato lidhen edhe me disa karakteristika të veçanta, që kanë të bëjnë me shkallën e lartë të homogjenitetit të popullsisë, që ndan të njëjtat vlera kulture e gjuhe, pa përjashtuar diversitetin kulturor dhe subkulturat.²⁵

Prania dhe bashkekzistenca e tre besimeve të popullit shqiptar: mysliman, ortodoks dhe katolik, ka bërë që toleranca ndërfetare të jetë një domosdoshmëri historike, duke shërbyer kështu, si mjet dhe faktor, që ka siguruar unitetin kombëtar dhe ekzistencën tonë si komb, megjithëse shqiptarët kurrë nuk e kanë ndarë përkushtimin fetar nga interesi kombëtar.

Në krijimin e një fryme tolerante, krahas besimeve fetare dhe përfaqësuesve të tyre ndër vite, ka ndikuar edhe trashëgimia socio-antropologjike e shqiptarëve, sistemi shoqëror tradicional dhe ai i vlerave.

Evropa duhet bërë të kuptojë se realiteti fetar i Shqipërisë është pasojë e historisë së veçantë të gadishullit ballkanik

²⁴ “Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri”, konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2004.

²⁵ Gjoka, R., “Tipologjia e konflikteve me natyrë fetare”, Tiranë, 2010:84.

dhe s' duhet të jetë kurrsesi shkak për ta parë atë me dyshim. Islami në Ballkan është dhe duhet parë, si një pasuri kulturore dhe shpirtërore, pjesë përbërëse e historisë evropiane.²⁶

Harmonia ndërjetare është shfaqur si një përbërës i rëndësishëm i modelimit psikokulturor të shqiptarëve, duke kaluar drejt një vetëdije kombëtare për këtë vlerë.

E ruajtur thellë në ndërgjegjen e besimtarëve, gjatë regjimit komunist feja kishte humbur përkohësisht vetëm klerin dhe shfaqjen e saj të jashtme, ceremoniale. Sistemi monist nuk mundi të depërtonte deri në thellësi të shpirtave njerëzore. Kur ky sistem u përmbys, baza për ringjalljen e fesë ekzistonte e paprekur. Ajo u rishfaq me elegancë të pashoqe, duke rindërtuar me shpejtësi gjithçka, që ishte shkatërruar materialisht. Të persekutuar njësoj nga regjimi komunist, të gjitha besimet fetare u paraqitën me tiparet e tyre të plota doktrinare dhe rituale. Diversiteti fetar u rishfaq kështu fare natyrshëm. “Të ndryshmit” nga njëri-tjetri, ashtu si dikur, vazhduan të bashkëjetojnë në harmoni shembullore.

Përfundimi, që del nga kjo përjasje e shkurtër historike, është se diversiteti nuk zhduket dot artificialisht dhe herët a vonë, nxjerr krye për ta kujtuar këdo se është i pranishëm dhe se me të duhet me u marrë seriozisht. Rrjedhimisht, studimi i diversitetit në çdo fushë, përcaktimi shkencor i përmase dhe karakteristikave të tij në shkallë kombëtare, komu-

²⁶ Misha, Pirro, “Kombi, feja dhe globalizmi në Shqipëri”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:82.

nitare dhe individuale, përbën një domosdoshmëri për të prodhuar më shumë tolerancë e mirëkuptim midis njerëzve në një shoqëri të hapur demokratike.

Në realitetin shqiptar, diversiteti fetar shfaqet si prodhues masiv tolerance, që e ka bazën pikërisht në pranimin pa kushte të faktit se “tjetri” është i ndryshëm, por jo i papranueshëm ose edhe armiqësor. Kjo nuk do të thotë se besimtarët e feve të ndryshme nuk kanë anë të përbashkëta, të cilat luajnë rol në harmoninë, që ata kanë midis tyre, por ato nuk duhen mbivlerësuar. Glorifikimi absolut i anëve të përbashkëta në procesin e praktikimit të tolerancës, sado që tingëllon bukur, në thelb nuk është produktiv, sepse mohon disi nevojën e përsosjes së vazhdueshme të dialogut ndërfaqet, në një kohë që është ky i fundit ai që zotëron potencialin, për të zbuluar ngjashmëri të reja gjithmonë e më të thella.²⁷

Harmonia ndërfaqetare, që ekziston në Shqipëri është fryti një ndërveprimi të shkëlqyer midis diversitetit dhe tolerancës. Ajo ka krijuar kushte të mrekullueshme për një dialog ndërfaqet në nivel kapilar, nëpërmjet të cilit të realizohet njohja e ndërsjellë e “ndryshimeve” dhe pranimi i tyre si kusht për thellimin e këtij dialogu.²⁸

Mbështetur në historinë e këtij vendi, besnikëria ndaj harmonisë ndërfaqetare nuk mund të fiksohet vetëm te toleranca

²⁷ Kule, Virgjil, “Pranimi dhe njohja e diversitetit-kusht për harmoni dhe dialog ndërfaqet”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqet në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:104.

²⁸ Po aty, fq. 112.

fetare, por në një gjykim bashkëkohor të përbashkët të shqiptarëve, që do të thotë një gjykim qytetarie, barazi para ligjit, harmoni dhe solidaritet kombëtar, përfaqësim sa më i drejtë i komuniteteve fetare në strukturat civile, shpirt tolerance dhe mirëkuptimi mbi çështje të ndryshme të jetës së përditshme, etj..

Përvoja shqiptare e bashkëpunimit ndërfeetar

Në vitet e fundit bashkësitë tradicionale fetare në Shqipëri janë angazhuar në një sërë përpjekjesh për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë fetare në vend. Këto përpjekje janë përkrahur edhe nga organizata e programe të huaja e ndërkombeëtare, që përkrahin zhvillimin e dialogut dhe të bashkëpunimit ndërfeetar në botë.

Forcimi i harmonisë fetare kërkon edhe një klimë të favorshme të jetës publike, ku diferencat fetare njihen, respektohen si vlera dhe nuk shihen si burime të padiskutueshme konflikti. Projekti për Përsosjen e Vlerave të Harmonisë Fetare përkrahu një sërë veprimtarish, që synonin në krijimin e një klime të tillë: prodhimin e filmave dokumentarë, që dokumentojnë vlerat e harmonisë fetare në vend dhe venë në pah të përbashkëtat e vlerave fetare në të rinj të besimeve të ndryshme, takime e trajnime me gazetarë e studentë, lehtësimin e dialogut mes udhëheqësve fetarë, gazetarëve dhe akademikëve, si dhe studime lidhur me marrëdhëniet ndërfeetare në Shqipëri. Analiza e përvojës së programeve të përmendura më lart, por edhe të disa përpjekjeve të tjera, si p.sh. të një

programi për kultivimin e dialogut ndërfetar në shkollat fetare në vend, tregon se përpjekje të tilla hasin në disa sfida.²⁹

Jeta shqiptare është shumëplanëshe. Pavarësisht nga laïciteti i shtetit, bota e fesë zë aty një vend të rëndësishëm me ndikime të gjera në plan kombëtar e ndoshta, për Shqipërinë, më shumë në plan ndërkombëtar. Nëse duam të promovojmë më tej, bie fjala, harmoninë ekzistuese ndërfetare, na duhet t'i njohim në detaje mjediset, ku ajo lind dhe zhvillohet. Këtu kërkohet kontribut nga media, por edhe nga komunitetet dhe institucionet fetare, të cilat duhet t'i bëjnë të ditur medias linjat themelore, ku ngjizet bashkëveprimi dhe harmonia brenda dhe midis tyre.

Aktivitete akademike të dialogut ndërfetar në Shqipëri

Tashmë që pas viteve 90 në Shqipëri janë organizuar shumë konferenca, simpoziume dhe aktivitete ndërfetare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Krahas këtyre aktiviteteve ndër vite, dua të ndalem në bashkëpunimin akademik dhe pedagogjik të Universitetit Bedër në përgjithësi dhe të Departamentit të Shkencave Islame në veçanti, të cilët në një bashkëpunim ndërfetar midis tre teologjive në Shqipëri, asaj Islame në Bedër, Ortodokse, nëpërmjet Akademisë Teologjike Ortodokse, Shën Vlash, Durrës dhe Institutit Teologjik Katolik në Seminarin Ndërdioqezian,

²⁹ Rugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:51.

Shkodër, kanë hedhur hapa konkretë prej disa vitesh në këtë fushë.

Kështu tashmë pas zhvillimit të seminareve dhe leksioneve të hapura të dialogut ndërjetar dhe shpjegimit teologjik të besimit të secilit me studentët e tre teologjive nga pedagogët e teologjive të ndërsjella, prej tre vitesh janë zhvilluar gjashtë simpoziume ndërjetare, të organizuara me radhë në tre institucionet arsimore, duke e kthyer këtë organizim në një traditë, që vazhdon me një periodik të caktuar, prej dy herësh në vit.

Këto organizime bashkëpunimi ndërjetar dhe shumë aktivitete të tjera të këtij lloji, e mveshin Universitetin Bedër me një specifikë dhe mision të veçantë, të cilët kontribuojnë në paqen sociale në Shqipëri dhe përtej saj, si dhe janë garanci të ruajtjes, promovimit dhe forcimit të frymës së bashkëpunimit midis të ndryshmëve, si një pluralizëm multikulturor dhe multifetar, në një botë që edhe pse çdo ditë e më tepër vjen e globalizohet, shtohen sfidat dhe problematikat për të ruajtur vlerat universale, që duhet të karakterizojnë një shoqëri të shekullit XXI.

Në vend të mbylljes

Përkatësia multifetare e shqiptarëve e bën më të pasur dhe më të ndërlikuar identitetin kombëtar. Këtë e dëshmojnë të dhëna të panumërta të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar. Por, nuk ka dyshim se përkatësia multifetare, përpos se e bën më të pasur dhe më të përbërë, mund ta bëjë edhe më të plagosshëm identitetin kombëtar shqiptar,

natyrisht, në qoftë se ndonjëra prej këtyre besimeve fetare do të favorizohej në mënyrë të veçantë prej institucioneve politike e shtetërore, siç veprohet herë pas here pas viteve '90.

Njëra prej dukurive më të vërejtura në jetën shoqërore të shqiptarëve sot, pa dyshim është shprehja e lirë e vetëdijes fetare, aq e penguar në kohën e komunizmit dhe kjo shprehje e lirë e vetëdijes fetare është fryt i çmuar i zhvillimit të demokracisë në shoqërinë tonë.

Shqiptarët, prej shekujsh jetojnë në udhëkryqin mes Lindjes e Perëndimit dhe janë ndikuar prej qytetërimit të Krishterë dhe atij Islam. Ndërthurja e kulturave të ndryshme e ka pasuruar kulturën shqiptare, duke e bërë të veçantë në rajon dhe në botë.

Rrënjët e kulturave dhe të qytetërimeve të popujve janë të thella: ato shtrihen thellë në kohë dhe janë materiale e shpirtërore. Në kohën e globalizmit është e vërtetë se ato rrënjë po dobësohen: njerëzit në krejt botën jetojnë gjithnjë e më një-lloj, argëtohen gjithnjë e më njëlloj, mendojnë e flasin për gjëra gjithnjë e më të përbashkëta.

Humanisti Karlos Fuentes thotë mbi dialogjet dhe marrëveshjet e vetëkuptueshme të qytetërimeve, siç e thonë gjithashtu antropologët dhe etnologët modernë, se “nuk ka kultura të larta e të ulëta; ka vetëm kultura të ndryshme që, secila në mënyrën e vet, i plotëson nevojat dhe dëshirat e pjesëtareve të saj”.³⁰

³⁰ Qosja, Rexhep, Gazeta “Korrieri”, 10 Shkurt 2006.

Bibliografia:

- “Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri”, konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2004.
- Anamali, Skender, ‘Ilirët dhe shqiptarët’ në “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, 1990.
- Bernatzik, Hugo Adolf, “Shqipëria-vendi i shqiptarëve”, botuar nga Uegen, Tiranë, 2003.
- Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1962:111; Xhufi, Pëllumb, “Shqipëria dhe bota mesdhetare në Mesjetë” (shek. XI-XIV), “Studime historike”, 2, 1990.
- Deklarata universale e të drejtave të njeriut, neni 18.
- Dervishi, Zyhdi, “Fakte rrjedhëse të mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve: një provë shpjegimore”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.
- Dervishi, Zyhdi & Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Tiranë, Prizmi, 2008.
- Durham, Edith, “Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë edhe shqiptarët”, Sh.N. “8 Nëntori”, Tiranë, 1990.
- Durkheim, Emile, “Format elementare të jetës fetare”, Tiranë, 2000.
- Ergene, Enes, “Drejt një qytetërimi botëror me dashuri dhe tolerancë”, Prizmi, Tiranë, 2005.
- Fuga, Artan, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.

- Gjoka, Rasim, “Tipologjia e konflikteve me natyrë fetare”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.
- Kule, Virgjil, “Pranimi dhe njohja e diversitetit-kusht për harmoni dhe dialog ndërfaqetar”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.
- Misha, Pirro, “Kombi, feja dhe globalizmi në Shqipëri”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.
- Presidenti Moisiu, A., Londër, 9.11.2005, fjalim; Loloci, C., gazeta “Trepça”, 4 gusht 2005.
- Qosja, Rexhep, Gazeta “Korrieri”, 10 Shkurt 2006.
- Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.
- Said, Eduard, “Orientalizmi”, 1995.
- Ulqini, Karaman, “Faktorë kulturorë e fetarë”, Shkodër, 1999.
- www.president.al, faqja zyrtare e Presidencës, 9.11.2005.

Prof. dr. Hysen MATOSHI

KULTUROCIDI MBI HAPËSIRËN ETNIKE TË MUHAXHIRËVE SHQIPTARË

Ndryshimet e mëdha në historinë e shekullit XIX, që sollën defaktorizimin e ndjeshëm të Perandorisë Osmane dhe forcimin e rolit të Rusisë cariste në hapësirën evro-aziatike, ndikuan edhe në fatin e shqiptarëve. Dy tubime të mëdha të karakterit ndërkombëtar, sikurse Paqja e Shën e Stefanit dhe Kongresi i Berlinit¹, e tkurrën ndjeshëm hapësirën etnike të shqiptarëve, duke iu bërë vend interesave ruse dhe sllave përgjithësisht, pa harruar me këtë rast edhe interesat greke. Duke mos qenë një subjekt politik, Shqipëria etnike, si pjesë e Perandorisë Osmane, u zvogëlua ndjeshëm në pjesët e saj

¹ Shih *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, vëllimi II, f. 1254, 2009, vëllimi III, f. 2736; Mr. Halil Alidema, *Paqja e Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit (vendimet dhe refleksimet e tyre)*, përgatiti për shtyp Prof. dr. Hakif Bajrami, Prishtinë, 2004, f. 168.

veriore dhe jugore. Faktet mbi pësimet gjeografike e demografike të shqiptarëve tashmë janë të njohura.² Për to besoj se do të flitet në vijimësi në kontributet historiografike si për njërën ndër tragjeditë më të mëdha që pësuan shqiptarët që nga koha e lindjes së shteteve ballkanase. Mjafton të kujtojmë me këtë rast Proklamatën e princit Milan Obrenoviç, drejtuar njërive ushtarake që kishin marrë përsipër t'i spastronin këto vise nga popullsia autoktone shqiptare: “Sa më pak arnautë të mbesin në territoret e çliruara nga Turqia, aq më shumë do të kontribuoni për shtetin. Sa më shumë arnautë të shpërngulur, aq më të mëdha meritat për atdhe!”³ Në të vërtetë kjo proklamatë u zbatua pothuajse tërësisht, ngase popullsia shqiptare e këtyre viseve u zhbë për një kohë të shkurtër, duke përjashtuar vetëm pak fshatra të mbetura në rrethinën e Medvegjës, ndonëse edhe prej tyre pati popullatë të larguar shqiptare.⁴

Nëse deri diku ne e kemi trajtuar çështjen e shqiptarëve të vrarë, të shpronësuar e të dëbuar, përkatësisht çështjen e zvo-

² Shih: Dr. Sabit Uka, “*Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë (1877/1878-1912)*”, Libri I-II, botim i dytë, Prishtinë, 2004; Dr. Sadik Mehmeti, “*Dokumente osmane për shpërnguljen e shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në Arkivin e Maqedonisë*”, “Albanologji”, nr. 5, 2014, Prishtinë, 2015, f. 435-440. (Punimet nga konferenca shkencore “Java e Albanologjisë”, mbajtur më 16-18 qershor 2014.)

³ Dimitrije Mita Petroviç, *Luftimet në Toplicë 1877-1878*, përktheu Hamit Gurguri, botoi “Erik Hans”, Bora, Suedi, 2017, f. 23.

⁴ Për më shumë informacione lidhur me fshatrat shqiptare të Komunës së Medvegjës shih librat e mr. Bislim Pirevës: *E folmja shqipe e Jabllanicës së Epërme të Medvegjës* (1995) dhe *Shkolla shqipe në Komunën e Medvegjës* (1998).

gëlimit të ndjeshëm të hapësirës etnike shqiptare, duhet thënë se një vëmendje e tillë nuk i është kushtuar trashëgimisë që kjo popullsi autoktone e la prapa vetes, në trojet e saja etnike. Shqiptarët, duke pasur një vijimësi jetese shekullore në këto hapësira, krijuan edhe vlera të kulturës së tyre dhe të identifikueshme me ta në kontekstin historik e shoqëror.

Largimi i detyrueshëm, në përpjekje për ta shpëtuar jetën, ishte i shoqëruar me dhembje të madhe pikërisht për një varg dëshmish esenciale kulturore që nuk mund të merreshin me vete. Kështu, nga dëshmi të shumta të kohës del se muhaxhirët shqiptarë morën me vete, përveçse rrobave të trupit, vetëm shpirtrat dhe kujtesën e trashëgiminë e tyre shpirtërore. Trevat, në të cilat popullsia shqiptare ishte e konsiderueshme, shumicë dërrmuese, ose edhe popullsi e vetme, nga pushtuesit e rinj, përveçse u spastruan në planin etnik, për një kohë të shkurtër, u spastruan edhe në planin kulturor. Qëllimshëm u eliminuan pjesa më e madhe e fakteve kulturore të cilat dëshmonin se më parë aty kishte një popullsi e cila nuk ishte serbe. Pamja e vendbanimeve, veçmas e atyre urbane, ndryshoi rrënjësisht. Nuk u rrënuan vetëm tempujt fetarë, ngase një fat të tillë e përjetoi edhe infrastruktura tjetër arkitekturore me shtresime islame e orientale, e cila u shfityrue rëndë. Një varg mejtepesh, medresesh, karvan sarajesh, hanesh, hamamesh, imaretesh e objekteve të tjera, që të kujtonin të kaluarën, u zhbënë. Madje, u shkatërruan edhe monumentet mbivarrore dhe varrezat e popullsisë autoktone u kthyen në hapësira për destinime të tjera. Sot, në këto hapësira, është vështirë të gjesh përbërës kulturorë që i përkisnin popullsisë së dëbuar autoktone. Se sa u shfityrue kjo pjesë e botës shqi-

ptare mund të kuptojmë më mirë nga një krahasim ndërmjet gjendjes së saj para pushtimit serb dhe gjendjes së sotme.

Në mënyrë të veçantë u vunë në plan të parë atakues xhamitë, mesxhidet, teqetë dhe tyrbet, ndër të cilat kishte edhe monumente të rralla kulturore, madje disashekullore. Se cilat ishin përmasat e këtij shkatërrimi mund të bindemi lehtë nga të dhënat, të cilat i ka qëmtuar gjithandej studiuesi i mirënjohur dr. Sabit Uka⁵, njëri ndër njohësit më të mirë të fatit tragjik të kësaj trashëgimie kulturore islame e shqiptare. Duhet thënë se shkatërrimi i objekteve të këtilla rëndom fillonte me plaçkitjen masive që u bëhej. Edhe vetë autorë serbë e pohojnë një fakt të këtillë. Bie fjala, Dimitrije Mita Petroviç, lidhur me këtë çështje shkruan: “Nëpër shtëpia kishte gjëra të bukura e rroba, por pak gjëra i morën (lexo i plaçkitën, vër. H.M.) ushtarët, pasi as nuk mund t’i bartnin. Në xhamia kishte qilima të mirë, por ata i mblodhën zyrtarët”.⁶ Marrë parasysh gjerësinë e kësaj teme, në këtë format shkrimi, kam ndërmend të sjell vetëm disa sosh dhe një varg të dhënash për praninë e tyre si objekte kulti që i jepnin një ngjyrim të caktuar identitar një pjese të konsiderueshme të qyteteve në Serbinë e sotme.

Do të nisim nga Beogradi, kryeqytet i Serbisë së sotme dhe Jugosllavisë së dikurshme. Duhet thënë se në kohën e vizitës së Evlija Çelebiut, viti 1660, qyteti kishte 270 objekte

⁵ Dr. Sabit Uka, “*Xhamitë, mesxhidet dhe teqetë në Sanxhakun e Nishit deri më 1878*”, në vëllimin “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët” (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 147-151.

⁶ Dimitrije Mita Petroviç, *Luftimet në Toplicë 1877-1878...*, po aty, f. 70.

fetare islame, duke përmendur me emër vetëm ato xhami në të cilat falej namazi i xhumasë. Autori, me këtë rast, potencon emërtimet konkrete për 35 xhami dhe 12 mesxhide.⁷ Ky fakt kontestohet nga shkenca serbe, e cila thekson se Beogradi nuk kishte më shumë se 70 xhami. Megjithatë, Evlia Çelebiu ofron edhe të dhëna për një numër prej 17 teqesh, ndër të cilat e përmend Teqenë e Dervish Mehmet Horasanit, të themeluar nga Mehmet Pasha i biri i Jahja Pashës.⁸ Se Beogradi ishte një qendër me identitet të këtillë e dëshmon edhe fakti i ekzistimit të një sistemi arsimor që përfaqësohej nga 270 shkolla fillore (mejtepe), nëntë shkolla për mësimin e traditës së shenjtë të hadithit (dâru 'l-hadîth) dhe tetë medrese të njohura, ndër të cilat potencon Medresenë e Xhamisë së Imaretit dhe Medresenë e Xhamisë së Bajram Beut.⁹ Edhe objektet e tjera publike e sociale të karakterit oriental - islam, sipas këtij udhëpërshkruesi të njohur, ishin shumë të përhapura, sikurse janë çezmat me mbishkrime emrash dhe kushtimesh të bami-rësve, sebilat, karvan sarajet, hanet e tregtarëve, çarshia, tregu, hamamet etj. Struktura e këtillë e objekteve fetare ishte pasqyrim i saktë edhe i strukturës së popullsisë, e cila në rreth 80 për qind ishte e përkatësisë islame, përkatësisht nga 98 mijë veta vetëm 21 mijë nuk ishin myslimanë. Pak a shumë edhe vetë të dhënat e Evlia Çelebiut për objektet feta-

⁷ Evlija Çelebi, *Putopis* (Odlomci o jugoslovenskim zemljama), përkthyer në serbokritisht, përgatitur dhe komentuar nga Hazim Šabanović, "Veseljini Masleša", Sarajevë, 1973, f. 85.

⁸ Evlija Çelebi, *Putopis...*, po aty, f. 87.

⁹ Po aty.

re të përkatësisë joislame e vërtetojnë këtë raport të popullsisë.¹⁰ Askush nuk pretendon që karakteri i qartë oriental i këtij qyteti, të cilin e kishte para pushtimit serb, të ruhej deri në ditët e sotme, por është e pakuptimtë që të rrënohet e gjithë kjo trashëgimi, e cila përfaqëson disa shekuj të jetës së qytetit të bukur në brigjet e Savës dhe të Danubit. Në të vërtetë, nga krejt këto vlera kulturore deri në ditët e sotme ka mbetur vetëm Bajrakli Xhamia, e cila, për fat të keq, nën thirrjet “vdekje shqiptarëve”, është djegur më 2004 bashkë me 7000 vepra, dorëshkrime të rralla të periudhës osmane.¹¹ Objekti është rinovuar vetëm pjesërisht, ndërsa dëmi i shkaktuar sa i përket trashëgimisë shkrimore mbetet i pakompensueshëm. Në manifestime të ndryshme, me sens nacionalist, që organizohen në kryeqytetin serb, mbi muret e kësaj xhamie, edhe sot e gjithë ditën vijnë të shkruhen rregullisht grafito fyese dhe porosi kërcënuese për përkatësi të tjera fetare dhe kombëtare.¹² Pra, më shumë se një shenjë e mbetur e identi-

¹⁰ Sipas Evlia Çelebiut, në Beogradin e atëhershëm kishte vetëm nëntë faltore (kisha) greke, armene, serbe, bullgare dhe hebraike. Vep. e cit., f. 90.

¹¹ <http://www.politika.rs/sr/clanak> Ožiljci nasilja i dalje na Bajrakliji džamiju, 28.3.2011. Në pjesën hyrëse të këtij teksti thuhet: “Në një hakmarrje të çmendur, në natën ndërmjet 17 dhe 18 marsit, u dogj Bajrakli Xhamia, u mbush grafito, u rrënuan të gjitha objektet e saj përcjellëse, u dogjën 7000 libra, mes të cilave edhe dorëshkrime të çmueshme të myslimanëve të Beogradit nga periudha osmane....”

¹² Sipas studimit të Divna Gjuriq - Zamollos, “*Džamije u užoj Srbije iz XIV - XIX vijeka*”, Bajrakli Xhamia, e cila e mbante këtë emërtim nga viti 1780 dhe e njohur deri atëherë si Xhamia e Çokaxhi Haxhi Alisë, është ngritur ndërmjet viteve 1660 - 1688, ndërsa, gjithnjë sipas saj, në periudhën e okupimit austriak të Beogradit, gjatë viteve 1717 - 1739, kjo xhami ishte kthyer në katedrale katolike.

tetit dikur mbizotërues kulturor, ky objekt në ditët e sotme (kur flitet kaq shumë për diversitetin, multietnicitetin, tolerancën dhe harmoninë ndërmjet komuniteteve të ndryshme) shërben si tabelë publikimesh të ideve dhe porosive me përmbajtje raciste.¹³

Pa u ndalur më gjatë si ilustrim dua ta sjell në një plan vizual vetëm fatin e Batall Xhamisë, ose Xhamisë së Ajhan Beut, njëra ndër më të bukurat e gjithë Ballkanit, e cila, si kurse duket edhe në foto, është rrënuar përfundimisht me urdhrin e Milan Obrenoviqit, më 1878, ndërsa në të njëjtin vend është ngritur ndërtesa e Kuvendit të Jugosllavisë, përkatësisht Kuvendit të Serbisë, që si ndërtesë është shenjtëruar më 1936. Pra, në themelet e një xhamie, e një objekti fetar, është ngritur institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i Serbisë.

¹³ Bazuar në studimin e sipërcituar të Divna Gjuriq - Zamollos, mund të përfundohet se as sot ndaj kësaj trashëgimie nuk vërehet ndonjë qëndrim më i drejtë i autoriteteve të Serbisë. Kështu, nga e gjithë kjo trashëgimi asgjë nuk është përfshirë në listën e monumenteve të mbrojtura nga UNESCO. Madje, nga trashëgimia e dikurshme dhe e begatë islame nuk është përfshirë as edhe një objekt i vetëm në listën e *Monumenteve kulturore me rëndësi të veçantë në Republikën e Serbisë*. Në listën e *Monumenteve me rëndësi të madhe*, pra të monumenteve të rangut të dytë, janë përfshirë vetëm Bajrakli Xhamia e Beogradit dhe Altun-Alem Xhamia e Novi Pazarit. Ky fakt flet qartazi për atë se shpërfillja e sotme është në vazhden e politikës së djeshme të zhbërjes së shtresimeve kulturore që nuk janë ortodokse, përkatësisht që nuk janë serbe.



*Foto: Batall Xhamia, ose Xhamia e Ajhan Beut,
njëra ndër më të bukurat e Ballkanit*

Se Beogradi ishte një qytet me xhami dhe objekte të tjera fetare islame të shumta dëshmojnë autorë të ndryshëm. Mes tyre ka edhe studiues nga Serbia, sikundër është Divna Gjuriq - Zamollo, e cila në studimin “Kontribut për njohjen e xhamive të Beogradit”¹⁴, krahas tjerash, vë në dukje se si një varg objektesh të sotme janë ngritur mbi xhamitë e dikurshme. Kështu në vend të Xhamisë së Larme ishte ngritur kafe-neja “Proleće”, Sinxhirli Xhamia ishte mënjeluar për t’i bërë vend banjës publike, Kuvendi i sotëm i Serbisë (ish-Jugosllavisë) ishte ngritur në themelet e Batall Xhamisë, Teatri Popu-

¹⁴ Divna Gjuriq - Zamollo, “Kontribut për njohjen e xhamive të Beogradit, në: “Studime orientale”, nr. 2, Prishtinë, 2002, f. 177-189, përktheu Ismail Rexhepi.


llor ishte ngritur mbi një xhami mjaft të madhe, ose mbi dy objekte fetare islame (përmendet edhe një teqe), përkatësisht ato objekte fetare ishin përshtatur si objekte ndihmëse të Teatrit etj.



*Foto: Ndërtesa e Kuvendit të Jugosllavisë/Serbisë,
ngritur mbi themelet e Batall Xhamisë*

Duhet thënë se sipas udhëpërshkruesit austriak, Feliks Kanic, Xhamia pranë Teatrit Popullor, e njohur si Kara Xhamia (Xhamia e Zezë), nga autoritet serbe ishte shndërruar në një fabrikë gazi, e cila shërbente për ndriçimin e ambienteve të Teatrit. Është i njohur edhe ilustrimi i këtij autori, të cilin po e paraqesim në vijim dhe ku shihet qartë se minarja ishte shndërruar në oxhakun e kësaj fabrike, ndërsa emërtimin e saj si “Xhamia e Zezë” (emërtim i pazakonshëm, do të tho-sha unik në mbarë botën) mbase e kishte marrë pas ndryshi-

mit të destinimit të saj si rezultat i tymit dhe blozës që liroheshin nga djegia e gazit.



Xhamia e njohur si Kara Xhamia shndërruar në fabrikë gazi

Një kontribut me peshë lidhur me xhamitë dhe mesxhidet e Beogradit e ka ofruar edhe studiuesi i mirënjohur shqiptar, i lindur në Siri, Muhamed Mufaku. Libri i tij “Xhamitë dhe mesxhidet e Beogradit”¹⁵ është sinteza më e plotë e një studiuesi tonë, ndonëse, si e tillë, më shumë ofron informacion bazik lidhur me xhamitë dhe mesxhidet e Beogradit, pa bërë

¹⁵ Dr. Muhamed Mufaku, “*Xhamitë dhe mesxhidet e Beogradit*” (titulli i origjinalit: Xhevâmiu ve mesâxhidu Belgrâd), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2000, f. 73. Parathënia Qemal Morina, përkthyer nga Sadik Mehmeti.

ndonjë përgjithësim aq të nevojshëm lidhur me procesin dhe pasojat e zhbërjes së kësaj trashëgimie kulturore, pas largimin të Perandorisë Osmane prej këtij qyteti të rëndësishëm në udhëkryqin ballkanik. Të dhënat me vlerë për 57 xhami dhe 22 mesxhide (pa lënë anash as musalatë/namazgjahët) që ofrohen në këtë libër janë dëshmi e qartë se Beogradi dikur kishte një mbizotërim absolut të komunitetit islam, duke supozuar edhe një strukturë krejtësisht tjetër etnike të popullsisë, të cilën e përbënte shumica boshnjake, shqiptare dhe turke. Ndër xhamitë më të rëndësishme, qoftë për faktin se ishin ndër të parat të themeluara, qoftë për faktin se ishin monumentale, zihen ngoje edhe: Xhamia e Ibrahim Beut, Bajrakli Xhamia, Xhamia e Bajram Beut (Xhamia e Zezë), Xhamia e Defterdarit, Xhamia e Reis Efendiut, dy Xhamitë e Sulltan Sulejmanit, Xhamia e Ali Pashës, Xhamia e Haxhi Aliut të Varfër, Xhamia e Kapixhikut, Xhamia e Këzllar Agës, Xhamia e Sulltan Mahmudit, Xhamia e Sulltan Mustafës, Batall Xhamia, Xhamia e Portit, Xhamia e Haxhi Nezirit, Xhamia e Jahja Pashës etj.

Shkatërrimi masiv i xhamive të Beogradit kishte filluar qysh me rastin e pushtimit austriako-gjerman (1688-1690), ndërsa xhamitë e mbetura të padëmtuara ishin shndërruar në kisha. Megjithatë, pas ripushtimit të Beogradit (1690-1717) osmanlinjtë shumë nga xhamitë e shkatërruara i kishin meremetuar ose i kishin rindërtuar që nga themeli.¹⁶

¹⁶ Abdulah Talundžić, *Džamije u Beogradu poslije odlaska Turaka - Osmanlija 1867. godine*, "Most", Časopis za Obrazovanje, Nauku i Kulturu, br. 174, Mostar, maj 2004.

Nishi, nga ana tjetër, në vitet 60 të shek. XVII, kishte 22 mejtepe që kryesisht funksiononin pranë xhamive, ndërkaq në periudhën 1877-1878, pra në prag të pushtimit nga serbët, i kishte 13 xhami të mëdha, 6 xhami të vogla, 4 tyrbe të njohura, kundruall vetëm dy kishave dhe një sinagoge. Edhe xhamia e vetme e mbijetuar deri në kohën e sotme nuk u shpëtoi neronëve modernë serbë më 2004. Më tutje, Piroti më 1873 kishte 9 xhami të mëdha, disa mesxhide, tri teqe, 2 kisha dhe një sinagogë. Leskoci, sipas autorit Miliqeviq, më 1872 kishte 8 xhami dhe 10 teqe. Vranja më 1873 kishte 5 xhami të mëdha, disa mesxhide të vogla, 6 teqe dhe 2 kisha. Prokupla më 1873 kishte 5 xhami, 8 tyrbe dhe 1 kishë, ndërkaq Kurshumlia (sipas Evlija Çelebiut) më 1660, kishte 3 xhami, kurse në këtë qytet para Kongresit të Berlinit jetonin vetëm 3 serbë. Për ta kuptuar më qartë se cili është dimension i ndryshimit drastik të hapësirës kulturore dhe etnike, do të sjellim ndërmend të dhënat për një hapësirë më të madhe territoriale. Kështu, bie fjala, të dhënat flasin për një pamje krejtësisht tjetër të Pashallëkut të Beogradit kishte atëbotë më se 600 xhami.¹⁷

Rrënimi i trashëgimisë kulturore islame në hapësirat nga të cilat u dëbuan shqiptarët kishte vijuar edhe në fazat e mëvonshme historike. Objektet fetare islame, që për çfarëdo arsyeje i kishin shpëtuar për një kohë shkatërrimit dhe zhbër-

¹⁷ Për më shumë informacion lidhur me tjetërsimin e hapësirës etnike shqiptare shih edhe librin tonë dygjuhësh *"Hapësira etnike e kulturore shqiptare dhe Kisha Ortodokse Serbe/Albanian cultural space and the Serbian Orthodox Church"*, botoi Logos A, Shkup, 2012.

jes, “do të trajtoheshin” në kontekste të tjera historike. Shembull tipik është rrënimi i minares së Xhamisë së Sulltan Bajazitit në Leskoc më 1942, akt ky që është dokumentuar me një foto.



*Rrënimi i minares së Xhamisë së Sulltan Bajazitit
në Leskoc më 1942*

Mund të thuhet se, edhe nëse kanë mbetur shenja të identitetit shqiptar, shkenca serbe ka bërë përpjekje që ato t'i paraqesë kryesisht si trashëgimi kulturore turke. Madje, jo vetëm monumentet e kulturës materiale, për të cilat u fol deri tani, ngase ky shfytyrim i identitetit shqiptar ka prekur edhe aspekte gjuhësore. Po sjell këtu vetëm rastin e hidronimit “Gjaqki potok”, një përrua i ndodhur në Kurshumli, karakteristikë e të cilit është ngjyra e kuqe e ujit, mbase për shkak të strukturës së tokës nëpër të cilën kalon përroi. Një studiues serb e sqaronte këtë hidronim si emërtim nga gjuha turke, duke e shpjeguar emrin “gjak” si fjalë të kësaj gjuhe dhe jo si fjalë e shqipes.

Marrë në përgjithësi, dëbimi i shqiptarëve nga trojet e veta etnike u pasua nga një fushatë e egër eliminuese të pjesës dërrmuese të shenjave identitare që të kujtonin popullatën e vrarë apo të dëbuar prej tyre. Serbia atëbotë e bëri spastrimin etnik të shqiptarëve në përmasa të një gjenocidi të vërtetë, i cili u pasua nga kulturocidi, përkatësisht shkatërrimi i planifikuar e sistematik i gjithë atyre vlerave kulturore që dëshmonin se në këto treva dikur kishin jetuar shqiptarët. Gjithnjë duke i mbështetur në këtë praktikë veprimi shteti serb e aplikoi edhe njëherë formulën e dëbimit masiv të popullatës shqiptare dhe të shkatërrimit të vlerave të saja kulturore. Këtë herë, madje në fundin e shekullit XX, përkatësisht në vitet 1998-1999, krahas dëbimit të një milion shqiptarëve, shkatërrroi plotësisht ose pjesërisht dhe përdhosi 218 objekte fetare

islame.¹⁸ Nuk jemi në dijeni se është dënuar ndokush për këtë formë të vrazhdë të kulturocidit. Gjithashtu, sikurse është e ditur, Serbia, gjatë tërheqjes së forcave të saja ushtarako-police nga Kosova, ka plaçkitur edhe vlera të rëndësishme muzeale, kulturore, dokumentare e arkivore të Kosovës.

Nëse bota do ta ndiqte këtë praktikë të mbrapshtë dhe rrënuese në aspektin kulturologjik, sot në Egjipt nuk do t'i kishim piramidat, në Stamboll nuk do të ekzistonte Aja Sofia, në Peru nuk do të ekzistonin shenja të civilizimit të inkëve, në Amerikën e Mesme nuk do të ekzistonin shenja të civilizimit maja, në Indi nuk do të ekzistonte Taxh Mahalli etj.

Me një fjalë, civilizimet dhe kulturat botërore do të varfëroheshin shumë.

¹⁸ Lidhur me kulturocidin serb ndaj objekteve të trashëgimisë islame shih monografinë e botuar në tri gjuhë *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt '98 - qershor 99)*; Serbian barbarities against islamic monuments in Kosova (February '98 - June '99), الوحشية الصربية ضد الآثار الإسلامية في كوسوفا (برابر ٩٨ - يونيو ٩٩), ShB "Dituria Islame", Prishtinë, 2000, f. 5.

HISTORI E ARSIMIT

Dr. Sadik MEHMETI

MEDRESETË NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS OSMANE - vështrim i përgjithshëm -

Hyrje

Me depërtimin e osmanlinjve në Kosovë dhe me vendosjen e administrimit të tyre (shek. XIV-XV), dhe pas pranimit të Islamit nga pjesa më e madhe e popullatës së saj, osmanët, siç është e ditur, kanë sjellë në këto anë parimet e njëjta të cilat i kishin përvetësuar nga arabët dhe persianët¹. Në mesin e këtyre, bëjnë pjesë edhe shkollat fetare myslimane - *mejetpet dhe medresetë*, të cilat, - pas xhamive, - i hasim shumë herët në Kosovë.

¹ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AITC, Tiranë, 2009, f. 366.

Në të vërtetë, fillet e para të veprimtarisë arsimore-edukative islame në trojet tona datojnë qysh nga periudha më e hershme e krijimit të bërthamave të para të komunitetit shqiptar të islamizuar. Kjo veprimtari në fillimet e saj është zhvilluar *në xhami*, ose *pranë xhamisë*. Pikërisht për këtë arsye edhe historia e veprimtarisë së arsimimit islam ndërlidhet me historinë e ngritjes së xhamive të para në këto troje, që ka filluar në vitet e para të vendosjes së pushtetit osman.

Historikisht xhamia ka luajtur rol shumë më të gjerë dhe më kompleks se sa roli i saj si faktore apo si vend ku kryhej rituali i faljes (namazit). Ajo ka qenë institucioni themelor islam, me të cilën kanë qenë të lidhura ngushtë jeta fetare, arsimore-edukative, kulturore, politike dhe shoqërore e myslimanëve qysh në fillimet e saj.

Më vonë, afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin filleor, të quajtura *mejtepe*, numri i të cilave u rrit aq shumë, saqë në çdo fshat kishte të tillë, madje në shumë raste kishte edhe më tepër se një².

Pas mejtepeve, si institucione klasike të arsimit osman, *medresetë*, që prej themelimit të perandorisë e deri në fund të saj, kanë ofruar arsimimin dhe përgatitjen e një lloji dhe niveli të caktuar të dijetarëve, i cili përputhej me nevojat e shtetit dhe të shoqërisë në çështjet fetare, juridike dhe shkencore. Meqenëse ato financoheshin nga vakëfet, medresetë nuk lidheshin financiarisht me shtetin. Por pavarësisht kësaj, zyrtarët që u diplomuan nëpër medrese (kadilerët, myftilerët,

² Ziya Kazıcı, *İslâm medeniyeti ve müesseseleri tarihi*, M. Ü. İlâhiyât Fakültesi Vakfı Yayınları, Nu: 191, İstanbul, 2011, f. 325-326.

myderrizët, imamët etj.), kishin ndikim mbi popullatën si përfaqësues, nga njëra anë të rregullave zyrtare të shtetit dhe nga ana tjetër të ideologjisë së tij. Për këtë arsye shteti i kushtoi rëndësi të madhe medreseve të cilat kishin strukturën e tyre hierarkike³. Shteti gjithashtu nuk hezitonte të ndërhynte në punët e brendshme të këtyre institucioneve. Megjithatë, qëllimi themelor i medreseve ose arsimimit të medreseve ishte të nxirrte “besimtarë të përgatitur” dhe myslimanë të cilët do të mund të mbronin fenë islame kundër sfidave intelektuale nga jashtë bashkësisë⁴.

Medresetë e para

Në bazë të vakëfnameve dhe burimeve të tjera të publikuara deri sot, mund të konstatohet se medresetë e para në trojet shqiptare janë ngritur në fillim të shek. XV. Medreseja më e vjetër e ngritur në këto troje është *medreseja e Is'hak Beut në Shkup* e hapur para vitit 1411⁵. Kurse Medreseja më e vjetër në Kosovë është ajo e themeluar në Vushtrri brenda viteve 1444-1455 nga Gazi Aliu beu, pastaj para vitit 1516 në Pejë nga Mehmet Beu, pastaj e Gazi Mehmet Pashës në Prizren e vitit 1537, Medrseja e Besharet Begut në Prishtinë

³ Ziya Kazıcı, *Islâm medeniyeti...*, po aty, f. 441.

⁴ Po aty, f. 442.

⁵ Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku*, Prishtinë, 1972, f. 90; Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, IA, Prishtinë, 2017, f. 231.

e ngritur nga Besharet Begu qysh para vitit 1566 etj.⁶ Pas këtyre u hapen edhe në qytete të tjera, sa që në shek. XVIII, sipas të dhënave që na ofron udhëpërshkruesi i njohur Evlija Çelebiu, në trojet shqiptare numri i tyre ishte shtuar, aq sa kishte qytete me më shumë se një medrese⁷. Në shek. XIX dhe në fillimi të shek. XX në Kosovë ekzistonin 16 medrese: katër në Prizren, dy në Prishtinë, dy në Gjakovë, dy në Pejë, dy në Vushtrri, një në Mitrovicë, një në Gjiilan, një në Opojë dhe një në Dobërçan, të cilat i vijonin një numër i madh i nxënësve nga treva të ndryshme, madje edhe jashtë Kosovës. Të gjitha medresetë nuk kanë qenë të të njëjtit nivel⁸. Disa prej tyre për shkak të lëndëve që mësoheshin aty dhe autoritetit që gëzonin myderrizët e tyre, krahasoheshin me medresetë e larta të rangut të fakultetit “Fatih” të Stambollit, si medreseja “Mehmet Pasha” në Prizren, “Medreseja e Madhe” në Gjakovë (e ndërtuar në vitin 1707) etj.

⁶ Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare...*, po aty, f. 232; I njëjti, *Kontribute albanologjike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 222 e tutje.

⁷ Më gjerësisht, shih: Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, “Horizont”, Tiranë, 2000; Evlija Çelebiu, *Në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mali i Zi, Ohër*, përgatitur nga Robert Elsie, përkthyer nga Abdurrahim Myftiu, SHB. “55”, Tiranë, 2008.

⁸ Medresetë në Perandorinë Osmane rangoheshin sipas niveleve akademike të cilat përcaktoheshin sipas pagës ditore të myderrizit, si 20 akçe, 30, 35, 40, 45 dhe 50 akçe. Medresetë e Kosovës i kanë takuar rangut të medreseve 20 akçe. Shih: Cahid Baltacı, *Osmanli Medreseleri (XV-XVI Yüzyillarda)*, vëll. 1-2, M.Ü. İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, nu. 198, Stamboll, 2005.

Lëndët mësimore

Studentët në medrese janë regjistruar pasi të kenë përfunduar shkollën fillore (mejtepin), ose në periudha të mëvonshme, edhe shkollën e mesme të ulët (mektebi rushdije). Kohëzgjatja e mësimit në medrese ka qenë 12-16 vjet. Pas kryerjes së medresesë, studentëve, - që quheshin *softe* ose *talebe*⁹, - u lëshohej ixhazetnameja/diploma mbi kryerjen e studimeve dhe më të studentit i jepej licenca që t'i mësoj edhe të tjerët. Kishte disa lloje të ixhazetnameve, duke filluar nga ato të përgjithshme ('âmmë), e deri te ato të veçanta për një fushë apo fusha të caktuara (hâssa), siç është hifzi, kiraeti, hadithi, tefsiri, akaidi, e drejta islame, kaligrafia, tesavufi, medicina, matematika, zanatet e veçanta etj.¹⁰

Në këto medrese, jepnin mësim myderrizët, të cilët kanë qenë njerëz shumë të arsimuar, shumica e të cilëve të shkolluar në qendrat e ndryshme të arsimit dhe kulturës islame. Disa kanë qenë specialistë vetëm për një lëndë, ndërsa të tjerët për shumë lëndë.¹¹

Në medresetë e Kosovës, janë mësuar lëndët e njëjta si në medresetë e tjera të këtij niveli në Perandorinë Osmane.

⁹ Fjala “*softa*” është me prejardhje nga persishtja “*suhte*”, që d.m.th. “*i djegur, i dashuruar pas dijes*”, kurse fjala “*talebe*” është njëjësi i “*tullâb*”, që rrjedh nga arabishtja, që d.m.th. “*kërkues i dijes*”. Ziya Kazıcı, *Islâm medeniyeti...*, po aty, f. 383.

¹⁰ Haso Popara, *Idžazetname u rukopisima Gazi Husrev-begove biblioteke*, në: “Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, knjg. XXV-XXVI, Sarajevë, 2007, f.5.

¹¹ Hasan Kaleshi, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, Gjurmime Albanologjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 94.

Edhe pse nga burimet e kohës nuk mund të jepet në mënyrë të qartë dhe të hollësishme programi mësimor i medreseve, megjithatë duke parë biografitë e mësuesve dhe të dijetarëve (ulemasë, myderrizëve), diplomat e tyre, vakëfnâmetë etj., mund të krijojmë një ide të përgjithshme se çfarë mësohej në medrese.

Në medresetë e kohës mësoheshin këto lëndë me disiplinat e tyre: komentimi i Kuranit (*tafsîr*), shkenca për Traditën (*‘ilm al-hadîth*), doktrina/apologjetika (*‘aqâid*), e drejta e Sheriatit (*fiqh*) dhe burimet e së drejtës së Sheriatit (*usûl al-fiqh*), e drejta e trashëgimisë sipas Sheriatit (*farâid*), gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe (*sarf, nahv*) etj.. Nxënësit për disa vite mësonin gramatikën dhe sintaksën e gjuhës arabe. Mësimi zhvillohej duke lexuar, duke sqaruar tekstet dhe duke mësuar përmendsh rregullat e morfologjisë dhe sintaksës, e përveç gramatikës dhe sintaksës, mësoheshin edhe leksikografia (*‘ilm al-luga*), retorika (*‘ilm al-belâga*) dhe metrika (*‘ilm al-‘arûd*).¹²

Ndonjëherë kishte ndryshime në renditjen dhe numrin e këtyre studimeve dhe lëndëve. Në medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren, në bazë të dokumenteve arkivore të kësaj shkolle¹³, dihet se mësoheshin 20 lëndë me disiplinat e tyre: 1. *Kurâni Kerîm*, 2. *Texhvîd*, 3. *E drejta e Sheriati* (*‘Ilmi*

¹² Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski...*, po aty, f. 23.

¹³ Arkivi i Kosovës, *Fondi i dokumenteve osmane*, i pa rregulluar, dokumenti/shehâdetnâmeje e Fahri ef. Iljazit nga Gjakova. Shih edhe shehâdetnâmenë e Mehmet Salihut nga Bresana e Opojës, një kopje e së cilës gjendet në duartona.

fikh), 4. *Burimet e së drejtës së Sheriatit* ('Ilmi Usûli fikh), 5. *Dogmatikë/apologjetikë* ('Ilmi Kelâm), 6. *Shkencat natyrore-fizikë* (Hikmeti Tabi'ijje), 7. *Teologji* (Hikmeti ilâhijje), 8. *Logjikë* ('Ilmi mantik), 9. *Komentim i Kuranit* ('Ilmi tefsîr), 10. *Shkenca e Traditës* ('Ilmi hadîth), 11. *E drejta trashëgimore* ('Ilmi ferâiz), 12. *Matematikë* (Hisâb), 13. *Histori e pejgamberëve* (Tarîh-i enbijâ), 15. *Metafora* ('Ilmi bejân), 16. *Retorik* ('Ilmi bedî'), 17. *Kaligrafi* (Hüsni hatt), 18. *Bukurshkrim* (Imlâ), 19. *Gramatikë* ('Ilmi sarf), 20. *Sintaksë* ('Ilmi nahv)

Gjuha arabe, sipas praktikës së shumëgjuhësisë në Perandorinë Osmane, ka qenë gjuhë e shkencës, persishtja gjuhë e poezisë, kurse turqishtja gjuhë e administratës dhe e dijeve laike. Kjo traditë në Perandorinë Osmane, si bartëse e kulturës dhe qytetërimit islam, ka zgjatur gjithnjë deri në shek. XIX, dhe, si rrjedhojë, shkenca islame bazohej në njohjen e gjuhës arabe, jo vetëm për të njohur dhe studiuar Kuranin e Hadithin, por për të njohur edhe shkencat e tjera, si metrikën, retorikën, stilistikën, gramatikën, poetikën dhe disa disiplina të tjera, të cilat studioheshin dhe komentoheshin në gjuhën arabe në tërë Botën Islame¹⁴.

¹⁴ Fehim Nametak, *Književnost bosnaskohercegovačkih Muslimana na turskom jeziku do XVII stoljeća*, Godišnjak institut za jezik i književnost, Sarajevë, 1982, f. XI/119, Cituar sipas: Jusuf Ramić, *Izučavanje arapskog jezika kod nas*, në: "Zbornik Radova", nr. 2, Sarajevë, 1987, f. 237.

Tekstet shkollore

Në bazë të ixhâzetnâmeve që kemi marrë në shqyrtim dhe burimeve të tjera¹⁵, si tekste në medresetë tona, me ndonjë ndryshim, janë përdorur:

- “*Texhvîd*” - ka të bëjë me studimin e artikulimit dhe të vetive të shkronjave arabe, në mënyrë që të mësohet të kënduarit e drejtë dhe të bukur të Kuranit. Te ne më së shumti është përdorur “*Karabâsh Texhvîdi*”, të cilin e ka shkruar ‘*Abdurrahmân Karabâshi* por edhe texhvid të tjerë.
- “*Munijjâ*” (“*Munjetu ‘l-Musal-lî*”) e Saduddîn Muhammed bin el-Kashgarî.
- “*Halebîjâ*” (“*Sherhu ‘l-Munijjâ*”) - koment veprës së më sipërme, nga autori Ibrâhîm ibn Muhammed bin Ibrâhîm el-Halebî. Autori ka dy komentime: ai i shkurti me titullin “*Gunjetu ‘l-Mutemli fî sherhi Munjetu ‘l-Musal-lî*”, që njihet me emrin e popullarizuar “*Halebî sagîr*” (Halebi i vogël), për t’u dalluar nga komentimi tjetër i gjerë me emrin e popullarizuar “*Halebî kebîr*” (Halebi i madh), që të dy këto vepra shumë të njohura ndër ulematë tanë.

¹⁵ Cahid Baltaci, *Osmanli Medreseleri...*, vëll. 1, po aty, f. 87-90; Murat Akgündüz, *Osmanli medreseleri -IXI Asir*, 2 baski, Beyan, Stamboll, 2012, f.156; Omer Nakičević, *Arapsko-islamske znanosti i glavne škole od XV do XVII vijeka (Sarajevo, Mostar, Prusac)*, Starješinstva IZ, Sarajevo, 1999, f.87-107; Kasim Dobrača, *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 1963 dhe svezak drugi, Srajevo 1979; Zejnil Fajić, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, vëll. III, London/Sarajevo, 2000; Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008. etj.

- "*Durrijektâ*", e autorit Imam zâde Ahmed Es'ad el-Konavî.
- "*Kudûrî*" ("*Muhtesaru 'l-Kudûrî*")- I shkruar nga njëri prej përfaqësuesve më të njohur të shkollës juridike hanefite, Ebu 'l-Husein Ahmed b. Muhammed el-Kudûrî el-Bagdâdî "*Muhtesaru 'l-Kudûrî*".
- "*Multeka 'l-ebhur*" - Është një nga shkrimet themelore të fikhut hanefi, e shkruar në mënyrë të thuktë dhe koncize, me stil të lehtë, andaj dhe ka qenë shumë e popullarizuar dhe gjatë është përdorur si doracakë dhe si libër mësimi i fikhut nëpër medrese. Veprën e ka shkruar Ibrâhîm b. Muhammed el-Halebî.
- "*Mevkûfâtî*" - Komentim dhe përkthim në gjuhën turke i veprës së më sipërme "*Multekâ*". E ka shkruar Muhammed efendi Mevkûfâtî. Përveç titullit të lartshënuar, ky koment, në burime të ndryshme, njihet edhe me emra të tjerë me pak ndryshime "*Terxheme-i Multeka 'l-ebhur*", "*Sherh Multeka 'l-ebhur*", "*Sherh-i Kitâb Multekâ el-ebhur*", "*Terxheme-i Multeka 'l-ebhur me'a sherhi bit-turkijjeti li 'l-Mevkûfâtî*".
- "*Bergivî Sherhi*" ("*Kâdî zâde*") - Është koment i veprës së Birgeviut "*Risâle-i Birgevî*" dhe ka të bëjë me elementet e besimit islam. E ka shkruar Ahmed Mehmed Emin Islamboli Kâdî Zâde.
- "*T'alîmu 'l-Mute'allim*", - vepër mbi sjelljen fetare-morale dhe me edukatën e nxënësit. E ka shkruar Burhânuddîn ez-Zarnûxhî.
- "*Pendi 'Attâr*" - Emri i plotë dhe i drejtë i saj është "*Pend-nâme*", e poetit mistik persian Feriduddîn 'Attârî.

- "*Gülistân*" - vepër që përmban rrëfenja moralizuese në vargje në gjuhën perse. Autor është i mirënjohuri Ebû 'Abdullâh Muslihuddîn Sa'adî esh-Shîrâzî.
- "*Emsile*" - përmban shembuj për foljet në gjuhën arabe (me përkthim në gjuhën turke) nga një autor anonim.
- "*Binâ*" - shpjegon foljet në gjuhën arabe. Si autori i mundur i kësaj vepre merret Abdullâh ed-Dinkûz.
- "*Maksûd*" ("*el-Maksûd fî 't-tasrîf*") - Vepër nga morfologjia e gjuhës arabe. Rreth autorit të saj ka disa mendime. Rëndom përmendet Imâmi 'Azâm Ebû Hanîfe Nu'mân Thâbit el-Kûfî.
- "*Izzî*" - "*Tasrifu 'l-Izzî*" - trajton të njëjtën temë sikurse "*Maksûd*" në gjuhën arabe. Autor i saj është Abdulvehhâb Izuddîn ez-Zenxhânî.
- "*Merâhu 'l-ervâh*" - gramatikë e morfologji arabe, e autorit Ahmed b. 'Ali b. Mes'ûd.
- "*Merâh Sherhi*" - Është komentim i veprës së sipërpërmen-
dur. Ka disa komentime me këtë emër.
- "*'Avâmil*" - Vepër e shkurtër mbi agensët në sintaksën e gjuhës arabe, njihet edhe me emrat "*el-'Avâmilu 'l-mije 'l-xhedîde*" dhe "*el-'Avâmilu fî n-nahvî*". E ka shkruar Muhammed b. Pîr 'Ali el-Birgevî.
- "*Iz'hâr*" - është vepër e shkurtër mbi sintaksën arabe, e përdorur shumë në medresetë e kohës. Autor i veprës është Pîr Ali efendi el-Birgevî.
- "*Kâfija*" ("*el-Kâfiye fî 'n-nahv*") Është vepër nga gramatika arabe e shkruar nga Xhemâleddîn Ebû 'Amr Osmân b. Ebî Beker b. el-Haxhîbi.

- "*Mullâ Xhâmî* - është gramatikë e gjerë e gjuhës arabe dhe zhvillohet në gjuhën arabe. Njihet sipas emrit të autorit Mevlânâ 'Abdurrahmân b. Ahmed el-Xhâmî. Titulli i saktë i kësaj vepre është "*el-Favâid ed-Dijâijje*".
- "*Isâgûxhî*" ("*Isâgoxhî*") - Vepër nga logjika, në gjuhën arabe e autorit Etheruddîn Mufeddal b. Omer el-Ebherî.
- "*Fenârî*" - Edhe ky është një koment i veprës "*Isâgûxhî*" të Etheruddîn el-Ebheriut, të cilin e ka bërë Shemsuddîn Muhammed b. Hamza el-Fenârî. Njihet me emrat "*el-Fevâidu 'l-Fenârije*" ose "*Sherh el-Isâgûxhî lil-Fenârî*".
- "*El-Kâmûsu 'l-muhît*" - është fjalor i gjuhës arabe të cilin e ka shkruar Muhammed Mexhduddîn Firûz'abâdî. Në gjuhën turke e ka përkthyer Sejid Ahmed 'Âsim efendiu. Te ne më shumë është përdorur përkthimi në gjuhën turke se origjinali.
- "*Sherhu 'l-'Akâidi n-Nesefijje*" - është doracak për apologetikën islame. Është komentim i bërë veprës "*Akâid en-Nesefî*" të autorit Nexhmuddîn Ebû Hafsa Omer b. Muhammed en-Nesefî. Komentimi është i Saduddîn Mes'ûd bin Omer Taftâzânî.
- "*Sherhu 'l-Hidâjeti 'l-Hikme*" - Është komentimi i bërë veprës "*Hidâjetu 'l-hikme*" të autorit Etheruddîn el-Ebherî. Autor i komentit është Kâdî Mîr Husein el-Mîbîdî.
- "*Sherhu 'l-'Akâ'idu 'l-'Adûdijje li Devânî*" - Vepër në gjuhën arabe nga dogmatika, e autorit 'Aduddîn 'Abdurrahmân b. Ahmed el-Îxhî. Kurse komentimin e ka shkruar Muhammed Xhelaluddîn Devânî.

- "*Mutavvel*" - "*Sherh telhîsu 'l-Miftâh*" - është doracak mbi stilistikën në gjuhën arabe e autorit Saduddîn Mes'ûd b. Omer Taftâzânî.
- "*Durru 'l-Muhtâr*" ("*ed-Durru 'l-Muhtâr fî sherhi Tenvîri 'l-ebîsâr*") - është vepër nga jurisprudenca islame dhe e drejta e Sheriatit në gjuhën arabe, e autorit Muhammed Haskefî el-Hanefî. Në të vërtetë është koment i vepërës "*Tenvîru 'l-ebîsâr*" të Dimeshkîut.
- "*Ved'ijje*" - "*err-Rrisaletu 'l-'Adudijje fî 'l-ved'i*" - është shpjegim i shkurtër për etimologjinë e fjalës në gjuhën arabe (*vad'*), të cilën e ka shkruar 'Aduddîn 'Abdurrah-mân b. Ahmed el-Îxhî. Është e njohur me emrin "*Risâle fî 'l-Ved'i*" dhe sipas autorit "*Risâle el-'Adudijje*".
- "*Veledijje*" - është libër mbi disputacionin (debatin) për fillëstarët. Autor i vepërës është Muhammed Saçaklî Zâde. Njihet edhe me emrin "*Risâle mine 'l-Edeb li Saçaklî Zâde*" dhe me emrin "*Err-Rrisâle-i 'l-veledijje*".
- "*Sherhi shemsijje*" - Vepër mbi logjikën. Emri i plotë është "*Tahrîru 'l-kavâ'idî 'l-mantikijje fî sherhi err-Rrisâleti 'sh-shemsijje*" e autorit Kutbuddîn Muhammed er-Rrâzî et-Tahtânî.
- "*Envâru 't-Tenzîl ve Esrâru 't-Te'vîl*" - është koment i Kuranit (tefsîr) i autorit Omer ibn Muhammed ibn 'Ali Ebul-Hajr Nasiruddîn el-Bejdavî.
- "*el-Keshshâf*" ("*Hakâiku 't-tenzîl*") - komentim i Kuranit nga Ebu 'l-Kâsim Mahmûd ibn Omer el-Zamahsherî.
- "*Sahîhu 'l-Buhârî*" - autor: Muhammed ibn Ismâ'îl ibn Ib-râhîm el-Buhârî. Ka përjetuar disa komente, më të njohurit dhe që janë mësuar në medresetë tona janë: "*Umdetu*

‘l-Qârî fî sherh Sahîhu ‘l-Buhârî”, nga Bedruddîn ibn Muhammed, i njohur me emrin ‘Ajni al-Hanefî dhe komentit *“Fet’hu ‘l-Barî fî Sharh Sahîhu ‘l-Buhârî* i autorit Ibn Haxher el-Askâlânî.

- *“Shemâili sherîf”* - Është përmbledhje e haditheve që bëjnë fjalë për personalitetin dhe jetën e pejgamberit Muhammed a.s. e autorit Hâfidh Ebî ‘Îsâ Muhammed et-Tirmîdhî.
- *“Mirâtu ‘l-Usûl fî sherh Mirkâtu ‘l-Vusûl”* - Këtë vepër dhe komentimin e saj nga lëmi i filozofisë së të drejtës së Sheriatit i ka shkruar më 1470-1471, dijetari i njohur, i treti “shehu ‘l-islam” me radhë i Perandorisë Osmane, Mulla Muhammed bin Feramerz bin Ali, i njohur si Mulla Husrev (vd. 885/1480).
- *“Delâ’ilu ‘l-hajrât fî shevâriki ‘l-envâr”* - e Ebû Abdullâh Muhammed b. Suleymân el-Xhezûlî.
- *“Ilmi Ferâiz”* - vepër e shkurtër mbi ndarjen e trashëgimisë në mes të trashëgimtarëve, e autorit Sirâxhuddîn Muhammed b. Aburrâshid es-Sixhâvendî.
- *“Muhtesaru ‘l-Me’ânî sherîf”* - e ka shkruar Saduddîn Mesud bin Omer Taftâzânî.
- *“Kasîde-i Burde”*, -Titulli i plotë i kësaj kasideje është *“el-Kavâkibu ‘d-Durrijje fî med’hi Hajru ‘l-berijje”*, e autorit Sherefuddîn Abu ‘Abdullâh Muhammad b. Sa’îd al-Bûsirî.
- *“et-Tarîkatu ‘l-Muhammedijje ve es-Sîretu ‘l-Ahmedijje”* e autorit Muhammad Pir ‘Ali el-Bergivî.
- *“el-Mesâbihu ‘s-sunne”* - është nga fusha e hadithit e autorit Husein b. Mes’ûd el-Begavî esh-Shâfî’.

- “*Tenkîhu ‘l-usûl ve tavzihu’t-tenkih*” - është nga jurisprudenca islame, e autorit Burhân esh-Sherîa Mahmûd b. Sadrî esh-Sherîa el-Evvel Ahmed b. Ubejdullâh el-Mahbûb el-Hanefî.
- “*El-Hidâje*” - Nga fusha e jurisprudencës islame e autorit Burhanuddîn b. Ebî Beker el-Merginânî.
- “*Muhtesaru ‘l-Vikâje*” - Është vepër për jurisprudencën islame (fikh), e autorit Sadr esh-Sherîa eth-Thânî.
- “*Sherhu ‘l-Menâr*”- Komentim i veprës “*Menâru ‘l-Envâr*” e autorit Ebu ‘l-Berekât Hâfîzuddîn en-Nesefî.
- “*el-Mugni*” - (“*el-Mugni fî usûli ‘l-fikh*”) - vepër e njohur e drejtimit juridik hanefij, të cilin e ka shkruar Xhelâluddîn Omer el-Habbaz el-Huxhândî.
- “*Kenzu ‘d-dekâik*” - e Hâfîzuddân Ebu el-Berekât Abdullâh b. Ahmed b Mahmûd en-Nesefî.
- “*El-Kasîdetu ‘n-Nûnijje*”- poezi mbi besimin, e autorit Mevlânâ Hidr-bej b. Xhelâluddîn.
- “*Esh-shifâ bi t’arîfi hukûki ‘l-Mustafâ*” - përmbledhje e thënieve nga profeti Muhammed a.s. dhe detyrat e myslimanit për të respektuar atë. E ka shkruar Ebu ‘l-Fadl ‘Ijâd b. Mûsâ el-Jahsubî es-Sabti.
- “*Kasîdetu Bedu ‘l-Emâl*”- kaside nga apologjetika islame, e autorit Sirâxhuddîn Ebû Muhammed ‘Ali Osmân el-Fergânî.

Ekzemplarë të këtyre veprave, gjenden në bibliotekat e institucioneve që në kuadër të fondeve dhe koleksioneve të tyre ruajnë edhe vepra dhe dorëshkrime në gjuhët orientale,

por edhe ndër posedues privat dhe individ me kulturë dhe vetëdije historike mbi vlerat fetare islame dhe tradicionale¹⁶.

Arkitektura

Medresetë në Kosovë ishin të tipit të medreseve të vogla në formë të shkronjës “L”, rëndom në oborrin e xhamisë, ose si komplekse të veçanta. Nga ana arkitektonike, janë ndërtuar sipas shembullit të arkitekturës osmane, por me një lloj transformimi nën ndikimin e traditës vendore të ndërtimit. Nuk kanë qenë të mbuluara me kupola, nuk kanë pasur pretendencë monumentale dhe tërësisht u përgjigjeshin mundësive të donatorëve, andaj arkitektura e tyre njëjtësohet me arkitekturën ndërtuese tradicionale. Si rezultat i kësaj, hasen edhe elemente të arkitekturës së thjeshtë ndërtuese, sikur që janë çardakët-divanhanet dhe lokalet për pritjen e mysafirëve, të cilat nuk paraqiten si pjesë përbërëse e medreseve të vendeve të tjera¹⁷.

Të gjitha medresetë në Kosovë janë ndërtuar në saje të vakëfeve dhe të nismave individuale të banorëve vendas, si përshtypshme të tyre. Për mirëmbajtjen e tyre janë lënë objekte ekonomike, si dyqane, mullinj, ara, male etj., ose të holla

¹⁶ Ndër bibliotekat e institucioneve që ruajnë këso pasurish janë: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Prishtinës, Biblioteka e Arkivit të Kosovës, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, Biblioteka e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës etj., pastaj nëpër teqe, xhami dhe trashëgimtarë të ulemasë së më hershme shqiptare.

¹⁷ Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture na Kosovu*, në: “Starine Kosova”, nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 81-96.

të gatshme, në mënyrë që të siguroheshin të ardhurat e sigurta dhe të rregullta, për personelin mësimor dhe për mirëmbajtjen e medreseve. Nxënësit kanë pasur të siguruar banimin, diku edhe ushqimin, e diku merrnin edhe bursa.

Roli kombëtar i medreseve

Mbështetur në planprogramet mësimore të këtyre medreseve si dhe në nivelin mjaftë të lartë profesional dhe intelektual të myderrizëve të tyre, gjë që pasqyrohet në veprat e tyre të mbetura në dorëshkrim, mund të përfundohet se këto medrese kanë krijuar një shtresë intelektuale fetare e akademike të admirueshme. Në këto medrese janë shkruar, kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, fushash e disiplina të ndryshme fetare, shkencore, e letrare, përfshirë edhe letërsinë shqipe alamiado, e cila ka prodhuar efekte shumë pozitive në zhvillimin kulturor të masave popullore shqiptare edhe jashtë objekteve të medresesë.

Në këto institucione arsimore zuri fill dhe u intensifikua përpjekja për futjen e gjuhës shqipe në shërbime të fesë islame në xhami dhe jashtë saj, përkatësisht thellimi i punës në drejtim të shqiptarizimit sa më të plotë të xhamisë dhe institucioneve të tjera islame¹⁸. Në këtë drejtim dallohen Tahir ef. Gjakova, Sheh Mala nga Rahoveci, Selim ef. Drejta nga Vushtrria, Mehmet Sezai nga Prishtina, Ymer Shemsiu e Vejsel Xhelaludin Guta nga Ferizajt, Hysen ef. Statovci nga

¹⁸ Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IA, Prishtinë, 1989, f. 384.

Prishtina, Mehmet Salihu nga Opoja e shumë të tjerë të cilët janë autorë të njohur veprash fetare, didaktike dhe atdhetare, disa prej të cilave të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, në radhë të parë për nevoja të nxënësve dhe të studentëve, e pastaj edhe të masës së gjerë të komunitetit mysliman.

Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në *Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*, në Lidhjen e Pejës “*Besa Besë*”, kryengritjet e ndryshme etj. Veprimtarët politik më të dalluar nga radhët e myderrizëve janë haxhi Ymer Prizreni, Halim ef. Gjergjizi, Haxhi Zeka, Ali ef. Mici, Hasan ef. Shllaku, Ismail ef. Yveysi, Hafiz Ymer Guta, Haxhi Rrystem Shporta, e shumë e shumë të tjerë, të cilët aktivitetin e tyre politik e paguan me internime e burgosje. Më vonë u dalluan sheh Mehmet Sezai, hfz. Abdullah Hizri, Asim ef. Luzha, Mulla Idriz Gjilani, Haki ef. Sermaxhaj dhe një plejadë e tërë e myderrizëve.

Si përfundim

Me një fjalë, medresetë në Kosovë ishin një pjesë e pandarë e jetës publike, të cilat qëndronin mbi baza intelektuale dhe që rrënjët i kishin te feja. Strukturalisht ato ishin pjesë e sistemit të vakëfeve, financiarisht ishin të pavarura dhe i zhvillonin aktivitetet nën mbikëqyrjen e shtetit. Ato vazhduan të funksionojnë kështu për një periudhë disa qindra vjeçare.

Ramadan SHKODRA

**RRETHANAT POLITIKE PAS LUFTËS
SË DYTË BOTËRORE NË KOSOVË
DHE ROLI I MYDERRIZËVE NË HAPJEN
E MEDRESESË**

I.

Në Kosovës, siç dihet nga të dhënat historike, kanë funksionuar një numri i konsiderueshëm i medreseve të shtrira në qendra kryesore, të cilat, përveç funksionit të tyre primar për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm për nevojat e komunitet mysliman, ato, për shqiptarët, kanë luajtur një rol të rëndësishëm, duke u nisur që nga organizmi shoqëror, politik, kulturor, social dhe posaçërisht në ngritjen intelektuale e shpirtërore. Medresetë në Kosovë, ashtu si edhe në viset e

tjera shqiptare, janë themeluar gjatë periudhës së Perandorisë Osmane¹.

Roli i medreseve për shqiptarët merr peshë edhe më të rëndësishme pas vitit 1912, kur Kosova okupohet nga Serbia e më vonë integrohet dhunshëm në atë që njihet si Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene, apo më pas Jugosllavia borgjeze. Në këtë periudhë, medresetë në Kosovë udhëhiqeshin e drejtueshin nga prijës të shquar atdhetarë, të cilët medresetë i kishin shndërruar në vatra e çerdhe të kauzës kombëtare. Një aktivitet i tillë sigurisht që nuk i shkonte për shtati pushtetit të Jugosllavisë borgjeze, i cili në vazhdimësi ndërmernte masa nga më të ndryshmet ndaj medreseve, drejtuesve të tyre dhe strukturave të Komunitetit Mysliman.

Qëndrimi i autoriteteve të Jugosllavisë borgjeze ndaj medreseve më së miri shihet nga shkresa e ministrit të fesë, dërguar Këshillit Kryesor të Ministrisë së Arsimit në Beograd, të datës 7 shtator 1923, ku pos të tjerash, thuhet: “Në Kosovë çështja e arsimit fetar të myslimanëve është shumë e komplikuar... Në këto vise ka afro 50 myftinj dhe 600 imamë, prej të cilëve asnjëri nuk e njeh si duhet gjuhën serbe, të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit tonë.”²

¹ *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*, përgatitën Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, f. 36.; Sadik Mehmeti, *Të dhëna të reja arkivore për Medresenë e Ulët të Prishtinës 1951-1962*, në: “Takvim/Kalendari”, Prishtinë, 2004.

² Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1988, fq. 117.

Më tutje në shkesë thuhet: “Në to nuk mësohet gjë tjetër pos si të urrehen sa më tepër ata që nuk janë myslimanë. Për ta evituar rrezikun që mund të rrjedhë prej tyre, duhet që sa më parë medresetë të futen nën kontrollin e plotë të shtetit, në të vërtetë, së pari të mbyllen e më vonë në vend të tyre të hapet një medrese.”³

II.

Pas Luftës së Dytë Botërore, rrjedha objektive e ngjarjeve që çonte drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, u ndërpre. Popullsia shqiptare e Kosovës u përball me presionet, me mashtrimet dhe me dhunën e udhëheqësve komunistë jugosllavë, sidomos të atyre serbë. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës, u harruan. Derisa brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrah popujve jugosllavë për çlirimin e plotë të Jugosllavisë, mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi u ushtrua një dhunë e egër, pati arrestime, terror e persekutime të shqiptarëve (kujtojmë këtu Plojën e Tivarit, Luftën e Drenicës, Masakrën e Gjilanit etj.), u ndalua përdorimi i flamurit kombëtar, nëpunësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me serbë dhe u ndërmorën një sërë masash të tjera represive⁴.

³ Po aty, fq. 118

⁴ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar IV, Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2008, f.339,

Goditjet që u ndërmorën mbi popullsinë shqiptare menjëherë pas luftës dhe gjatë Administratës Ushtarake ishin në përputhje me Elaboratin e Vasa Çubrilloviqit “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re”, dërguar qeverisë së re jugosllave ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor të vitit 1944⁵.

Përballë gjithë këtyre, popullata shqiptare nuk ndenji dukarkyq, por ajo u organizua kundër ripushtimit të Kosovës nga Serbia, përkatësisht Jugosllavia. Në ballë të këtyre revoltave dhe rezistencës shqiptare u gjendën edhe ulemaja shqiptare dhe në shërbim të tyre u vunë edhe institucionet islame, si xhamitë, medresetë etj⁶.

Pas shtypjes së revoltave masive popullore nga ana e pushtetit komunist, qëndresa kundër pushtetit jugosllav vazhdoi në rrugë ilegale.

Duhet thënë edhe këtë se qëndrimi i sistemit komunist që po instalohesh me të përfunduar Lufta e Dytë Botërore në një pjesë të madhe të Evropës, e fatkeqësisht edhe në Shqipëri dhe në viset tona, për sa i përket fesë, ishte armiqësor. Kjo sepse sipas pikëpamjeve komuniste feja shihej si pengesë kryesore për jetësimin e platformës ideologjike komuniste, ngaqë feja kishte rol të rëndësishëm dhe ishte e shtrirë në gjithë shtresat e popullit⁷.

⁵ Po aty, f. 341.

⁶ Ramadan Shkodra, Hfz. *Bajram Agani-Nismëtar dhe projektues i riorganizimit të Bashkësisë Islame të Kosovës pas Luftës së Dytë botërore*, në përmbledhjen “Myderriz Hfz. Bajram Agani jeta dhe vepra 1899-1962”, Prishtinë, 2013, f. 40.

⁷ Po aty, f. 41.

III.

Në Kosovë po edhe në Maqedoni, sistemi komunist që po instalohej, përveç arsyeve etnike dhe fetare, kishte edhe një arsye më tepër që të vihej në ndjekje të ulemasë shqiptare dhe atakimin e institucioneve islame, sepse këta bënë rezistencë të fortë dhe qenë angazhuar me gjithçka patën kundër ripushtimit sllav dhe u vunë në mbrojtje të vatanin dhe fesë së tyre. Është e tepërt të përmendet këtu roli i mulla Idriz Gjilanit, Ibrahim Lutfiut, Haki ef. Sermaxhës, Ilajz ef. Brojës, Asim ef. Luzhës e shumë të tjerëve. Ndërsa nga institucionet, përveç vetë Bashkësisë Islame rol të rëndësishëm për çështjen kombëtare, përveç kuptoj asaj fetare, lutjen edhe medresetë me një histori të bujshme shekullore, të cilët qenë shndërruar në vatra të trinomit fe, atdhe e arsim⁸.

Këto kushte e rrethana në të cilat u gjenden shqiptarët me të drejtë konsideroheshin shumë të rënda. Një gjendje e tillë dominonte edhe në jetën fetare të besimtarëve myslimanë, ku shumica absolute e tyre kishin qenë pjesë e strukturave të Komunitetit Mysliman Shqiptar të Tiranës dhe cilësoheshin si kolaboracionist e armiq të popullit dhe të pushtetit komunist jugosllav.

Po ashtu, pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë ekzistonte një gjendje e rëndë në fushën e arsimit. Nga Jugosllavia monarkiste që trashëguar një sistem shkollor tejet i varfër, që nuk ishte në gjendje t'i përmbushte kërkesat minimale për shkollim. Andaj, me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendjeje,

⁸ Po aty. f. 41.

që në fillim u morën disa masa organizative në fushën e arsimit. Me përpjekje të shumta u arrit që në vitin shkollor 1945-1946 në territorin e Kosovës të fillonin punën 392 shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe në atë serbokroate⁹.

Megjithëqë në të gjitha dokumentet shtetërore e partiake të Jugosllavisë proklamohet e drejta e shkollimit në gjuhën amtare, shkolla shqipe përjetoi vështirësi të mëdha. Diskriminimet ndaj shkollës shqipe ishin evidente. Me qëllim të kapërcimit të sistemit shkollor të trashëguar nga Jugosllavia monarkiste, shteti mori disa masa, si suprimimin e shkollave private, ato të qytezës, të shkollave qytetare dhe ato të karakterit fetar¹⁰. Në këtë kuadër të masave gjoja reformuese pusheteti i Jugosllavisë së AVNOJ-it mbylli të gjitha medresetë ani pse disa prej tyre kishin traditë shumë shekullore¹¹ dhe këtu praktikisht komunitetit mysliman ia mbylli të gjitha institucionet arsimore, megjithëqë me Kushtetutën e vendit dhe ligjet në fuqi manifestimi i fesë e i besimit ishte i lejuar.

⁹ Grup autorësh, *Historia e populli shqiptar IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Botimet "Toena", Tiranë 2008, f. 390.

¹⁰ Po aty, f. 391.

¹¹ Deri në vitin 1948, kur edhe mbyllet medreseja e fundit në Kosovë, kanë ekzistuar një numër i konsiderueshëm i medreseve, madje edhe nga dy e më shumë në të njëjtin qytet, si Medreseja e "Sulltan Selimi III" dhe Medreseja "Pirinaz" në Prishtinë, Medreseja "Mehmed Pasha", Medreseja "Sinan Pasha" dhe Medreseja "Emin Pasha" në Prizren, Medreseja "Atik" në Gjiilan, Medreseja "Atik" në Pejë, "Medreseja e Madhe" dhe "Medreseja e Vogël" në Gjakovë etj.

IV

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe njëherë padrejtësisht ndahet nga ëma e saj-Shqipëria dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajësës artificiale të quajtur Jugosllavi.

Në këto rrethana në viset shqiptare, sidomos në ato që u aneksuan nga Jugosllavia, u bënë ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike, të cilat ushtruan ndikim edhe në veprimtarinë e bashkësive fetare. Në vitet e para të pas luftës puna e institucioneve fetare në këto vise ishte vështirësuar në masë të madhe. Kjo për shkak të rrethanave që iu imponuan Kosovës e në këtë kontekst edhe Bashkësisë Islame, së cilës tani i pamundësohet veprimi i mëtutjeshëm në kuadër të KMSH-së, ku ishte inkuadruar më 1941¹². Andaj, aktiviteti i BI bëhej kryesisht në nivel të Zyrrave të Vakëfeve dhe nëpër xhemate, ku vazhdonin aktivitetin kryheshin ceremonitë dhe ritet fetare. Ndërsa, struktura organizative e Bashkësisë Islame, e ndërtuar gjatë Luftës pushoi së vepruari dhe kështu praktikisht Bashkësia Islame ngeli pa organizim dhe udhëheqje qendrore¹³.

Mirëpo, paria fetare islame në vend, respektivisht myftinjë të qendrave të mëdha, të vetëdijshëm për rrethanat e reja që u krijuan pas aneksimit të Kosovës nga Jugosllavia, respektivisht Serbia, nuk qëndruan duarkryq, por u vetorganizu-

¹²Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 329-331.

¹³Dr. HakiKasumi, vepra e cituar më lart, f. 13-14.

an dhe ndërmorën nisma e hapa për organizmin e mëvetësi-shëm e të pavarur të Bashkësisë Islame në Kosovë. Kështu, me gjithë qëndrimin jo të mirë të sistemit socialist e ideologjisë moniste që po instalohej ndaj fesë në vend, paria islame e Kosovës mbajti në Prizren dy kongrese, në cilat u hodhën hapat e parë dhe themelet e organizmit të BI në Kosovë në kushte e rrethana aspak të favorshëm për fenë¹⁴. Në kuadër të riorganizimit Bashkësia Fetare Islame në Kosovë, pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1947 të Bashkësisë Fetare Islame për RPFJ, me të cilën rregullohej funksionimi i BI, bëhej pjesë përbërëse - njësi e BFI-së në Jugosllavi, ndërsa BI e Kosovë u detyrua që të ndërronte qendrën nga Tirana¹⁵ për në Sarajevë. Bazuar në këtë Kushtetutë, bëhej edhe organizimi i parapara i Bashkësive Islame në nivel republikash. Kuvendi i Vakëfnor për RPS, ku përfshihej edhe territori i Kosovës e rrjedhimisht edhe Bashkësia Islame në Kosovë, ishte konstituuar-themeluar në Beograd më 20 gusht të vitit 1947¹⁶.

¹⁴ Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në harkun kohor prej 15 muajsh, korrik 1945 - tetor 1946, në qytetin e Prizrenin nga paria islame, me qëllim të riorganizimit të pavarur të BFI janë mbajtur dy kongrese. (Kongresi i parë korrik 1945, shih: Seit Lipa, *Kosova në periudhën e rindërtimit*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë 1982, f. 122, ndërsa Kongresi i tjetër në tetor 1946 shih: dokumentin nr. 1, AR KBK, Kutia nr. 46)

¹⁵ Gjatë periudhës 1941-1944, Bashkësia e Fesë Islame të Kosovës me dy Kryemyftinitë e saj (Kryemyftininë e Prizrenit dhe Kryemyftininë e Prishtinës) do të lidhej me Komunitetin Mysliman me qendër në Tiranë. Organizimi i saj ishte i ndarë në Kryemyftini dhe Nënmyftini.

¹⁶ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj 16 korrik deri më 23 maj 1951. f. 1.

Ndërkaq, Kryesia Islame në Prishtinë ka nisur më 1 janar 1948¹⁷.

Paria e BI-së ndër prioritet e para vendosi gjetjen e mundësive për hapjen, respektivisht rihapjen e një institucioni arsimor ku do të përgatiteshin kuadrot e reja. Për realizimin e këtij objekti prijet e BI-së ndërmorën një sërë takimesh në nivele të ndryshme, pastaj përgatitën shkresa e kërkesa të vazhdueshme, ku argumentonin së pari nevojën e pastaj edhe të drejtën për hapjen e medresesë. Kjo më së miri kuptohet nga shkresa e Kryesisë së BIK-ut, e datës 13 shkurt 1950, ku përveç tjerash thuhet: “BFI në territorin e RP të Serbisë nuk ka asnjë shkollë të ulët, të mesme dhe të lartë fetare. Qytetarët myslimanë, - thuhet më tutje në shkresë - e shohin mungesën e arsimit fetar dhe prej organeve të pushtetit popullor me padurim presin lejimin e hapjes së një shkolle fetare, si edhe mundësinë e mbajtjes së lëndës së mësim-besimit në shkollat shtetërore”¹⁸.

V.

Në këto rrethana, paria e Bashkësisë Islame e asaj kohe, e vetëdijshme për vështirësitë me të cilat përballej me pushtetin serb në rrafshin nacional e etnik dhe me atë ateist-komunist në rrafshin e rregullimit shoqëror e ideologjik në njërën anë, dhe në anën tjetër po ashtu e vetëdijshme për rëndësisë që kishte hapja e medresesë për Bashkësinë Islame dhe be-

¹⁷ Po aty f. 2.

¹⁸ Dr. Haki Kasumi, vepra e cituar më lart, f. 128.

simtarët mysliman, u angazhuan seriozisht që në kuadër të atyre pak mundësive e hapësirave ligjore të gjenin rrugën që në Kosovë të (ri) hapej një medrese. Në këtë ndërmarrje, duhet përmendur angazhimin e myderrizëve të shquar për hapjen e medresesë. Nga të dhënat e dokumenteve raporteve dhe kronikave të kohës, shihet se paria e BIK-ut çështjen e medresesë respektivisht arsimimit e kishte një ndër objektiva parësore pas konsolidimit të BIK-ut. Për këtë ndërmarrje i gjejmë të angazhuar, prijësit e BIK-ut, duke filluar nga Hfz. Bajram ef. Agani - kryetar i kryesisë së BI-së, pastaj hfz. Mutafa Canhasi (anëtar i Kryesisë BI-së)¹⁹, i cili ka qenë i angazhuar dhe i autorizuar nga Kryesia për përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e proceduarve te organet komplete të shtetit, si në nivel krahinor, ashtu edhe në nivele më të larta, për hapjen e medresesë. Kontribut të theksuar për hapjen e medresesë kanë pasuar edhe myderrizët e tjerë, siç janë hfz. Ismailhaki ef. Ustaibo, hfz. Isak Saidi, Ahmet ef. Mustafa, pastaj Hajrrullah ef. Zaimi, hfz. Fahri ef. Iljazi, Hasan ef. Nahi, Sheh Hasani, hfz. Shefki ef. Kallaba, hfz. Lutfi ef. Ahmeti, hfz. Abullah ef. Kaçapor, Mulla Rusha ef. Drekoviq etj²⁰.

Pushteti i atëhershëm monist, pas një sërë shtyrjesh e zvarritjesh pas insistimit të BI-së, Këshilli Ekzekutiv i Këshillit Krahinor për Kosovë e Metohi (siç quhej atëkohë), në

¹⁹ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj 16 korrik deri më 23 maj 1951.

²⁰ Po aty.

qershor të vitit 1949 (me vendimin nr. 29503, të datës 26. VI. 1949)²¹, jep pëlqimin e hapjes së Medresesë së Ulët në Prishtinë (e cila atëherë quhej Medreseja e Ultë Shqiptare²²).

Leja për hapjen e medresesë nga pushteti i asaj kohe Bashkësisë Islame fillimisht i qe dhënë për në qytetin e Pejës, por për shkak të mungesës së objektit, medreseja u bart në Prishtinë. Përgatitjet për hapjen e Medresesë, Kryesia e BI-së i kishte bërë gjatë vitit 1950 e me intensitet më të madh gjatë vitit 1951, kur kishte investuar në rregullimin e objekteve për Medresenë në oborrin e xhamisë “Alaudin”, pastaj kishte emëruar për drejtor mësuesin e pensionuar Ahmet ef. Mustafën²³.

Kështu, në vazhden e përgatitjeve për hapjen e Medresesë, drejtoria përmes qarkores²⁴ kishte njoftuat Këshillat Vakëfnorë (Këshillat e Bashkësisë Islame) e përmes tyre xhematin dhe të interesuarit për pranimin e nxënësve në medrese. Në qarkore ishin përcaktuar kushtet dhe dokumentacioni që duhej të plotësonin të interesuarit për t’u regjistruar në medrese.

²¹ Arkivi i Kosovës, Fondi Bashkësia e Fesë Islame, Kutia nr. 55, vitit 1951.

²² Po aty.

²³ Ahmet ef. Musatafa (1980-1990), drejtor i medresesë është emëruar më 17 qershor 1951. Është drejtori i parë i Medresesë (Shih: Raport mbi punën e Kryesisë së Fesë Islame të RP të Serbisë në Prishtinë, në periudhën prej 15 majit deri më 23 shtator 1951, Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22., fq. 6.

²⁴ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport mbi punën e Kryesisë së Fesë Islame të RP të Serbisë në Prishtinë, në periudhën prej 15 maj deri më 23 shtator 1951.

Kryesia e BI-së, respektivisht Drejtoria e Medresesë, kishte paraparë që mësimi në medrese të fillonte më 1 shtator 1951, por për shkaqe objektive mësimi filloi më 1 nëntor 1951²⁵.

Nga raporti i Drejtorisë së Medresesë për Kryesinë e BI-së, shihet se hapjen e Medresesë popullata e Kosovës dhe ajo e Sanxhakut e kishin mirëpritur. Kjo nënkuptohet nga fakti se në konkursin e hapur nga Medreseja ishin paraqitur 122 kandidatë²⁶ për të ndjekur mësimet aty, ndërsa ishin pranuar 50 prej tyre, duke marrë parasysh suksesin, moshën dhe rajonin nga vinin. Nga numri i nxënësve të pranuar 29 ishin nga Kosova, ndërsa 21 nga Sanxhaku²⁷.

Hapja e Medresesë në Prishtinë ka edhe një rëndësi të veçantë për popullatën shqiptare dhe jo vetëm në Kosovë, por kudo që jetonte ajo, qoftë në kuadër të ish-Jugosllavisë Federative, në Diasporë apo në Shqipërinë komuniste, për faktin se ishte e vetmja vatër në të cilën mësimi për fenë islame mbahej në gjuhën shqipe dhe ishte pikërisht medreseja ajo që përgatiti kuadrin për Bashkësinë Islame në Kosovë, Maqedoni, Sanxhak, Mal të Zi e gjetiu. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se Medreseja e nisi punën e saj në rrethana të rënduara politike për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi, si dhe në kohën kur po instaloheshin ideologjia moniste në Shqipëri e cila më vonë, më saktë më 1967, me ligj ndaloi besimin, hapja e Medresesë në Prishtinë merr rol dhe rëndësi jetike sidomos për

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

besimtarët myslimanë shqiptarë. Themë këtë ngase kemi parasysh faktin se suksesi i kësaj medreseje hapi udhë për mbarëvajtjen e jetës fetare në terren dhe më vonë hapjen dhe themelimin e institucioneve të tjera në kuadër të BI-së.

Medreseja e Prishtinës ishte shkolla e dytë fetare islame në ish-Jugosllavi, pasi Medreseja e Gazi Husrev Begut në Sarajevë i kishte shpëtuar mbylljes nga ish-sistemi.

E thamë edhe më parë se Medreseja praktikisht e nis misionin e saj më 1 nëntor 1951 dhe këtë në dy objekte që edhe më herët kishin shërbyer si shkolla në oborrin e Xhamisë “Alaudin”, në lagjen Alaudin, prej nga më vonë e mori edhe emrin edhe Medreseja.

Si medrese e ulët veçoi plot 10 vjet - deri më 1962, kur ngrihet në rangun e medresesë së mesme me sistem mësimi 5-vjeçar.

Lejimi i themelimit të medresesë, e për më tepër funksionalizimi i saj, ishte një e arritur e madhe e parisë myslimane, e realizuar në kohë e ditë të vështira për popullin shqiptar, arsimin shqip dhe Kosovën në përgjithësi. Mirëpo, me këtë u arritën disa objektiva që do të jenë derterminues për të ardhmen e BI-së jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Me këtë rast duhet përmendur se me funksionalizimin e medresesë, apo rihapjen e saj, përveçse u arrit një e drejtë themelore - e drejta për arsimim, për më tepër u ruajt vazhdimësia e medreseve historike e shekullore. Kjo u arrit përmes myderrizëve të shquar të cilët u angazhuan për gjetjen e mundësive për hapjen e medresesë, ndërsa, pasi pushteti dha miratimin, iu përveshën punës për funksionalizimin e medresesë duke

bartur përvojën, traditën dhe dijen që kishin nga medresetë e mëhershme.

Kështu, që në hapjen e medresesë më 1951, në procesin mësimor u angazhua vetë kryetari i Kryesisë së BI të Kosovës, myderriz Bajram ef. Agani²⁸ (nga Medreseja e Madhe e Gjakovës), i cili së bashku me myderriz Isak ef. Saidin²⁹ (nga Medreseja e Pirinazit-Prishtinë) morën përsipër ligjërimin e lëndëve fetare. Më pas në medrese në procesin mësimor e gjejmë edhe Ismailhaki Ustaibon³⁰ (nga Medreseja Mehmet Pasha-Prizren), hfz. Muharrem Adilin³¹ (Medreseja Pirinazit), pastaj Myderriz Rushit Osmanin³² (Medreseja e Pirinazit), Hasan ef. Nahi³³ (Medreseja e Madhe e Gjakovës), H.

²⁸ Myderriz Bajram Agani (1881-1962), kryetar i Kryesisë së BI të Kosovës (1947-1951); drejtor i Medresesë (1953-1956); Në Medresenë e Ulët ka ligjëruar lëndët: gjuhë arabe, gjuhë turke, akad, ahlak.

²⁹ Hfz. Ishak ef. Saidi (1897-?), myderriz i njohur i ish-medresesë “Pirinaz” të Prishtinës, në Medrese e Ulët ka mbajtur lëndën e Kuranit.

³⁰ Hfz. Ismailhaki Ustaibo (1921-1983), kryetar i Kryesisë së BI të Kosovës (1963-1983); drejtor i Medresesë (1960-1966), në Medrese ka mbajtur lëndën e Kuranit.

³¹ Hfz. Muharrem Adili (Ramadani), (1919-2013), pedagog në medrese, ka mbajtur lëndën e Kuranit, gjuhës arabe, gjuhës turke, histori islame.

³² Myderriz Rushit Osmani (1913-1991), drejtor i Medresesë së Mesme (1964-1968), në medrese ka mbajtur lëndën e Fikhut dhe ahlakut.

³³ Myderriz Hasan Nahi (1905-1991), i përket brezit të fundit të myderrizëve klasikë. Në Medrese e merrte nga fillimi klasën e tij nga viti i parë deri në të pestën, ku edhe ligjëronte lëndët bazike të fesë. Gjeneratat që ka përgatitur Hasan ef. Nahi njihen si gjenerata të Myderriz Hasan ef. Nahit. Gjatë punës së tij në Medrese ka përgatitur tri gjenerata.

Sherif Ahmeti³⁴ (Medreseja e Pirinazit) dhe Myderriz Sadri Prestreshi³⁵ (Medreseja e Pirinazit, përkatësisht e Sulltan Selimit - Prishtinë).

Këta myderrizë paraqesin lidhjen ndërmjet medreseve të mëhershme me medresenë së re, por tani të reformuar dhe duke iu përgjigjur kërkesave të kohës.

Kontributi i tyre për medresenë, përveç mësimdhënies, është edhe në përgatitjen e dispensave për lëndët që i mbanin, ku duhet përmendur kontributin e Myderriz Sherif Ahmetit (për lëndën e akaidit) e Myderriz Rashid Osmanit (për lëndën e fikhut) dhe myderriz Sadri ef. Prestreshit (për lëndën e ahlakut).

Falë këtij brezi të myderrizëve, Medreseja u vu në binarë të shëndoshë, rrugë të cilën e trasuan dhe e ndoqën më pastaj edhe ish-nxënësit e tyre, që u inkadruan si mësimdhënës në medrese.

Të theksojmë këtu edhe faktin se me myderrizët e sipërpërmendur, përfundon edhe epoka e artë e ixhazetlinjve mësimdhënës në medrese.

Zoti i shpërbleftë të gjithë ata për punën dhe sakrificën që kanë bërë në përhapjen e dijes dhe arsimimit e të edukimit tonë!

³⁴ Myderriz Sherif ef. Ahmeti (1929-1998), drejtor i Medresesë (1970-1983), në medrese mbajti lëndën e akaidit, historisë islame dhe filozofisë islame.

³⁵ Myderriz Sadri ef. Prestreshi (1917-2002), myderriz i njohur i Medresesë, ku mbajti lëndën e ahlakut e një kohë ka qenë edhe edukator në konvikt.

PERSONALITETE

Nuridin AHMETI

PROFILI INTELEKTUAL E KOMBËTAR I HOXHË VOKËS SË DIBRËS NË SHTYPIN E RILINDJES KOMBËTARE

*“Seid Efendi ishte Shqiptare i vertete, i stolisuar me
vetija te nalta e me urtesi, punonte me mish e me
shpirt per qellimet e shenjte”.*

(Shahin Kolonja).¹

Hyrje

Shtypi shqiptarë i periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, konkretisht disa nga drejtuesit e gazetave dhe revistave, duke u munduar t'i “qëndronin besnik” thënies së Pashko Vasës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, botuan

¹ Shahih Kolonja, “Seid Efendi Dibra”, *Drita*, Sofje, nr.33, E premte 21 vjesh-te e trete, 1903, f. 1.

artikuj edhe kundra fesë dhe prijësve tanë fetarë. Këto shkrime, institucionet tona në Tiranë i mblodhën dhe i botuan në kuadër të dy vëllimeve,² duke seleksionuar artikujt që u botuan në përkrahje të elitës intelektuale të kohës, pra krerëve tanë fetarë.

Janë me dhjetëra artikuj që u botuan në përkrahje të krerëve tanë fetarë, duke shkruar në superltaiv për kontributin e tyre shkrimor dhe kombëtar.³ Pra, këtë drejtues të shtypit të kohës, e kuptuan drejtë thënien e lartcekur të Pashko Vasës, se elementi fetarë në arrijen e synimeve kombëtare në këtë periudhë nuk duhet të jetë element ndarës, por bashkues pavarësisht bindjeve fetare. Këtë mesazh e kishin kuptuar një pjesë e konsiderueshme e krerëve tanë fetarë, duke vepruar në të mirë të vendit dhe popullit të tyre duke bashkërenduar aspektin shpirtëror dhe kombëtar. Kjo bëri që një pjesë e drejtuesve të gazetave të kohës, pavarësisht bindjeve fetare të tyre, të shkruajnë me shumë admirim për disa nga krerët tanë fetarë.

Në mesin e atyre prijësve fetarë islam për të cilin u shkrua me shumë respekt në shtypin shqiptarë të kohës, ishte edhe personaliteti që ne e kemi marrë në trajtim, pra Said

² *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Vëll. I (1879-1908), UT-IHGJ, (Përgatiti: Zihni Haskaj), Tiranë, 1971, f. 305-329; *Mendimi politiko-shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Vëll. II (1908-1910), ASHRPSH-IH, (Përgatiti: Zihni Haskaj), Tiranë, 1976, f. 495-552.

³ Nuridin Ahmeti, “Feja dhe prijësit fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare sipas gazetës “Shkupi” (1911-1912)”, *Takvim*, nr. 46, BIK, Prishtinë, 2015, f. 271 - 287.

Najdeni, ose siç njihet Hoxhë Voka i Dibrës,⁴ i cili ka lënë gjurmë në Rilindjen Kombëtare Shqiptare.

Personaliteti i Said Najdenit-Hoxhë Voka i Dibrës në optikën e rilindësve shqiptarë

Njëri nga personalitet tona shpirtërore, që me kontributin e tij edhe kombëtar u bë i dashur dhe i afër i rilindësve tonë, promotor i arsimit shqip në mesin ku jetoj dhe veproj, për-krahës i alfabetit të shqipes me shkronja latine, etj., ishte edhe Said Najdeni apo i njohur ndryshe edhe si Hoxhë Voka i Dibrës.

U quajt si Hoxhë Voka i Dibrës, siç duket edhe për t'u dalluar në emërtim nga bashkëkohësi, kolegu e bashkëemëndimtari i tij, Hoxhë Voka i Tetovës. Në disa raste ka ndodhur që këto dy personalitet të njohura të Rilindjes edhe të identifikohet si një person, ndërkaq dihet se këta ishin dy personalitete të njohura të Rilindjes tonë kombëtare. Për Said Najdenin apo për Hoxhë Vokën, në shtypin tonë është shkruar mjaftë, ndërsa pas viteve të '90-ta, ka pasur edhe disa kon-

⁴ “**Said Najdeni(Hoxhë Voka 1864-1903)**. Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, Mësues i Popullit. Lindi në fshatin Perlep të Dibrës së Madhe. Studimet e larta i përfundoi në Stamboll, në Medresenë e Fatihut. Pas çeljes së Mësonjëtores së Parë Shqipe të Korçës, hapi fshehtas, shkollën e parë shqipe të Dibrës së Madhe (1888). Për shkak të veprimtarisë atdhetare u arrestua dhe dënua me 15 muaj burg në Stamboll. Në v. 1900 botoi në Sofje librin “Fe-Rrëfenjëseja e myslimanëve”, “Abetare e gjuhës shqipe, ndë të folë gegë-nish”(1900)”. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* 3, ASHSH, Tiranë, 2009, f. 1807.

tribute shkencore. Kohët e fundit, ka pasur përkushtime edhe më të mëdha për ndriçimin e jetës dhe veprës së tij.⁵

Për këtë arsye, ne dëshirojmë që t'i qasemi jetës dhe veprës së tij, nga një vështrim tjetër, pa u thelluar në të dhëna që tanimë janë potencuar nga studiuesit tanë.

Çështjen e këtij personaliteti, nga këndi i të tjerëve për Hoxhë Vokën e Dibrës, studiuesi M. Hysa e potencon në një pjesë të studimit të tij.⁶

Ne jemi ndalur, vetëm në vështrimin e njërit prej artikujve që u shkrua më rastin e vdekjes së tij. Është fjala për shkrimin e publicistit tonë të njohur të Rilindjes, Shahin Kolonja të botuar në vitin 1903.

Ka disa arsyeje, pse ne kemi menduar t'i bëjmë një vështrim të tillë këtij personaliteti:

E para- janë shkrimet e pakta apo nuk ka fare që trajtojnë krerët fetarë nga prizmi i rilindësve tanë dhe në veçanti nga punimi që ne po i bëjmë vështrim.

E dyta- nuk na ka renë të shohim shumë shkrime të shkruara nga rilindësit tanë për ndonjë prijës fetarë islam siç është rasti me Hoxhë Vokën e Dibrës.

E treta- studiuesit tanë, kanë bërë disa vështrime mbi gazetën “Drita”,⁷ por çuditërisht askund nuk cekët ky artikull, edhe pse i shkruar me mjaftë përkushtim nga

⁵ Mahmud Hysa, *Studime 6*, ITKSHSH, Shkup, 2013, f. 15-203.

⁶ *Po aty*, f. 111-117.

⁷ Liman Rushiti, “Problemët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në gazetën “Drita”, të Sofjes”, *Kosova*, nr. 3, IH, Prishtinë, 1974, f. 241-257.

Sh. Kolonja.⁸ Këtu, bënë përjashtim shkrimi i Y. Bylykbashit, i cili nuk bënë vështrim të kësaj gazete, por vetëm e prezanton këtë gazetë më përmbajtjen e titujve në aspektin kronologjik, d.m.th., për secilin numër përmend edhe titujt e artikujve në forme tabelore, në këtë aspekt e përmend edhe titullin e artikullit të cilin ne e kemi në shqyrtim.⁹

Sigurisht, se parulla të cilën e proklamuan rilindësit tanë se “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, kishte më shumë mesazh uniteti në mes të popullit shqiptarë pa dallime fetare, dhe kjo nuk nënkupton mos bashkëpunimin e rilindësve tanë me prijësit fetarë të kohës. Përkundrazi, ata si në rastin e shkrimit për Hoxhë Vokën dëshmojnë se kanë bashkërenduar punët me ta, pothuajse në të gjitha rastet vendimtare për fatin e popullit shqiptarë.

Drejtuesi i gazetës “Drita” e cila dilte në Sofje të Bullgarisë më 1903 në nr. 33, me rastin e vdekjes së Seid Efendi Dibra siç e quante ai, shkruan artikullin më mjaftë pikëllim. Vdekjen e njeriut, me të cilin bashkëpunoj e quante si trishtim e hidhërim shumë të madhe. Ndërsa, për nga përkushtimi në aspektin kombëtar të Hoxhë Vokës së Dibrës, e vlerësonte si një shqiptar të vërtet, i pajisur me cilësi, vetëdije të lartë,

⁸ Emin Pllana, “Shahin Kolonja dhe gazeta e tij “Drita”, *Vjetari*, nr. VIII-IX, AK, Prishtinë, 1975, f. 37-55.

⁹ Ymer Bylykbashi, “Nga fondi i periodikut të Arkivit të Kosovës gazeta e përdyjavshme “Drita” e Sofjes”, *Vjetari*, nr. XVI-XVII, AK, Prishtinë, 1983, f. 162.

urtësi, njëri që punonte me mish e më shpirt për atdheun e tij e me përkushtim.

Takimin me këtë njeri, publicisti Sh. Kolonja e kujton në shkrim si një djalë 26 vjeç që kishte ardhur në Stamboll së bashku me një shok të tij, djalë i hollë, me mjekër e mustaqe të rralla, i pashëndetshëm, kishin studiuar nëpër medresetë e Fatihut në Stamboll, ishin liridashës e mendje të re, më një fjalë pamja dhe sjellja e tyre kishte lenë përshtypje të një rilindësi siç ishte Sh. Kolonja.

Si të pa përshtatshëm për regjimin xhonturk, Hoxhë Vokë Dibra dhe shoku i tij ishin burgosur në Stamboll, për këtë gjë ishte në dijen edhe Sh. Kolonja, i cili siç shkruan në nekrologun e tij, kishte bërë përpjeke që t'i nxirrte nga burgu, përmes një njeriu që shërbente në organet e rendit të atëhershme dhe i cili ishte me origjinë nga Shkodra, por nuk kishte pasur sukses. Ndërsa, siç shprehet Sh. Kolonja, i ka vizituar kohë pas kohe dhe u ka dërguar libra në gjuhën shqipe në burg, derisa pas pesë muajve ishte liruar nga burgu, ndërsa shoku tij pas 5 viteve.

Por, me daljen nga burgu, Sh. Kolonja, potenconte se Hoxhë Voka i Dibrës, kishte marr në një grumbull libra në gjuhën shqipe dhe ishte kthyer në Manastir, për ta përhapur gjuhën shqipe, ishte kthyer në vendlindje dhe beri përpjekje për hapjen edhe të një shkolle në gjuhën shqipe. Por, mbasi i kishin mbetur studimet pa përfunduar, Hoxhë Voka i Dibrës kthehet në Stamboll, i përfundon studimet, pa e ndalur aktivitetin e tij në avancimin e çështjes shqiptare, shkroi librin "Ferrefenjes", me udhëzime bazë për fenë islame, një libër i mirë sipas Sh. Kolonjës. Pas një kohe të qëndrimit në Stam-

boll, Hoxhë Voka i Dibrës, kthehet në Dibër dhe në gjithë hapësirën shqiptare, sipas Sh. Kolonjës nuk ndalet së vepruari në të mirë të avancimit të drejtave shqiptare të kohës. U ndoq në çdo hap nga regjimi xhon-turk, por ai edhe pse në varfëri dhe pa të ardhura të mira materiale, nuk u ndal asnjëherë së vepruari- shkruante Sh. Kolonja. Por, në fund të këtij shkrimi, shihet se autori i shkrimit e çmonte dijen e Hoxhë Vokë i Dibrës, dhe e vlerësonte si njëri që kishte të gjitha cilësitë e mira të njeriut në këtë botë.

Duke shfletuar, shkrimi për Hoxhë Vokën i Dibrës, lexuesi e sheh, se nga pena e Sh. Kolonjës dalin epitetet më të mira, që mund t'i thotë një bashkatdhetarë, për një bashkëveprimtar të tij.

Shkrimi fillon, duke e vlerësuar me epitete, por gjithmonë në kontekstin kombëtar si: “Shqiptari vërtet”, “me vetëdije të lartë”, “i urtë”, “punonte me mish e me shpirt”, “punëmbarë”, “atdhetarë” dhe e përfundon po me epitete që lartësojnë figurën edhe më shumë të Hoxhë Vokës së Dibrës, si: “Punë mbari”, “shpirtë ndrituri”, zemër bardhi”, “shpirtë miri”, “fjalë bukuri”, etj.

Ky shkrim, apo nekrolog, tregon qartë, dhimbjen që ka ndjerë jo vetëm Sh. Kolonja, por edhe bashkëveprimtarët tjerë, të cilët dhimbjen e tyre e kanë shprehur përmes penës së tyre në gazetat tjera shqipe të kohës.

Veprimtaria e Hoxhë Vokë Dibrës dhe bashkëpunimi me bashkëmendimtarët dhe bashkëkombësit tjerë, mbetet një panoramë e mirë për ne sot, sikurse edhe ky shkrim, që duhet të jetë një model, se si duhet trajtuar, të paktën pas vdekjes, një bashkëveprimtar, çoftë ai edhe me përgatitje teologjike.

Shkrimin mendojmë ta sjellim në tërsinë e tij, ndoshta do të jetë më e mirë për lexuesin që dëshirojnë t'i qasen në një formë tjetër.

“Seid Efendi Dibra -Me te madh trishtim e me shume hidhrim muarme vesh vdekjen e Seid Efendi Dibranit. I ndjyri Seid Efendi ishte Shqiptare i vertete, i stolisuar me vetija te nalta e me urtesi, punonte me mish e me shpirt per qellimet e shenjte. Nuk e dime mire ku e si mbaroj jeten ky punembare e i dashur memdhetare qe na la ne helm e ne vajtim; u be shume kohe qe s’kishim se si te çkembenim letra, nga frik e se malkuares Turqi!

Jane afro 10 vjet qe kisha njohur mire te lavduarin Dibran. Kur qesh n’Adrianopoje kishte ardhur atje bashke me nje hoxhe Shqiptar nga Kosova; ategere Seidi ishte nja 26 vjeç, djal, i hole, me mjeker e me mustaqe te paka e te rala, e si i pashndetshim; tjetri nja 40 vjeç. Te dy ishin sefte, kishin ndenjor e mesuar arabisht teologjine neper medresete e Fatihut ne Stambol, kurine fantiket e tru-ndryshkurit e temrruar; po keta te dy e kishin kupetuar udhen e vertet edhe ishin liri-dashes e me menjdje te re, po qene perzerje me disa tyrq te rinje edhe shkonin pas programit te genjeshtert te xon turqet.

Me shkak te ramazanit kishin ardhur qe te predikonin pas zakonit te shoktevet dhe te benin propaganda e shok per xon turqit. Ato dite q’u ndodhe n’Adrianopoje benin fjale me kuxim kundre pamundesive te guvernes; per te shkuar muajin e Ramazanit kishin vajtur ne nje katund afer qytetit. Si shkuan 3-4 dite erdh kryepolici me dis ate tjere e rethuan shkollen, gjimnaze, ku qesh edhe une mesonjetor per matematik e per fizik, po s’getne gje; mua me ndodheshin disa

shkrime te demçim po i pasha dhe qendrova me ngak te ftohet, me gjithë kete me dinin që kisha mendime te shqiptarta e jo xhonturkta; nga ky shaka mua s'me trazuan. Erdhi nje mik ne shkollet e me tha që kishin zene nja 30-40 veta si xon turq edhe vete Sultani ka thirur valine e o bene fjale me teligraf. Vajta që te kuptonja se si që kjo pune; e mora vesh që puna që e vertet edhe Seid Efendine me shokun e vete i kishin sjelle e mbyllir ne burg. S'kisha se sit e piqsha me ta, se s'linin njeri t'u aferohej e te bente fjale me keta. Atehere n'Adrianopoje kumandare i xandermanse ishte Edip pasha që ka qene vali ne Shkoder e ne Manastir e tashti e dergojne andej ketej ku behen trazime e kryengrtje, me te cilin qesh njohur mire edhe kisha miqesi; nga ky shaka me shkonte fjala neper oficeret e xandermase; vajta u poqa me ta ku ishin mbylluar edhe nja 15 oficere e te tjere per kete pune. U kishte dal i pa bese nje oficer tyrk e kishte hequr nje teligraf ne Jeldiz-Qoshk edhe s'andejme dhane urdher çpejt që te meren masa te repta; oficeri tradhetor kaperxeu dy a tri shkalle me njehere, mori edhe te hola nga Sultani e vajti ne Stamboll; tashti do te jete pasha e ne Jildiz. Te pafajshmit Seid effendi s'I kishin zene nonje shkrim te demçim edhe si ndenji nja 5 muej i mbyllur mezi shpetoj., po shoku i ti bashke me te tjeret mbetne ne burg dy vjet e ca; po miqt e ti kishin hequr teligraf nga Mitrovica ne Stamboll edhe keshtu e leshuan. Ne burg vinja e piqesha me ta denduar; u kisha dhene shume libra shqip; edhe nja dy tyrq q'ishin te burgosur bashke me keta kishin mesuar shkronjat edhe shkruanin turqisht me shkronja shqip. Ato dite që dote delte Seid Efendiu nga burgu, mua me kishin derguar ne Fymylxine

direktor; posa doli nga burgu erdi atje e ndenji ca dite; e kishte marr vesh mire per se e si ishte nevoje te punonte. Mori nje tok libra shqip shkoj ne Manastir ku u poq me disa memdhetare edhe vajti ne Dibre qe te perhapte libra e mendimet e me shume t'u epte te kuptonin kryelidhurve qe te mesonin shqip e te perpiqeshin per kete qellim. Kishte bere pune te mire edhe perpiqej qe te hapte nje shkoll ne Dibre, po frika e guvernes edhe kallzimet e disa tradhetorve e ndalonin. I kishin mbetur edhe edhe nja dy vjet qe te merrte leje (Ixazet) si hoxhe i mbaruar edhe keshtu t'i shkonte fjala me mire neper kryelidhur e te bente pune per qellimin qe kishte. U kthye ne Stamboll edhe i mbaroj mesimet e ndryshkur te medreses; po edhe ne Stamboll s'pushoj se punuaeri e se beri propaganda shpirt-ndrituri Dibran. Shkroj nje libre te vogel (Ferrefenjes) per besimet e per punerat e nevojshme te fese muhamedane; kjo libre u shtyp dhe gjendet ketu. Nga Stambolli vajti prap ne Shqiperi per kete qelim; ne Dibre, ne Shkup, ne Mitrovice e gjetk perhapi mendime te pelqyer e beri pune te mire, po govern e filiqur e kishte marr vesh edhe e ndiqte si Firauni Musane; edhe qe ku i shtypne koken sit e gjarperit midis Dibre ati kepucgrysuri me roba t'arta te Sul-tanit, nuk e shkonte dot kudo, se kishte urdher nga Stambolli qe ta zinin e ta benin syrgjyn. Per fate te keq, ishte edhe i pas-hendetshim e i varfer; shkonte me skamje e me shterngim te madh, po kure s'kerkonte e i duronte te gjitha me trimeri e me shpres! Pune-mbari, shpirt-ndrituri, Seid effendi ishte zemer-bardh, shpirt-mire, fjale-bukur e me te gjitha vetijat te pelqyera e te lavderuara ne kete jete. Kishte mesuar shume mire teologjine(ulum-i-dinije), gjuhen arabishte e turqisht,

Said Hoxhën-siç e quante kjo revistë. Sikurse edhe gazeta “Drita”, edhe shkruesit në “Kalendar Kombiar” do të shkruajnë me epitete të çmuara si. “ Shqiptari me zemre e ment”, “njeri i matur”, “ me vetije te mire” etj. Po që se shikohet ky shkrim i publikuar në këtë revistë në rreshta duken pak, por shikuar në aspektin përmbajtjesor, shkrimi fletë mjaftë. **“Said Hoxa.** Ne funt te motit 1903 vdiq ne Dibre shqiptari me zemre e me ment Said Hoxha. Saidi ish nga Dibra, kish mbaruare medresen’ e fatihut ne Stamboll. Kur ish ne medrese shkroj nje libre shqip q’u shtyp ne Sofje me mere Ferrefenjesa e Myslimanevet, dhe shënuare Hoxe Voka. Si mbaroj medresene Saidi vete ne Dibre ku përpqesh per te përhapure mesimin dhe mendimin kombiar, sikundre bente kur ishdhe ne Stamboll. Ish njeri i matur, me vetije te mire dhe do t’i kish ber’ akoma shume shërbime kombit sikur te kish rojtuar’ akoma; kur vdiq do t’ish nja 30 e 35 vjeç”.¹¹

Said Hoxa. Ne funt te motit 1903 vdiq ne Dibre Shqiptari me zemre e me ment Said Hoxa. Saidi is nga Dibra, kis mbaruare medresen’ e Fatihut ne Stamboll. Kur is ne medrese skroj ne libre shqip q’u etyp ne Sofje me emre Ferrefenjeseja e Myslimanevet, dhe senuare Hoxe Voka. Si mbaroj medresene Saidi vate ne Dibre ku perpiqesh per te perhapure mesimin dhe mendimin kombiar, sikundre bente kur is dhe ne Stamboll. Is njeri i mature, me vetije te mire dhe do t’i kis ber’ akoma sume serbime kombit sikur te kis rojtuar’ akoma; kur vdiq do t’is nga 30 a 35 vjeç.

(“Said Hoxa”, *Kalendar kombiar*, Sofje, 1905)

¹¹ “Said Hoxa”, *Kalendar kombiar*, Sofje, 1905, f. 29.

Përfundim

Duke shfletuar shkrimet e shtypit të Rilindjes Kombëtare që u shkruan për këtë personalitet mund të konstatojmë se Hoxhë Voka i Dibrës ishte nga ata krerë fetarë mysliman shqiptarë që në mes privilegjit të kohës dhe lavdisë kombëtare, ky e kishte zgjedhur këtë të dytën edhe pse kishte të gjitha mundësit si një njeri i përgatitur ta jetonte jetën duke shfrytëzuar privilegjet e kohës. Rruga të cilën ky e zgjodhi, sigurisht se kishte koston më të shtrenjtë që ky e pagoi edhe fizikisht dhe psikikisht, por kjo ishte vetëdija e këtij njeriu që e zgjodhi me plotë dëshirë në moshën më të mirë.

Po që se do t'i referohemi të dhënave biografike dhe asaj që u shkruajtë më lartë për të se ky njeri jetoi afër 40 vjeç, atëherë na rezulton se është ndër personalitetet e rralla shpirtërore e kombëtare të kombit tonë, që jetoj një jetë relativisht të shkurtër, por që më bëmat e tij, la gjurmë në historinë tonë, këtë mendim tonin e dëshmojnë edhe dy shkrimet që në i kemi trajtuar më lartë dhe që u shkruan për këtë njeri.

Duke e njohur nga afër profilin e tij intelektual dhe shpirtëror, bashkëkohësit e tij kishin krijuar bindjen, se ky njëri po të jetonte edhe më shumë, do t'i jepte akoma atdheut të tij dhe popullit tij. Për këtë, në njërin nga shkrimet që e potencuam edhe më lartë, në fjalinë e fundit, të shkruar për këtë figurë shpirtërore e kombëtare shkruante *“do t'i kish ber akoma shume shërbime kombit sikur te kish rojtuar’ akoma”*.

Mexhid YVEJSI

IMAMI VEHBI ISMAILI (1919-2008) (Përkujtimit - në 100-vjetorin e lindjes)

Kush ishte Imam Vehbi Ismaili?

Imam Vehbi Ismaili ishte një figurë e ndritur fetare, një figurë e shquar kombëtare, një shembull për botën shqiptare...

Lindi në Shkodër me 25 Nëntor 1919, nga prindër shkodranë, prej një familjeje me tradita fetare-atdhetare.

Mësimet e para i filloi në Shkodër, kurse i përfundoi në Krujë, ku i ati, Myderriz Ismail Hakiu, filloi të shërbente si Myfti i Krujës.



Imam Vehbi Ismaili

Në vitin 1933 u regjistruë në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës, ku diplomoi në vitin 1937.

Vazhdoi studimet në Universitetin zëmadh “Al-Az-har” në Kairo, Egjipt, në të cilin diplomoi në teologji në vitin 1943.

Prej Shoqërisë Myslimane Shqiptare-Amerikane, me qendër në Detroit, Michigan, SHBA, u ftue në Amerikë për të shërbye si imam...

Imam Vehbi Ismaili vajti në New York më 22 Prill 1949, ku u pritë me gëzim dhe shumë dashamirësi prej shqiptarëve të Amerikës: z. Ahmet Ramo, z. Hysen Kole nga Detroit-i, z. Nuri Mborja, z. Vejsel Çami nga New Yorku e shumë të tjerë.

U martue më 27 Maj 1950 me zonjushën 18-vjeçare, Naxhije Braushi, e lindur në Philadelphia më 26 Maj 1932, nga prindër shqiptar, z. Azmi K.Braush, me prejardhje nga fshati Dobronik i Beratit.

Imam Vehbiu menjëherë filloi me shërbye me devotshmëri, me dituri, me urtësi, kështu që, për pak kohë, arriti t’i afroj shqiptarët e shpërndarë, që ishin larguar nga Atdheu për shkaqe politike, ekonomike, kështu që falë angazhimit të tij arriti me përkushtim t’i bashkojë, t’i udhëzojë, t’i frymëzojë bashkatdhetarët e mërguar dhe filloi t’i ushqejë me ndjenja fetare- kombëtare...

Si fryt i kësaj veprimtarie, Imam Vehbi Ismaili me 6 Qershor 1951, në Amerikë, e themeloj Xhaminë e parë për myslimanët shqiptarë...

Meqë shqiptarët u bashkuan, besimtarët u shtuan, u detyruan të ndërtojnë një Xhami të Re, më të madhe, e cila u

shndërrua në Qendër Islame Shqiptare-Amerikane, e cila u përrurue, me 23 Shkurt 1963, ku i madh e i vogël u gëzua...

Qendra Islame Shqiptare-Amerikane, në Harper Woods, Detroit, në shtetin Michigan, SHBA, nën udhëheqjen e Imam Vehbi Ismailit, u rrit, u zhvillue, dritë rrezatonte, shqiptarët i bashkonte, fëmijtë i edukonte, me ndjenja fetare dhe atdhetare i frymëzonte... Besimtarët aty gjenin prehje, qetësi, më mirë se në shtëpi, madje disa thoshnin me gëzim, me mallëngjim:” Kjo është Shqipëria e vogël në mërgim...” “

Imam Vehbi Ismaili në Kosovë (1974)

Me gjithë këtë veprimtari në kontinuitet e në vazhdimësi, edhe Imam Vehbi ishte njeri, si njeriu që pikëllohet, dëshpërohet, përmallohet...

Shtypi shqiptar në Amerikë, në veçanti gazeta “Dielli”, e Bostonit, sidomos në vitet e para, e fyente, e akuzonte, e mallkonte Imam Vehbiun, sikur që bënte edhe propaganda komuniste në Shqipëri...

Një ditë e gjeta shumë të dëshpruar, tepër të përmalluar dhe e pyeta, pa u vonuar: Imam Vehbi, nuk po të them qysh je, por çka t’mirën ke?

- Ah! Mexhid i dashtun, malli për Shkodër, për Shqipni, m’ka djeg, m’ka shkrumue... shumë jam përmallue... Dje, më njoftuen dhe shumë jam dëshpëruar se kërkesa për Shqipni m’u ka refuzue...

Ndoshta është ma hajr që komunistët të ndalojnë, sepse kështu edhe më shumë atdhetarët të nderojnë...”e ngushëllova” dhe e përqafova dhe vazhdova duke i thënë:

Imam Vehbi, meqë ke nënshtetësi amerikane, provoni me shkua në Kosovë, sado kudo, përmallimi për Shqipni, për Shkodër, do të zvogëlohet, sepse edhe Kosova, nën robëri, nën Serbi, me një grimcë autonomi, është Shqipni...

- Ashtu është, por s'kam të njohur atje-më tha.

- Shko në Gjakovë,- i thashë, në shtëpi te baba im, Hafiz Selim Yvejsi, në qendër të Gjakovës dhe nga aty të çelen dyert e krejt Kosovës.

- Më përqafoi dhe pas disa dite udhëtoi.

Në Gjakovë qëndroi disa ditë, të cilat i kujtonte shpesh dhe ishte kënaqur shumë me ylematë e Gjakovës, si Myderizin Hafiz Fahri Efendi Iljazi, Myderiz Tahir Efendi Thaçi, Haxhi Jahja Bakalli, Mulla Sadik Brovina, Hafiz Selim Yvejsi, i cili e kishte shoqërua tërë kohën në Gjakovë dhe nëpër Kosovë...

Shpesh thoshte: “Gjakova, Kosova, m’ka freskue, m’ka përtri, t’punojmë n’dashtë Zoti e t’bashkohet me Shqipni...”

I përkushtuar ndaj fjalës së shkruar

Imam Vehbi Ismaili ka qenë dhe do të mbetet shembull i fetarit, atdhetarit dhe dijetarit të përkushtuar, në veçanti ndaj fjalës së shkruar...

Qysh si nxënës, kur ishte në Medresenë e Tiranës, 1933-1937, shkruante, përkthente dhe botonte punime në revistën “Zani i Naltë” dhe në të përjavshmen “Vatra e Rinisë” që asokohe botoheshin në Tiranë...

Shkruante, botonte edhe në Kairo, Egjipt, gjatë studimeve, madje aty botoi edhe dy libra: “Djepi i artë”, novela të zgjedhura nga letërsia shqiptare, që e botoi, me 1948, Shtëpia

Botuese “Bejan Al-Arabi” dhe librin: “Ngjyra tërheqëse”, një përmbledhje tregimesh nga letërsia shqiptare.

Në Amerikë, sa kishte ardhur, filloi me botua në Detroit revistën: “Jeta Myslimane Shqiptare” (The Albanian Moslem Life”), shqip dhe anglisht, Organ’ i Shoqërisë Myslimane Shqiptare”, numri i parë doli në dritë në muajin tetor, 1949 dhe kishte 72 faqe...

Më vonë nxori revistën “Thirrja Islame”.

Fjala e shkruar Imam Vehbi Ismailin e ka përjetësuar...

E ka përjetësuar jo vetëm në Amerikë, jo vetëm në publicistikë, por kudo që ka shqiptarë, kudo që ka besimtarë...

Imam Vehbi Ismaili, në Amerikë, që nga viti 1960 dhe deri sa ndërroi jetë, ka shkrua, ka përkthye, ka botuar, ribotuar mbi 50 libra fetare- letrare, të cilat janë përkthye në rreth njëzet e pesë (25) gjuhë të ndryshme.

Disa prej veprave të botuara në Amerikë:

“Islamizmi dhe lutjet”,

“Muhamedi profeti islam”, ky libër është ribotuar edhe në Prishtinë nga Bashkësia Islame e Kosovës,

“Një tufë lulësh-tregime nga historia islame”

“Fjalë të profetit, Muhamedit a.s. - 150 hadithe”,

“Kërkuesi i së vërtetës-Selman Farisi”,

“Bilalli, myezin i profetit”,

“Kujtime të rinisë”,

“Muhamedi, profeti i fundit”, ky libër u përkthye në tetë gjuhë të tjera, në Perëndim dhe në Lindje dhe mësohet në disa shtete si tekst shkollor-mësimor,

“Banorët e Shpellës”, përkthim nga gjuha arabe, të cilin e ribotoi “Rilindja” e Prishtinës

MERHUMËT TANË

NË NDERIM TË MR. MUHIDIN EF. AHMETIT (1962-2018)

I.

Muaj më parë, saktësisht më datën 05.06.2018 u nda nga kjo botë dhe kaloi në të amshueshmen, hoxha, studiuesi, bashkëpunëtori dhe miku ynë i vyeshëm, Mr. Muhidin efendi Ahmeti.

Muhidin Ahmeti u lind më 1962 në fshatin Zaplluxhe të Opojës, nga i ati Mulla Xhavit ef. Ahmeti dhe e ëma Fetija. Shkollën fillore e kreu në vendlindjen (1969-1977), Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë (1977-1982), Fakultetin Teologjik Islam në Sarajevë (1982-1986), kurse studimet postdiplomike i kreu në Kajro (2002-2004).

Me të përfunduar studimet në Sarajevë, u kthye në Prizren dhe u emërua imam, hatib dhe mualim në Xhaminë “Sinan Katib”, në të cilën shërbeu gjatë viteve 1988-1992. Në këtë periudhë, filloi edhe veprimtarinë shkrimore, duke u bërë një nga penat e reja premtuese në fushën e islamologjisë.

Rrethanat e reja shoqërore-politike të krijuara në fund të viteve '80 dhe në fillim të '90, nuk mund ta linin indiferent Muhidin efendiun, prandaj e ngriti zërin e tij kundërshtues dhe u radhit në radhën e atyre mbrojtësve të vatanit, në radhët e atyre që dinë ta mbrojnë atdheun e tyre sa me laps po aq dhe me kundërshtim dhe jo nënshtrim. Kjo, natyrisht, nuk mbeti pa u rënë në sy organeve të pushtetit okupues, prandaj e detyruan Mr. Muhidin efendiun që në vitin 1993 të shpërngulej në Shqipëri, për t'u vendosur fillimisht në Lezhë e më pastaj në Shkodër. Sikurse në çdo sprovë në të cilën fshihen urtësi, por të cilat rob i di, edhe më këtë rast kjo u dëshmua katërçipërisht. Në Shqipërinë e viteve të kthesave të mëdha, e viteve delikate, kritike e të vështira, ndihma, kontributi dhe misioni human, pedagogjik dhe fetar i Mr. Muhidin efendiut ishte më se i nevojshëm. Në Shkodër Muhidin efendiut emërohet menjëherë mësimdhënës, pedagog dhe kryetar i komisionit të lëndëve fetare në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia". Krahas kësaj, mbante ligjërata dhe predikime në xhamitë kryesore të Shkodrës me rrethinë, si në Xhaminë Ebu Bekër, në Xhaminë e Tophanes - Perash, në Xhaminë e Plumbit, në xhaminë e Bushati, në Boks dhe në shumë fshatra të tjera të rrethit të Postribës. Përgatitja morale dhe intelektuale shumë shpejtë i bënë vend Muhidin efendiut në pozitën e ligjëruesit shkencor dhe fetar në Qendrën Kulturore "Daut Boriçi" po në Shkodër. Gjatë kësaj kohe ai edhe themeloi Klubin Kulturor "Drita" dhe u emërua drejtor i saj. Në kuadër të këtij Klubi themeloi, botoi dhe drejtoi edhe gazetën "Drita e Dijes", e cila për vite të tëra e pa dritën e botimit në Shkodër dhe u bë një zë i fuqishëm në përhapjen e mësimave

fetare islame e kulturore. Në Shkodër u shqua edhe për kurset me studentë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, për ligjëratat nëpër tribuna dhe për debatet në medie, ku vlerësohej për thellësinë e mendimit, elokuencën dhe trajtimin e çështjeve aktuale dhe bashkëkohore, me se fitoi respektin e elitës intelektuale dhe zemrat e shkodranëve.

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, Mr. Muhidin efendiu në Shkodër mori pjesë me kumtesa në sesione shkencore, dhe natyrisht vazhdoi punën e tij në fushën e botimit të shkrimeve të tija.

Pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, Mr. Muhidin ef. së bashku me familjen e tij kthehet në Prizren për të vazhduar misionin e tij aty ku e kishte lënë kur u detyrua të largohej për në Shqipëri. Në këtë rast bëri një sërë aktivitetesh dhe veprimtarish të ndryshme fetare dhe kulturore.

Në vitin 2006, Mr. Muhidin efendiu shkoi në Wels të Austrisë, ku emërohet imam në xhaminë “Mesxhid Err- Rresul”, të cilës përpos ligjëratave, predikimeve dhe këshillave të tija do t’ia linte trashëgimi dhe Qendrën Islame Kulturore, e cila u themelua falë urtësisë dhe mençurisë së Muhidin efendiut. Përveç kësaj, Mr. Muhidin efendiu ishte edhe Kryetar i Unionit të Shqiptarëve Myslimanë, respektivisht Kryeimam të ALKIG-ut (DAMO), dhe Anëtar i Bashkësisë Islame të Austrisë - Dega Linz, si dhe mësimdhënës në Shkollat e Mesme Publike në Linz dhe në Wels.

Muhidin efendiu fliste dhe shkruante rrjedhshëm gjuhën boshnjake, gjuhën arabe, gjuhën gjermane dhe në një shkallë të kënaqshme zotëronte edhe gjuhën turke.

II.

Muhidin efendiun e kam njohur, kam përcjellë sukseset dhe punën e tij dhe e kam vlerësuar këtu e dyzet vjet më parë, pra saktësisht që nga viti 1978 kur e kam parë për herë të parë dhe deri në ditët kur ai u nda fizikisht nga ne. Dhe këtë njohje, do ta ndaja kryesisht tri faza kryesore: Muhidinin si nxënës, Muhidinin si studentë dhe Muhidin efendiun si koleg dhe bashkëpunëtor.

Kur erdhi Muhidini në Medrese, unë isha pedagog, pra ndaj dhe pesë vite janë të mjaftueshme për të njohur një nxënës dhe për të dhënë vlerësime për të. Muhidinin si nxënës të Medresesë e kujtoj për energjinë, zellin dhe gjallërinë e tij të theksuar dhe e cila e shquante nga shokët e tjerë të klasës. Ishte, si të thuash, më i burrëruar dhe më i vendosur se të tjerët. Ndryshe edhe nuk mund të ishte, sepse në këtë kishte ndikuar sigurisht rrethi i tij familjar dhe vendi nga vinte. Ishte këmbëngulës në kërkesat e tij, ishte dhe temperament, e mbase pakës edhe kokëfortë dhe me një sedër të ndjeshme. Në mësim ishte i shkëlqyeshëm, kurse sjelljet gjithmonë i kishte shembullore. Në sytë e tij dallohej dëshira për mësim dhe për t'u bërë hoxhë.

Pas mbarimit me sukses të shkëlqyeshëm të Medresesë, Muhidini, sikurse pritej, studimet i vazhdoi në Sarajevë në Fakultetin Teologjik Islam. Shtëpinë e parë nuk e harroi, përkundrazi, sa here vinte në vendlindje, studenti ynë Muhidin efendiu, ndalej në Prishtinë, për të na takuar dhe për t'i ndërruar ca muhabete me ne. Nga Sarajeva për Muhidinin vinin lajme të mira dhe vetëm të mira, dhe kjo ishte kuptueshme dhe nuk mund të ndodhte ndryshe. Kënaqesha dhe shpirti më

bëhej mal kur kolegët e mi boshnjakë dhe pedagogë të Muhidinit më flisnin fjalë miradije për të dhe për sukseset e tij. E po, nuk ka ndjenjë më të mirë dhe më të lumtur se sa kur të tjerët të flasin mirë për një person të cilin e njeh, ia njeh familjen, rrethin, dhe për më tepër ta kesh pasur edhe nxënës tëndin. Kjo është edhe merita më e madhe që një ish-nxënës a studentë ia jep mësuesit të tij; ky është shpërblimi më i madh që t'i dilet borxhit. Këto vlerësime të pedagogëve të tij, mua sa vinin e ma shtonin respektin dhe vlerësimin për Muhidin, të cilin e shihja duke u formuar e rritur si hoxhë dhe si intelektual.

Pas studimeve, Muhidin efendiu, sikurse u tha, u emërua imam, hatib dhe mualim në Prizren dhe, nga kjo kohë, edhe filloi veprimtarinë e tij në fushën e shkrimeve, duke u bërë kështu edhe një nga kolegët dhe bashkëpunëtorët tanë më të vyeshëm.

E kur dallgët e jetës e “gjuajtën” në Shkodër, aty ku dha një kontribut shumë të madh, në veçanti në ngritjen e vetëdijes fetare pas një periudhe të gjatë komuniste, nga atje më vinin fjalë miradije e lëvdata për Muhidin efendin dhe kontributin e tij. Lumturohesha pa masë, jo vetëm për ato që i dëgjoja atëherë, por edhe sot kur takoj shkodranët më flasin në superlativ dhe ruajnë kujtimet dhe përzgjedhin fjalët më të mira për Muhidin efendin, familjen, punën dhe veprimtarinë e tij.

Gjatë një vizite pune në Shkodër që kisha, pashmangshëm shkova edhe në konakun e Muhidin efendit në të cilin qe vendosur përkohësisht. Meqë kishte goxha një kohë që nuk ishim parë, takimi ynë ishte shumë i ngrohtë dhe vëllazë-

ror. Revokuam shumë kujtime, duke filluar që nga takimi ynë i parë në Medrese e deri te veprimtaria e tij në Shkodër dhe rrethanat e përgjithshme shoqërore e politike në Kosovë e Shqipëri. Muhidin efendiu ka qenë edhe një ndër bashkëpunëtorët më të frytshëm dhe për një kohë të gjatë i yni në revistën “Takvimi”. Temat të cilat ai i ka prekur gjithnjë kanë qenë aktuale dhe interesante, sepse gjithmonë kanë zgjuar kërshërinë e lexuesve, prandaj dhe kanë zënë vend të veçantë në faqet e “Takvimit”.

III.

Mr. Muhidin ef. Ahmeti sikurse e thamë, që herët ka filluar të merrej me shkrime, të cilat nuk i la deri në ditët e fundit të jetës së tij. Ai i përket brezit të tretë të atyre autorëve që kanë shkruar dhe botuar në fushën e islamologjisë në gjuhën shqipe në Kosovë. Ky është një dimension tjetër i veprimtarisë së Mr. Muhidin efendiut, dhe në këtë drejtim, themi me plotë bindje, se ka lënë kontribute të çmueshme dhe me vlerë. Kësaj, sigurisht, i ka ndihmuar njohja e disa gjuhëve dhe përgatitja intelektuale që nga familja në Opojë e Prizren, pastaj jeta në qendrat kryesore të shkollimit dhe të qëndrimit të tij: Prishtina, Sarajeva, Kajroja, Shkodra dhe së fundmi edhe përvoja tjetër në Austri.

Gama e interesimeve dhe studimeve të Mr. Muhidin efendiut është mjaftë e gjerë dhe shumë dimensionale, por për aq sa e njoh veprimtarinë shkrimore të tij, i jap të drejtë vetës të konstatoj se tri kanë qenë fushat kryesore për të cilat ka shkruar ai: *familja, rinia, shoqëria*.

Ata të cilët do të shkruajnë për Mr. Muhidin efendiun dhe do të merren me vlerësimin e veprimtarisë së tij shkencore në të ardhmen, nuk do ta kenë të lehtë t'i mbledhin të gjitha shkrimet që ai ka botuar. Themi kështu, sepse Muhidin efendi ka botuar disa monografi autoriale dhe në përkthim dhe ka botuar edhe shumë artikuj në shtypin islam gjithandej në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni etj.. Ai, me sa jemi në dijeni, ka lënë edhe disa vepra në dorëshkrim, të cilat një ditë sigurisht që duhet të shohin dritën e botimit, sikurse që jeta dhe vepra e Mr. Muhidin efendiut meriton të trajtohet dhe të vlerësohet edhe në një sesion shkencor.

Ne po i përmendim vetëm disa nga veprat/monografite, qoftë autoriale, qoftë të përkthyera nga Mr. Muhidin efendi, pa pretenduar se do t'i përfshijmë të gjitha:

1. Dr. Mustafa Mahmud, *Dialog me mikun ateist*, (bashkëpërkthyes), Prizren, 1990.
2. Muhamed Ikbali, *Poezi të zgjedhura*, Prizren, 1990.
3. Hasan Çengiç, *Temat islame*, Shkup, 1991.
4. *Të rinjtë dhe droga*, Gjilan, 1995.
5. *Përmbledhje ligjërataresh fetare*, Shkodër, 1996.
6. *Rreth përhapjes së Islamit të shqiptarët* (përmbledhje studimesh nga grup autorësh, përktheu dhe përgatiti), Shkodër, 1997
7. *Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës*, (përkthim nga boshnjakishtja), Shkodër, 1998.
8. *Këshilla islame*, Prizren, 2000
9. *Bazat e pedagogjisë kuranore*, Prizren, 2002
10. *Mësimet e Kur'anit*, Prizren, 2003
11. *Agjërimi i Ramazanit*, Prizren, 2003

12. *Shteti islam*, Prizren, 2004
13. *Të jetosh në islam (Hutbe të zgjedhura)*, Wels/Austri, 2006
14. *Sfidat e rinisë bashkëkohore në kohën e globalizmit* (autoriale), Wels/Austri, 2008
15. *Martesa islame* (autoriale), Wels/Austri, 2010
16. *Mevludi në gjuhën shqipe*, Wels/Austri, 2010

Kurse vetëm në revistën “Takvimi/Kalendar”, Mr. Muhidin efendiu ka botuar gjithsej 15 kontribute, 10 shkrime autoriale dhe 5 përkthime, duke u bërë kështu një nga bashkëpunëtorët më të vyeshëm dhe më besnikë të “Takvimit/Kalendarit”. Me shpresën se do t’u ndihmojmë të gjithë atyre që në të ardhmen do të shkruajnë për Mr. Muhidin efendiu dhe kontributin e tij shkrimor, në vazhdim po japim listën e plotë të zërave të tij të botuar në “Takvim/Kalendar”. Po e bëjmë këtë edhe për një arsye tjetër, le të shërbejë kjo edhe një si mirënjohje dhe falënderim për bashkëpunëtorin tonë të çmuar dhe shumë vjeçar, mungesa e penës së të cilit me siguri ka për t’u ndier në faqet e “Takvimit/Kalendarit” në veçanti dhe të literaturës islame në gjuhën shqipe në përgjithësi. Mirëpo, caktimeve të Zotit ne u themi vetëm Amin, kurse për ata që na kanë paraprirë për në botën tjetër, e lusim Zotin që t’i shpërblejë me Xhenetin Firdevs!

Ja dhe lista e zërave të botuar në “Takvim/Kalendar” nga Mr. Muhidin ef. Ahmeti:

Shkrime autoriale:

- *Selami - përshëndetje paqësore*, “Takvim/Kalendar”, 1413-14/1993, f. 58-67.
- *Agjërimi i Ramazanit*, “Takvim/Kalendar” 1417-18/1997, f.49-65.
- *Bota në fillim të mileiumit të ri*, “Takvim/Kalendar”, 1423-24/2003, f. 145-166.
- *Qëllimi dhe kuptimi i fesë-besimit*, “Takvim/Kalendar”, 1424-45/2004, f. 67-80.
- *Vlera e së humburës ndërmjet së kaluarës, mësimi dhe porosisë*, “Takvim/Kalendar”, 1426-27/2006, f. 43-60.
- *E drejta e jetës edhe në shkollë*, “Takvim/Kalendar”, 1428-1430/2008, f. 211-224.
- *Balsami i rinisë*, “Takvim/Kalendar”, 1430-31/2009, f. 169-202.
- *Drita e besimit dhe e Mevludit*, “Takvim/Kalendar”, 1433-34/2012, f. 179-198.
- *Fenomenologjia e festive*, “Takvim/Kalendar”, 1434-35/2013, f. 121-140.
- *Martesa në fenë islame*, “Takvim/Kalendar”, 1440-41/2019.

Përkthime:

- H. Husein Gjozo, *Çështja e moralit dhe gjendja e njeriut*, “Takvim/Kalendar”, 1406-1986, f. 68-81.
- Shefik Kurdiq, *Xhihadi në hadithet e Pejgamberit a.s.*, “Takvim/Kalendar”, 1408-09/1988, f. 102-132.
- Hasan Çengiç, *Veshja në fenë islame*, “Takvim/Kalendar”, 1411-12/1992, f. 112-140.
- Tomas W. Arnold, *Përhapja e islamizmit në Shqipëri*, “Takvim/Kalendar”, 1416-17/1996, f. 125-145.
- Hasan Çengiç, *Prostitucioni është rrugë e shëmtuar*, “Takvim/Kalendar”, 1421-22/2001, f. 132-147.



TAKVIM
1440-1441
KALENDAR
2019

JANAR I / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e martë	24	Viti i Ri 2019, Rebiul-Ahir 1440 V.H.
2	e mërkurë	25	
3	e enjte	26	
4	e premte	27	
5	e shtunë	28	e Xhuma
6	e diel	29	
V - Xhumadel-Ula 1440 V.H.			
7	e hënë	1	Hëna e re
8	e martë	2	
9	e mërkurë	3	
10	e enjte	4	
11	e premte	5	e Xhuma
12	e shtunë	6	
13	e diel	7	
14	e hënë	8	
15	e martë	9	
16	e mërkurë	10	
17	e enjte	11	
18	e premte	12	e Xhuma
19	e shtunë	13	
20	e diel	14	Hëna e plotë
21	e hënë	15	
22	e martë	16	
23	e mërkurë	17	
24	e enjte	18	
25	e premte	19	e Xhuma
26	e shtunë	20	
27	e diel	21	
28	e hënë	22	
29	e martë	23	
30	e mërkurë	24	
31	e enjte	25	Hamsini

JANAR I / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jada	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e martë	5:21	7:03	11:44	14:05	16:21	18:00	9:18
2	e mërkurë	21	03	45	06	21	18:00	19
3	e enjte	20	02	45	06	22	18:00	20
4	e premte	20	02	45	06	23	18:01	21
5	e shtunë	5:20	7:02	11:45	14:07	16:24	18:02	9:22
6	e diel	5:20	7:02	11:46	14:08	16:25	18:03	9:23
V - Xhumadel-Ula 1440 V.H.								
7	e hënë	5:20	7:01	11:46	14:08	16:26	18:04	9:25
8	e martë	20	01	46	09	27	05	26
9	e mërkurë	20	01	47	10	28	06	27
10	e enjte	19	7:00	47	11	29	07	29
11	e premte	5:19	7:00	11:47	14:12	16:30	18:08	9:30
12	e shtunë	19	7:00	48	13	31	09	31
13	e diel	19	7:00	48	14	33	10	33
14	e hënë	19	7:00	49	15	34	11	34
15	e martë	19	7:00	50	16	35	12	35
16	e mërkurë	19	6:59	50	17	36	13	37
17	e enjte	18	59	50	18	37	14	38
18	e premte	5:18	6:59	11:51	14:19	16:39	18:15	9:40
19	e shtunë	18	58	51	20	40	16	42
20	e diel	18	58	52	21	41	17	43
21	e hënë	17	57	52	22	42	18	45
22	e martë	17	56	52	23	44	19	48
23	e mërkurë	17	55	52	24	45	20	50
24	e enjte	16	54	53	25	46	21	52
25	e premte	5:15	6:53	11:53	14:26	16:47	18:22	9:54
26	e shtunë	14	52	53	27	49	23	57
27	e diel	14	51	54	29	50	24	59
28	e hënë	13	50	54	30	51	25	10:01
29	e martë	12	49	54	31	53	27	04
30	e mërkurë	12	48	54	32	54	28	06
31	e enjte	5:11	6:47	11:54	14:33	16:55	18:29	10:08

SHKURT II / 2019

Data sipas kal., botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e premte	26	Xhumadel-Ula 1440 V.H., e xhuma
2	e shtunë	27	
3	e diel	28	
4	e hënë	29	
5	e martë	30	
VI - Xhumadel-Uhra 1440 V.H.			
6	e mërkurë	1	Hëna e re
7	e enjte	2	
8	e premte	3	e Xhuma
9	e shtunë	4	
10	e diel	5	
11	e hënë	6	
12	e martë	7	
13	e mërkurë	8	
14	e enjte	9	
15	e premte	10	e Xhuma
16	e shtunë	11	
17	e diel	12	Dita e Pavarësisë
18	e hënë	13	
19	e martë	14	Xhemra I në ajër, Hëna e plotë
20	e mërkurë	15	
21	e enjte	16	
22	e premte	17	e Xhuma
23	e shtunë	18	
24	e diel	19	
25	e hënë	20	Xhemra II në ujë
26	e martë	21	
27	e mërkurë	22	
28	e enjte	23	

SHKURT II / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e premte	5:10	6:46	11:54	14:34	16:57	18:30	10:11
2	e shtunë	09	45	54	35	58	31	13
3	e diel	08	44	54	36	16:59	32	15
4	e hënë	07	43	54	37	17:00	33	17
5	e martë	5:06	6:42	11:54	14:38	17:02	18:34	10:20
VI - Xhumadel-Uhra 1440 V.H.								
6	e mërkurë	5:05	6:41	11:54	14:39	17:03	18:35	10:22
7	e enjte	03	39	54	40	04	36	25
8	e premte	5:02	6:38	11:54	14:41	17:05	18:37	10:27
9	e shtunë	5:01	37	54	42	07	39	30
10	e diel	4:59	36	54	43	08	40	32
11	e hënë	58	35	54	44	10	42	35
12	e martë	57	33	54	45	11	43	38
13	e mërkurë	56	32	54	46	13	45	41
14	e enjte	55	31	55	48	14	46	44
15	e premte	4:54	6:29	11:55	14:49	17:16	18:48	10:47
16	e shtunë	53	28	55	50	17	49	49
17	e diel	51	27	55	51	18	50	51
18	e hënë	50	25	54	51	19	51	54
19	e martë	49	23	54	52	21	52	10:58
20	e mërkurë	48	22	54	53	22	53	11:00
21	e enjte	46	20	54	54	23	54	11:03
22	e premte	4:44	6:18	11:54	14:55	17:25	18:56	11:07
23	e shtunë	43	17	54	56	26	57	10
24	e diel	41	15	53	57	27	58	12
25	e hënë	40	13	53	57	28	58	15
26	e martë	39	11	52	58	29	18:59	18
27	e mërkurë	37	08	51	58	30	19:00	22
28	e enjte	4:35	6:05	11:51	14:59	17:32	19:02	11:27

MARS III / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e premte	24	Xhumadel-Uhra 1440 V.H., e xhuma
2	e shtunë	25	
3	e diel	26	
4	e hënë	27	
5	e martë	28	Xhemra III në tokë
6	e mërkurë	29	
7	e enjte	30	Nata e Regaibit
VII - Rexheb 1440 V.H.			
8	e premte	1	e Xhuma, Hëna e re
9	e shtunë	2	
10	e diel	3	
11	e hënë	4	
12	e martë	5	
13	e mërkurë	6	
14	e enjte	7	
15	e premte	8	e Xhuma
16	e shtunë	9	
17	e diel	10	
18	e hënë	11	
19	e martë	12	
20	e mërkurë	13	
21	e enjte	14	Hëna e plotë, Pranvera
22	e premte	15	e Xhuma
23	e shtunë	16	
24	e diel	17	
25	e hënë	18	
26	e martë	19	
27	e mërkurë	20	
28	e enjte	21	
29	e premte	22	e Xhuma
30	e shtunë	23	
31	e diel	24	Llogaritja e kohës verore +1 orë

MARS III / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e premte	4:34	6:04	11:51	14:59	17:33	19:03	11:29
2	e shtunë	33	03	50	15:00	34	05	31
3	e diel	31	02	50	15:01	36	07	34
4	e hënë	29	6:01	50	02	37	08	36
5	e martë	27	6:00	50	02	38	09	38
6	e mërkurë	25	5:58	50	03	39	10	41
7	e enjte	4:23	5:56	11:50	15:03	17:40	19:11	11:44
VII - Rexheb 1440 V.H.								
8	e premte	4:21	5:55	11:50	15:04	17:42	19:13	11:47
9	e shtunë	20	53	50	05	43	14	50
10	e diel	18	51	50	06	44	15	53
11	e hënë	16	49	50	06	45	16	11:56
12	e martë	15	47	49	07	47	18	12:00
13	e mërkurë	14	46	49	08	48	19	12:02
14	e enjte	13	44	49	08	49	20	05
15	e premte	4:11	5:42	11:49	15:08	17:50	19:21	12:08
16	e shtunë	09	40	49	08	51	22	11
17	e diel	08	38	48	09	52	23	14
18	e hënë	06	36	48	09	53	25	17
19	e martë	04	35	48	10	55	26	20
20	e mërkurë	02	33	48	11	56	27	23
21	e enjte	4:00	31	48	12	57	28	26
22	e premte	3:57	5:29	11:47	15:12	17:58	19:30	12:29
23	e shtunë	55	27	47	13	17:59	31	32
24	e diel	53	25	46	13	18:00	32	35
25	e hënë	51	24	45	14	18:02	34	38
26	e martë	49	22	45	15	03	35	41
27	e mërkurë	46	20	45	15	04	36	44
28	e enjte	44	18	45	16	05	37	47
29	e premte	3:41	5:16	11:44	15:16	18:06	19:38	12:50
30	e shtunë	3:39	5:14	11:44	15:17	18:07	19:40	53
31	e diel	4:37	6:13	12:43	16:17	19:08	20:41	12:55

PRILL IV / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e hënë	25	Rexheb 1440 V.H.
2	e martë	26	Nata e Miraxhit
3	e mërkurë	27	
4	e enjte	28	
5	e premte	29	e Xhuma
VIII - Sha'ban 1440 V.H.			
6	e shtunë	1	Hëna e re
7	e diel	2	
8	e hënë	3	
9	e martë	4	
10	e mërkurë	5	
11	e enjte	6	
12	e premte	7	e Xhuma
13	e shtunë	8	
14	e diel	9	
15	e hënë	10	
16	e martë	11	
17	e mërkurë	12	
18	e enjte	13	
19	e premte	14	e Xhuma, Nata e Beratit, Hëna e plotë
20	e shtunë	15	
21	e diel	16	
22	e hënë	17	
23	e martë	18	
24	e mërkurë	19	
25	e enjte	20	
26	e premte	21	e Xhuma
27	e shtunë	22	
28	e diel	23	
29	e hënë	24	
30	e martë	25	

PRILL IV / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e hënë	4:35	6:11	12:43	16:17	19:09	20:42	12:58
2	e martë	34	09	43	18	10	44	13:01
3	e mërkurë	32	07	42	18	12	46	04
4	e enjte	31	06	42	19	13	47	07
5	e premte	4:29	6:04	12:42	16:19	19:14	20:48	13:10
VIII - Sha'ban 1440 V.H.								
6	e shtunë	4:27	6:02	12:42	16:20	19:15	20:50	13:13
7	e diel	25	6:01	41	20	16	51	15
8	e hënë	22	5:59	41	20	17	52	18
9	e martë	20	57	40	21	18	54	21
10	e mërkurë	18	56	40	21	20	56	24
11	e enjte	16	54	40	22	21	57	27
12	e premte	4:14	5:52	12:40	16:22	19:22	20:58	13:30
13	e shtunë	12	51	39	22	23	21:00	32
14	e diel	10	49	39	22	24	21:01	35
15	e hënë	08	48	39	22	25	02	37
16	e martë	06	46	38	22	26	03	40
17	e mërkurë	05	44	38	22	27	05	43
18	e enjte	03	42	38	22	28	06	46
19	e premte	4:01	5:40	12:37	16:22	19:29	21:08	13:49
20	e shtunë	3:59	39	37	23	31	10	52
21	e diel	57	38	37	24	32	12	54
22	e hënë	55	36	37	24	33	13	57
23	e martë	52	35	37	25	34	15	13:59
24	e mërkurë	50	33	36	25	35	17	14:02
25	e enjte	47	31	36	25	36	18	05
26	e premte	3:45	5:30	12:36	16:26	19:37	21:20	14:07
27	e shtunë	43	29	36	26	38	22	09
28	e diel	41	28	36	27	40	24	12
29	e hënë	39	27	36	28	41	25	14
30	e martë	3:37	5:26	12:36	16:29	19:42	21:27	14:16

MAJ V / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e mërkurë	26	Shaban 1440 V.H., Festa e punës
2	e enjte	27	
3	e premte	28	e Xhuma
4	e shtunë	29	
5	e diel	30	Nata e Ramazanit
IX - Ramazan 1440 V.H.			
6	e hënë	1	Dita e parë e Ramazanit, Hëna e re, Shëngjergji
7	e martë	2	
8	e mërkurë	3	
9	e enjte	4	
10	e premte	5	e Xhuma
11	e shtunë	6	
12	e diel	7	
13	e hënë	8	
14	e martë	9	
15	e mërkurë	10	
16	e enjte	11	
17	e premte	12	e Xhuma
18	e shtunë	13	
19	e diel	14	Hëna e plotë
20	e hënë	15	
21	e martë	16	
22	e mërkurë	17	Dita e fitorës në Bedër
23	e enjte	18	
24	e premte	19	e Xhuma
25	e shtunë	20	I'tikjafi - Dita e çlirimit të Mekës viti 630
26	e diel	21	
27	e hënë	22	
28	e martë	23	
29	e mërkurë	24	
30	e enjte	25	
31	e premte	26	e Xhuma, Nata e Kadrit*

* Dhënia e Sadekatul-fitrit, është më e pëlqyeshme të bëhet prej Natës së madhe të Kadrit e deri në mbrëmje të Natës së Bajramit.

MAJ V / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e mërkurë	3:35	5:25	12:36	16:29	19:43	21:28	14:18
2	e enjte	33	24	36	30	44	30	20
3	e premte	3:31	5:22	12:36	16:30	19:45	21:31	14:23
4	e shtunë	29	20	35	30	46	32	26
5	e diel	3:27	5:18	12:35	16:30	19:47	21:33	14:29
IX - Ramazan 1440 V.H.								
6	e hënë	3:25	5:17	12:35	16:31	19:48	21:35	14:31
7	e martë	23	15	35	31	49	36	34
8	e mërkurë	21	14	35	31	50	37	36
9	e enjte	19	13	35	31	51	38	38
10	e premte	3:17	5:12	12:35	16:31	19:52	21:40	14:40
11	e shtunë	15	10	34	31	53	41	43
12	e diel	13	09	34	32	54	43	45
13	e hënë	11	08	34	32	55	45	47
14	e martë	09	07	34	32	56	46	49
15	e mërkurë	07	06	34	32	57	48	51
16	e enjte	06	05	34	33	58	50	53
17	e premte	3:04	5:04	12:34	16:33	19:59	21:51	14:55
18	e shtunë	02	03	34	34	20:00	53	14:57
19	e diel	3:01	02	34	34	20:02	55	15:00
20	e hënë	3:00	5:01	35	35	03	57	15:02
21	e martë	2:59	5:00	35	36	04	21:58	04
22	e mërkurë	57	4:59	35	36	05	22:00	06
23	e enjte	56	58	35	36	06	22:02	08
24	e premte	2:55	4:57	12:35	16:37	20:07	22:03	15:10
25	e shtunë	54	57	35	38	08	05	11
26	e diel	52	56	35	38	08	06	12
27	e hënë	50	55	35	38	09	07	14
28	e martë	48	55	35	38	10	09	15
29	e mërkurë	47	54	35	39	11	10	17
30	e enjte	45	54	36	39	12	12	19
31	e premte	2:44	4:53	12:36	16:40	20:13	22:13	15:20

QERSHOR VI / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e shtunë	27	Ramazan 1440 V.H.
2	e diel	28	
3	e hënë	29	Nata e Fitër Bajramit
X - Shevval 1440 V.H.			
4	e martë	1	Dita e I e Fitër Bajramit, Hëna e re
5	e mërkurë	2	Dita e II e Fitër Bajramit
6	e enjte	3	Dita e III e Fitër Bajramit
7	e premte	4	e Xhuma
8	e shtunë	5	
9	e diel	6	
10	e hënë	7	
11	e martë	8	
12	e mërkurë	9	
13	e enjte	10	
14	e premte	11	e Xhuma
15	e shtunë	12	
16	e diel	13	
17	e hënë	14	Hëna e plotë
18	e martë	15	
19	e mërkurë	16	
20	e enjte	17	Dita më e gjatë e vitit: 15:35 min.
21	e premte	18	e Xhuma
22	e shtunë	19	Vera
23	e diel	20	
24	e hënë	21	
25	e martë	22	
26	e mërkurë	23	
27	e enjte	24	
28	e premte	25	e Xhuma
29	e shtunë	26	
30	e diel	27	

QERSHOR VI / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatesia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e shtunë	2:43	4:53	12:36	16:40	20:13	22:14	15:20
2	e diel	42	52	36	40	14	15	22
3	e hënë	2:41	4:52	12:36	16:40	20:15	22:16	15:23
X - Shevval 1440 V.H.								
4	e martë	2:40	4:51	12:36	16:40	20:15	22:17	15:24
5	e mërkurë	38	51	36	40	16	18	25
6	e enjte	37	50	36	40	16	19	26
7	e premte	2:36	4:50	12:36	16:40	20:17	22:20	15:27
8	e shtunë	35	49	37	40	17	21	28
9	e diel	34	49	37	40	18	22	29
10	e hënë	34	48	37	41	18	23	30
11	e martë	33	48	37	41	19	24	31
12	e mërkurë	33	48	37	41	19	24	31
13	e enjte	32	48	37	41	20	25	32
14	e premte	2:32	4:48	12:38	16:42	20:21	22:25	15:33
15	e shtunë	32	49	38	43	22	26	33
16	e diel	32	49	39	44	23	27	34
17	e hënë	32	49	39	44	23	28	34
18	e martë	32	50	40	44	24	29	34
19	e mërkurë	33	50	40	45	24	30	34
20	e enjte	33	50	40	45	25	31	35
21	e premte	2:33	4:51	12:40	16:46	20:25	22:32	15:34
22	e shtunë	33	51	41	46	25	32	34
23	e diel	33	51	41	46	25	32	34
24	e hënë	34	51	41	46	25	32	34
25	e martë	34	52	42	46	26	33	34
26	e mërkurë	35	52	43	47	26	32	34
27	e enjte	36	52	43	47	26	32	33
28	e premte	2:36	4:53	12:43	16:47	20:25	22:31	15:32
29	e shtunë	36	53	43	47	25	31	32
30	e diel	2:37	4:53	12:43	16:47	20:25	22:31	15:32

Namazi i sabahut falet në ora: 5:04 min.

Namazi i Fitër Bajramit falet në orën: 5:34 min.

KORRIK VII / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e hënë	28	Shevval 1440 V.H.
2	e martë	29	
3	e mërkurë	30	
XI - Dhul-Ka'de 1440 V.H.			
4	e enjte	1	Hëna e re
5	e premte	2	e Xhuma
6	e shtunë	3	
7	e diel	4	
8	e hënë	5	
9	e martë	6	
10	e mërkurë	7	
11	e enjte	8	
12	e premte	9	e Xhuma
13	e shtunë	10	
14	e diel	11	
15	e hënë	12	
16	e martë	13	
17	e mërkurë	14	Hëna e plotë
18	e enjte	15	
19	e premte	16	e Xhuma
20	e shtunë	17	
21	e diel	18	
22	e hënë	19	
23	e martë	20	
24	e mërkurë	21	
25	e enjte	22	
26	e premte	23	e Xhuma
27	e shtunë	24	
28	e diel	25	
29	e hënë	26	
30	e martë	27	
31	e mërkurë	28	

KORRIK VII / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e hënë	2:38	4:54	12:43	16:47	20:25	22:30	15:31
2	e martë	39	54	43	47	24	29	30
3	e mërkurë	2:39	4:54	12:43	16:47	20:24	22:29	15:30
XI - Dhul-Ka'de 1440 V.H.								
4	e enjte	2:40	4:55	12:43	16:47	20:24	22:28	15:29
5	e premte	2:41	4:55	12:43	16:47	20:23	22:27	15:28
6	e shtunë	42	56	43	47	23	27	27
7	e diel	43	57	43	47	23	26	26
8	e hënë	44	47	43	47	22	25	25
9	e martë	45	58	43	47	22	25	24
10	e mërkurë	47	4:59	44	47	22	24	23
11	e enjte	49	5:00	44	48	21	23	22
12	e premte	2:50	5:00	12:44	16:48	20:21	22:22	15:21
13	e shtunë	51	5:01	44	48	20	21	19
14	e diel	52	01	44	48	19	19	18
15	e hënë	53	01	44	47	18	18	17
16	e martë	55	02	44	47	18	17	16
17	e mërkurë	57	03	44	47	17	16	14
18	e enjte	2:59	04	44	47	16	14	12
19	e premte	3:00	5:05	12:44	16:46	20:16	22:13	15:11
20	e shtunë	3:02	06	44	46	15	12	09
21	e diel	04	06	44	46	14	10	08
22	e hënë	05	07	44	45	13	09	06
23	e martë	06	08	44	45	12	07	04
24	e mërkurë	08	09	44	45	11	05	15:02
25	e enjte	09	10	44	44	10	04	15:00
26	e premte	3:11	5:12	12:44	16:44	20:09	22:02	14:58
27	e shtunë	12	13	44	44	09	22:01	56
28	e diel	14	15	45	44	08	22:00	53
29	e hënë	16	16	45	44	07	21:58	51
30	e martë	18	17	45	44	06	57	49
31	e mërkurë	3:20	5:18	12:45	16:43	20:05	21:55	14:47

GUSHT VIII / 2019			
Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënimet të tjera astronomike
1	e enjte	29	Dhul-Ka'de 1440 V.H.
XII - Dhul-Hixhxhe 1440 V.H.			
2	e premte	1	e Xhuma, Hëna e re, Aligjyni
3	e shtunë	2	
4	e diel	3	
5	e hënë	4	
6	e martë	5	Gjysma e verës
7	e mërkurë	6	
8	e enjte	7	
9	e premte	8	e Xhuma
10	e shtunë	9	Nata e Kurban Bajramit*
11	e diel	10	Dita e I e K. Bajramit
12	e hënë	11	Dita e II e K. Bajramit
13	e martë	12	Dita e III e K. Bajramit
14	e mërkurë	13	Dita e IV e K. Bajramit
15	e enjte	14	Hëna e plotë
16	e premte	15	e Xhuma
17	e shtunë	16	
18	e diel	17	
19	e hënë	18	
20	e martë	19	
21	e mërkurë	20	
22	e enjte	21	
23	e premte	22	e Xhuma
24	e shtunë	23	
25	e diel	24	
26	e hënë	25	
27	e martë	26	
28	e mërkurë	27	
29	e enjte	28	
30	e premte	29	e Xhuma
- Muharrem 1441 V.H.			
31	e shtunë	1	Viti i Ri sipas Hixhretit 1441, Hëna e re

* Pas çdo farzi të namazit këndohen Tekbiret, duke filluar nga sabahu i natës së Bajramit deri me Ikindi të ditës së katërt të tij.

GUSHT VIII / 2019								
Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e enjte	3:22	5:19	12:45	16:43	20:04	21:54	14:45
XII - Dhul-Hixhxe 1440 V.H.								
2	e premte	3:24	5:20	12:45	16:43	20:03	21:52	14:43
3	e shtunë	26	21	45	42	02	50	41
4	e diel	28	23	45	42	20:01	49	38
5	e hënë	30	24	45	42	20:00	47	36
6	e martë	32	25	45	42	19:58	45	33
7	e mërkurë	33	26	45	41	57	44	31
8	e enjte	35	27	45	41	56	43	29
9	e premte	3:37	5:28	12:45	16:40	19:55	21:41	14:27
10	e shtunë	39	29	45	40	53	39	24
11	e diel	40	30	45	39	52	38	22
12	e hënë	42	31	45	39	50	36	19
13	e martë	43	32	45	38	49	34	17
14	e mërkurë	45	33	45	37	47	32	14
15	e enjte	47	34	44	36	46	30	12
16	e premte	3:49	5:35	12:44	16:35	19:44	21:28	14:09
17	e shtunë	50	36	43	34	43	26	07
18	e diel	52	37	43	33	41	24	04
19	e hënë	53	38	42	32	40	22	14:02
20	e martë	55	39	42	31	38	20	13:59
21	e mërkurë	57	40	42	30	36	17	56
22	e enjte	3:59	41	41	29	35	15	54
23	e premte	4:01	5:42	12:41	16:28	19:33	21:13	13:51
24	e shtunë	03	43	41	27	32	11	49
25	e diel	05	44	41	27	30	09	46
26	e hënë	06	45	41	26	28	07	43
27	e martë	07	46	41	25	27	05	41
28	e mërkurë	09	48	41	25	25	03	37
29	e enjte	10	49	40	24	24	21:01	35
30	e premte	4:11	5:50	12:40	16:24	19:22	20:59	13:32
I - Muharrem 1441 V.H.								
31	e shtunë	4:12	5:51	12:40	16:23	19:21	20:58	13:30

Namazi i sabahut falet në orën 5:45 min.

Namazi i Kurban Bajramit falet në orën 6:15 min.

SHTATOR IX / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e diel	2	Muharrem 1441 V.H.
2	e hënë	3	
3	e martë	4	
4	e mërkurë	5	
5	e enjte	6	
6	e premte	7	e Xhuma
7	e shtunë	8	
8	e diel	9	
9	e hënë	10	Dita e Ashureve
10	e martë	11	
11	e mërkurë	12	
12	e enjte	13	
13	e premte	14	e Xhuma, Hëna e plotë
14	e shtunë	15	
15	e diel	16	
16	e hënë	17	
17	e martë	18	
18	e mërkurë	19	
19	e enjte	20	
20	e premte	21	e Xhuma
21	e shtunë	22	
22	e diel	23	
23	e hënë	24	Vjeshta
24	e martë	25	
25	e mërkurë	26	
26	e enjte	27	
27	e premte	28	e Xhuma
28	e shtunë	29	
29	e diel	30	
II - Safer 1441 V.H.			
30	e hënë	1	Hëna e re

SHTATOR IX / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ilkindia	Akshami	Jacia	Gatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e diel	4:14	5:52	12:40	16:23	19:19	20:56	13:27
2	e hënë	16	53	40	22	18	54	25
3	e martë	18	55	40	21	16	52	21
4	e mërkurë	19	56	40	20	14	50	18
5	e enjte	20	57	39	19	12	47	15
6	e premte	4:21	5:58	12:38	16:18	19:10	20:45	13:12
7	e shtunë	23	5:59	38	17	08	43	09
8	e diel	24	6:00	37	16	07	41	07
9	e hënë	26	6:01	37	15	05	39	04
10	e martë	27	02	37	14	19:03	37	13:01
11	e mërkurë	28	03	37	12	19:01	35	12:58
12	e enjte	29	04	36	11	19:00	33	56
13	e premte	4:30	6:05	12:36	16:10	18:58	20:31	12:53
14	e shtunë	31	06	36	09	56	29	50
15	e diel	32	07	35	08	54	27	47
16	e hënë	34	08	35	07	53	25	45
17	e martë	36	09	35	06	51	23	42
18	e mërkurë	38	10	34	05	49	21	39
19	e enjte	40	11	34	03	47	19	36
20	e premte	4:41	6:12	12:33	16:02	18:45	20:17	12:33
21	e shtunë	42	13	33	16:00	44	16	31
22	e diel	44	14	33	15:59	42	14	28
23	e hënë	45	15	32	58	40	12	25
24	e martë	46	16	31	56	38	10	22
25	e mërkurë	47	17	31	55	36	08	19
26	e enjte	48	18	30	53	35	06	17
27	e premte	4:49	6:20	12:30	15:52	18:33	20:04	12:13
28	e shtunë	50	21	30	51	31	20:02	10
29	e diel	4:51	6:22	12:29	15:50	18:29	20:00	12:07
II - Safer 1441 V.H.								
30	e hënë	4:52	6:23	12:28	15:48	18:27	19:58	12:04

TETOR X / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e martë	2	Safer 1441 V.H.
2	e mërkurë	3	
3	e enjte	4	
4	e premte	5	e Xhuma
5	e shtunë	6	
6	e diel	7	
7	e hënë	8	
8	e martë	9	
9	e mërkurë	10	
10	e enjte	11	
11	e premte	12	e Xhuma
12	e shtunë	13	
13	e diel	14	Hëna e plotë
14	e hënë	15	
15	e martë	16	
16	e mërkurë	17	
17	e enjte	18	
18	e premte	19	e Xhuma
19	e shtunë	20	
20	e diel	21	
21	e hënë	22	
22	e martë	23	
23	e mërkurë	24	
24	e enjte	25	Dita e OKB-së
25	e premte	26	e Xhuma
26	e shtunë	27	
27	e diel	28	Llogaritja e kohës dimërore -1 orë
28	e hënë	29	
III - Rebiul-Evvel 1441 V.H.			
29	e martë	1	Hëna e re
30	e mërkurë	2	
31	e enjte	3	

TETOR X / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e martë	4:52	6:24	12:28	15:47	18:25	19:56	12:01
2	e mërkurë	53	25	28	46	23	54	11:58
3	e enjte	53	26	28	45	22	52	56
4	e premte	4:54	6:28	12:28	15:44	18:20	19:50	11:52
5	e shtunë	55	29	27	43	18	48	49
6	e diel	56	30	27	42	17	47	47
7	e hënë	4:58	32	27	41	16	46	44
8	e martë	5:00	33	27	41	14	44	41
9	e mërkurë	5:01	34	26	40	12	42	38
10	e enjte	03	35	26	39	11	41	36
11	e premte	5:05	6:36	12:26	15:38	18:09	19:40	11:33
12	e shtunë	06	37	26	37	08	38	31
13	e diel	08	38	26	36	06	36	28
14	e hënë	09	39	26	35	05	35	26
15	e martë	10	41	26	34	03	33	22
16	e mërkurë	11	42	25	32	18:01	31	19
17	e enjte	12	43	25	31	17:59	29	16
18	e premte	5:13	6:45	12:25	15:29	17:58	19:28	11:13
19	e shtunë	14	47	25	28	56	26	09
20	e diel	15	48	25	27	55	25	07
21	e hënë	16	50	25	26	53	23	11:03
22	e martë	17	51	25	25	51	22	11:00
23	e mërkurë	18	52	25	24	49	20	10:57
24	e enjte	19	53	24	22	48	19	55
25	e premte	5:20	6:55	12:24	15:21	17:46	19:17	10:51
26	e shtunë	5:21	6:56	12:24	15:20	17:45	19:16	49
27	e diel	4:23	5:57	11:24	14:19	16:43	18:15	46
28	e hënë	4:24	5:58	11:24	14:18	16:42	18:14	10:44
III - Rebiul-Evvël 1441 V.H.								
29	e martë	4:25	6:00	11:24	14:17	16:41	18:13	10:41
30	e mërkurë	26	6:01	24	16	39	11	38
31	e enjte	4:27	6:02	11:24	14:15	16:38	18:10	10:36

NËNTOR XI / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e premte	4	Rebiul-Evvel 1441 V.H., e xhuma
2	e shtunë	5	
3	e diel	6	
4	e hënë	7	
5	e martë	8	
6	e mërkurë	9	
7	e enjte	10	
8	e premte	11	e Xhuma, Shëmitri
9	e shtunë	12	
10	e diel	13	
11	e hënë	14	Hëna e plotë
12	e martë	15	
13	e mërkurë	16	
14	e enjte	17	
15	e premte	18	e Xhuma
16	e shtunë	19	
17	e diel	20	
18	e hënë	21	
19	e martë	22	Nata e Mevludit
20	e mërkurë	23	Ditëlindja e Muhamedit a.s. viti 571 e.r.
21	e enjte	24	
22	e premte	25	e Xhuma
23	e shtunë	26	
24	e diel	27	
25	e hënë	28	
26	e martë	29	
27	e mërkurë	30	
IV - Rebiul-Ahir 1441 V.H.			
28	e enjte	1	Hëna e re, Dita e Flamurit kombëtar
29	e premte	2	e Xhuma
30	e shtunë	3	

NËNTOR XI / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ilkindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e premte	4:28	6:04	11:24	14:14	16:36	18:08	10:32
2	e shtunë	4:29	05	24	13	35	07	30
3	e diel	30	07	24	12	34	06	27
4	e hënë	31	08	24	11	33	05	25
5	e martë	33	09	24	10	31	04	22
6	e mërkurë	34	10	24	09	30	03	20
7	e enjte	36	11	24	08	29	02	18
8	e premte	4:37	6:13	11:24	14:07	16:28	18:01	10:15
9	e shtunë	38	14	24	06	26	17:59	12
10	e diel	39	15	24	05	25	58	10
11	e hënë	40	16	24	04	24	57	08
12	e martë	41	17	24	03	23	57	06
13	e mërkurë	42	18	25	02	22	56	04
14	e enjte	43	20	25	02	21	55	10:01
15	e premte	4:44	6:22	11:25	14:01	16:20	17:54	9:58
16	e shtunë	45	24	25	14:00	20	54	56
17	e diel	47	26	26	14:00	19	53	53
18	e hënë	48	27	26	13:59	18	53	51
19	e martë	49	28	26	58	17	52	49
20	e mërkurë	50	29	26	58	16	51	47
21	e enjte	51	30	26	57	16	51	45
22	e premte	4:52	6:32	11:27	13:57	16:15	17:51	9:43
23	e shtunë	53	33	27	56	15	51	42
24	e diel	54	34	27	56	14	50	40
25	e hënë	55	35	27	55	14	50	39
26	e martë	56	37	28	55	13	49	36
27	e mërkurë	4:57	6:38	11:28	13:55	16:13	17:49	9:35
IV - Rebiul-Ahir 1441 V.H.								
28	e enjte	4:58	6:39	11:29	13:55	16:13	17:49	9:34
29	e premte	4:59	6:40	11:29	13:55	16:12	17:49	9:32
30	e shtunë	5:00	6:41	11:29	13:54	16:12	17:49	9:31

DHJETOR XII / 2019

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e diel	4	Rebiul-Ahir 1441 V.H.
2	e hënë	5	
3	e martë	6	
4	e mërkurë	7	
5	e enjte	8	
6	e premte	9	e Xhuma
7	e shtunë	10	
8	e diel	11	
9	e hënë	12	
10	e martë	13	
11	e mërkurë	14	Hëna e plotë
12	e enjte	15	
13	e premte	16	e Xhuma
14	e shtunë	17	
15	e diel	18	
16	e hënë	19	
17	e martë	20	
18	e mërkurë	21	
19	e enjte	22	
20	e premte	23	e Xhuma
21	e shtunë	24	Dita më e shkurtër e vitit, 9:14 min.
22	e diel	25	Arbaini, Dimri
23	e hënë	26	
24	e martë	27	
25	e mërkurë	28	
26	e enjte	29	
V - Xhumadel-Ula 1441 V.H.			
27	e premte	1	e Xhuma, Hëna e re
28	e shtunë	2	
29	e diel	3	
30	e hënë	4	
31	e martë	5	

DHJETOR XII / 2019

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaki	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e diel	5:01	6:42	11:30	13:54	16:12	17:49	9:30
2	e hënë	02	43	30	54	12	49	29
3	e martë	03	44	31	54	11	49	27
4	e mërkurë	04	45	31	54	11	49	26
5	e enjte	05	46	31	54	11	49	25
6	e premte	5:06	6:47	11:32	13:54	16:10	17:48	9:23
7	e shtunë	06	48	32	54	10	48	22
8	e diel	07	49	32	54	10	48	21
9	e hënë	08	50	33	54	10	48	20
10	e martë	09	51	33	54	10	48	19
11	e mërkurë	10	52	34	55	11	49	19
12	e enjte	11	53	35	56	11	49	18
13	e premte	5:12	6:54	11:35	13:56	16:11	17:50	9:17
14	e shtunë	12	54	36	56	11	50	17
15	e diel	13	55	36	56	12	51	17
16	e hënë	14	56	37	57	12	51	16
17	e martë	15	56	37	57	12	51	16
18	e mërkurë	15	57	38	58	13	52	16
19	e enjte	16	58	39	59	13	52	15
20	e premte	5:17	6:59	11:39	13:59	16:14	17:52	9:14
21	e shtunë	18	7:00	40	14:00	14	53	14
22	e diel	18	7:00	40	14:00	14	53	14
23	e hënë	18	7:00	40	14:00	15	54	15
24	e martë	19	7:01	41	14:01	16	55	15
25	e mërkurë	19	01	42	02	16	55	15
26	e enjte	5:19	7:01	11:42	14:02	16:17	17:56	9:16
V - Xhumadel-Ula 1441 V.H.								
27	e premte	5:19	7:01	11:42	14:02	16:17	17:56	9:16
28	e shtunë	19	01	42	02	18	57	17
29	e diel	20	02	43	03	19	58	17
30	e hënë	20	02	44	04	19	58	17
31	e martë	5:20	7:02	11:44	14:04	16:20	17:59	9:18

Përmbajtja

NË VEND TË PARATHËNIES.....	5
Sabri BAJGORA	
KOMENTIMI I KAPTINËS “EL-KARIATU”	11
Azmir JUSUFI	
MAHMUD SHEL TUTI DHE KOMENTIMI I TIJ I KURANIT ...	25
Musa VILA	
SHPJEGIM I NJË HADITHI TË PEJGAMBERIT A.S.	45
Resul REXHEPI	
RREGULLAT E FIKHUT PËRKITAZI ME IMAMIN, NAMAZIN ME XHEMAT DHE EZANIN	55
Jusuf ZIMERI	
MALLI- KAPITALI PËR TË CILIN JEPET ZEKAT	85
Hajrullah HOXHA	
TË GJITHË PEJGAMBERËT I THIRRËN NJERËZIT PËR BESIM NË NJË ZOT	101
Kasim GËRGURI	
ÇËSHTJA E IMANIT DHE DEFINICIONI I TIJ	123
Bahri ALIU	
BAMIRËSIA (IHSÂNI) NË ISLAM.....	149
Qazim QAZIMI	
E VËRTETA MBI SHPËRBLIMET PËR LEXIMIN E KUR'ANIT	159
Miftar AJDINI	
DISA THEKSIME TË DREJTËSISË ISLAME - trajtim gjuhësor dhe sociologjik -	193
Bajrush AHMETI	
QËNDRIMI ISLAM PËR PJESËMARRJEN E GRUAS NË PUNË TË PËRGJITHSHME.....	205

Dr. Sedat ISLAMI	
SOLIDARITETI SHOQËROR VËSHTRUAR	
SIPAS MËSIMJEVE ISLAME	219
Ejup HAZIRI	
DITURIA FORMË E EDUKIMIT,	
NGRITJES DHE AVANCIMIT	245
Ali F. ILJAZI	
STRESI NGA KËNDVËSHTRIMI I KURANIT,	
HADITHIT DHE SHKENCËS.....	273
Dr. Genti KRUJA	
BASHKËJETESA NDËRFETARE NDËR SHQIPTARË,	
SI FAKTOR STABILITETI SOCIAL	289
Prof. dr. Hysen MATOSHI	
KULTUROCIDI MBI HAPËSIRËN ETNIKE	
TË MUHAXHIRËVE SHQIPTARË	325
Dr. Sadik MEHMETI	
MEDRESETË NË KOSOVË GJATË PERIUdhËS OSMANE	
- vështrim i përgjithshëm -	341
Ramadan SHKODRA	
RRETHANAT POLITIKE PAS LUFTËS SË DYTË	
BOTËRORE NË KOSOVË DHE ROLI I MYDERRIZËVE	
NË HAPJEN E MEDRESEË.....	359
Nuridin AHMETI	
PROFILI INTELEKTUAL E KOMBËTAR I HOXHË VOKËS	
SË DIBRËS NË SHTYPIN E RILINDJES KOMBËTARE.....	375
Mexhid YVEJSI	
IMAMI VEHBI ISMAILI (1919-2008)	
(Përkujtim - në 100-vjetorin e lindjes)	389
NË NDERIM TË MR. MUHIDIN EF. AHMETIT (1962-2018).....	395
Përmbajtja	431